

Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të
Sektorit Publik

Volumi II

VOLUMI II - PËRMBAJTJA

	Faqe
SNKSP 28—Instrumentet Financiare: Paraqitja	717
SNKSP 29—Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja	746
SNKSP 30—Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjegues	771
SNKSP 31—Aktivet Afatgjatë Jo Materiale.....	830
SNKSP 32—Marrëveshjet Konçesionare të Shërbimit: Grantdhënësi	873
SNKSP 33—Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas të Drejtave dhe Detyrimeve të Konstatuara	888
SNKSP 34—Pasqyrat Financiare të Veçanta.....	937
SNKSP 35—Pasqyrat Financiare të Konsoliduara	950
SNKSP 36—Investimet në Pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta	976
SNKSP 37—Marrëveshjet e Përbashkëta	998
SNKSP 38—Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në lidhje me Interesat në Njësitë e Tjera.....	1013

SNKSP 28—INSTRUMENTET FINANCIARE: PARAQITJA**Shënime të Mirënjohjes**

Ky Standard Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) është hartuar kryesisht nga Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit (SNK) 32, *Instrumentet Financiare: Paraqitja* dhe Interpretimi 2 i Komitetit të Interpretimeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (KINRF 2), *Aksionet e Anëtarëve në Njësitë Ko-operative dhe Instrumente të Ngjashme* të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Ekstrakte nga SNK 32 dhe KINRF 2 janë riprodhuar në këtë publikim të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) me lejen e Fondacionit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Teksti i aprovuar i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) është ai i publikuar nga BSNK në gjuhën angleze dhe kopjet mund të merren direkt nga IFRS Foundation, Costumer Service, Columbus Building, 7 Westferry Circus, Canary Wharf, London E14 4HD, United Kingdom.

E-mail: publications@ifrs.org

Internet: www.ifrs.org

Të drejtat e autorit për SNRF-të, SNK-të, Draftet e Paraqitura dhe publikime të tjera të BSNK-së i përkasin Fondacionit SNRF.

"SNRF", "SNK", "BSNK", "Fondacioni SNRF", "Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit" dhe "Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar" janë marka tregtare të Fondacionit SNRF dhe nuk duhet të përdoren pa aprovimin e Fondacionit SNRF.

SNKSP 28—INSTRUMENTET FINANCIARE: PARAQITJA

Historia e SNKSP

Ky version përfshin ndryshime që rezultojnë nga SNKSP-të e botuara deri në 31 janar, 2019.

SNKSP 28, *Instrumentet Financiare: Paraqitja* u publikua në janar 2010.

Që atëherë, SNKSP 28 është ndryshuar nga SNKSP-të e mëposhtme:

- SNKSP 42, *Përfitimet Sociale* (botuar në janar 2019)
- SNKSP 41, *Instrumentet Financiare* (botuar në gusht 2018)
- SNKSP 39, *Përfitimet e Punonjësve* (botuar në korrik 2016)
- *Zbatueshmëria e SNKSP-ve* (botuar në prill 2016)
- SNKSP 37, *Marrëveshjet e Përbashkëta* (botuar në janar 2015)
- SNKSP 35, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara* (botuar janar 2015)
- SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik* (SNKSP) sipas të Drejtave dhe Detyrimeve të Konstatuara (botuar në janar 2015)
- *Përmirësime të SNKSP-ve 2014* (botuar në janar 2015)
- *Përmirësime të SNKSP-ve 2011* (botuar tetor 2011)

Tabela e Paragrafëve të Ndryshuar në SNKSP 28

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
Seksioni i parathënies	U Fshi	Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2011
2	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
3	U Ndryshua	SNKSP 35 Janar 2015 SNKSP 37 Janar 2015 SNKSP 39 Korrik 2016

INSTRUMENTET FINANCIARE: PARAQITJA

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
		SNKSP 41 Gusht 2018
4	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
7	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
8	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
9	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
10	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
14	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
28	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
36	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
40	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP- ve Janar 2015
40A	I Ri	Përmirësime të SNKSP- ve Janar 2015
42	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP- ve Janar 2015
44	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP- ve Janar 2015
47	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018

INSTRUMENTET FINANCIARE: PARAQITJA

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
48	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
56	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
57	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
58	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
60A	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Janar 2015
60B	I Ri	SNKSP 33 Janar 2015
60C	I Ri	SNKSP 37 Janar 2015 SNKSP 35 Janar 2015
60D	I Ri	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
60E	I Ri	SNKSP 39 Korrik 2016
60F	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
60G	I Ri	SNKSP 42 Janar 2019
61	U Ndryshua	SNKSP 33 Janar 2015
AG2	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
AG23	U Ndryshua	SNKSP 42 Janar 2019
AG53	U Ndryshua	SNKSP 35 Janar 2015

INSTRUMENTET FINANCIARE: PARAQITJA

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
AG55	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
AG63	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit AG63A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG63A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG63B	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG63C	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG63D	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit AG63E	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG63E	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG63F	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
B19	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
B21	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
IE1	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
IE5	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018

**SNKSP 28—INSTRUMENTET FINANCIARE:
PARAQITJA
PËRMBAJTJA**

	Paragrafi
Objektivi	1–2
Objekti	3–8
Përkufizime	9–12
Paraqitja	13–55
Detyrimet dhe Aktivitet/Kapitali Neto 13–32	
Instrumentet e Kthyeshëm	15–16
Instrumentet, ose Përbërësit e Instrumenteve, që Imponojnë për Njësinë Ekonomike një Detyrim për t'i Dhënë një Pale Tjetër një Pjesë Proporcionale të Aktiveve Neto të Njësisë Ekonomike Vetëm në Momentin e Likuidimit	17–18
Riklasifikimi i Instrumenteve të Kthyeshëm dhe Instrumenteve që Imponojnë për Njësinë Ekonomike një Detyrim për t'i Dhënë një Pale Tjetër një Pjesë Proporcionale të Aktiveve Neto të Njësisë Ekonomike Vetëm në Momentin e Likuidimit	19–20
Nuk ka Detyrim Kontraktual për të Dhënë Mjete Monetare ose Ndonjë Aktiv Tjetër Financiar	21–24
Shlyerja në Instrumentet e Kapitalit të Vetë Njësisë Ekonomike	25–29
Dispozitat e Shlyerjes së Kushtëzuar	30
Opsionet e Shlyerjes	31–32
Instrumente Financiare të Përbërë	33–37
Aksionet e Thesarit	38–39
Interesi, Dividendët ose Shpërndarjet, Humbjet dhe Fitimet e Ngjashme	40–46
Kompensimi i një Aktivi Financiar dhe një Detyrimi Financiar	47–55
Periudha Kalimtare	56–58
Data Efektive	59–61
Shfuqizimi dhe Zëvendësimi i SNKSP 15 (2001)	62

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik 28, *Instrumentet Financiare: Paraqitja*, është përcaktuar në paragrafët 1–62. Të gjithë paragrafët kanë autoritet të barabartë. SNKSP 28 duhet të lexohet në kontekstin e objektivit të tij, Bazës për Konkluzione, *Parathënies së Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik*, dhe *Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar me Qëllim të Përgjithshëm nga Njësitë e Sektorit Publik*. SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, jep një bazë për zgjedhjen dhe zbatimin e politikave të kontabilitetit në mungesë të udhëzimeve të qarta.

Objektivi

1. Objektivi i këtij Standardi është të vendosë parime për paraqitjen e instrumenteve financiare si detyrime ose aktive/kapital neto dhe për kompensimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare. Ai zbatohet për klasifikimin e instrumenteve financiare, nga këndvështrimi i emetuesit, në aktive financiare, detyrime financiare dhe instrumente të kapitalit; klasifikimin e interesave të lidhura, dividendëve ose shpërndarjeve, humbjeve dhe fitimeve të ngjashme; dhe rrethanat në të cilat aktivet dhe detyrimet financiare duhet të kompensohen.
2. Parimet në këtë Standard plotësojnë parimet për njohjen dhe matjen e aktiveve dhe detyrimeve financiare në SNKSP 41, *Instrumentet Financiare*, dhe për dhënien e informacioneve shpjegues rreth tyre në SNKSP 30, *Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjegues*.

Objekti (shih gjithashtu paragrafët AG3–AG9)

3. **Një njësi (ekonomike) që pregatit dhe paraqet pasqyrat financiare sipas kontabilitetit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara do të zbatojë këtë Standard për të gjitha llojet e instrumenteve financiare, përveç:**
 - (a) **Atyre interesave në njësitë ekonomike të kontrolluara, shoqërive ose sipërmarrjeve të përbashkëta që kontabilizohen në përputhje me SNKSP 35, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara*, SNKSP 34, *Pasqyrat Financiare të Veçanta*, SNKSP 36, *Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta*. Megjithatë, në disa raste, SNKSP 34, SNKSP 35 ose SNKSP 36 kërkojnë ose lejojnë një njësi ekonomike të kontabilizojë një interes në një njësi ekonomike të kontrolluar, shoqëri, ose sipërmarrje të përbashkët duke përdorur SNKSP 41; në ata raste, njësitë ekonomike do të zbatojnë kërkesat e këtij Standardi. Njësitë do të zbatojnë gjithashtu këtë Standard për të gjithë derivativët e lidhur me interesat në njësitë e kontrolluara, shoqëritë, ose sipërmarrjet e përbashkëta.**
 - (b) **Të drejtave dhe detyrimeve të punëdhënësve sipas planeve të përfitimeve të punonjësve, për të cilat zbatohet SNKSP 39, *Përfitimet e Punonjësve*.**
 - (c) **Detyrimeve që vijnë nga kontratat e siguracionit. Megjithatë, ky Standard zbatohet për:**
 - (i) **Derivativët që janë të përfshirë në kontratat e siguracionit nëse SNKSP 41 kërkon që njësia t'i kontabilizojë ata veç; dhe**
 - (ii) **Kontratat e garancisë financiare, nëse emetuesi zbaton SNKSP 41 në njohjen dhe matjen e kontratave, por do të zbatojë standardin përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të**

kontabilitetit që trajton kontratat e siguracionit, nëse emetuesi zgjedh të zbatojë atë standard në njohjen dhe matjen e tyre.

Përveç pikave (i) dhe (ii) më sipër, një njësi mund të zbatojë këtë Standard për kontratat e siguracionit që përfshijnë transferimin e rrezikut financiar.

- (d) **Instrumenteve financiare që janë brenda objektit të standardit ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton kontratat e siguracionit, sepse ato përmbajnë një veçori të pjesëmarrjes me vendimarrje të lirë. Emetuesi i këtyre instrumenteve përjashtohet nga zbatimi për këto veçori i paragrafëve 13–37 dhe AG49–AG60 të këtij Standardi për dallimin ndërmjet detyrimeve financiare dhe instrumenteve të kapitalit. Megjithatë, këta instrumente i nënshtrohen të gjitha kërkesave të tjera të këtij Standardi. Për më tepër, ky Standard zbatohet për derivativët që janë të përfshirë në këta instrumente (shih SNKSP 41).**
- (e) **Instrumenteve financiare, kontratave dhe detyrimeve sipas transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione, për të cilat zbatohet standardi përkatës ndërkombëtar ose kombëtar i kontabilitetit që trajton pagesat e bazuara në aksione, me përjashtim të:**
 - (i) **Kontratave brenda fushëveprimit të paragrafëve 4-6 të këtij Standardi, për të cilat zbatohet ky Standard; ose**
 - (ii) **Paragrafëve 38 dhe 39 të këtij Standardi, të cilët do të zbatohen për aksionet e thesarit të blerë, shitur, emtuar ose anuluar në lidhje me planet e opsionit të aksioneve të punonjësve, planet e blerjes së aksioneve të punonjësve dhe të gjitha marrëveshjet e tjera të pagesave të bazuara në aksione.**

- 4. **Ky Standard do të zbatohet për ato kontrata për të blerë ose shitur një element jofinanciar që mund të shlyhet neto në mjete monetare ose një instrument tjetër financiar, ose duke shkëmbyer instrumente financiare, sikur kontratat të ishin instrumente financiare, me përjashtim të kontratave në të cilat ishte hyrë dhe vazhdojnë të mbahen për qëllimin e marrjes ose dhënies së një elementi jofinanciar në përputhje me kërkesat e pritshme të blerjes, shitjes, ose përdorimit të njësisë. Megjithatë, ky Standard do të zbatohet për ato kontrata që një njësi ekonomike përcakton si të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit në përputhje me paragrafin 6 të SNKSP 41.**
- 5. **Ka mënyra të ndryshme në të cilat një kontratë për blerjen ose shitjen e një elementi jofinanciar mund të shlyhet neto në mjete monetare ose në një instrument tjetër financiar ose duke shkëmbyer instrumente financiare. Këto përfshijnë:**

- (a) Kur kushtet e kontratës lejojnë secilën palë ta shlyejë atë neto në mjete monetare ose në një instrument tjetër financiar ose duke shkëmbyer instrumente financiare;
- (b) Kur aftësia për të shlyer neto në mjete monetare ose në një instrument tjetër financiar, ose duke shkëmbyer instrumente financiare, nuk është e shprehur qartë në kushtet e kontratës, por njësia ka një praktikë të shlyerjes së kontratave të ngjashme neto në mjete monetare ose në një instrument tjetër financiar, ose duke këmbyer instrumente financiare (qoftë me palën tjetër, duke lidhur kontrata kompensuese, ose duke e shitur kontratën përpara ushtrimit ose skadimit të saj);
- (c) Kur, për kontrata të ngjashme, njësia ka një praktikë të marrjes së artikullit bazë dhe shitjes së tij brenda një periudhe të shkurtër pas dorëzimit me qëllim të gjenerimit të një fitimi nga luhatjet afatshkurtra në çmimin ose marzhin e tregtarit; dhe
- (d) Kur elementi jofinanciar që është objekt i kontratës është lehtësisht i konvertueshëm në kesh/mjete monetare.

Një kontratë për të cilën zbatohet (b) ose (c) nuk është lidhur për qëllimin e marrjes ose dhënies së artikullit jofinanciar në përputhje me kërkesat e pritshme të njësisë ekonomike të blerjes, shitjes ose përdorimit dhe, në përputhje me rrethanat, është brenda fushëveprimit të këtij Standardi. Kontratat e tjera për të cilat zbatohet paragrafi 4 vlerësohen për të përcaktuar nëse ato janë lidhur dhe vazhdojnë të mbahen për qëllimin e marrjes ose dhënies së elementit jofinanciar në përputhje me kërkesat e pritshme të njësisë ekonomike të blerjes, shitjes ose përdorimit, dhe në përputhje me rrethanat, nëse ato janë brenda objektit të këtij Standardi.

- 6. Një opSION i shkruar për të blerë ose shitur një element jofinanciar që mund të shlyhet neto në mjete monetare ose një instrument tjetër financiar, ose duke këmbyer instrumente financiare, në përputhje me paragrafin 5(a) ose (d) është brenda fushëveprimit të këtij Standardi. Një kontratë e tillë nuk mund të lidhet për qëllimin e marrjes ose dhënies së elementit jofinanciar në përputhje me kërkesat e pritshme të njësisë ekonomike për blerje, shitje, ose përdorim.
- 7. [Fshirë]
- 8. [Fshirë]

Përkufizime (shih gjithashtu paragrafët AG10–AG48)

- 9. **Termet e mëposhtëm përdoren në këtë Standard me kuptimet e specifikuara:**

Një **instrument kapitali** është çdo kontratë që evidenton një interes të mbetur në aktivet e një njësie pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të saj.

Një **instrument financiar** është çdo kontratë që krijon si një aktiv financiar të një njësie ekonomike ashtu edhe një detyrim financiar ose instrument kapitali të një njësie tjetër.

Një **aktiv financiar** është çdo aktiv që është:

- (a) Mjete monetare;
- (b) Një instrument kapitali neto i një njësie tjetër ekonomike;
- (c) Një e drejtë kontraktuale:
 - (i) Për të marrë mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar nga një njësi ekonomike tjetër; ose
 - (ii) Për të shkëmbyer aktivet ose detyrimet financiare me një njësi tjetër ekonomike në kushte që janë potencialisht të favorshme për njësinë ekonomike; ose
- (d) Një kontratë që do të ose mund të shlyhet në instrumentet e kapitalit të vetë njësisë ekonomike dhe është:
 - (i) Një jo-derivativ për të cilin njësia ekonomike është ose mund të jetë e detyruar të marrë një numër të ndryshueshëm të instrumenteve të kapitalit të vetë njësisë ekonomike; ose
 - (ii) Një derivativ që do të shlyhet ose mund të shlyhet ndryshe nga këmbimi i një shume fikse mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar për një numër fikse të instrumenteve të kapitalit të vetë njësisë. Për këtë qëllim instrumentet e kapitalit të vetë njësisë nuk përfshijnë instrumente financiare të kthyeshëm të klasifikuar si instrumente të kapitalit në përputhje me paragrafët 15 dhe 16, instrumente që i imponojnë njësisë një detyrim për t'i dhënë një pale tjetër një pjesë proporcionale të aktiveve neto të njësisë vetëm në likuidim dhe klasifikohen si instrumente të kapitalit në përputhje me paragrafët 17 dhe 18, ose instrumente që janë kontrata për marrjen ose dhënien e ardhshme të instrumenteve të kapitalit të vetë njësisë.

Një **detyrim financiar** është çdo detyrim që është:

- (a) Një detyrim kontraktual:
 - (i) Për t'i dhënë mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar një njësie tjetër; ose
 - (ii) Për të shkëmbyer aktivet financiare ose detyrimet financiare me një njësi ekonomike tjetër në kushte që janë potencialisht të pafavorshme për njësinë ekonomike; ose

- (b) **Një kontratë që do të shlyhet ose mund të shlyhet në instrumentet e kapitalit të vetë njësisë dhe është:**
- (i) **Një instrument jo-derivativ për të cilin njësia ekonomike është ose mund të jetë e detyruar të japë një numër të ndryshueshëm të instrumenteve të kapitalit të vetë njësisë ekonomike; ose**
 - (ii) **Një instrument derivativ që do të shlyhet ose mund të shlyhet ndryshe nga këmbimi i një shume fikse mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar për një numër fikse të instrumenteve të kapitalit të vetë njësisë. Për këtë qëllim, të drejtat, opsionet ose garancitë për të blerë një numër fikse të instrumenteve të kapitalit të vetë njësisë për një shumë fikse të çdo monedhe janë instrumente të kapitalit nëse njësia u ofron të drejtat, opsionet ose garancitë proporcionale për të gjithë pronarët e saj ekzistues të së njëjtës klasë të instrumenteve të saj të kapitalit jo-derivativ. Gjithashtu, për këta qëllime instrumentet e kapitalit të vetë njësisë nuk përfshijnë instrumente financiare të kthyeshëm të klasifikuar si instrumente të kapitalit në përputhje me paragrafët 15 dhe 16, instrumente që i imponojnë njësisë një detyrim për t'i dhënë një pale tjetër një pjesë proporcionale të aktiveve neto të njësisë vetëm në likuidim dhe klasifikohen si instrumente të kapitalit në përputhje me paragrafët 17 dhe 18, ose instrumente që janë kontrata për marrjen ose dhënien e ardhshme të instrumenteve të kapitalit të vetë njësisë.**

Si përjashtim, një instrument që plotëson përkufizimin e një detyrimi financiar klasifikohet si instrument i kapitalit nëse ka të gjitha tiparet dhe plotëson kushtet në paragrafët 15 dhe 16 ose paragrafët 17 dhe 18.

10. Termat e mëposhtëm përcaktohen në paragrafin 9 të SNKSP 41 ose paragrafin 10 të SNKSP 29, *Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja*, dhe përdoren në këtë Standard me kuptimin e specifikuar në ata Standarde.
- Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar;
 - Ç'regjistrimi;
 - Derivativi;
 - Metoda e interesit efektiv;
 - Detyrimet financiare me vlerën e drejtë përmes sufititit ose defititit;
 - Kontrata e garancisë financiare;
 - Angazhim i palëkundur;

- Transaksion parashikimi;
 - Efektiviteti i mbrojtjes;
 - Zërat e mbrojtur;
 - Instrument mbrojtës;
 - I mbajtur për tregtim;
 - Blerje ose shitje në mënyrë të rregullt; dhe
 - Kostot e transaksionit.
11. Në këtë Standard, "kontrata" dhe "kontraktuale" i referohen një marrëveshjeje midis dy ose më shumë palëve që ka pasoja të qarta ekonomike, të cilat palët kanë pak ose aspak liri për t'i shmangur, zakonisht për shkak se marrëveshja është e imponueshme me ligj. Kontratat, dhe rrjedhimisht instrumentet financiare, mund të marrin forma të ndryshme dhe nuk duhet domosdoshmërisht të jenë me shkrim.
12. Në këtë Standard, "njësia ekonomike" përfshin njësitë ekonomike të sektorit publik, individët, partneritetet, organet e inkuorporuara dhe trustet.

Paraqitja

Detyrimet dhe Aktivet/Kapitali Neto (shih gjithashtu paragrafët AG49–AG54)

13. **Emetuesi i një instrumenti financiar do të klasifikojë instrumentin, ose pjesët përbërëse të tij, në njohjen fillestare si një detyrim financiar, një aktiv financiar ose një instrument kapitali në përputhje me thelbin e marrëveshjes kontraktuale dhe përkufizimet e një detyrimi financiar, një aktivi financiar dhe një instrumenti kapitali.**
14. Kur një emetues zbaton përkufizimet në paragrafin 9 për të përcaktuar nëse një instrument financiar është një instrument kapitali dhe jo një detyrim financiar, instrumenti është një instrument kapitali, nëse dhe vetëm nëse, plotësohen të dy kushtet (a) dhe (b) më poshtë.
- (a) Instrumenti nuk përfshin ndonjë detyrim kontraktual:
- (i) Për t'i dhënë mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar një njësie tjetër; ose
 - (ii) Për të shkëmbyer aktive ose detyrime financiare me një njësi ekonomike tjetër në kushte që janë potencialisht të pafavorshme për emetuesin.
- (b) Nëse instrumenti do të shlyhet ose mund të shlyhet në instrumentet e kapitalit të vetë emetuesit, ai është:
- (i) Një jo-derivativ që nuk përfshin asnjë detyrim kontraktual për

emetuesin për të dhënë një numër të ndryshueshëm të instrumenteve të tij të kapitalit; ose

- (ii) Një derivativ që do të shlyhet vetëm nga emetuesi që këmben një shumë fikse të mjeteve monetare ose një aktiv tjetër financiar për një numër fiks të instrumenteve të tij të kapitalit. Për këtë qëllim, të drejtat, opsionet ose garancitë për të blerë një numër fiks të instrumenteve të kapitalit të vetë njësisë për një shumë fikse të çdo monedhe janë instrumente të kapitalit nëse njësia u ofron të drejtat, opsionet ose garancitë proporcionale për të gjithë pronarët e saj ekzistues të së njëjtës klasë të instrumenteve të saj të kapitalit jo-derivativ. Gjithashtu, për këto qëllime instrumentet e kapitalit të vetë emetuesit nuk përfshijnë instrumente që kanë të gjitha tiparet dhe plotësojnë kushtet e përshkruara në paragrafët 15 dhe 16 ose në paragrafët 17 dhe 18, ose instrumente që janë kontrata për marrjen ose dhënien e ardhshme të instrumenteve të kapitalit të vetë emetuesit.

Një detyrim kontraktual, duke përfshirë atë që vjen nga një instrument financiar derivativ, që do të rezultojë ose mund të rezultojë në marrjen ose dhënien e ardhshme të instrumenteve të kapitalit të vetë emetuesit, por që nuk plotëson kushtet (a) dhe (b) më sipër, nuk është një instrument kapitali. Si përjashtim, një instrument i cili plotëson përkufizimin e një detyrimi financiar klasifikohet si instrument i kapitalit nëse ka të gjithë tiparet dhe plotëson kushtet në paragrafin 15 dhe 16 ose në paragrafët 17 dhe 18.

Instrumentet e Kthyeshëm

15. Një instrument financiar i kthyeshëm përfshin një detyrim kontraktual për emetuesin për të riblerë ose shlyer atë instrument me mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar gjatë ushtrimit të kthimit. Si përjashtim nga përkufizimi i një detyrimi financiar, një instrument që përfshin një detyrim të tillë klasifikohet si instrument i kapitalit nëse ka të gjithë tiparet e mëposhtëm:
- (a) Ai i jep të drejtë zotëruesit për një pjesë proporcionale të aktiveve neto të njësisë në rast të likuidimit të njësisë. Aktivet neto të njësisë janë ata aktive që mbeten pas zbritjes së të gjitha pretendimeve të tjera mbi aktivet e saj. Një pjesë proporcionale përcaktohet nga:
- (i) Ndarja e aktiveve neto të njësisë në likuidim në njësi me shumë të barabartë; dhe
- (ii) Shumëzimi i asaj shume me numrin e njësive të mbajtura nga mbajtësi i instrumentit financiar.
- (b) Instrumenti është në klasën e instrumenteve që është në varësi të të gjitha klasave të tjera të instrumenteve. Për të qenë në një klasë të tillë,

instrumenti:

- (i) Nuk ka përparësi ndaj pretendimeve të tjera ndaj aktiveve të njësisë në likuidim; dhe
 - (ii) Nuk është e nevojshme të shndërrohet në një instrument tjetër përpara se të jetë në klasën e instrumenteve që është në varësi të të gjitha klasave të tjera të instrumenteve.
- (c) Të gjithë instrumentet financiare në klasën e instrumenteve që janë në varësi të të gjitha klasave të tjera të instrumenteve kanë karakteristika identike. Për shembull, ata duhet të jenë të gjithë të kthyeshëm, dhe formula ose metoda tjetër e përdorur për llogaritjen e çmimit të riblerjes ose të rishlyerjes është e njëjtë për të gjithë instrumentet në atë klasë.
- (d) Përveç detyrimit kontraktual për emetuesin për të riblerë ose shlyer instrumentin për mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar, instrumenti nuk përfshin asnjë detyrim kontraktual për t'i dhënë mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar një njësie tjetër, ose për të shkëmbyer aktive financiare ose detyrime financiare me një njësi tjetër në kushte që janë potencialisht të pafavorshme për njësinë, dhe nuk është një kontratë që do të shlyhet ose mund të shlyhet në instrumentet e kapitalit të vetë njësisë, siç përcaktohet në nënparagrafin (b) të përkufizimit të një detyrimi financiar.
- (e) Flukset totale të pritshme monetare që i atribuohen instrumentit gjatë jetës së instrumentit bazohen kryesisht në sufiçitin ose defiçitin, ndryshimin në aktivet neto të njohura ose ndryshimin në vlerën e drejtë të aktiveve neto të njohura dhe të panjohura të njësisë ekonomike gjatë jetëgjatësisë së instrumentit (duke përfshirë çdo efekt të instrumentit).

16. Që një instrument të klasifikohet si një instrument kapitali, përveç instrumentit që ka të gjithë tiparet e mësipërm, emetuesi nuk duhet të ketë asnjë instrument ose kontratë tjetër financiare që ka:

- (a) Flukset totale monetare të bazuar kryesisht në sufiçitin ose defiçitin, ndryshimin në aktivet neto të njohura, ose ndryshimin në vlerën e drejtë të aktiveve neto të njohura dhe të panjohura të njësisë ekonomike (duke përfshirë çdo efekt të një instrumenti ose kontrate të tillë); dhe
- (b) Efekti i kufizimit ose fiksimit të ndjeshëm të kthimit/fitimit të mbetur të mbajtësit e instrumenteve të kthyeshëm.

Për qëllime të zbatimit të këtij kushti, njëzia nuk do të marrë në konsideratë kontratat jofinanciare me një mbajtës të një instrumenti të përshkruar në paragrafin 15 që kanë terma dhe kushte kontraktuale që janë të ngjashëm me termat dhe kushtet kontraktuale të një kontrate ekuivalente që mund të ndodhë ndërmjet një jo-mbajtësi të instrumentit dhe njësisë emetuese. Nëse njëzia ekonomike nuk mund të përcaktojë që ky kusht plotësohet, ajo nuk do ta

klasifikojë instrumentin e kthyeshëm si një instrument kapitali.

Instrumentet, ose Përbërësit e Instrumenteve, që Imponojnë për Njësinë Ekonomike një Detyrim për t'i Dhënë një Pale Tjetër një Pjesë Proporcionale të Aktiveve Neto të Njësisë Ekonomike Vetëm në Momentin e Likuidimit

17. Disa instrumente financiare përfshijnë një detyrim kontraktual për njësinë emetuese për t'i dhënë një njësie tjetër një pjesë proporcionale të aktiveve të saj neto vetëm në momentin e likuidimit. Detyrimi lind sepse likuidimi ose është i sigurt se do të ndodhë dhe është jashtë kontrollit të njësisë ekonomike (p.sh. një njësi ekonomike me jetë të kufizuar), ose është i pasigurt të ndodhë, por është në zgjedhjen e mbajtësit të instrumentit. Si përjashtim nga përkufizimi i një detyrimi financiar, një instrument që përfshin një detyrim të tillë klasifikohet si instrument i kapitalit nëse ka të gjithë tiparet e mëposhtëm:
- (a) Ai i jep të drejtë zotëruesit për një pjesë proporcionale të aktiveve neto të njësisë në rast të likuidimit të njësisë. Aktivet neto të njësisë janë ata aktive që mbeten pas zbritjes së të gjitha pretendimeve të tjera mbi aktivet e saj. Një pjesë proporcionale përcaktohet nga:
 - (i) Ndarja e aktiveve neto të njësisë në likuidim në njësi me shumë të barabartë; dhe
 - (ii) Shumëzimi i asaj shume me numrin e njësive të mbajtura nga mbajtësi i instrumentit financiar.
 - (b) Instrumenti është në klasën e instrumenteve që është në varësi të të gjitha klasave të tjera të instrumenteve. Për të qenë në një klasë të tillë, instrumenti:
 - (i) Nuk ka përparësi ndaj pretendimeve të tjera ndaj aktiveve të njësisë në likuidim; dhe
 - (ii) Nuk është e nevojshme të shndërrohet në një instrument tjetër përpara se të jetë në klasën e instrumenteve që është në varësi të të gjitha klasave të tjera të instrumenteve.
 - (c) Të gjithë instrumentet financiare në klasën e instrumenteve që janë në vartësi të të gjitha klasave të tjera të instrumenteve duhet të kenë një detyrim kontraktual identik për njësinë ekonomike emetuese për të dhënë një pjesë proporcionale të aktiveve të saj neto në likuidim.
18. Që një instrument të klasifikohet si një instrument kapitali, përveç instrumentit që ka të gjithë tiparet e mësipërm, emetuesi nuk duhet të ketë asnjë instrument ose kontratë tjetër financiare që ka:
- (a) Flukset totale të mjeteve monetare të bazuar kryesisht në sufiçitin ose defiçitin, ndryshimin në aktivet neto të njohura ose ndryshimin në vlerën e drejtë të aktiveve neto të njohura dhe të panjohura të njësisë (duke përjashtuar çdo efekt të një instrumenti ose kontrate të tillë); dhe

- (b) Efekti i kufizimit ose fiksimit të ndjeshëm të kthimit/fitimit të mbetur tek mbajtësit e instrumentit.

Për qëllimet e zbatimit të këtij kushti, njësia nuk do të marrë në konsideratë kontratat jofinanciare me një mbajtës të një instrumenti të përshkruar në paragrafin 17 që kanë terma dhe kushte kontraktualë që janë të ngjashëm me termat dhe kushtet kontraktualë të një kontrate ekuivalente që mund të ndodhë ndërmjet një jo-mbajtësi të instrumentit dhe njësisë emetuese. Nëse njësia nuk mund të përcaktojë që ky kusht plotësohet, ajo nuk do ta klasifikojë instrumentin si një instrument kapitali.

Riklasifikimi i Instrumenteve të Kthyeshëm dhe Instrumenteve që Imponojnë për Njësinë Ekonomike një Detyrim për t'i Dhënë një Pale Tjetër një Pjesë Proporcionale të Aktiveve Neto të Njesisë Ekonomike Vetëm në Momentin e Likuidimit

19. Një njësi duhet të klasifikojë një instrument financiar si një instrument kapitali në përputhje me paragrafët 15 dhe 16 ose paragrafët 17 dhe 18 nga data kur instrumenti ka të gjitha tiparet dhe plotëson kushtet e përcaktuara në këta paragrafë. Një njësi do të riklasifikojë një instrument financiar nga data kur instrumenti pushon së pasuri të gjitha tiparet ose plotëson të gjithë kushtet e përcaktuara në këta paragrafë. Për shembull, nëse një njësi shlyen të gjithë instrumentet e saj jo të kthyeshëm të emetuar dhe çdo instrument i kthyeshëm që mbetet i papaguar ka të gjithë tiparet dhe plotëson të gjithë kushtet në paragrafët 15 dhe 16, njësia do të riklasifikojë instrumentet e saj të kthyeshëm si instrumente të kapitalit që nga data kur shlyen instrumentet jo të kthyeshëm.
20. Një njësi do të kontabilizojë si më poshtë për riklasifikimin e një instrumenti në përputhje me paragrafin 19:
- (a) Ajo do të riklasifikojë një instrument të kapitalit si një detyrim financiar nga data kur instrumenti ndalon së patur i të gjithë tiparet ose plotëson kushtet në paragrafët 15 dhe 16 ose në paragrafët 17 dhe 18. Detyrimi financiar do të matet me vlerën e drejtë të instrumentit në datën e riklasifikimit. Njësia do të njohë në aktivet/kapitalin neto çdo diferencë ndërmjet vlerës së mbartur të instrumentit të kapitalit dhe vlerës së drejtë të detyrimit financiar në datën e riklasifikimit.
- (b) Ajo do të riklasifikojë një detyrim financiar si një instrument kapitali që nga data kur instrumenti ka të gjithë tiparet dhe plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafët 15 dhe 16 ose në paragrafët 17 dhe 18. Një instrument i kapitalit do të matet me vlerën e mbartur të detyrimit financiar në datën e riklasifikimit.

Nuk ka Detyrim Kontraktual për të Dhënë Mjete Monetare ose Ndonjë Aktiv Tjetër Financiar (paragrafi 14(a))

21. Me përjashtim të rrethanave të përshkruara në paragrafët 15 dhe 16 ose në paragrafët 17 dhe 18, një tipar kritik në diferencimin e një detyrimi financiar nga

një instrument i kapitalit është ekzistenca e një detyrimi kontraktual të njëjës palë ndaj instrumentit financiar (emetuesit) ose t'i japë mjete financiare ose një aktiv tjetër financiar palës tjetër (mbajtësit apo zotëruesit) ose të shkëmbejë aktive financiare ose detyrime financiare me mbajtësin në kushte që janë potencialisht të pafavorshme për emetuesin. Megjithëse mbajtësi i një instrumenti të kapitalit mund të ketë të drejtë të marrë një pjesë proporcionale të çdo dividendi ose shpërndarjeje të ngjashme të deklaruar, ose shpërndarje të aktiveve/kapitalit neto, emetuesi nuk ka një detyrim kontraktual për të bërë shpërndarje të tilla, sepse nuk mund t'i kërkohet të japë mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar te një palë tjetër.

22. Thelbi i një instrumenti financiar, dhe jo forma e tij ligjore, rregullon klasifikimin e tij në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë. Substanca dhe forma ligjore janë zakonisht të qëndrueshme, por jo gjithmonë. Disa instrumente financiare marrin formën ligjore të instrumenteve të kapitalit, por janë detyrime në thelb dhe të tjerët mund të kombinojnë tipare të lidhur me instrumentet e kapitalit dhe tipare të lidhur me detyrimet financiare. Për shembull:

- (a) Një aksion preferencial që parashikon/lejon shlyerje të detyrueshme nga emetuesi për një shumë fikse ose të përcaktueshme në një datë të ardhshme fikse ose të përcaktueshme, ose i jep mbajtësit të drejtën t'i kërkojë emetuesit të shlyejë instrumentin në ose pas një date të caktuar për një shumë fikse ose të përcaktueshme, është një detyrim financiar.
- (b) Një instrument financiar që i jep mbajtësit të drejtën t'ia kthejë atë emetuesit për mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar (një "instrument i kthyeshëm") është një detyrim financiar, me përjashtim të atyre instrumenteve të klasifikuar si instrumente të kapitalit në përputhje me paragrafët 15 dhe 16 ose paragrafët 17 dhe 18. Instrumenti financiar është një detyrim financiar edhe kur shumta e mjeteve monetare ose aktiveve të tjera financiare përcaktohet në bazë të një indeksi ose një elementi tjetër që ka potencial të rritet ose të ulet. Ekzistenca e një opsioni që mbajtësi t'ia kthejë instrumentin emetuesit për mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar do të thotë që instrumenti i kthyeshëm plotëson përkufizimin e një detyrimi financiar, me përjashtim të atyre instrumenteve të klasifikuar si instrumente të kapitalit në përputhje me paragrafët 15 dhe 16 ose paragrafët 17 dhe 18. Për shembull, fondet e përbashkëta me afat të hapur, trustet e njësisive, partneritetet dhe disa njësi ko-operuese mund t'u ofrojnë njësi-mbajtësve ose anëtarëve të tyre të drejtën për të marrë interesat e tyre te emetuesi në çdo kohë në para, gjë që rezulton që interesat e njësi-mbajtësve ose anëtarëve të klasifikohen si detyrime financiare, me përjashtim të atyre instrumenteve të klasifikuar si instrumente të kapitalit në përputhje me paragrafët 15 dhe 16 ose paragrafët 17 dhe 18. Megjithatë, klasifikimi si detyrim financiar nuk përjashton përdorimin e përshkruesve si p.sh. "vlera neto e aktiveve që i atribuohet njësi-mbajtësve" dhe "ndryshimi në vlerën neto të aktiveve që

u atribuohen njësi-mbajtësve" në faqen e pasqyrave financiare të një njësie ekonomike që nuk ka aktive/kapitale neto të kontribuar (të tilla si disa fonde të përbashkëta dhe truste të njësive, shih shembullin ilustrues 7) ose përdorimin e informacioneve shpjeguese shtesë për të treguar se interesat totale të anëtarëve përfshijnë elementë të tillë si rezervat që plotësojnë përkufizimin e aktiveve/kapitalit neto dhe instrumenteve të kthyesëm që nuk e bëjnë këtë (shih shembullin ilustrues 8).

23. Nëse një njësi nuk ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shmangur dhënien e mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar për të shlyer një detyrim kontraktual, detyrimi plotëson përkufizimin e një detyrimi financiar, me përjashtim të atyre instrumenteve të klasifikuar si instrumente të kapitalit në përputhje me paragrafët 15 dhe 16 ose paragrafët 17 dhe 18. Për shembull:

- (a) Një kufizim në aftësinë e një njësie për të përbushur një detyrim kontraktual, të tillë si mungesa e aksesit në monedhë të huaj ose nevoja për të marrë aprovimin për pagesë nga një autoritet rregullator, nuk mohon detyrimin kontraktual të njësisë ekonomike ose të drejtën kontraktuale të mbajtësit sipas instrumentit.
- (b) Një detyrim kontraktual që kushtëzohet me ushtrimin e të drejtës për të rimarrë/paguar/riblerë nga një palë tjetër është një detyrim financiar sepse njësia ekonomike nuk ka të drejtën e pakushtëzuar për të shmangur dhënien e mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar.

24. Një instrument financiar që nuk përcakton në mënyrë eksplicite një detyrim kontraktual për të dhënë mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar mund të krijojë një detyrim në mënyrë indirekte nëpërmjet termave dhe kushteve të tij. Për shembull:

- (a) Një instrument financiar mund të përmbajë një detyrim jofinanciar që duhet të shlyhet, nëse dhe vetëm nëse, njësia ekonomike dështon të bëjë shpërndarje ose të shlyejë instrumentin. Nëse njësia ekonomike mund të shmangë transferimin e mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar vetëm duke shlyer detyrimin jofinanciar, instrumenti financiar është një detyrim financiar.
- (b) Një instrument financiar është një detyrim financiar nëse parashikon që me shlyerjen njësia ekonomike do të japë ose:
 - (i) Mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar; ose
 - (ii) Aksionet e veta, vlera e të cilave është përcaktuar të tejkalojë ndjeshëm vlerën e mjeteve monetare ose të aktivitetit tjetër financiar.

Edhe pse njësia ekonomike nuk ka një detyrim kontraktual të shprehur qartë për të dhënë mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar, vlera e alternativës së shlyerjes përmes aksioneve është e tillë që njësia do të shlyejë në mjete monetare. Në çdo rast, mbajtësit në thelb i është garantuar marrja e një shume që

është të paktën e barabartë me opsionin e shlyerjes në mjete monetare (shih paragrafin 25).

Shlyerja në Instrumentet e Kapitalit të Vetë Njesisë (paragrafi 14(b))

25. Një kontratë nuk është një instrument kapitali vetëm sepse mund të rezultojë në marrjen ose dhënien e instrumenteve të kapitalit të vetë njesisë. Një njësi ekonomike mund të ketë një të drejtë ose detyrim kontraktual për të marrë ose dhënë një numër të aksioneve të veta ose instrumenteve të tjerë të kapitalit që ndryshon në mënyrë që vlera e drejtë e instrumenteve të kapitalit të vetë njesisë që do të merren ose do të jepen të jetë e barabartë me shumën e së drejtës ose detyrimit kontraktual. Një e drejtë ose detyrim i tillë kontraktual mund të jetë për një shumë fikse ose një shumë që luhetet pjesërisht ose plotësisht në përgjigje të ndryshimeve në një variabël të ndryshëm nga çmimi i tregut të instrumenteve të kapitalit të vetë njesisë (p.sh. një normë interesi, një çmim komoditeti/produkti bujqësor/lëndë e parë, ose një çmim të instrumentit financiar). Dy shembuj janë (a) një kontratë për të dhënë aq shumë nga instrumentet e kapitalit të vetë njesisë sa janë të barabarta në vlerë me 100 NJM dhe (b) një kontratë për të dhënë aq shumë nga instrumentet e kapitalit të vetë njesisë ekonomike sa janë të barabarta në vlerë me vlerën prej 100 fuçi naftë. Një kontratë e tillë është një detyrim financiar i njesisë ekonomike edhe pse njësia ekonomike duhet ose mund ta shlyejë atë duke dorëzuar instrumentet e veta të kapitalit. Ai nuk është një instrument kapitali, sepse njësia përdor një numër variabël të instrumenteve të saj të kapitalit si një mjet për të shlyer kontratën. Prandaj, kontrata nuk evidenton një interes të mbetur në aktivet e njesisë pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të saj.
26. Përveç siç thuhet në paragrafin 27, një kontratë që do të shlyhet nga njësia (duke marrë ose) duke dhënë një numër fiks të instrumenteve të kapitalit të vet në këmbim të një shume fikse mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar është një instrument kapitali. Për shembull, një opsion aksioni i emtuar që i jep palës tjetër të drejtën për të blerë një numër fiks të aksioneve të njesisë ekonomike për një çmim fiks ose për një shumë fikse të caktuar të principalit të një obligacioni, është një instrument kapitali. Ndryshimet në vlerën e drejtë të një kontrate që vijnë nga ndryshimet në normat e interesit të tregut, të cilat nuk ndikojnë në shumën e mjeteve monetare ose aktiveve të tjera financiare për t'u paguar ose marrë, ose numrin e instrumenteve të kapitalit që do të merren ose do të jepen, në shlyerjen e kontratës nuk e përjashtojnë që kontrata të jetë një instrument kapitali. Çdo shumë e marrë (siç është primi i marrë për një opsion të blerë ose garanci për aksionet e vetë njesisë ekonomike) shtohet drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto. Çdo shumë e paguar (siç është primi i paguar për një opsion të blerë) zbritet drejtpërdrejt nga aktivet/kapitali neto. Ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti të kapitalit nuk njihen në pasqyrat financiare.
27. Nëse instrumentet e kapitalit të vetë njesisë që do të merren ose do të jepen nga njësia pas shlyerjes së një kontrate janë instrumente financiare të kthyeshëm me

të gjitha tiparet dhe plotësojnë kushtet e përshkruara në paragrafët 15 dhe 16, ose instrumente që i imponojnë njësisë një detyrim për t'i dorëzuar një pale tjetër një pjesë proporcionale të aktiveve neto të njësisë ekonomike vetëm në likuidim me të gjitha tiparet dhe plotësimin e kushteve të përshkruara në paragrafët 17 dhe 18, kontrata është një aktiv financiar ose një detyrim financiar. Kjo përfshin një kontratë që do të shlyhet nga njësia që merr ose jep një numër fiks instrumentesh të tillë në këmbim të një shume fikse mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar.

28. Me përjashtim të rrethanave të përshkruara në paragrafët 15 dhe 16 ose në paragrafët 17 dhe 18, një kontratë që përmban një detyrim për një njësi për të blerë instrumente të kapitalit të vet për mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar, krijon një detyrim financiar për vlerën aktuale të shumës së riblerjes/shlyerjes (p.sh., për vlerën aktuale të çmimit të riblerjes së ardhshme, çmimin e ushtrimit të opsionit ose shumën tjetër të riblerjes/shlyerjes). Ky është rasti edhe nëse vetë kontrata është një instrument kapitali. Një shembull është detyrimi i një njësie sipas një kontrate të ardhshme për të blerë instrumentet e veta të kapitalit në mjete monetare. Detyrimi financiar njihet fillimisht me vlerën aktuale të shumës së shlyerjes dhe riklasifikohet nga aktivet/kapitali neto. Më pas, detyrimi financiar matet në përputhje me SNKSP 41. Nëse kontrata skadon pa dorëzim/dhënie, vlera kontabël e detyrimit financiar riklasifikohet në aktivet/kapitalin neto. Detyrimi kontraktual i një njësie për të blerë instrumente të kapitalit të vet krijon një detyrim financiar për vlerën aktuale të shumës së riblerjes, edhe nëse detyrimi për të blerë është i kushtëzuar nga ushtrimi i të drejtës së riblerjes nga pala tjetër (p.sh., një opsion shitjeje me shkrim që i jep të drejtën palës tjetër për t'i shitur njësisë instrumentet e kapitalit të vetë njësisë për një çmim fiks).
29. Një kontratë që do të shlyhet nga njësia që jep ose merr një numër fiks të instrumenteve të kapitalit të vet në këmbim të një shume të ndryshueshme të mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar, është një aktiv financiar ose detyrim financiar. Një shembull është një kontratë që njësia të japë 100 instrumente të kapitalit të vet në këmbim të një shume monetare të llogaritur të barabartë me vlerën e 100 fuçive naftë.

Dispozitat e Shlyerjes së Kushtëzuar

30. Një instrument financiar mund t'i kërkojë njësisë ekonomike të japë mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar, ose përndryshe ta shlyejë atë në një mënyrë të tillë që do të ishte një detyrim financiar, në rast të shfaqjes ose jo të ngjarjeve të pasigurta të ardhshme (ose në rezultatin e rrethanave të pasigurta) që janë jashtë kontrollit si të emetuesit, ashtu edhe të mbajtësit të instrumentit, të tilla si një ndryshim në një indeks të tregut të aksioneve, indeksin e çmimeve të konsumit, normën e interesit, ose kërkesat tatimore, ose të ardhurat e ardhshme të emetuesit, sufiçitin ose defiçitin, ose raportin e borxhit ndaj kapitalit. Emetuesi i një instrumenti të tillë nuk ka të drejtën e pakushtëzuar për të

shmangur dhënien e mjeteve monetare ose një aktiv tjetër financiar (ose përndryshe ta shlyejë atë në një mënyrë të tillë që do të ishte një detyrim financiar). Prandaj, ai është një detyrim financiar i emetuesit përveç nëse:

- (a) Pjesa e dispozitës së shlyerjes së kushtëzuar që mund të kërkojë shlyerje në mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar (ose ndryshe në një mënyrë të tillë që do të ishte një detyrim financiar) nuk është e vërtetë;
- (b) Emetuesit mund t'i kërkojë të shlyejë detyrimin në mjete monetare ose me një aktiv tjetër financiar (ose ndryshe ta shlyejë atë në mënyrë të tillë që do të ishte një detyrim financiar) vetëm në rast likuidimi të emetuesit; ose
- (c) Instrumenti ka të gjitha tiparet dhe plotëson kushtet në paragrafët 15 dhe 16.

Opsionet e Shlyerjes

- 31. **Kur një instrument financiar derivativ i jep një palë një zgjedhje mbi mënyrën se si shlyhet (p.sh., emetuesi ose mbajtësi mund të zgjedhë shlyerjen neto në para ose duke shkëmbyer aksionet me para), ai është një aktiv financiar ose një detyrim financiar, përveç nëse të gjitha alternativat e shlyerjes do të rezultojnë që ai të jetë një instrument kapitali.**
- 32. Një shembull i një instrumenti financiar derivativ me një opSION shlyerjeje që është një detyrim financiar është një opSION aksioni që emetuesi mund të vendosë ta shlyejë me para ose duke shkëmbyer aksionet e veta për para. Në mënyrë të ngjashme, disa kontrata për të blerë ose shitur një element jofinanciar në këmbim të instrumenteve të kapitalit të vetë në njësi ekonomike janë brenda fushëveprimit të këtij standardi sepse ato mund të shlyhen ose me dhënien e artikullit jofinanciar ose neto në mjete monetare ose një instrument tjetër financiar. (shih paragrafët 4–6). Kontrata të tilla janë aktive ose detyrime financiare dhe jo instrumente të kapitalit.

Instrumentet Financiare të Përbërë (shih gjithashtu paragrafët AG55–AG60 dhe Shembujt Ilustrues 9–12)

- 33. **Emetuesi i një instrumenti financiar jo-derivativ do të vlerësojë kushtet e instrumentit financiar për të përcaktuar nëse ai përmban si një përbërës detyrimi ashtu edhe një përbërës të aktiveve/kapitalit neto. Përbërës të tillë do të klasifikohen veç si detyrime financiare, aktive financiare, ose instrumente të kapitalit në përputhje me paragrafin 13.**
- 34. Një njësi njihet veç përbërësit e një instrumenti financiar që (a) krijon një detyrim financiar të njësisë ekonomike dhe (b) i jep një opSION zotëruesit/mbajtësit të instrumentit për ta konvertuar atë në një instrument të kapitalit të njësisë. Për shembull, një obligacion ose instrument i ngjashëm i konvertueshëm nga mbajtësi në një numër fiks të aksioneve të zakonshme të njësisë ekonomike është një instrument financiar i përbërë. Nga këndvështrimi i njësisë ekonomike,

një instrument i tillë përbëhet nga dy komponentë: një detyrim financiar (një marrëveshje kontraktuale për të dhënë mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar) dhe një instrument kapitali (një opsjon blerjeje që i jep mbajtësit të drejtën, për një periudhë të specifikuar kohore, për ta konvertuar atë në një numër fiks të aksioneve të zakonshme të njësisë). Efekti ekonomik i emetimit të këtij instrumenti është në thelb i njëjtë me emetimin njëkohësisht të një instrumenti borxhi me një kusht për shlyerje të mëparshme dhe garancinë për të blerë aksione të zakonshme, ose me emetimin e instrumentit të borxhit me garanci të ndashme të blerjes së aksionit. Prandaj, në të gjitha rastet, njësia ekonomike paraqet përbërësit e detyrimit dhe e aktiveve/kapitalit neto veç në pasqyrën e saj të pozicionit financiar.

35. Klasifikimi i një instrumenti të konvertueshëm në përbërësit e tij nuk redaktohet si rezultat i një ndryshimi në gjasat që një opsjon konvertimi do të ushtrohet, edhe kur ushtrimi i opsjonit mund të duket se është bërë ekonomikisht i favorshëm për disa mbajtës. Mbajtësit mund të mos veprojnë gjithmonë në mënyrën që mund të pritet sepse, për shembull, pasojat tatimore që rezultojnë nga konvertimi mund të ndryshojnë midis mbajtësve. Për më tepër, gjasat e konvertimit do të ndryshojnë herë pas here. Detyrimi kontraktual i njësisë për të bërë pagesat e ardhshme mbetet i pashlyer derisa të shuhet nëpërmjet konvertimit, maturimit të instrumentit, ose ndonjë transaksioni tjetër.
36. SNKSP 41 trajton matjen e aktiveve dhe detyrimeve financiare. Instrumentet e kapitalit evidentojnë një interes të mbetur në aktivet e një njësie ekonomike pas zbritjes së të gjitha detyrimeve të saj. Prandaj, kur vlera e mbartur fillestare e një instrumenti financiar të përbërë alokohet në përbërësit e tij, komponentit të aktiveve/kapitalit neto i caktohet shuma e mbetur pasi të jetë zbritur nga vlera e drejtë e instrumentit në tërësi shuma e përcaktuar veç për përbërësin e detyrimit. Vlera e çdo veçorie derivative (si opsjoni i blerjes) i përfshirë në instrumentin financiar të përbërë përfshihet në përbërësin e detyrimit, përveç rastit kur ai është pjesë e përbërësit të aktiveve/kapitalit neto (si opsjoni i konvertimit të kapitalit). Shuma e vlerës së mbartur të caktuar për përbërësit e detyrimit dhe e aktiveve/kapitalit neto në njohjen fillestare është gjithmonë e barabartë me vlerën e drejtë që do t'i atribuohet instrumentit në tërësi. Nuk lind asnjë fitim ose humbje nga njohja fillimisht veç e përbërësve të instrumentit.
37. Sipas metodës së përshkruar në paragrafin 36, emetuesi i një obligacioni të konvertueshëm në aksione të zakonshme përcakton fillimisht vlerën e mbartur të përbërësit të detyrimit duke matur vlerën e drejtë të një detyrimi të ngjashëm (duke përfshirë çdo tipar të përfshirë derivativ jo të kapitalit neto) që nuk ka një komponent të lidhur të aktiveve/kapitalit neto. Vlera e mbartur e instrumentit të kapitalit e përfaqësuar nga opsjoni për të konvertuar instrumentin në aksione të zakonshme përcaktohet më pas duke zbritur vlerën e drejtë të detyrimit financiar nga vlera e drejtë e instrumentit financiar të përbërë në tërësi.

Aksionet e Thesarit (shih gjithashtu paragrafin AG61)

38. **Nëse një njësi riblen instrumentet e saj të kapitalit, ato instrumente (“aksionet e thesarit”) do të zbriten nga aktivet/kapitali neto. Asnjë fitim ose humbje nuk do të njihet në sufiçit ose defiçit në blerjen, shitjen, emetimin, ose anulimin e instrumenteve të kapitalit të vetë një njësisë. Aksione të tilla thesari mund të blihen dhe mbahen nga njësia ose nga anëtarë të tjerë të njësisë ekonomike. Shuma e paguar ose e marrë do të njihet drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto.**
39. Shuma e aksioneve të thesarit të mbajtura paraqitet veç ose në pasqyrën e pozicionit financiar ose në shënimet, në përputhje me SNKSP 1. Një njësi jep informacione shpjeguese në përputhje me SNKSP 20, *Paraqitja e Informacioneve për Palët e Lidhura* nëse njësia riblen instrumentet e saj të kapitalit nga palët e lidhura.

Interesi, Dividendët ose Shpërndarjet, Humbjet dhe Fitimet e Ngjashme (shih gjithashtu paragrafin AG62)

40. **Interesi, dividendët ose shpërndarjet, humbjet dhe fitimet e ngjashme në lidhje me një instrument financiar ose një përbërës që është një detyrim financiar do të njihen si të ardhura ose shpenzime në sufiçit ose defiçit. Shpërndarjet për zotëruesit/mbajtësit e një instrumenti të kapitalit do të njihen nga njësia drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto. Kostot e transaksioneve të bëra për transaksionet në aktivet/kapitalin neto do të llogariten si zbritje nga aktivet/kapitali neto.**
- 40A. Tatimi mbi fitimin në lidhje me shpërndarjet për mbajtësit e një instrumenti të kapitalit dhe me kostot e transaksionit të një transaksioni të kapitalit do të kontabilizohet në përputhje me standardin përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton tatimet mbi të ardhurat.
41. Klasifikimi i një instrumenti financiar si një detyrim financiar ose një instrument kapitali përcakton nëse interesi, dividendët ose shpërndarjet, humbjet, dhe fitimet e ngjashme në lidhje me atë instrument njihen si të ardhura ose shpenzime në sufiçit ose defiçit. Kështu, dividendët ose shpërndarjet e ngjashme mbi aksionet e njohura tërësisht si detyrime njihen si shpenzime në të njëjtën mënyrë si interesi i një obligacioni. Në mënyrë të ngjashme, fitimet dhe humbjet e lidhura me shlyerjet ose rifinancimet e detyrimeve financiare njihen në sufiçit ose defiçit, ndërsa shlyerjet ose rifinancimet e instrumenteve të kapitalit njihen si ndryshime në aktivet/kapitalin neto. Ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti të kapitalit nuk njihen në pasqyrat financiare.
42. Një njësi zakonisht shkakton kosto të ndryshme në emetimin ose blerjen e instrumenteve të veta të kapitalit. Këto kosto mund të përfshijnë regjistrimin dhe tarifatat e tjera rregullatore, shumatat e paguara për këshilltarët ligjorë, kontabël dhe profesionistë të tjerë, kostot e printimit, dhe detyrimet e vulës. Çdo kosto e ndërlidhur e transaksionit kontabilizohet si një zbritje nga aktivet/kapitali neto

në masën që ato janë kosto shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt transaksionit që përndryshe do të ishin shmangur. Kostot e një transaksioni të tillë që braktiset njihen si një shpenzim.

43. Kostot e transaksionit që lidhen me emetimin e një instrumenti financiar të përbërë alokohen te detyrimi dhe përbërësit e aktiveve/kapitalit neto të instrumentit në proporcion me alokimin e të ardhurave. Kostot e transaksionit që lidhen së bashku me më shumë se një transaksion u alokohen atyre transaksioneve duke përdorur një bazë alokimi që është racionale dhe në përputhje me transaksione të ngjashme.
44. Shuma e kostove të transaksionit të kontabilizuar si zbritje nga aktivet/kapitali neto në periudhë paraqitet veç në përputhje me SNKSP 1.
45. Dividendët ose shpërndarjet e ngjashme të klasifikuara si shpenzime paraqiten në pasqyrën e performancës financiare ose me interes mbi detyrimet e tjera ose si një element i veçantë. Përveç kërkesave të këtij Standardi, paraqitja e informacionit për interesat dhe dividendët ose shpërndarjet e ngjashme i nënshtrohet kërkesave të SNKSP 1 dhe SNKSP 30. Në disa rrethana, për shkak të dallimeve ndërmjet interesit dhe dividendëve ose shpërndarjeve të ngjashme në lidhje me çështje të tilla si p.sh. zbritjes tatimore, është e dëshirueshme që ato të paraqiten veç në pasqyrën e performancës financiare.
46. Fitimet dhe humbjet në lidhje me ndryshimet në vlerën e mbartur të një detyrimi financiar njihen si të ardhura ose shpenzime në sufitit ose defisit edhe kur ato lidhen me një instrument që përfshin një të drejtë për interesin e mbetur në aktivet e njësisë në këmbim të mjeteve monetare ose një aktivi tjetër financiar (shih paragrafin 22(b)). Sipas SNKSP 1, njësia paraqet çdo fitim ose humbje që vjen nga rimatja e një instrumenti të tillë veç në pasqyrën e performancës financiare kur është relevante për shpjegimin e performancës së njësisë.

Kompensimi i një Aktivi Financiar dhe një Detyrimi Financiar (shih gjithashtu paragrafët AG63 dhe AG64)

47. **Një aktiv financiar dhe një detyrim financiar do të kompensohen dhe shuma neto do të paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur, një njësi:**
 - (a) **Aktualisht ka një të drejtë të imponueshme ligjërisht për të kompensuar shumat e njohura; dhe**
 - (b) **Synon ose të shlyejë mbi bazën neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.**

Në kontabilizimin e një transferimi të një aktivi financiar që nuk kualifikohet për çregjistrim, njësia nuk duhet të kompensojë aktivin e transferuar dhe detyrimin shoqërues (shih SNKSP 41, paragrafi 33).

48. Ky standard kërkon paraqitjen e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare mbi një bazë neto, kur kjo pasqyron flukset e ardhshme monetare të një njësie

nga shlyerja e dy ose më shumë instrumenteve financiare të veçantë. Kur një njësi ka të drejtë të marrë ose të paguajë një shumë të vetme neto dhe synon ta bëjë këtë, ajo ka, në fakt, vetëm një aktiv financiar ose detyrim financiar të vetëm. Në rrethana të tjera, aktivet financiare dhe detyrimet financiare paraqiten veç nga njëra-tjetra në përputhje me karakteristikat e tyre si burime ose detyrime të njësisë. Një njësi duhet të japë informacionin e kërkuar në paragrafët 17B–17E në SNKSP 30 për instrumentet financiare të njohur që janë brenda fushëveprimit të paragrafit 17A të SNKSP 30.

49. Kompensimi i një aktivi financiar të njohur dhe i një detyrimi financiar të njohur dhe paraqitja e shumës neto ndryshon nga çregjistrimi i një aktivi financiar ose i një detyrimi financiar. Megjithëse kompensimi nuk shkakton njohjen e një fitimi ose humbjeje, çregjistrimi i një instrumenti financiar jo vetëm që rezulton në heqjen e elementit të njohur më parë nga pasqyra e pozicionit financiar, por gjithashtu mund të rezultojë në njohjen e një fitimi ose humbjeje.
50. E drejta e kompensimit është e drejta ligjore e debitorit, me kontratë ose ndryshe, për të shlyer ose eliminuar ndryshe të gjithë ose një pjesë të shumës që i takon kreditorit duke zbatuar kundrejt asaj shume një shumë që i detyrohet kreditorit. Në rrethana të pazakonta, një debitor mund të ketë të drejtën ligjore për të zbatuar një shumë të detyrimit nga një palë e tretë kundrejt shumës që i takon një kreditori me kusht që të ketë një marrëveshje midis tre palëve që përcakton qartë të drejtën e debitorit për kompensim. Për shkak se e drejta e kompensimit është një e drejtë ligjore, kushtet që mbështesin të drejtën mund të ndryshojnë nga një juridiksion ligjor në tjetrin dhe ligjet e zbatueshëm për marrëdhëniet ndërmjet palëve duhet të merren parasysh.
51. Ekzistenca e një të drejte të imponueshme për të kompensuar një aktiv financiar dhe një detyrim financiar ndikon në të drejtat dhe detyrimet që shoqërojnë një aktiv financiar dhe një detyrim financiar dhe mund të ndikojë në ekspozimin e një njësie ekonomike ndaj rrezikut të kredisë dhe likuiditetit. Megjithatë, ekzistenca e së drejtës, në vetvete, nuk është një bazë e mjaftueshme për kompensim. Në mungesë të një synimi për të ushtruar të drejtën ose për të shlyer njëkohësisht, shuma dhe koha e flukseve monetare të ardhshme të një njësie ekonomike nuk ndikohen. Kur një njësi ekonomike synon të ushtrojë të drejtën ose të shlyejë njëkohësisht, paraqitja e aktivitetit dhe detyrimit mbi bazën neto pasqyron në mënyrë më të përshtatshme shumat dhe kohën e flukseve monetare të pritshme në të ardhmen, si dhe rreziqet ndaj të cilave ekspozohen këta flukse monetare. Një synim nga njëra ose të dyja palët për të shlyer në një bazë neto pa të drejtën ligjore për ta bërë këtë nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar kompensimin sepse të drejtat dhe detyrimet që lidhen me aktivin financiar dhe detyrimin financiar individual mbeten të pandryshuara.
52. Synimet e një njësie ekonomike në lidhje me shlyerjen e aktiveve dhe detyrimeve të veçanta mund të ndikohen nga praktikat e saj normale të funksionimit, kërkesat e tregjeve financiare dhe rrethana të tjera që mund të

kufizojnë aftësinë për të shlyer neto ose për të shlyer njëkohësisht. Kur një njësi ekonomike ka të drejtën e kompensimit, por nuk synon të shlyejë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht, efekti i së drejtës në ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë së njësisë ekonomike jepet në informacione shpjeguese në përputhje me paragrafin 42 të SNKSP 30.

53. Shlyerja e njëkohshme e dy instrumenteve financiare mund të ndodhë, për shembull, nëpërmjet funksionimit të një shtëpie kleringu në një treg financiar të organizuar ose një shkëmbimi ballë për ballë. Në këto rrethana, flukset monetare janë, në fakt, ekuivalente me një shumë të vetme neto dhe nuk ka ekspozim ndaj rrezikut të kreditit ose likuiditetit. Në rrethana të tjera, një njësi ekonomike mund të shlyejë dy instrumente duke marrë dhe paguar shumën të veçanta, duke u ekspozuar ndaj rrezikut të kreditit për shumën e plotë të aktivitetit ose rrezikut të likuiditetit për shumën e plotë të detyrimit. Ekspozime të tilla rreziku mund të jenë të rëndësishme edhe pse relativisht të shkurtra. Prandaj, realizimi i një aktiviteti financiar dhe shlyerja e një detyrimi financiar trajtohen si të njëkohshme vetëm kur transaksionet ndodhin në të njëjtin moment.
54. Kushtet e përcaktuar në paragrafin 47 në përgjithësi nuk plotësohen dhe kompensimi është zakonisht i papërshtatshëm kur:
- (a) Disa instrumente të ndryshëm financiarë përdoren për të imituar tiparet e një instrumenti të vetëm financiar (një "instrument sintetik");
 - (b) Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare lindin nga instrumentet financiare që kanë të njëjtin ekspozim primar ndaj rrezikut (p.sh., aktivitetet dhe detyrimet brenda një portofoli kontratash të ardhshme ose instrumente të tjera derivative), por përfshijnë palë të ndryshme;
 - (c) Aktivitetet financiare ose aktive të tjerë janë premtuar si kolateral për detyrimet financiare pa të drejtë tërheqje;
 - (d) Aktivitetet financiare lihen mënjandë në trust nga një debitor me qëllim të përmbushjes së një detyrimi pa qenë pranuar nga kreditori për shlyerjen e detyrimit (p.sh., një marrëveshje fondi ku kontribuohet periodikisht); ose
 - (e) Detyrimet e krijuara si rezultat i ngjarjeve që shkaktojnë humbje pritet të rikuperohen nga një palë e tretë në bazë të një pretendimi të bërë sipas një kontrate siguracioni.
55. Një njësi që ndërmerr një numër transaksionesh të instrumenteve financiare me një palë tjetër të vetme mund të hyjë në një "marrëveshje kryesore që rregullon transaksione të ndërthurur nga marrëveshje të tjera – marrëveshje kryesore e ndërthurur" me atë palë. Një marrëveshje e tillë parashikon një shlyerje të vetme neto të të gjithë instrumenteve financiare të mbuluar nga marrëveshja në rast mospërmbushjeje, ose përfundimi të, ndonjë kontrate. Këto marrëveshje mund të përdoren zakonisht për të ofruar mbrojtje kundër humbjes në rast falimentimi ose rrethanash të tjera që rezultojnë në pamundësinë e palës tjetër për të

përbushur detyrimet e saj. Një marrëveshje kryesore e ndërthurur zakonisht krijon një të drejtë kompensimi që bëhet e imponueshme dhe ndikon në realizimin ose shlyerjen e aktiveve dhe detyrimeve financiare individuale vetëm pas një ngjarjeje të caktuar mospagimi në kohë ose në rrethana të tjera që nuk pritret të krijohen në rrjedhën normale të operacioneve. Marrëveshja kryesore e ndërthurur nuk ofron një bazë për kompensim nëse nuk plotësohen të dy kriteret në paragrafin 47. Kur aktivet financiare dhe detyrimet financiare që i nënshtrohen një marrëveshjeje kryesore të ndërthurur nuk kompensohen, efekti i marrëveshjes në ekspozimin e një njësie ekonomike ndaj rrezikut të kreditit paraqitet në përputhje me paragrafin 42 të SNKSP 30.

Periudha Kalimtare

- 56. [Fshirë]
- 57. [Fshirë]
- 58. [Fshirë]

Data Efektive

- 59. Një njësi duhet të zbatojë këtë Standard për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2013. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2013, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.
- 60. Një njësi nuk do të zbatojë këtë Standard përpara datës 1 janar, 2013, përveçse kur zbaton gjithashtu SNKSP 29 dhe SNKSP 30.
- 60A. Paragrafët 40, 42 dhe 44 u ndryshuan dhe paragrafi 40A u shtua nga *Përmirësime të SNKSP-ve 2014* botuar në janar 2015. Një njësi do t'i zbatojë ato ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2015. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2015, ajo duhet të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.
- 60B. Paragrafët 56, 57, 58 dhe 61 u ndryshuan nga SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas të Drejtave dhe Detyrimeve të Konstatuara* botuar në janar 2015. Një njësi do t'i zbatojë ato ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2017. Zbatimi i mëparshëm lejohet. Nëse një njësi zbaton SNKSP 33 për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2017, ndryshimet do të zbatohen gjithashtu për atë periudhë të mëparshme.
- 60C. SNKSP 35, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara* dhe SNKSP 37, *Marrëveshjet e Përbashkëta* botuar në janar 2015, ndryshuan paragrafët

3(a) dhe AG53. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime kur zbaton SNKSP 35 dhe SNKSP 37.

- 60D. **Paragrafët 7 dhe 8 u fshinë nga *Zbatueshmëria e SNKSP-ve*, botuar në prill 2016.** Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2018. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.
- 60E. **Paragrafi 3 u ndryshua nga SNKSP 39, *Përfitimet e Punonjësve*, botuar në korrik 2016.** Një njësi do të zbatojë këtë ndryshim për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2018. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimin për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 39 në të njëjtën kohë.
- 60F. **Paragrafët 2, 3, 4, 9, 10, 14, 28, 36, 47, 48, AG2 dhe AG55 u ndryshuan, paragrafi AG63 u fshi dhe paragrafët AG63A, AG63B, AG63C, AG63D, AG63F4 u shtuan nga SNKSP 41, botuar në gusht 2018.** Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2022. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2022, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 41 në të njëjtën kohë.
- 60G. **Paragrafi AG23 u ndryshua nga SNKSP 42, *Përfitimet Sociale*, botuar në janar 2019.** Një njësi do ta zbatojë këtë ndryshim në të njëjtën kohë me zbatimin e SNKSP 42.
61. Kur një njësi adopton SNKSP-të e kontabilitetit sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, siç përkufizohet në SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas të Drejtave dhe Detyrimeve të Konstatuara* për qëllime të raportimit financiar pas kësaj date efektive, ky Standard zbatohet për pasqyrat financiare vjetore të njësisë duke mbuluar periudhat që fillojnë në ose pas datës së adoptimit të SNKSP-ve.

Shfuqizimi dhe Zëvendësimi i SNKSP 15 (2001)

62. Ky Standard dhe SNKSP 30 zëvendësojnë SNKSP 15, botuar në vitin 2001. SNKSP 15 mbetet i zbatueshëm derisa SNKSP 28 dhe SNKSP 30 të zbatohen ose të hyjnë në fuqi, cilado qoftë më herët.

SNKSP 29—INSTRUMENTET FINANCIARE: NJOHJA DHE MATJA

Shënime të Mirënjohjes dhe Informacione të Tjera

Ky Standard Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) është hartuar kryesisht nga Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit (SNK) 39, *Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja*, Interpretimi 9 i Komitetit të Interpretimeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IKINRF), *Rivlerësimi i Derivatëve të Përfshirë*, (IKNIRF 9) dhe Interpretimi 16 (IKINRF 16) i KINRF, *Mbrojtjet e një Investimi Neto në një Operacion të Huaj* publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Ekstrakte nga SNK 39, IKNIRF 9 dhe IKNIRF 16 janë riprodhuar në këtë publikim të Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) me lejen e Fondacionit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Teksti i aprovuar i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) është ai i publikuar nga BSNK në gjuhën angleze dhe kopjet mund të merren direkt nga IFRS Foundation, Customer Service, Columbus Building, 7 Westferry Circus, Canary Wharf, London E14 4HD, United Kingdom.

E-mail: publications@ifrs.org

Internet: www.ifrs.org

Të drejtat e autorit për SNRF-të, SNK-të, Draftet e Paraqitura dhe publikime të tjera të BSNK-së i përkasin Fondacionit SNRF.

"SNRF", "SNK", "BSNK", "Fondacioni SNRF", "Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit" dhe "Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar" janë marka tregtare të Fondacionit SNRF dhe nuk duhet të përdoren pa aprovimin e Fondacionit SNRF.

SNKSP 29—INSTRUMENTET FINANCIARE: NJOHJA DHE MATJA

Historia e SNKSP

Ky version përfshin ndryshime që rezultojnë nga SNKSP-të e botuara deri në 31 janar, 2019.

SNKSP 29, *Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja* u publikua në janar 2010.

Që atëherë, SNKSP 29 është ndryshuar nga SNKSP-të e mëposhtme:

- SNKSP 41, *Instrumente Financiare (botuar në gusht 2018)*
- SNKSP 40, *Kombinimet e Sektorit Publik (botuar në janar 2017)*
- SNKSP 39, *Përfitimet e Punonjësve (botuar në korrik 2016)*
- *Zbatueshmëria e SNKSP-ve (botuar në prill 2016)*
- *Përmirësime të SNKSP-ve 2015 (botuar në prill 2016)*
- SNKSP 37, *Marrëveshjet e Përbashkëta (botuar në janar 2015)*
- SNKSP 35, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara (botuar janar 2015)*
- SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (botuar në janar 2015)*
- SNKSP 32, *Marrëveshjet Konçesionare të Shërbimit: Grantdhënësi (botua në tetor 2011)*
- *Përmirësime të SNKSP-ve 2011 (botuar në tetor 2011)*

Tabela e Paragrafëve të Ndryshuar në SNKSP 29

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
Seksioni i parathënies	U Fshi	Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2011
1	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
2	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017 SNKSP 39 Korrik 2016 SNKSP 37 Janar 2015

INSTRUMENTET FINANCIARE: NJOHJA DHE MATJA

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
		SNKSP 35 Janar 2015 SNKSP 32 Tetor 2011 SNKSP 41 Gusht 2018
3	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
4	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
5	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
6	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
7	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
8	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
9	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
10	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
11–79	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
80	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
88	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
89	U Ndryshua	SNKSP 35 Janar 2015
98	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
99	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
101	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
102	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018

INSTRUMENTET FINANCIARE: NJOHJA DHE MATJA

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
107	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
108	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
109	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
111	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
112	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
113	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
114	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
115	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
116	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
117	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
118	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
119	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
120	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
121	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
122	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
123	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
125A	I Ri	SNKSP 32 Tetor 2011
125B	I Ri	SNKSP 33 Janar 2015
125C	I Ri	SNKSP 37 Janar 2015 SNKSP 35 Janar 2015

INSTRUMENTET FINANCIARE: NJOHJA DHE MATJA

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
125D	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Prill 2016
125E	I Ri	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
125F	I Ri	SNKSP 39 Korrik 2016
125G	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
125H	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
126	U Ndryshua	SNKSP 33 Janar 2015
AG35	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017
AG51	U Ndryshua	SNKSP 35 Janar 2015
AG52	U Ndryshua	SNKSP 35 Janar 2015
AG53	U Ndryshua	SNKSP 35 Janar 2015
AG1-AG126	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
AG128	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
AG129	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
AG131	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017
AG134	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
AG156A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG157	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
AG161	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
B1-B7	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
C2	U Ndryshua	SNKSP 37 Janar 2015

INSTRUMENTET FINANCIARE: NJOHJA DHE MATJA

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
A.1–G.2	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
IE32–IE50	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018

**SNKSP 29—INSTRUMENTET FINANCIARE: NJOHJA DHE
MATJA**

PËRMBAJTJA

	Paragrafi
Objektivi	1
Objekti	2–8
Përkufizime	9–10
Derivatvët e Përfshirë	11–15
Njohja dhe Çregjistrimi.....	16–44
Njohja Fillestare.....	16
Çregjistrimi/Mosnjohja e Një Aktivi Financiar	17–39
Transferta që Kualifikohen për Çregjistrim.....	26–30
Transferta që nuk Kualifikohen për Çregjistrim.....	31
Përfshirja e Vazhdueshme në Aktivet e Transferuara.....	32–37
Të gjitha Transfertat	38–39
Blerjet dhe Shitjet e Rregullta të Një Aktivi Financiar	40
Çregjistrimi i një Detyrimi Financiar.....	41–44
Matja.....	45–79
Matja Fillestare e Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare.....	45–46
Matja e Mëpasshme e Aktiveve Financiare	47–48
Matja e Mëpasshme e Detyrimeve Financiare	49
Shumat e Vlerës së Drejtë.....	50–52
Riklasifikime	53–63
Fitimet dhe Humbjet.....	64–66
Zhvlerësimi dhe Mosarkëtimi e Aktiveve Financiare	67–79
Aktivet Financiare të Mbajtura me Kosto të Amortizuar	72–74
Aktivet Financiare të Mbajtur me Kosto	75

INSTRUMENTET FINANCIARE: NJOHJA DHE MATJA

Aktivitet Financiare të Disponueshëm për Shitje.....	76–79
Mbrojtja	80–113
Instrumentet Mbrojtës.....	81–86
Instrumentet Mbrojtës Kualifikues	81–82
Klasifikimi i Instrumenteve Mbrojtës.....	83–86
Artikuj të Mbrojtur	87–94
Artikuj Kualifikues	87–89
Klasifikimi i Artikujve Financiare si Artikuj të Mbrojtur.....	90–91
Klasifikimi i Artikujve Jofinanciare si Artikuj të Mbrojtur	92
Klasifikimi i Grupeve të Artikujve si Artikuj të Mbrojtur.....	93–94
Kontabiliteti Mbrojtës.....	95–113
Mjete Mbrojtës ndaj Vlerës së Drejtë.....	99–105
Mjete Mbrojtës ndaj Flukseve Monetare	106–112
Mjete Mbrojtës të Një Investimi Neto	113
Periudha Kalimtare	114–123
Data Efektive	124–126

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik 29, *Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja*, është përcaktuar në paragrafët 1–126. Të gjithë paragrafët kanë autoritet të barabartë. SNKSP 29 duhet lexuar në kontekstin e objektivit të tij, Bazës për Konkluzione, *Parathënies së Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik*, dhe *Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar me Qëllim të Përgjithshëm nga Njësitë e Sektorit Publik*. SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, jep një bazë për zgjedhjen dhe zbatimin e politikave të kontabilitetit në mungesë të udhëzimeve të qarta.

Objektivi

1. [Fshirë]

Objekti

2. **Ky Standard do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjitha instrumentet financiare brenda fushëveprimit të SNKSP 41, *Instrumentet Financiare* nëse, dhe në masën që:**

- (a) **SNKSP 41 lejon që kërkesat e kontabilitetit mbrojtës të këtij Standardi të zbatohen; dhe**
- (b) **Instrumenti financiar është pjesë e një marrëdhënieje mbrojtëse që kualifikohet për kontabilitet mbrojtës në përputhje me këtë Standard.**

3–8 [Fshirë]

Përkufizime

9. Termat e përcaktuar në SNKSP 28 dhe SNKSP 41 përdoren në këtë Standard me kuptimet e specifikuara në paragrafin 9 të SNKSP 28 dhe paragrafin 9 të SNKSP 41. SNKSP 28 dhe SNKSP 41 përcaktojnë termat e mëposhtëm:

- Kostoja e amortizuar e një aktivi financiar ose detyrimi financiar;
- Çregjistrimi/Mosnjohja;
- Derivativi;
- Metoda e interesit efektiv;
- Norma efektive e interesit;
- Instrument kapitali;
- Aktiv financiar;
- Instrument financiar;
- Detyrim financiar;
- Angazhim i palëkundur;
- Transaksion parashikimi;

dhe jep udhëzime për zbatimin e këtyre përkufizimeve.

10. **Termat e mëposhtëm përdoren në këtë Standard me kuptimet e specifikuara:**

Përkufizime që kanë të bëjnë me kontabilitetin mbrojtës

Një **instrument mbrojtës** është një derivativ i caktuar ose (vetëm për një mbrojtje nga rreziku i ndryshimeve në kursin e këmbimit në monedhë të huaj) një aktiv financiar joderivativ ose detyrim financiar joderivativ i caktuar, vlera e drejtë ose flukset monetare të të cilit pritet të kompensojnë ndryshimet në vlerën e drejtë ose flukset monetare të një elementi të mbrojtur të caktuar (paragrafët 81–86 dhe paragrafët e Shtojcës A AG127–AG130 shtjellojnë përkufizimin e një instrumenti mbrojtës).

Një **element i mbrojtur** është një aktiv, detyrim, angazhim i fortë/solid/i vendosur, një transaksion parashikues shumë i mundshëm, ose një investim neto në një operacion të huaj që (a) e ekspozon njësinë ekonomike ndaj rrezikut të ndryshimeve në vlerën e drejtë ose flukseve monetare të ardhshëm dhe (b) përcaktohet si i mbrojtur (paragrafët 87–94 dhe shtojca A, paragrafët AG131–AG141 shtjellojnë përkufizimin e elementeve të mbrojtur).

Efektiviteti i mbrojtjes është shkalla në të cilën ndryshimet në vlerën e drejtë ose flukset monetare të elementit të mbrojtur që i atribuohen një rreziku të mbrojtur kompensohen nga ndryshimet në vlerën e drejtë ose flukset monetare të instrumentit mbrojtës (shih Shtojcën A paragrafët AG145–AG156).

Termet e përcaktuar në SNKSP-të e tjera përdoren në këtë Standard me të njëjtin kuptim si në ato Standarde dhe riprodhohen në Fjalorin e Termave të Përkufizuar *Fjalorin e Termave të Përkufizuar* të publikuar veçmas.

11–79. [Fshirë]

Mbrojtja

80. Nëse një njësi zbaton SNKSP 41 dhe nuk ka zgjedhur si politikë të saj të kontabilitetit të vazhdojë të zbatojë kërkesat e kontabilitetit mbrojtës të këtij Standardi (shih paragrafin 177 të SNKSP 41), ajo do të zbatojë kërkesat e kontabilitetit mbrojtës në paragrafët 113–155 të SNKSP 41. Megjithatë, për një mbrojtje ndaj vlerës së drejtë të ekspozimit ndaj normës së interesit të një pjese të një portofoli aktivesh financiare ose detyrimesh financiare, një njësi ekonomike mund, në përputhje me paragrafin 115 të SNKSP 41, të zbatojë kërkesat e kontabilitetit mbrojtës në këtë Standard në vend të atyre në SNKSP 41. Në atë rast, njësia ekonomike duhet të zbatojë gjithashtu kërkesat specifike për kontabilizimin mbrojtjes ndaj vlerës së drejtë për një mbrojtje portofoli të rrezikut të normës së interesit (shih paragrafët 91, 100 dhe AG157–AG175).

Instrumentet Mbrojtës

Instrumentet Kualifikues

81. Ky Standard nuk kufizon rrethanat në të cilat një derivativ mund të klasifikohet

si një instrument mbrojtës me kusht që të plotësohen kushtet në paragrafin 98, me përjashtim të disa opsioneve të shkruar (shih Shtojcën A paragrafin AG127). Megjithatë, një aktiv financiar joderivativ ose një detyrim financiar joderivativ mund të klasifikohen si një instrument mbrojtës vetëm për një mbrojtje të një rreziku të monedhës së huaj.

82. Për qëllime të kontabilitetit mbrojtës, vetëm instrumentet që përfshijnë një palë të jashtme të njësisë ekonomike raportuese (d.m.th., të jashtme të njësisë ekonomike ose njësisë ekonomike individuale për të cilën raportohet) mund të klasifikohen si instrumente mbrojtës. Megjithëse njësitë ekonomike individuale brenda një njësie ekonomike ose divizionet brenda një njësie ekonomike mund të hyjnë në transaksione mbrojtëse me njësi të tjera brenda njësisë ekonomike ose divizione brenda njësisë ekonomike, çdo transaksion i tillë brenda njësisë ekonomike eliminohet në konsolidim. Prandaj, transaksione të tilla mbrojtëse nuk kualifikohen për kontabilitet mbrojtës në pasqyrat financiare të konsoliduara të njësisë ekonomike. Megjithatë, ata mund të kualifikohen për kontabilitet mbrojtës në pasqyrat financiare individuale ose të veçanta të njësisë ekonomike brenda njësisë ekonomike me kusht që ata të jenë të jashtëm ndaj njësisë ekonomike individuale për të cilën raportohet.

Klasifikimi i Instrumenteve Mbrojtës

83. Zakonisht ekziston një matës i vetëm i vlerës së drejtë për një instrument mbrojtës në tërësinë e tij, dhe faktorët që shkaktojnë ndryshime në vlerën e drejtë janë të ndërvarur. Kështu, një marrëdhënie mbrojtëse përcaktohet nga një njësi ekonomike për një instrument mbrojtës në tërësinë e tij. Përjashtimet e vetme të lejuara janë:

- (a) Ndarja e vlerës së brendshme dhe vlerës në kohë të një kontrate opsioni dhe klasifikimi/përcaktimi si instrument mbrojtës vetëm i ndryshimit në vlerën e brendshme të një opsioni dhe përjashtimi i ndryshimit në vlerën e tij në kohë; dhe
- (b) Ndarja e elementit të interesit dhe çmimit aktual në treg të një kontrate të ardhshme.

Këta përjashtime lejohen sepse vlera e brendshme e opsionit dhe primi i ardhshëm në përgjithësi mund të maten veç. Një strategji mbrojtëse dinamike që vlerëson vlerën e brendshme dhe vlerën në kohë të një kontrate opsioni mund të kualifikohet për kontabilitetin mbrojtës.

84. Një pjesë e të gjithë instrumentit mbrojtës, si 50 për qind e shumës së vlerësuar, mund të përcaktohet si instrument mbrojtës në një marrëdhënie mbrojtëse. Megjithatë, një marrëdhënie mbrojtëse nuk mund të përcaktohet vetëm për një pjesë të periudhës kohore gjatë së cilës një instrument mbrojtës mbetet i papaguar.
85. Një instrument i vetëm mbrojtës mund të përcaktohet/klasifikohet si një mbrojtje

e më shumë se një lloj rreziku me kusht që (a) rreziqet e mbrojtura të mund të identifikohen qartë; (b) efektiviteti i mbrojtjes mund të demonstrohet; dhe (c) është e mundur të sigurohet se ka përcaktim/klasifikim specifik të instrumentit mbrojtës dhe pozicioneve të ndryshme të rrezikut.

86. Dy ose më shumë derivativë ose proporcione të tyre, (në rastin e mbrojtjes nga rreziku i monedhës, dy ose më shumë joderivativë ose proporcione të tyre, ose një kombinim të derivativëve dhe joderivativëve ose proporcioneve të tyre), mund të shihen në kombinim dhe të përcaktohen së bashku si një instrument mbrojtës, duke përfshirë edhe rastet kur rreziqet që lindin nga disa derivativë kompensojnë ata që lindin nga të tjerë derivativë. Megjithatë, kufijtë e investimit me interes ose instrumente të tjerë derivativë, që kombinojnë një opSION të shkruar me një opSION blerjeje nuk kualifikohen si instrument mbrojtës në qoftë se është, në fakt, një opSION i shkruar neto (për të cilin merret një prim neto). Në mënyrë të ngjashme, dy ose më shumë instrumente (ose pjesë të tyre) mund të klasifikohen/përcaktohen si instrumente mbrojtës vetëm nëse asnjëri prej tyre nuk është opSION i shkruar ose opSION i shkruar neto.

Zërat e mbrojtur

Zërat kualifikues

87. Një zë i mbrojtur mund të jetë një aktiv ose detyrim i njohur, një angazhim i palëkundur i panjohur, një transaksion i parashikuar shumë i mundshëm ose një investim neto në një operacion të huaj. Zëri i mbrojtur mund të jetë (a) një aktiv i vetëm, një detyrim, një angazhim i përcaktuar, një transaksion parashikues me probabilitet të lartë ose një investim neto në një njësi ekonomike të huaj, (b) një grup aktivesh, pasivesh, angazhimesh të përcaktuara, transaksionesh parashikuese me probabilitet të lartë ose investimesh neto në njësi ekonomike të huaja, me karakteristika të njëjta rreziku ose (c) në një portofol mbrojtës nga rreziku i normës së interesit, vetëm një pjesë e portofolit të aktiveve financiare ose pasiveve financiare që ndajnë rrezikun nga i cili janë të mbrojtur.
88. [Fshirë]
89. Për qëllime të kontabilitetit mbrojtës, vetëm aktivet, detyrimet, angazhimet e përcaktuara ose transaksionet që parashikohen me një probabilitet të lartë të cilat përfshijnë një palë të jashtme për njësinë ekonomike mund të përcaktohen si zëra të mbrojtur. Si pasojë kontabiliteti mbrojtës mund të zbatohet për transaksionet ndërmjet njësisë në të njëjtin njësi ekonomike vetëm në pasqyrat financiare individuale ose të veçanta të këtyre njësisë dhe jo në pasqyrat financiare të konsoliduara të njësisë ekonomike, përveç pasqyrave financiare të konsoliduara të një njësie ekonomike investuese siç përcaktohet në SNKSP 35, ku transaksionet ndërmjet një njësie ekonomike investuese dhe njësisë ekonomike të kontrolluara të saj të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit nuk do të eliminohen në pasqyrat financiare të konsoliduara. Si një përjashtim, rreziku i monedhës së huaj i elementit monetar brenda një njësie

ekonomike (p.sh. një i pagueshëm/i arkëtueshëm ndërmjet dy njësive të kontrolluara) mund të kualifikohet si një element i mbrojtur në pasqyrat financiare të konsoliduara nëse rezulton në një ekspozim ndaj fitimeve ose humbjeve nga kursi i këmbimit valutor që nuk janë eliminuar plotësisht gjatë konsolidimit në përputhje me SNKSP 4, *Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit në Monedhë të Huaj*. Në përputhje me SNKSP 4, fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit të elementeve monetare brenda një njësie ekonomike nuk eliminohen plotësisht në konsolidim kur elementi monetar tregtohet ndërmjet dy njësive brenda njësisë ekonomike që kanë monedha të ndryshme funksionale. Gjithashtu, rreziku i monedhës së huaj i një transaksioni të parashikuar shumë të mundshëm brenda njësisë ekonomike mund të kualifikohet si një element i mbrojtur në pasqyrat financiare të konsoliduara me kusht që transaksioni të jetë i shprehur në një monedhë të ndryshme nga monedha funksionale e njësisë ekonomike që hyn në atë transaksion dhe rreziku i monedhës së huaj do të ndikojë në suficitin ose deficitin e konsoliduar.

Klasifikimi i Elementeve Financiare si Elemente të Mbrojtur

90. Nëse elementi i mbrojtur është një aktiv financiar ose detyrim financiar, ai mund të jetë një element i mbrojtur në lidhje me rreziqet që shoqërohen me vetëm një pjesë të flukseve monetare të tij ose të vlerës së drejtë (të tilla si një ose më shumë flukse monetare kontraktuale të zgjedhur ose pjesë të tyre ose një përqindje e vlerës së drejtë) me kusht që efektiviteti të mund të matet. Për shembull, një pjesë e identifikueshme dhe e matshme veç e ekspozimit ndaj normës së interesit të një aktivi ose detyrimi me interes mund të klasifikohet si rrezik i mbrojtur (siç është një normë interesi pa rrezik ose një komponent i normës së interesit bazë të ekspozimit total ndaj normës së interesit të një instrumenti financiar të mbrojtur).
91. Në një mbrojtje me vlerë të drejtë të ekspozimit të normës së interesit të një portofoli aktivesh financiare ose detyrimesh financiare (dhe vetëm në një mbrojtje të tillë), pjesa e mbrojtur mund të përcaktohet në termat e një shume të një monedhe (p.sh., një shumë dollarësh, eurosh, paundësh ose randësh) dhe jo si aktive (ose detyrime) individuale. Megjithëse portofoli, për qëllime të menaxhimit të rrezikut, mund të përfshijë aktive dhe detyrime, shuma e përcaktuar është një shumë aktivesh ose një shumë detyrimesh. Përcaktimi i një shume neto që përfshin aktivet dhe detyrimet nuk lejohet. Njësia mund të mbrojë një pjesë të rrezikut të normës së interesit të shoqëruar me këtë shumë të caktuar. Për shembull, në rastin e një mbrojtjeje të një portofoli që përmban aktive të parapagueshme, njësia mund të mbrojë ndaj ndryshimit në vlerën e drejtë që i atribuohet një ndryshimi në normën e interesit të mbrojtur në bazë të datave të pritshme dhe jo datave kontraktuale të ripërcatimit të çmimit. Kur pjesa e mbrojtur bazohet në datat e pritshme të ripërcaktimit të çmimit, efekti që kanë ndryshimet në normën e interesit të mbrojtur në ato data të pritshme të ripërcaktimit të çmimit do të përfshihet kur të përcaktohet ndryshimi në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur. Rrjedhimisht, nëse një portofol që përmban

artikuj të parapagueshëm është i mbrojtur me një derivativ jo të parapagueshëm, joefektiviteti lind nëse datat në të cilat artikujt në portofolin e mbrojtur pritet të parapagohen ndryshohen, ose datat aktuale të parapagimit ndryshojnë nga ato të pritura.

Klasifikimi i Elementëve Jofinanciare si Elementë të Mbrojtur

92. **Nëse elementi i mbrojtur është një aktiv jofinanciar ose detyrim jofinanciar, ai do të klasifikohet/përcaktohet si një element i mbrojtur (a) për rreziqet e monedhës së huaj, ose (b) në tërësi për të gjitha rreziqet, për shkak të vështirësisë së izolimit dhe matjes së pjesës së duhur të flukseve monetare ose të ndryshimeve në vlerën e drejtë që i atribuohen rreziqeve specifike të ndryshme nga rreziqet e monedhës së huaj.**

Klasifikimi i Grupeve të Elementëve si Elementë të Mbrojtur

93. Aktive të ngjashme ose detyrime të ngjashme do të grupohen dhe mbrohen si grup vetëm nëse aktivet individuale ose detyrimet individuale në grup kanë të përbashkët ekspozimin ndaj rrezikut që është përcaktuar si ai ndaj të cilit po mbrohen. Për më tepër, ndryshimi në vlerën e drejtë që i atribuohet rrezikut nga i cili mbrohet çdo element individual në grup pritet të jetë afërsisht proporcional me ndryshimin e përgjithshëm në vlerën e drejtë që i atribuohet rrezikut ndaj të cilit mbrohet grupi i elementeve.
94. Për shkak se një njësi ekonomike vlerëson efektivitetin e mbrojtjes duke krahasuar ndryshimin në vlerën e drejtë ose fluksin monetar të një instrumenti mbrojtës (ose grupi instrumentesh të ngjashëm mbrojtës) dhe një elementi të mbrojtur (ose grup artikujsh të ngjashëm të mbrojtur), duke krahasuar një instrument mbrojtës me një pozicion neto të përgjithshëm (p.sh., netoja e të gjitha aktiveve me normë fikse dhe detyrimeve me normë fikse me maturime të ngjashme), në vend të një elementi të mbrojtur specifik, nuk kualifikohet për kontabilitet mbrojtës.

Kontabiliteti Mbrojtës

95. Kontabiliteti mbrojtës njihet efektet kompensuese mbi defiçitin ose defiçitin e ndryshimeve në vlerat e drejta të instrumentit mbrojtës dhe të elementit të mbrojtur.
96. **Marrëdhëniet mbrojtëse janë të tre llojeve:**
- (a) **Mbrojtja ndaj vlerës së drejtë: një mbrojtje e ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e drejtë të një aktivi ose detyrimi të njohur ose të një angazhimi të palëkundur të panjohur, ose të një pjese të identifikuar të një aktivi, detyrimi, ose angazhimi të fortë, që i atribuohet një rreziku të veçantë dhe mund të ndikojë defiçitin.**
 - (b) **Mbrojtja ndaj flukseve monetare: një mbrojtje e ekspozimit ndaj**

ndryshueshmërisë në flukset monetare që (i) i atribuohet një rreziku të veçantë të shoqëruar me një aktiv ose detyrim të njohur (të tilla si të gjitha ose disa pagesa të ardhshme të interesit për borxhin me normë të ndryshueshme) ose një transaksion shumë të mundshëm të parashikuar dhe (ii) mund të ndikojë mbi suficiçtin ose defiçitin.

(c) Mbrojtja e një investimi neto në një operacion të huaj siç përcaktohet në SNKSP 4.

97. Një mbrojtje e rrezikut të monedhës së huaj të një angazhimi të palëkundur mund të kontabilizohet si një mbrojtje ndaj vlerës së drejtë ose si një mbrojtje ndaj flukseve monetare.

98. Një marrëdhënie mbrojtëse kualifikohet për kontabilitetin mbrojtës sipas paragrafëve 99-113 nëse, dhe vetëm nëse, plotësohen të gjithë kushtet e mëposhtëm.

(a) Në fillim të mbrojtjes ka klasifikim/përcaktim dhe dokumentim zyrtar të marrëdhënies mbrojtëse dhe objektivit e strategjisë së menaxhimit të rrezikut të njësisë për ndërmarrjen e mbrojtjes. Ky dokumentacion do të përfshijë identifikimin e instrumentit mbrojtës, elementin ose transaksionin e mbrojtur, natyrën e rrezikut ndaj të cilit mbrohet dhe mënyrën se si njësia do të vlerësojë efektivitetin e instrumentit mbrojtës në kompensimin e ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur ose flukseve monetare që i atribuohen rrezikut ndaj të cilit mbrohet.

(b) Mbrojtja pritet të jetë shumë efektive (shih Shtojcën A paragrafët AG145–AG156) në arritjen e ndryshimeve kompensuese në vlerën e drejtë ose flukset monetare që i atribuohen rrezikut të mbrojtur, në përputhje me strategjinë e menaxhimit të rrezikut të dokumentuar fillimisht për atë marrëdhënie të veçantë mbrojtëse.

(c) Për mbrojtjen e flukseve monetare, një transaksion i parashikuar që është objekt i mbrojtjes duhet të jetë shumë i mundshëm dhe duhet të prezantojë një ekspozim ndaj variacioneve në flukset monetare që mund të ndikojnë përfundimisht te suficiçti ose defiçiti.

(d) Efektiviteti i mbrojtjes mund të matet në mënyrë të besueshme, d.m.th., vlera e drejtë ose flukset monetare të elementit të mbrojtur që janë të atribuueshëm ndaj rrezikut ndaj të cilit mbrohet dhe vlerës së drejtë e instrumentit mbrojtës mund të matet me besueshmëri.

(e) Mbrojtja vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme dhe përcaktohet në fakt se ka qenë shumë efektive përgjatë periudhave të raportimit financiar për të cilat mbrojtja është caktuar.

Mbrojtja e Vlerës së Drejtë

99. Nëse një mbrojtje ndaj vlerës së drejtë plotëson kushtet në paragrafin 98 gjatë periudhës, ajo do të kontabilizohet si më poshtë:

- (a) **Fitimi ose humbja nga rimatja e instrumentit mbrojtës me vlerën e drejtë (për një instrument mbrojtës derivativ) ose përbërësi i monedhës së huaj të vlerës të tij së mbartur të matur në përputhje me SNKSP 4 (për një instrument mbrojtës joderivativ) do të njihet në sufiçit ose defiçit; dhe**
- (b) **Fitimi ose humbja nga elementi i mbrojtur që i atribuohet rrezikut ndaj të cilit mbrohet do të rregullojë vlerën e mbartur të elementit të mbrojtur dhe do të njihet në sufiçit ose defiçit.**

Kjo vlen nëse elementi i mbrojtur matet me kosto. Njohja e fitimit ose humbjes që i atribuohet rrezikut të mbrojtur në sufiçit ose defiçit zbatohet nëse elementi i mbrojtur është një aktiv financiar i matur me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto në përputhje me paragrafin 41 të SNKSP 41.

100. Për një mbrojtje ndaj vlerës së drejtë të ekspozimit të normës së interesit të një pjese të një portofoli aktivesh ose detyrimesh financiare (dhe vetëm në një mbrojtje të tillë), kërkesa në paragrafin 99(b) mund të plotësohet duke prezantuar fitimin ose humbjen që i atribuohet elementit të mbrojtur ose:

- (a) Në një rresht të vetëm të veçantë brenda aktiveve, për ato periudha kohore të ripërcaktimit të çmimit për të cilat elementi i mbrojtur është një aktiv; ose
- (b) Në një rresht të vetëm të veçantë brenda detyrimeve, për ato periudha kohore të ripërcaktimit të çmimit për të cilat elementi i mbrojtur është një detyrim.

Zërat e rreshtave të veçantë të përmendur në (a) dhe (b) më sipër do të prezantohen pranë aktiveve financiare ose detyrimeve financiare. Shumat e përfshira në këta zëra do të hiqen nga pasqyra e pozicionit financiar kur aktivet ose detyrimet me të cilat lidhen çregjistrohen.

101. Nëse mbulohen vetëm rreziqe të veçanta që i atribuohen një elementi të mbrojtur, ndryshimet e njohura në vlerën e drejtë të elementit të mbrojtur që nuk lidhen me rrezikun ndaj të cilit mbrohet njihen siç përcaktohet në paragrafin 101 të SNKSP 41.

102. **Një njësi do të ndërpresë në mënyrë prospektive kontabilitetin mbrojtës të specifikuar në paragrafin 99 nëse:**

- (a) **Instrumenti mbrojtës skadon ose shitet, përfundon ose ekzekutohet. Për këtë qëllim, zëvendësimi ose kalimi i një instrumenti mbrojtës në një instrument tjetër mbrojtës nuk është një skadim ose përfundim nëse një zëvendësim ose kalim i tillë është pjesë e strategjisë**

mbrojtëse të dokumentuar të njësisë. Për më tepër, për këtë qëllim nuk ka një skadim ose përfundim të instrumentit mbrojtës nëse:

- (i) Si konsekuencë e ligjeve ose rregulloreve ose hyrjes në fuqi të ligjeve ose rregulloreve, palët në instrumentin mbrojtës bien dakord që një ose më shumë kundërpalë kleringu të zëvendësojnë kundërpalën e tyre origjinale për t'u bërë kundërpalë e re për secilën nga palët. Për këtë qëllim, një kundërpalë kleringu është një kundërpalë qendrore (nganjëherë quhet 'organizatë kleringu' ose 'agjensi kleringu') ose një njësi ose disa njësi, për shembull, një anëtar kleringu i një organizate kleringu ose një klient i një anëtarit kleringu të një organizatës së kleringut, të cilat veprojnë si kundërpalë për të kryer klerimin nga një kundërpalë qendrore. Megjithatë, kur palët në instrumentin mbrojtës zëvendësojnë kundërpalët e tyre origjinale me kundërpalë të ndryshme, ky paragraf do të zbatohet vetëm nëse secila prej këtyre palëve kryen klerim me të njëjtën kundërpalë qendrore.
 - (ii) Ndryshime të tjerë, nëse ka, në instrumentin mbrojtës janë të kufizuara në ato që janë të nevojshme për të realizuar një zëvendësim të tillë të kundërpalës. Ndryshime të tilla janë të kufizuara në ato që janë në përputhje me kushtet që do të priteshin nëse instrumenti mbrojtës do të aprovohej fillimisht me kundërpalën e kleringut. Këta ndryshime përfshijnë ndryshime në kërkesat e kolateralit, të drejtat për të kompensuar balancat e të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve, dhe tarifat e vendosura.
- (b) Mbrojtja nuk i plotëson më kriteret për kontabilitetin mbrojtës në paragrafin 98; ose
- (c) Njësia revokon klasifikimin/përcaktimin.

103. Çdo rregullim që vjen nga paragrafi 99(b) në vlerën e mbartur të një instrumenti financiar të mbrojtur për të cilin përdoret metoda e interesit efektiv (ose, në rastin e një mbrojtjeje portofoli të rrezikut të normës së interesit, në elementin përkatës të veçantë në pasqyrën e pozicionit financiar përshkruar në paragrafin 100) do të amortizohet në sufiçit ose defiçit. Amortizimi mund të fillojë sapo të ekzistojë një rregullim dhe do të fillojë jo më vonë se kur elementi i mbrojtur ndalon së qeni i rregulluar për ndryshimet në vlerën e tij të drejtë që i atribuohen rrezikut nga i cili mbrohet. Rregullimi bazohet në një normë interesi efektive të rillogaritur në datën e fillimit të amortizimit. Megjithatë, nëse, në rastin e një mbrojtjeje ndaj vlerës së drejtë të ekspozimit të normës së interesit të një portofoli aktivesh ose detyrimesh financiare (dhe vetëm në një mbrojtje të tillë), amortizimi duke përdorur një normë interesi efektive të rillogaritur

nuk është i praktikueshëm, rregullimi do të amortizohet duke përdorur metodën lineare. Rregullimi do të amortizohet plotësisht deri në maturimin e instrumentit financiar ose, në rastin e një mbrojtjeje portofoli të rrezikut të normës së interesit, deri në skadimin e periudhës kohore përkatëse të ripërcaktimit të çmimit.

104. Kur një angazhim i palëkundur i panjohur klasifikohet si një element i mbrojtur, ndryshimi i mëpasshëm kumulativ në vlerën e drejtë të angazhimit të palëkundur që i atribuohet rrezikut nga i cili mbrohet njihet si një aktiv ose detyrim me një fitim ose humbje korresponduese të njohur në sufiçit ose defiçit (shih paragrafin 99 (b)). Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës njihen gjithashtu në sufiçit ose defiçit.
105. Kur një njësi ekonomike hyn në një angazhim të palëkundur për të blerë një aktiv ose për të marrë një detyrim që është një element i mbrojtur në një mbrojtje ndaj vlerës së drejtë, vlera e mbartur fillestare e aktivit ose detyrimit që rezulton nga përmbushja e angazhimit të vendosur nga njësia ekonomike rregullohet për të përfshirë ndryshimin kumulativ në vlerën e drejtë të angazhimit të vendosur që i atribuohet rrezikut nga i cili mbrohet që u njoh në pasqyrën e pozicionit financiar.

Mbrojtja e Flukseve Monetare

106. **Nëse një element mbrojtës i flukseve monetare plotëson kushtet në paragrafin 98 gjatë periudhës, ai do të kontabilizohet si më poshtë:**
- (a) **Pjesa e fitimit ose humbjes në instrumentin mbrojtës që përcaktohet të jetë një mbrojtje efektive (shih paragrafin 98) do të njihet drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto nëpërmjet pasqyrës së ndryshimeve në aktivet/kapitalin neto; dhe**
 - (b) **Pjesa joefektive e fitimit ose humbjes në instrumentin mbrojtës do të njihet si sufiçit ose defiçit.**
107. Më konkretisht, një mjet mbrojtës ndaj flukseve monetare kontabilizohet si më poshtë:
- (a) Komponenti i veçantë i aktiveve/kapitalit neto të shoqëruar me elementin e mbrojtur rregullohet me më të voglën nga sa vijon (në shuma absolute):
 - (i) Fitimit ose humbjes kumulative të instrumentit mbrojtës që nga fillimi i mbrojtjes; dhe
 - (ii) Ndryshimi kumulativ në vlerën e drejtë (vlerën aktuale) të flukseve monetare të pritshëm në të ardhmen mbi elementin e mbrojtur që nga fillimi i mbrojtjes;
 - (b) Çdo fitim ose humbje e mbetur në instrumentin mbrojtës ose përbërës të caktuar të tij (që nuk është një mbrojtje efektive) njihet në sufiçit ose defiçit; dhe
 - (c) Nëse strategjia e dokumentuar e menaxhimit të rrezikut të një njësie

ekonomike për një marrëdhënie të veçantë mbrojtëse përjashton nga vlerësimi i efektivitetit të mbrojtjes një komponent specifik të fitimit ose humbjes ose flukseve monetare të shoqëruara me instrumentin mbrojtës (shih paragrafët 83, 84 dhe 98(a)), ai komponent i përjashtuar i fitimit ose humbjes njihet në përputhje me paragrafin 101 të SNKSP 41.

108. Nëse një mbrojtje e një transaksioni të parashikuar rezulton më pas në njohjen e një aktivi financiar ose një detyrimi financiar, fitimet ose humbjet e shoqëruara që janë njohur drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto në përputhje me paragrafin 106 do të riklasifikohen në sufiçit ose defiçit si një rregullim riklasifikimi në të njëjtën periudhë ose periudha gjatë të cilave flukset monetare të parashikuara të mbrojtura ndikojnë te sufiçiti ose defiçiti (si në periudhat kur njihen të ardhurat nga interesi ose shpenzimet nga interesi). Megjithatë, nëse një njësi ekonomike pret që e gjithë ose një pjesë e një humbjeje të njohur drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto nuk do të rikuperohet në një ose më shumë periudha të ardhshme, ajo do ta riklasifikojë në sufiçit ose defiçit si një rregullim riklasifikimi shumë të nuk pritet të rikuperohet.
109. Nëse një mbrojtje e një transaksioni të parashikuar më pas rezulton në njohjen e një aktivi jofinanciar ose një detyrimi jofinanciar, ose një transaksion i parashikuar për një aktiv jofinanciar ose detyrim jofinanciar bëhet një angazhim i palëkundur për të cilin kontabiliteti mbrojtës ndaj vlerës së drejtë zbatohet, atëherë njësia do të adoptojë (a) ose (b) më poshtë:
- (a) Njësia riklasifikon fitimet dhe humbjet shoqëruese që janë njohur drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto në përputhje me paragrafin 106 në sufiçit ose defiçit si një rregullim riklasifikimi në të njëjtën periudhë ose periudha gjatë të cilave aktivi i blerë ose detyrimi i marrë ndikon mbi sufiçitin ose defiçitin (si p.sh. në periudhat kur amortizimi ose inventarët njihen si shpenzim). Megjithatë, nëse një njësi ekonomike pret që e gjithë ose një pjesë e një humbjeje të njohur drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto nuk do të rikuperohet në një ose më shumë periudha të ardhshme, ajo duhet të riklasifikojë nga aktivet/kapitali neto në sufiçit ose defiçit si një rregullim riklasifikimi që nuk pritet të rikuperohet.
 - (b) Njësia heq fitimet dhe humbjet shoqëruese që ishin njohur drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto në përputhje me paragrafin 106 dhe i përfshin ato në koston fillestare ose vlerën tjetër të mbartur të aktivit ose detyrimit.
110. Një njësi do të zbatojë ose (a) ose (b) në paragrafin 109 si politikën e saj kontabël dhe do ta zbatojë atë në mënyrë të qëndrueshme për të gjitha mjetet mbrojtës me të cilat lidhet paragrafi 109.
111. Për mbrojtjen e flukseve monetare të ndryshëm nga ata të mbuluar nga

paragrafët 108 dhe 109, shumat që ishin njohur drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto do të njihen si sufiçit ose defiçit si një rregullim riklasifikimi në të njëjtën periudhë ose periudha gjatë të cilave flukset monetare të parashikuar të mbrojtur ndikojnë sufiçitin ose defiçitin (p.sh., kur ndodh një shitje e parashikuar).

112. Në secilën nga rrethanat e mëposhtme, një njësi ekonomike duhet të ndërpresë në mënyrë prospektive kontabilitetin mbrojtës të specifikuar në paragrafët 106-111:

- (a) Instrumenti mbrojtës skadon ose shitet, përfundon ose ushtrohet. Në këtë rast, fitimi ose humbja kumulative në instrumentin mbrojtës që mbetet e njohur drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto që nga periudha kur mbrojtja ishte efektive (shih paragrafin 106(a)) do të mbetet e njohur veç në aktivet/kapitalin neto deri kur transaksioni i parashikuar ndodh. Kur ndodh transaksioni, zbatohet paragrafi 108, 109, ose 111. Për qëllimin e këtij nënparagrafi, zëvendësimi ose kalimi i një instrumenti mbrojtës në një instrument tjetër mbrojtës nuk është një skadim ose përfundim nëse një zëvendësim ose kalim i tillë është pjesë e strategjisë mbrojtëse të dokumentuar të njësisë. Për më tepër, për qëllimin e këtij nënparagrafi nuk ka një skadim ose përfundim të instrumentit mbrojtës nëse:
- (i) Si pasojë e ligjeve ose rregulloreve ose hyrjes në fuqi të ligjeve ose rregulloreve, palët në instrumentin mbrojtës bien dakord që një ose më shumë kundërpalë kleringu të zëvendësojnë kundërpalën e tyre origjinale për t'u bërë kundërpalë e re për secilën nga palët. Për këtë qëllim, një kundërpalë kleringu është një kundërpalë qendrore (nganjëherë quhet 'organizatë kleringu' ose 'agjensi kleringu') ose një njësi ose disa njësi, për shembull, një anëtar kleringu i një organizate kleringu ose një klient i një anëtari kleringu të një organizatave të kleringut, të cilat veprojnë si kundërpalë për të kryer klerimin nga një kundërpalë qendrore. Megjithatë, kur palët në instrumentin mbrojtës zëvendësojnë kundërpalët e tyre origjinale me kundërpalë të ndryshme, ky paragraf do të zbatohet vetëm nëse secila prej këtyre palëve kryen klerim me të njëjtën kundërpalë qendrore.
- (ii) Ndryshime të tjerë, nëse ka, në instrumentin mbrojtës janë të kufizuara në ato që janë të nevojshme për të realizuar një zëvendësim të tillë të kundërpalës. Ndryshime të tilla janë të kufizuara në ato që janë në përputhje me kushtet që do të priteshin nëse instrumenti mbrojtës do të aprovohej fillimisht me kundërpalën e kleringut. Këta ndryshime përfshijnë ndryshime në kërkesat e kolateralit, të drejtat për të

kompensuar balancat e të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve, dhe tarifat e vendosura.

- (b) Mbrojtja nuk i plotëson më kriteret për kontabilitetin mbrojtës në paragrafin 98. Në këtë rast, fitimi ose humbja kumulative në instrumentin mbrojtës që mbetet e njohur drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto që nga periudha kur mbrojtja ishte efektive (shih paragrafin 106(a)) do të mbetet e njohur veç në aktivet/kapitalin neto deri kur transaksioni i parashikuar ndodh. Kur ndodh transaksioni, zbatohet paragrafi 108, 109, ose 111.
- (c) Transaksioni i parashikuar nuk pritet më të ndodhë, në të cilin rast çdo fitim ose humbje kumulative e lidhur me instrumentin mbrojtës që është njohur drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto nga periudha kur mbrojtja ishte efektive (shih paragrafin 106(a)) do të të njihet në sufiçit ose defiçit si një rregullim riklasifikimi. Një transaksion i parashikuar që nuk është më shumë i mundshëm (shih paragrafin 98(c)) mund të pritet ende të ndodhë.
- (d) Njësia revokon klasifikimin/përcaktimin. Për mbrojtjen e një transaksioni të parashikuar, fitimi ose humbja kumulative në instrumentin mbrojtës që mbetet e njohur drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto nga periudha kur mbrojtja ishte efektive (shih paragrafin 106(a)) do të mbetet e njohur veç në aktivet/kapitalin neto derisa transaksioni i parashikuar të ndodhë ose nuk pritet më të ndodhë. Kur ndodh transaksioni, zbatohen paragrafi 108, 109, ose 111. Nëse transaksioni nuk pritet më të ndodhë, fitimi ose humbja kumulative që ishte njohur drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto do të njihet në sufiçit ose defiçit si një rregullim riklasifikimi.

Mbrojtja e një Investimi Neto

113. Mbrojtja e një investimi neto në një operacion të huaj, duke përfshirë një mbrojtje të një elementi monetar që kontabilizohet si pjesë e investimit neto (shih SNKSP 4), do të kontabilizohet në mënyrë të ngjashme me mbrojtjen ndaj flukseve monetare:

- (a) Pjesa e fitimit ose humbjes nga instrumenti mbrojtës që përcaktohet të jetë një mbrojtje efektive (shih paragrafin 98) do të njihet drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto nëpërmjet pasqyrës së ndryshimeve në aktivet/kapitalin neto (shih SNKSP 1); dhe
- (b) Pjesa joefektive do të njihet në sufiçit ose defiçit.

Fitimi ose humbja nga instrumenti mbrojtës që lidhet me pjesën efektive të mbrojtjes që është njohur drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto do të njihet në sufiçit ose defiçit si një rregullim riklasifikimi në përputhje me paragrafët 56-57 të SNKSP 4 në momentin e shitjes/nxjerrjes jashtë përdorimit të operacionit të jashtëm.

Periudha Kalimtare

- 114. [Fshirë]
- 115. [Fshirë]
- 116. [Fshirë]
- 117. [Fshirë]
- 118. [Fshirë]
- 119. [Fshirë]
- 120. [Fshirë]
- 121. [Fshirë]
- 122. [Fshirë]
- 123. [Fshirë]

Data Efektive

- 124. Një njësi do të zbatojë këtë Standard për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2013. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2013, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.
- 125. Një njësi nuk do të zbatojë këtë standard përpara datës 1 janar, 2013, përveçse kur zbaton SNKSP 28 dhe SNKSP 30.
- 125A. Paragrafi 2 u ndryshua nga SNKSP 32, *Marrëveshjet Konçesionare të Shërbimit: Grantdhënësi* botuar në tetor 2011. Një njësi do të zbatojë këtë ndryshim për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2014. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimin për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2014, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe në të njëjtën kohë do të zbatojë SNKSP 32, ndryshimet në paragrafët 6 dhe 42A të SNKSP 5, ndryshimet në paragrafët 25-27 dhe 85B të SNKSP 13, ndryshimet në paragrafët 5, 7 dhe 107C të SNKSP 17 dhe ndryshimet në paragrafët 6 dhe 132A të SNKSP 31.
- 125B. Paragrafët 114, 115, 116, 117, 118, 119, 120, 121, 122, 124 dhe 126 u ndryshuan nga SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara* botuar në janar 2015. Një njësi do të zbatojë ato ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2017. Zbatimi i mëparshëm lejohet. Nëse një njësi zbaton SNKSP 33 për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2017, ndryshimet do të zbatohen edhe për atë periudhë të mëparshme.

- 125C. **SNKSP 35, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara* dhe SNKSP 37, *Marrëveshjet e Përbashkëta*, të publikuara në janar 2015, ndryshuan paragrafët 2(a), 17, 89, AG2, AG14, AG51–53 dhe C2. Një njësi duhet t'i zbatojë këta ndryshime kur zbaton SNKSP 35 dhe SNKSP 37.**
- 125D. **Paragrafi AG8 u ndryshua nga *Përmirësime të SNKSP-ve 2015* botuar në prill 2016. Një njësi do të zbatojë këtë ndryshim për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2017. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimin për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2017, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.**
- 125E. **Paragrafët 7 dhe 8 u fshinë nga *Zbatueshmëria e SNKSP-ve*, botuar në prill 2016. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2018. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.**
- 125F. **Paragrafi 2 u ndryshua nga SNKSP 39, *Përfitimet e Punonjësve*, botuar në korrik 2016. Një njësi do të zbatojë këtë ndryshim për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2018. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimin për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 39 në të njëjtën kohë.**
- 125G. **Paragrafët 2, AG35, AG131 dhe B4 u ndryshuan nga SNKSP 40, *Kombinimet e Sektorit Publik*, botuar në janar 2017. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2019. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2019, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 40 në të njëjtën kohë.**
- 125H. **Paragrafët 2, 9, 10, 80, 98, 99, 101, 102, 107, 108, 109, 111, 112, 113, AG128, AG157 dhe AG161 u ndryshuan, paragrafi AG156A u shtua, dhe paragrafët 1, 3, 4, 5, 6, 11–79, 88, AG1–AG126 dhe AG129 u fshinë nga SNKSP 41, botuar në gusht 2018. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2022. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2022, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 41 në të njëjtën kohë.**
126. Kur një njësi ekonomike adopton SNKSP-të e kontabilitetit sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, siç përcaktohet në SNKSP 33, *Miratimi për Herë të*

Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara për qëllime të raportimit financiar pas kësaj date efektive, ky Standard zbatohet për pasqyrat financiare vjetore të njësisë ekonomike që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës së adoptimit të SNKSP-ve.

SNKSP 30—INSTRUMENTET FINANCIARE: DHËNIA E INFORMACIONEVE SHPJEGUES

Shënime të Mirënjohjes

Ky Standard Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) është hartuar kryesisht nga Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar (SNRF) 7, *Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjegues* publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Ekstrakte nga SNRF 7 janë riprodhuar në këtë publikim të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) me lejen e Fondacionit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Teksti i aprovuar i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) është ai i publikuar nga BSNK në gjuhën angleze dhe kopjet mund të merren direkt nga IFRS Foundation, Customer Service, Columbus Building, 7 Westferry Circus, Canary Wharf, London E14 4HD, United Kingdom.

E-mail: publications@ifrs.org

Internet: www.ifrs.org

Të drejtat e autorit për SNRF-të, SNK-të, Draftet e Paraqitura dhe publikime të tjera të BSNK-së i përkasin Fondacionit SNRF.

"SNRF", "SNK", "BSNK", "Fondacioni SNRF", "Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit" dhe "Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar" janë marka tregtare të Fondacionit SNRF dhe nuk duhet të përdoren pa aprovimin e Fondacionit SNRF.

SNKSP 30—INSTRUMENTET FINANCIARE: DHËNIA E INFORMACIONEVE SHPJEGUES

Historia e SNKSP

Ky version përfshin ndryshime që rezultojnë nga SNKSP-të e botuara deri në 31 janar, 2019.

SNKSP 30, *Instrumentet Financiare: Paraqitja e Informacioneve Shpjegues* u botua në janar 2010.

Që atëherë, SNKSP 30 është ndryshuar nga SNKSP-të e mëposhtme:

SNKSP 41, *Instrumentet Financiare* (botuar në gusht 2018)

- SNKSP 39, *Përfitimet e Punonjësve* (botuar në korrik 2016)
- *Zbatueshmëria e SNKSP-ve* (botuar në prill 2016)
- *Përmirësime të SNKSP-ve 2015* (botuar në prill 2016)
- SNKSP 38, *Paraqitja e Interesave në Njësitë e Tjera* (botuar në janar 2015)
- SNKSP 37, *Marrëveshjet e Përbashkëta* (botuar në janar 2015)
- SNKSP 35, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara* (botuar në janar 2015)
- SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara* (botuar në janar 2015)
- *Përmirësime të SNKSP-ve 2011* (botuar në tetor 2011)

Tabela e Paragrafëve të Ndryshuar në SNKSP 30

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
Seksioni i parathënies	U Fshi	Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2011
2	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
3	U Ndryshua	SNKSP 35 Janar 2015 SNKSP 37 Janar 2015 SNKSP 39 Korrik 2016

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
		SNKSP 41 Gusht 2018
4	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
5	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
5A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
6	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
7	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
8	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
11	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
12	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
13	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
13A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
14	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit 14A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
14A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
14B	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
15	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
15A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
15B	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
15C	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
16	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit 17	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
17	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit 17A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
17A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
17B	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
17C	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
17D	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
17E	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
17F	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
18	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
20	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
20A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
24	Ndryshuar	SNKSP 41 Gusht 2018
24A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
25A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
25B	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
25C	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
25D	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
26	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit 26A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
26A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
26B	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
26C	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit 27	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
27	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
27A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
27B	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
27C	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
27D	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
27E	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
27F	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit 28	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
28	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
28A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
28B	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
28C	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
28D	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
28E	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
28F	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit 28G	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
28G	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
34	Ndryshuar	SNKSP 41 Gusht 2018
35	Ndryshuar	SNKSP 41 Gusht 2018

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
36	Ndryshuar	SNKSP 41 Gusht 2018
37	Ndryshuar	SNKSP 41 Gusht 2018
37A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
39A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
41	Ndryshuar	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit 42A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
42A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
42B	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
42C	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
42D	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
42E	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit 42F	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
42F	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
42G	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit 42H	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
42H	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
42I	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
42J	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
42K	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
42L	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit 42M	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
42M	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
42N	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
43	Ndryshuar	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit 44	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
44	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
45	Ndryshuar	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit 49A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
49A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
49B	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
49C	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit 49D	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
49D	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit 49E	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
49E	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
49F	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
49G	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit 49H	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
49H	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit 49I	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
49I	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
49J	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
49K	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
49L	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
49M	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
49N	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
49O	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
49P	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
49Q	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
49R	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
49S	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
52A	I Ri	SNKSP 33 Janar 2015
52B	I Ri	SNKSP 38 Janar 2015 SNKSP 37 Janar 2015 SNKSP 35 Janar 2015
52C	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Prill 2016
52D	I Ri	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
52E	I Ri	SNKSP 39 Korrik 2016
52F	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
53	U Ndryshua	SNKSP 33 Janar 2015
AG1	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
Titujt para paragrafit AG4	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
AG4	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
AG5	Ndryshuar	SNKSP 41 Gusht 2018
AG6	U Ndryshua	SNKSP 38 Janar 2015
Titulli para paragrafit AG8A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG8A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG8B	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG8C	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit AG8D	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG8D	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG8E	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit AG8F	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG8F	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG8G	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
AG8H		
AG8H	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG8I	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG8J	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG9	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
AG10	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
AG24	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
AG29	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
Titujt para paragrafit AG31	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG31	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG32	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG32A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG33	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit AG34	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG34	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
Titulli para paragrafit AG35	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG35	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit AG36	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG36	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG37	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG38	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit AG39	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG39	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit AG40	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG40	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit AG41	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG41	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titujt para paragrafit AG42	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG42	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
AG43	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit AG44	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG44	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit AG45	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG45	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit AG46	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG46	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit AG47	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG47	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG48	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit AG49	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG49	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG50	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit AG51	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
AG51	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit AG52	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG52	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit AG53	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG53	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG54	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit AG55	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG55	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit IG3	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
IG3	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
IG4	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit IG7	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
IG7	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
IG8	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
IG9	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
IG10	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
IG11	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
IG14	Ndryshuar	SNKSP 41 Gusht 2018
IG15	Ndryshuar	SNKSP 41 Gusht 2018
IG16	Ndryshuar	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit IG25	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
IG25	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
IG26	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
IG27	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit IG28	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
IG28	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
IG29	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
IG30	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
IG31	U Fshi	SNKSP 41 Gusht 2018
IG36	Ndryshuar	SNKSP 41 Gusht 2018

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
Titulli para paragrafit IG41	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
IG41	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
IG42	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
IG43	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit IG44	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
IG44	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit IG45	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
IG45	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018

Janar 2010

SNKSP 30—INSTRUMENTET FINANCIARE: DHËNIA E INFORMACIONEVE SHPJEGUES

PËRMBAJTJA

	Paragrafi
Objektivi	1–2
Objekti	3–7
Përkufizime	8
Klasat e Instrumenteve Financiare dhe Niveli i Dhënie së Informacioneve	
Shpjeguese	9
Rëndësia e Instrumenteve Financiare për Pozicionin Financiar dhe	
Performancën Financiare	10–37
Pasqyra e Pozicionit Financiar	11–23
Kategoritë e Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare	11
Aktivet Financiare ose Detyrimet Financiare me Vlerë të Drejtë përmes Suficitit ose Deficitit	12–14
Riklasifikimi	15–16
Çregjistrimi	17
Kolaterali	18–19
Llogaria Ndihmëse për Humbjet e Kreditit	20
Instrumente Financiare të Përbërë me	
Derivativë të Përfshirë të Shumëfishtë	21
Mospagesat në Kohë dhe Shkeljet	22–23
Pasqyra e Performancës Financiare	24
Elementët e të Ardhurave, Shpenzimeve, Fitimeve ose Humbjeve ...	24
Dhënia e Informacioneve të Tjera	25–37
Politikat Kontabël	25
Kontabiliteti Mbrojtës	26–28
Vlera e Drejtë	29–36

INSTRUMENTET FINANCIARE: DHËNIA E INFORMACIONEVE SHPJEGUES

Kredi Konçesionare	37
Natyra dhe Masa e Rreziqeve që Vijnë nga Instrumentet Financiare	38–49
Paraqitja e Informacioneve Cilësore	40
Paraqitja e Informacioneve Sasiore	41–49
Rreziku i Kreditit	43–45
Aktivet Financiare të Cilave u ka Kaluar Afati i Pagesës ose janë Zhvlerësuar	44
Kolaterali dhe Përmirësime të Tjera të Kreditit të Mara.....	45
Rreziku i Likuiditetit.....	46
Rreziku i Tregut.....	47–49
Analizë e Ndjeshmërisë	47–48
Dhënia e Informacioneve të Tjera për Rrezikun e Tregut	49
Data Efektive dhe Periudha Kalimtare.....	50–53
Shfuqizimi dhe Zëvendësimi i SNKSP 15 (2001)	54

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik 30, *Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese*, është përcaktuar në paragrafët 1–54. Të gjithë paragrafët kanë autoritet të barabartë. SNKSP 30 duhet lexuar në kontekstin e objektivit të tij, Bazës për Konkluzione, *Parathënies së Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar me Qëllim të Përgjithshëm nga Njësitë e Sektorit Publik*. SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, jep një bazë për zgjedhjen dhe zbatimin e politikave të kontabilitetit në mungesë të udhëzimeve të qarta.

Objektivi

1. Objektivi i këtij Standardi është të kërkojë nga njësitë (ekonomike) të japin/paraqesin informacione shpjeguese në pasqyrat e tyre financiare që u mundësojnë përdoruesve të vlerësojnë:
 - (a) Rëndësinë e instrumenteve financiare për pozicionin dhe performancën financiare të njësisë ekonomike; dhe
 - (b) Natyrën dhe masën e rreziqeve që vijnë nga instrumentet financiare ndaj të cilëve njësia ekonomike është e ekspozuar gjatë periudhës dhe në fund të periudhës së raportimit, dhe si njësia ekonomike i menaxhon ato rreziqe.
2. Parimet në këtë Standard plotësojnë parimet për njohjen, matjen, dhe prezantimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare në SNKSP 28, *Instrumentet Financiare: Paraqitja* dhe SNKSP 41, *Instrumentet Financiare*.

Objekti

3. **Ky Standard do të zbatohet nga të gjitha njësitë (ekonomike) për të gjitha llojet e instrumenteve financiare, përveç:**
 - (a) Atyre interesave në njësitë e kontrolluara, shoqëritë, ose sipërmarrjet e përbashkëta që kontabilizohen në përputhje me SNKSP 34, *Pasqyrat Financiare të Veçanta*, SNKSP 35, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara* ose SNKSP 36, *Investimet në Pjesëmarrjet dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta*. Megjithatë, në disa raste, SNKSP 34, SNKSP 35 ose SNKSP 36 kërkojnë ose lejojnë një njësi të kontabilizojë për një interes në një njësi të kontrolluar, shoqëri, ose sipërmarrje të përbashkët duke përdorur SNKSP 41; në ata raste, njësitë do të zbatojnë kërkesat e këtij Standardi. Njësitë do të zbatojnë gjithashtu këtë Standard për të gjithë derivativët e lidhur me interesat në njësitë e kontrolluara, shoqëritë, ose sipërmarrjet e përbashkëta, përveç rastit kur derivativi plotëson përkufizimin e një instrumenti të kapitalit në SNKSP 28.
 - (b) Të drejtave dhe detyrimeve të punëdhënësve që vijnë nga planet e përfitimeve të punonjësve, për të cilat zbatohet SNKSP 39, *Përfitimet e Punonjësve*.
 - (c) Të drejtat dhe detyrimet që vijnë nga kontratat e siguracionit. Megjithatë, ky Standard zbatohet për:
 - (i) Derivatvët që janë të përfshirë në kontratat e siguracionit nëse SNKSP 41 kërkon që njësia t'i kontabilizojë ata veç; dhe
 - (ii) Një emetues i kontratave të garancisë financiare nëse emetuesi

zbaton SNKSP 41 në njohjen dhe matjen e kontratave, por do të zbatohë standardin përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton kontratat e siguracionit nëse emetuesi zgjedh të zbatohë ata standarde në njohjen dhe matjen e tyre.

Krahas (i) dhe (ii) më sipër, një njësi mund të zbatohë këtë Standard për kontratat e siguracionit që përfshijnë transferimin e rrezikut financiar.

- (d) **Instrumentet financiare, kontratat, dhe detyrimet sipas transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione, për të cilat zbatohet standardi përkatës ndërkombëtar ose kombëtar i kontabilitetit që trajton pagesën e bazuar në aksione, me përjashtim të kontratave brenda fushëveprimit të paragrafëve 6–8 të SNKSP 41, për të cilat zbatohet ai Standard.**
- (e) **Instrumentet që kërkohet të klasifikohen si instrumente të kapitalit në përputhje me paragrafët 15 dhe 16 ose paragrafët 17 dhe 18 të SNKSP 28.**

- 4. Ky Standard zbatohet për instrumentet financiare të njohura dhe të panjohura. Instrumentet financiare të njohur përfshijnë aktivet dhe detyrimet financiare që janë brenda fushëveprimit të SNKSP 41. Instrumentet financiare të panjohur përfshijnë disa instrumente financiare që, edhe pse jashtë fushëveprimit të SNKSP 41, janë brenda fushëveprimit të këtij Standardi (siç janë disa angazhime të kredive).
- 5. Ky Standard zbatohet për kontratat për të blerë ose shitur një element jofinanciar që janë brenda fushëveprimit të SNKSP 41 (shih paragrafët 6–8 të SNKSP 41).
- 5A. Kërkesat për dhënien e informacioneve shpjegues të rrezikut të kreditit në paragrafët 42A–42N zbatohen për ato të drejta për llogaritë e arkëtueshme që rezultojnë nga transaksionet e këmbimit që janë brenda fushëveprimit të SNKSP 9 dhe transaksionet pa këmbim brenda fushëveprimit të SNKSP 23, të cilët krijojnë instrumente financiare për qëllimin e njohjes së fitimeve ose humbjeve nga zhvlerësimi në përputhje me paragrafin 3 të SNKSP 41. Çdo referencë ndaj aktiveve financiare ose instrumenteve financiare në këta paragrafë do të përfshijë ato të drejta, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe.
- 6. [Fshirë]
- 7. [Fshirë]

Përkufizime

- 8. **Termet e mëposhtëm përdoren në këtë Standard me kuptimet e specifikuara:**

Rreziku i kreditit është rreziku që njëra palë në një instrument financiar do të shkaktojë një humbje financiare për palën tjetër duke mos arritur të

përbushë një detyrim.

Grupet e klasifikimit të rrezikut të kreditit janë një renditje i rrezikut të kreditit bazuar në rrezikun e një mospagimi në kohë që ndodh në instrumentin financiar.

Rreziku i monedhës është rreziku që vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshëm të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në kursin e këmbimit valutor.

Rreziku i normës së interesit është rreziku që vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut.

Rreziku i likuiditetit është rreziku që një njësi ekonomike do të hasë vështirësi në përbushjen e detyrimeve që lidhen me detyrimet financiare që shlyhen duke dhënë mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar.

Kreditë e pagueshme janë detyrime financiare, të ndryshme nga llogaritë e pagueshmet tregtare afatshkurtra me kushte normale krediti.

Rreziku i tregut është rreziku se vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshëm të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Rreziku i tregut përfshin tre lloje të rrezikut: rrezikun e monedhës, rrezikun e normës së interesit, dhe rrezikun tjetër të çmimit.

Rreziku tjetër i çmimit është rreziku se vlera e drejtë ose flukset monetare të ardhshëm të një instrumenti financiar do të luhaten për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut (të ndryshëm nga ata që vijnë nga rreziku i normës së interesit ose rreziku i monedhës), nëse këto ndryshime shkaktohen nga faktorë specifikë për instrumentet financiare individual ose emetuesi i tyre, ose faktorë që ndikojnë në të gjithë instrumentet financiare të ngjashëm të shitur/blerë në treg.

Termat e përkufizuar në SNKSP-të e tjera përdoren në këtë Standard me të njëjtin kuptim si në ato Standarde, dhe riprodhohen në *Fjalorin e Termave të Përkufizuar* publikuar veçmas.

Klasat e Instrumenteve Financiare dhe Niveli i Dhënies së Informacioneve

9. Kur ky Standard kërkon paraqitje informacionesh shpjeguese sipas kategorive/klasave të instrumenteve financiare, një njësi do të grupojë instrumentet financiare në klasa që janë të përshtatshme për natyrën e informacionit të paraqitur dhe që marrin parasysh karakteristikat e atyre instrumenteve financiare. Një njësi duhet të japë informacion të mjaftueshëm për të lejuar rakordimin me zërat e prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Rëndësia e Instrumenteve Financiare për Pozicionin Financiar dhe Performancën Financiare

10. Një njësi (ekonomike) do të paraqesë informacion shpjegues që u mundëson përdoruesve të pasqyrave të saj financiare të vlerësojnë rëndësinë e instrumenteve financiare për pozicionin dhe performancën e saj financiare.

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Kategoritë e Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare

11. Vlera e mbartur e secilës prej kategorive të mëposhtme, siç përcaktohet në SNKSP 41, do të paraqitet ose në pasqyrën e pozicionit financiar ose në shënimet:
- (a) Aktivet financiare të matur me vlerën e drejtë përmes sufiçitit ose defiçitit, duke treguar veç (i) ata të klasifikuar si të tillë në njohjen fillestare ose më pas në përputhje me paragrafin 152 të SNKSP 41, dhe (ii) ata të matur detyrimisht me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit në përputhje me SNKSP 41;
 - (b) [Fshirë]
 - (c) [Fshirë]
 - (d) [Fshirë]
 - (e) Detyrimet financiare me vlerën e drejtë përmes sufiçitit ose defiçitit, duke treguar veç (i) ata të klasifikuar si të tillë në njohjen fillestare ose më pas në përputhje me paragrafin 152 të SNKSP 41, dhe (ii) ata që plotësojnë përkufizimin e mbajtur për tregtim në SNKSP 41;
 - (f) Aktivet financiare të matur me kosto të amortizuar;
 - (g) Detyrimet financiare të matur me kosto të amortizuar; dhe
 - (h) Aktivet financiare të matur me vlerën e drejtë përmes aktiveve/kapitalit neto, duke treguar veç (i) aktivet financiare që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto në përputhje me paragrafin 41 të SNKSP 41; dhe (ii) investimet në instrumente të kapitalit të përcaktuar si të tillë me njohjen fillestare në përputhje me paragrafin 106 të SNKSP 41.

Aktivët Financiare dhe Detyrimet Financiare me Vlerë të Drejtë nëpërmjet Sufiçitit ose Defiçitit

12. Nëse njësi (ekonomike) ka përcaktuar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit një aktiv financiar (ose grup aktivesh financiare) që përndryshe do të matej me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto ose koston së amortizuar, ajo do paraqesë informacion për:
- (a) Ekspozimin maksimal ndaj rrezikut të kreditit (shih paragrafin 43(a)) të aktivit financiar (ose grupit të aktiveve financiare) në fund të periudhës së raportimit.

- (b) Shumën me të cilën çdo derivativ krediti ose instrumente të ngjashëm zbutin atë ekspozim maksimal ndaj rrezikut të kreditit (shih paragrafin 43(b)).
- (c) Shumën e ndryshimit, gjatë periudhës dhe në mënyrë kumulative, në vlerën e drejtë të aktivit financiar (ose grupit të aktiveve financiare) që i atribuohet ndryshimeve në rrezikun e kreditit/kredisë të aktivit financiar përcaktohet ose:
 - (i) Si shuma e ndryshimit në vlerën e drejtë të saj që nuk i atribuohet ndryshimeve në kushtet e tregut që shkaktojnë rrezikun e tregut; ose
 - (ii) Duke përdorur një metodë alternative, njësia ekonomike beson se përfaqëson në mënyrë më besnike shumën e ndryshimit në vlerën e drejtë të saj që i atribuohet ndryshimeve në rrezikun e kreditit/kredisë së aktivit.

Ndryshimet në kushtet e tregut që shkaktojnë rrezikun e tregut përfshijnë ndryshimet në një normë interesi të vëzhguar (bazë referimi), çmimin e lëndëve të para bazë, kursin e këmbimit valutor, ose indeksin e çmimeve ose normave.

- (d) Shumën e ndryshimit në vlerën e drejtë të çdo derivativi krediti të lidhur ose instrumente të ngjashëm që kanë ndodhur gjatë periudhës dhe në mënyrë kumulative që nga momenti i klasifikimit të aktivit financiar.

13. Nëse njësia ekonomike ka përcaktuar një detyrim financiar si me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit në përputhje me paragrafin 46 të SNKSP 41 dhe kërkohet të prezantojë efektet e ndryshimeve në rrezikun e kreditit së atij detyrimi në aktivet/kapitalin neto (shih paragrafin 108 të SNKSP 41), ajo do të paraqesë informacion për:

- (a) Shumën e ndryshimit, kumulativisht, në vlerën e drejtë të detyrimit financiar që i atribuohet ndryshimeve në rrezikun e kreditit/kredisë së atij detyrimi (shih paragrafët AG236–AG243 të SNKSP 41 për udhëzim mbi përcaktimin e efekteve të ndryshimeve në rrezikun e kreditit të një detyrimi);
- (b) Diferencën midis vlerës së mbartur të detyrimit financiar dhe shumës që njësisë ekonomike do t'i kërkohet kontraktualisht t'i paguajë në maturim mbajtësit të detyrimit;
- (c) Çdo transfertë të fitimit ose humbjes kumulative brenda aktiveve/kapitalit neto gjatë periudhës, duke përfshirë arsyen e këtyre transfertave;
- (d) Nëse një detyrim çregjistrohet gjatë periudhës, shumën (nëse ka) të prezantuar në aktivet/kapitalin neto që është realizuar në çregjistrim.

- 13A. Nëse një njësi ekonomike ka përcaktuar një detyrim financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit në përputhje me paragrafin 46 të SNKSP 41 dhe kërkohet të prezantojë të gjithë ndryshimet në vlerën e drejtë të atij detyrimi (duke përfshirë efektet e ndryshimeve në rrezikun e kreditit të detyrimit) në suficit ose deficit (shih paragrafët 108 dhe 109 të SNKSP 41), ajo do të paraqesë informacion për:
- (a) Shumën e ndryshimit, gjatë periudhës dhe në mënyrë kumulative, në vlerën e drejtë të detyrimit financiar që i atribuohet ndryshimeve në rrezikun e kreditit/kredisë të atij detyrimi (shih paragrafët AG236–AG243 të SNKSP 41 për udhëzim mbi përcaktimin e efekteve të ndryshimeve në rrezikun e kreditit së detyrimit); dhe
 - (b) Diferencën midis vlerës së mbartur të detyrimit financiar dhe shumës që njësisë do t'i kërkohet kontraktualisht t'i paguajë në maturim mbajtësit të detyrimit;
14. Njësia do të paraqesë gjithashtu:
- (a) Një përshkrim të detajuar të metodave të përdorura për të përmbushur kërkesat në paragrafët 12(c), 13(a) dhe 13A(a) dhe paragrafin 108(a) të SNKSP 41, duke përfshirë një shpjegim se pse metoda është e përshtatshme.
 - (b) Nëse njësia beson se informacioni shpjegues që ka dhënë, qoftë në pasqyrën e pozicionit financiar ose në shënime, është në përputhje me kërkesat në paragrafin 12(c), 13(a) ose 13A(a) ose paragrafi 108(a) i SNKSP 41 nuk përfaqëson me besnikëri ndryshimin në vlerën e drejtë të aktivitetit financiar ose detyrimit financiar që i atribuohet ndryshimeve në rrezikun e tij të kreditit, arsyet për arritjen e këtij përfundimi dhe faktorët që ai beson se janë relevantë.
 - (c) Një përshkrim të detajuar të metodologjisë ose metodologjive të përdorura për të përcaktuar nëse prezantimi i efekteve të ndryshimeve në rrezikun e kreditit/kredisë së një detyrimi në aktivet/kapitalin neto do të krijonte ose do të zgjeronte një mospërputhje kontabël në suficit ose deficit (shih paragrafët 108 dhe 109 të SNKSP 41). Nëse një njësi i kërkohet të prezantojë efektet e ndryshimeve në rrezikun e kreditit/kredisë së një detyrimi në suficit ose deficit (shih paragrafin 109 të SNKSP 41), dhënia e informacioneve shpjeguese duhet të përfshijë një përshkrim të detajuar të marrëdhënies ekonomike të përshkruar në paragrafin AG229 të SNKSP 41.

Investimet në Instrumentet e Kapitalit të Përcaktuar me Vlerën e Drejtë përmes Aktiveve/Kapitalit Neto

- 14A. Nëse një njësi ka përcaktuar investimet në instrumente të kapitalit për t'u matur me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto, siç lejohet nga paragrafi

106 i SNKSP 41, ajo do të japë informacione se:

- (a) Cilat investime në instrumentet e kapitalit janë përcaktuar për t'u matur me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto.
- (b) Arsyet e përdorimit të kësaj alternative të paraqitjes.
- (c) Vlerën e drejtë të çdo investimi të tillë në fund të periudhës së raportimit.
- (d) Dividendët e njohur gjatë periudhës, duke treguar veç ata që lidhen me investimet e çregjistruara gjatë periudhës së raportimit dhe ata që lidhen me investimet e mbajtura në fund të periudhës së raportimit.
- (e) Çdo transferim të fitimit ose humbjes kumulative brenda aktiveve/kapitalit neto gjatë periudhës, duke përfshirë arsyen e këtyre transfertave.

14B. Nëse një njësi çregjistroi investimet në instrumentet e kapitalit të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto gjatë periudhës së raportimit, ajo do të paraqesë informacione për:

- (a) Arsytet e shitjes së investimeve.
- (b) Vlerën e drejtë të investimeve në datën e çregjistrimit.
- (c) Fitimin ose humbjen kumulative në momentin e shitjes.

Riklasifikimi

15. [Fshirë]

15A. Një njësi do të japë informacione shpjeguese nëse, në periudhat aktuale ose të mëparshme të raportimit, ajo ka riklasifikuar ndonjë aktiv financiar në përputhje me paragrafin 54 të SNKSP 41. Për çdo ngjarje të tillë, një njësi ekonomike do të paraqesë:

- (a) Datën e riklasifikimit.
- (b) Një shpjegim të detajuar të ndryshimit në modelin e menaxhimit dhe një përshkrim cilësor të efektit të tij në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike.
- (c) Shumën e riklasifikuar në dhe jashtë çdo kategorie.

15B. Për çdo periudhë të raportimit pas riklasifikimit deri në çregjistrim, një njësi do të paraqesë informacione për aktivet e riklasifikuar jashtë vlerës së drejtë përmes kategorisë së sufiçitit ose defiçitit, në mënyrë që ata të maten me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto në përputhje me paragrafin 54 të SNKSP 41:

- (a) Normën efektive të interesit të përcaktuar në datën e riklasifikimit; dhe
- (b) Të ardhurat e njohura nga interesi.

- 15C. Nëse, që nga data e raportimit, një njësi ekonomike ka riklasifikuar aktivet financiare jashtë vlerë së drejtë përmes kategorisë së aktiveve/kapitalit neto, në mënyrë që ato të maten me koston e amortizuar ose jashtë vlerës së drejtë përmes kategorisë së sufiçitit ose defiçitit, në mënyrë që ata të maten me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto, ajo do të paraqesë:
- (a) Vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fund të periudhës së raportimit; dhe
 - (b) Fitimin ose humbjen e vlerës së drejtë që do të njihej në sufiçit ose defiçit ose aktivet/kapitalin neto gjatë periudhës së raportimit nëse aktivet financiare nuk do të ishin riklasifikuar.
16. [Fshirë]
17. [Fshirë]

Kompensimi i Aktiveve dhe Detyrimeve Financiare

- 17A. Dhënia e informacioneve shpjeguese në paragrafët 17B–17E i shtohet kërkesave të tjera për dhënie e informacioneve shpjeguese të këtij Standardi dhe kërkohet për të gjitha instrumentet financiare të njohur që janë përcaktuar në përputhje me paragrafin 47 të SNKSP 28. Këto informacione shpjeguese zbatohen gjithashtu për instrumentet financiare të njohur që janë subjekt i një marrëveshjeje kryesore të ndërthurur të imponueshme ose marrëveshjeje të ngjashme, pavarësisht nëse ata janë kompensuar në përputhje me paragrafin 47 të SNKSP 28.
- 17B. Një njësi do të japë informacion shpjegues për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave të saj financiare të vlerësojnë efektin ose efektin potencial të marrëveshjeve të ndërthurura në pozicionin financiar të njësisë. Kjo përfshin efektin ose efektin potencial të të drejtave të kompensimit të shoqëruara me aktivet financiare të njohur të njësisë dhe detyrimet financiare të njohur që janë brenda fushëveprimit të paragrafit 17A.
- 17C. Për të përmbushur objektivin në paragrafin 17B, një njësi ekonomike do të paraqesë, në fund të periudhës së raportimit, informacionin sasior vijues veç për aktivet financiare të njohur dhe detyrimet financiare të njohur që janë brenda fushëveprimit të paragrafit 17A:
- (a) Shumat bruto të atyre aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare të njohur;
 - (b) Shumat që kompensohen në përputhje me kriteret në paragrafin 47 të SNKSP 28 kur përcaktohen shumat neto të prezantuara në pasqyrën e pozicionit financiar;
 - (c) Shumat neto të prezantuara në pasqyrën e pozicionit financiar;

- (d) Shumat që i nënshtrohen një marrëveshjeje kryesore të ndërthurur të imponueshme ose marrëveshjeje të ngjashme që nuk përfshihen ndryshe në paragrafin 17C(b), duke përfshirë:
 - (i) Shumat që lidhen me instrumentet financiare të njohur që nuk plotësojnë disa ose të gjitha kriteret e kompensimit në paragrafin 47 të SNKSP 28; dhe
 - (ii) Shumat që lidhen me kolateralin financiar (përfshirë kolateralin në mjete monetare); dhe
- (e) Shuma neto pas zbritjes së shumave në (d) nga shumat në (c) më sipër.

Informacioni i kërkuar nga ky paragraf do të prezantohet në një format tabelor, veç për aktivet financiare dhe detyrimet financiare, përveç rasteve kur një format tjetër është më i përshtatshëm.

- 17D. Shuma totale e paraqitur në përputhje me paragrafin 17C(d) për një instrument do të kufizohet në shumën në paragrafin 17C(c) për atë instrument.
- 17E. Një njësi do të përfshijë një përshkrim në informacionet shpjeguese të të drejtave të kompensimit të shoqëruara me aktivet financiare të njohur të njësisë ekonomike dhe detyrimet financiare të njohur që i nënshtrohen marrëveshjeve kryesore të ndërthurura të imponueshme dhe marrëveshjeve të ngjashme që paraqiten në përputhje me paragrafin 17C(d), duke përfshirë natyrën e këtyre të drejtave.
- 17F. Nëse informacioni i kërkuar nga paragrafët 17B–17E paraqitet në më shumë se një shënim të pasqyrave financiare, një njësi do të kryq-referojë ndërmjet këtyre shënimeve.

Kolaterali

- 18. Një njësi do të paraqesë informacion për:
 - (a) Vlerën e mbartur të aktiveve financiare që ajo ka premtuar si kolateral për detyrimet ose detyrimet e kushtëzuara, duke përfshirë shumat që janë riklasifikuar në përputhje me paragrafin 34(a) të SNKSP 41; dhe
 - (b) Termat dhe kushtet që lidhen me premtimin.
- 19. Kur një njësi mban kolateral (në formën e aktiveve financiare ose jofinanciare) dhe lejohet të shesë ose të ripremtojë kolateralin në mungesë të mospagimit në kohë nga pronari i kolateralit, ajo do të paraqesë informacione për:
 - (a) Vlerën e drejtë të kolateralit të mbajtur;
 - (b) Vlerën e drejtë të çdo kolaterali të tillë të shitur ose të ripremtuar, dhe nëse njësia ekonomike ka një detyrim ta kthejë atë; dhe
 - (c) Termat dhe kushtet që shoqërohen me përdorimin e saj të kolateralit.

Llogaria Ndhmëse për Humbjet e Kreditit

20. [Fshirë]

20A. Vlera e mbartur e aktiveve financiare e matur me vlerën e drejtë përmes aktiveve/kapitalit neto në përputhje me paragrafin 41 të SNKSP 41 nuk zvogëlohet nga një shumë e lejuar për kompensimin e humbjes dhe një njësi nuk do të prezantojë shumën e lejuar për kompensimin e humbjes veç në pasqyrën e pozicionit financiar si një reduktim në vlerën e mbartur të aktivitetit financiar. Megjithatë, një njësi do të paraqesë informacion shpjegues për shumën e lejuar për kompensimin e humbjeve në shënimet e pasqyrave financiare.

Instrumente Financiare të Përbërë me Derivativë të Përfshirë të Shumëfishtë

21. Nëse një njësi ka emtuar një instrument që përmban si një përbërës detyrimi ashtu edhe një përbërës të kapitalit neto (shih paragrafin 33 të SNKSP 28) dhe instrumenti ka disa derivativë të përfshirë, vlerat e të cilëve janë të ndërrarura (si p.sh. një instrument borxhi i konvertueshëm që mund të paguhet më herët se data e maturimit), ajo do të japë informacion shpjegues për ekzistencën e atyre veçorive.

Mospagesat në Kohë dhe Shkeljet

22. Për kreditë e pagueshme të njohura në fund të periudhës së raportimit, një njësi ekonomike do të paraqesë informacione shpjeguese për:

- (a) Detajet e çdo mospagimi në kohë gjatë periudhës të principalit, interesit, fondit të lëna mënjanë të parave për pagesën graduale të borxhit. ose kushteve të shlyerjes së këtyre kredive të pagueshme;
- (b) Vlerën e mbartur të kredive të pagueshme të papaguara në kohë në fund të periudhës së raportimit; dhe
- (c) Nëse mospagimi në kohë është korrigjuar, ose kushtet e kredive të pagueshme janë rinegociuar, përpara se pasqyrat financiare të autorizoheshin për publikim.

23. Nëse gjatë periudhës, ka pasur shkelje të kushteve të marrëveshjes së kredisë, të ndryshme nga ato të përshkruara në paragrafin 22, një njësi do të paraqesë informacion shpjegues siç kërkohet nga paragrafi 22, nëse këto shkelje i lejojnë huadhënësit të kërkojnë ripagim të përshpejtuar (përveç rastit kur shkeljet korrigjohen, ose kushtet e kredisë rinegociohen, në ose përpara fundit të periudhës së raportimit).

Pasqyra e Performancës Financiare

Zërat e të Ardhurave, Shpenzimeve, Fitimeve, ose Humbjeve

24. Një njësi do të japë informacion për zërat e mëposhtëm të të ardhurave, shpenzimeve, fitimeve, ose humbjeve, ose në pasqyrën e performancës

financiare, ose në pjesën e shënimeve shpjeguese:

- (a) Fitimet neto ose humbjet neto për:
 - (i) Aktivet financiare ose detyrimet financiare të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit, duke treguar veç ato mbi aktivet financiare ose detyrimet financiare të përcaktuar si të tillë në njohjen fillestare ose më pas në përputhje me paragrafin 152 të SNKSP 41, dhe ato mbi aktivet financiare ose detyrimet financiare që janë matur në mënyrë të detyrueshme me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit në përputhje me SNKSP 41 (p.sh., detyrimet financiare që plotësojnë përkufizimin e të mbajturve për tregtim në SNKSP 41). Për detyrimet financiare të përcaktuar me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit, një njësi ekonomike duhet të tregojë veç shumën e fitimit ose humbjes së njohur në aktivet/kapitalin neto dhe shumën e njohur në sufiçit ose defiçit;
 - (ii) [Fshirë]
 - (iii) [Fshirë]
 - (iv) [Fshirë]
 - (v) Detyrimet financiare të matur me kosto të amortizuar;
 - (vi) Aktivet financiare të matur me kosto të amortizuar;
 - (vii) Investimet në instrumentet e kapitalit të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes mjeteve neto/kapitalit në përputhje me paragrafin 106 të ISAS 41 dhe
 - (viii) Aktivet financiare të matur me vlerën e drejtë përmes aktiveve/kapitalit neto në përputhje me paragrafin 41 të SNKSP 41, duke treguar veç shumën e fitimit ose humbjes së njohur në aktivet/kapitalin neto gjatë periudhës dhe shumën e riklasifikuar pas çregjistrimit nga aktivet/kapitali neto të akumuluar në sufiçit ose defiçit për periudhën.
- (b) Të ardhurat totale nga interesi dhe shpenzimet totale nga interesi (llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv) për aktivet financiare ose detyrimet financiare që maten me koston e amortizuar ose që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto në përputhje me paragrafin 41 të SNKSP 41 (duke treguar këto shuma veç); ose detyrimet financiare që nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit;
- (c) Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat (te ndryshme nga shumat e përfshira në përcaktimin e normës efektive të interesit) që vijnë nga:

- (i) Aktivitetet financiare ose detyrimet financiare që nuk janë me vlerën e drejtë përmes sufiçitit ose defiçitit; dhe
 - (ii) Aktivitete të trustit ose aktivitete të tjera të besueshme që rezultojnë në mbajtjen ose investimin e aktiveve në emër të individëve, trusteve, planeve të përfitimeve të pensionit, dhe institucioneve të tjera;
 - (d) [Fshirë]
 - (e) [Fshirë]
- 24A. Një njësi do të paraqesë një analizë të fitimit ose humbjes së njohur në pasqyrën e performancës financiare që vijnë nga çregjistrimi i aktiveve financiare të matur me koston e amortizuar, duke treguar veç fitimet dhe humbjet që vijnë nga çregjistrimi i këtyre aktiveve financiare. Ky informacion shpjegues do të përfshijë arsyet për çregjistrimin e këtyre aktiveve financiare.

Dhënia e Informacioneve të Tjera

Politikat Kontabël

25. Në përputhje me paragrafin 132 të SNKSP 1, një njësi jep informacion shpjegues, në përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit, bazën (ose bazat) e matjes të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe politikat e tjera të kontabilitetit të përdorura që janë relevante për të kuptuar pasqyrat financiare.

Kontabiliteti Mbrojtës

- 25A. Një njësi do të zbatojë kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafët 25B–28F për ato ekspozime ndaj rrezikut kundër të cilit një njësi ekonomike mbron dhe për të cilat ajo zgjedh të zbatojë kontabilitetin mbrojtës. Informacionet shpjeguese të kontabilitetit mbrojtës do të japin informacion rreth:
- (a) Strategjisë së menaxhimit të rrezikut të një njësie dhe mënyrës se si ajo zbatohet për të menaxhuar rrezikun;
 - (b) Si mund të ndikojnë aktivitetet mbrojtëse të njësisë në shumën, kohën dhe pasigurinë e flukseve monetare të saj të ardhshme; dhe
 - (c) Efektit që ka pasur kontabiliteti mbrojtës në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike, pasqyrën e performancës financiare dhe pasqyrën e ndryshimeve në aktivitet/kapitalin neto.
- 25B. Një njësi do të paraqesë informacionet shpjeguese të kërkuara në një shënim të vetëm ose seksion të veçantë në pasqyrat e saj financiare. Megjithatë, një njësi nuk ka nevojë të kopjojë informacionin që është prezantuar tashmë diku tjetër, me kusht që informacioni të përfshihet me referencë të kryqëzuar nga pasqyrat

financiare në ndonjë pasqyrë tjetër, si për shembull një koment i menaxhimit ose raport rreziku që është në dispozicion për përdoruesit e pasqyrave financiare në të njëjtat kushte si pasqyrat financiare dhe në të njëjtën kohë. Pa informacionin e përfshirë me referencë të kryqëzuar, pasqyrat financiare janë të paplota.

- 25C. Kur paragrafët 26A–28F kërkojnë që njësia të ndajë sipas kategorisë së rrezikut informacionin e paraqitur, njësia do të përcaktojë çdo kategori rreziku në bazë të ekspozimeve ndaj rrezikut kundrejt të cilit një njësi vendos të mbrojtje dhe për të cilin zbatohet kontabiliteti mbrojtës. Një njësi do të përcaktojë kategoritë e rrezikut në mënyrë të qëndrueshme konsistente për të gjitha informacionet shpjegues të kontabilitetit mbrojtës.
- 25D. Për të përmbushur objektivat në paragrafin 25A, një njësi (përveç rasteve kur specifikohet ndryshe më poshtë) do të përcaktojë se sa detaje duhet të jepen, sa theks duhet t'i kushtohet aspekteve të ndryshme të kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese, nivelin e duhur të grupimit ose të zbërthimit, dhe nëse përdoruesit e pasqyrat financiare kanë nevojë për shpjegime sheshtë për të vlerësuar informacionin sasior të paraqitur. Megjithatë, një njësi ekonomike do të përdorë të njëjtin nivel grupimi ose ndarjeje që përdor për kërkesat për dhënie/paraqitje informacionesh shpjeguese të informacionit të ngjashëm në këtë Standard.

26. [Fshirë]

Strategjia e Menaxhimit të Rrezikut

- 26A. Një njësi do të shpjegojë strategjinë e saj të menaxhimit të rrezikut për çdo kategori rreziku të ekspozimeve ndaj rrezikut ndaj të cilave vendos të mbrojtje dhe për të cilën zbatohet kontabiliteti mbrojtës. Ky shpjegim duhet t'u mundësojë përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë (për shembull):
- (a) Si lind çdo rrezik.
 - (b) Si e menaxhon njësia çdo rrezik; kjo përfshin nëse njësia ekonomike mbron një element në tërësi për të gjithë rreziqet ose mbron një përbërës (ose disa përbërës) rreziku të një elementi dhe pse.
 - (c) Shtirrijen e ekspozimeve ndaj rrezikut që menaxhon njësia.
- 26B. Për të përmbushur kërkesat në paragrafin 26A, informacioni duhet të përfshijë (por nuk kufizohet në) një përshkrim të:
- (a) Instrumenteve mbrojtës që përdoren (dhe si përdoren) për të mbrojtur nga ekspozimet ndaj rrezikut;
 - (b) Si e përcakton njësia marrëdhënien ekonomike ndërmjet elementit të mbrojtur dhe instrumentit mbrojtës për qëllimin e vlerësimit të efektivitetit të mbrojtjes; dhe
 - (c) Si e vendos njësia raportin e mbrojtjes dhe cilët janë burimet e një mbrojtje joefektive.

26C. Kur një njësi përcakton një përbërës rreziku specifik si një element të mbrojtur (shih paragrafin 128 të SNKSP 41), ajo duhet të japë, përveç informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafët 26A dhe 26B, informacion cilësor ose sasior rreth:

- (a) Si e përcaktoi njësia përbërësin e rrezikut që klasifikohet si element i mbrojtur (duke përfshirë një përshkrim të natyrës së marrëdhënies midis përbërësit të rrezikut dhe elementit në tërësi); dhe
- (b) Si lidhet komponenti i rrezikut me elementin në tërësinë e tij (për shembull, komponenti i rrezikut të përcaktuar historikisht mbuloi mesatarisht 80 për qind të ndryshimeve në vlerën e drejtë të elementit në tërësi).

Shuma, Koha, dhe Pasiguria e Flukseve të Ardhshme Monetare

27. [Fshirë]

27A. Përveçse kur përjashtohet nga paragrafi 27C, një njësi ekonomike do të japë informacione sasiore sipas kategorisë së rrezikut për të lejuar përdoruesit e pasqyrave të saj financiare të vlerësojnë termat dhe kushtet e instrumenteve mbrojtës dhe se si ata ndikojnë në shumën, kohën dhe pasigurinë e flukseve monetare të ardhshëm të njësisë.

27B. Për të përmbushur kërkesën në paragrafin 27A, një njësi do të japë një ndarje që paraqet:

- (a) Një profil të kohës së shumës nominale të instrumentit mbrojtës; dhe
- (b) Nëse është e zbatueshme, çmimin ose normën mesatare (për shembull çmimet fikse ose të ardhshëm të dakorduar etj.) të instrumentit mbrojtës.

27C. Në situatat në të cilat një njësi rivendos shpesh (d.m.th., ndërpret dhe rifillon) marrëdhëniet mbrojtëse sepse si instrumenti mbrojtës, ashtu edhe elementi i mbrojtur, ndryshojnë shpesh (d.m.th., njësia përdor një proces dinamik në të cilin si ekspozimi ashtu edhe instrumentet mbrojtës të përdorur për të menaxhuar atë ekspozim nuk mbeten të njëjtë për një kohë të gjatë—si p.sh. në shembullin në paragrafin AG317(b) të SNKSP 41) njësia:

- (a) Përjashtohet nga dhënia e informacioneve shpjegues të kërkuar nga paragrafët 27A dhe 27B.
- (b) Do të paraqesë:
 - (i) Informacion rreth asaj se cila është strategjia përfundimtare e menaxhimit të rrezikut në lidhje me ato marrëdhënie mbrojtëse;
 - (ii) Një përshkrim se si ajo pasqyron strategjinë e saj të menaxhimit të rrezikut duke përdorur kontabilitetin mbrojtës dhe duke përcaktuar/klasifikuar ato marrëdhënie të veçanta mbrojtëse; dhe

- (iii) Një tregues se sa shpesh ndërpriten dhe rifillojnë marrëdhëniet mbrojtëse si pjesë e procesit të njësisë në lidhje me ato marrëdhënie mbrojtëse.
- 27D. Një njësi do të paraqesë sipas kategorisë së rrezikut një përshkrim të burimeve të mbrojtjes joefektive që pritet të ndikojë në marrëdhënien mbrojtëse gjatë kohëzgjatjes të saj.
- 27E. Nëse burimet e një mbrojtje joefektive të mbrojtjes shfaqen në një marrëdhënie mbrojtëse, një njësi ekonomike do të japë informacion për ata burime sipas kategorisë së rrezikut dhe të shpjegojë inefektivitetin e mbrojtjes që rezulton.
- 27F. Për mbrojtjen e flukseve monetare, një njësi duhet të japë një përshkrim të çdo transaksioni parashikues për të cilin është përdorur kontabiliteti mbrojtës në periudhën e mëparshme, por që nuk pritet të ndodhë më.

Efektet e Kontabilitetit Mbrojtës mbi Pozicionin dhe Performancën Financiare

28. [Fshirë]

- 28A. Një njësi do të paraqesë, në një format tabelor, shumat e mëposhtme të lidhura me zërat e klasifikuar si instrumente mbrojtës veç sipas kategorisë së rrezikut për secilin lloj mbrojtjeje (mbrojtja ndaj vlerës së drejtë, mbrojtja ndaj fluksit monetar, ose mbrojtja e një investimi neto në një operacion të huaj):
- (a) Vlerën e mbartur të instrumenteve mbrojtës (aktivet financiare veç nga detyrimet financiare);
 - (b) Zërin përkatës në pasqyrën e pozicionit financiar që përfshin instrumentin mbrojtës;
 - (c) Ndryshimin në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës të përdorur si bazë për njohjen e inefektivitetit të mbrojtjes për periudhën; dhe
 - (d) Shumat nominale (duke përfshirë sasi të tilla si ton ose metër kub) të instrumenteve mbrojtës.
- 28B. Një njësi do të paraqesë, në një format tabelle, shumat e mëposhtme që lidhen me elementët e mbrojtur veç sipas kategorisë së rrezikut për llojet e mbrojtjeve si më poshtë:
- (a) Për mbrojtjet ndaj vlerës së drejtë:
 - (i) Vlerën e mbartur të elementit të mbrojtur të njohur në pasqyrën e pozicionit financiar (duke prezantuar aktivet veç nga detyrimet);
 - (ii) Shumën e akumuluar të rregullimeve të mbrojtjes ndaj vlerës së drejtë në elementin e mbrojtur, të përfshirë në vlerën e mbartur të elementit të mbrojtur të njohur në pasqyrën e pozicionit financiar (duke prezantuar aktivet veç nga detyrimet);
 - (iii) Zërin përkatës në pasqyrën e pozicionit financiar që përfshin elementin e mbrojtur;

- (iv) Ndryshimin në vlerën e elementit të mbrojtur të përdorur si bazë për njohjen e inefektivitetit të mbrojtjes për periudhën; dhe
 - (v) Shumën e akumuluar të rregullimeve të mbrojtjes ndaj vlerës së drejtë që mbetet në pasqyrën e pozicionit financiar për çdo element të mbrojtur që ka pushuar së qëni i rregulluar për fitimet dhe humbjet e mbrojtjes në përputhje me paragrafin 139 të SNKSP 41.
- (b) Për mbrojtjet ndaj flukseve monetare dhe mbrojtjet e një investimi neto në një operacion të huaj:
- (i) Ndryshimin në vlerën e elementit të mbrojtur të përdorur si bazë për njohjen e inefektivitetit të mbrojtjes për periudhën (d.m.th., për mbrojtjet ndaj flukseve monetare ndryshimin në vlerë të përdorur për të përcaktuar inefektivitetin e njohur të mbrojtjes në përputhje me paragrafin 140(c) të SNKSP 41);
 - (ii) Balancat në rezervën mbrojtëse të flukseve monetare dhe rezervën e përkthimit në monedhë të huaj për mbrojtjet e vazhdueshme që kontabilizohen në përputhje me paragrafët 140 dhe 142(a) të SNKSP 41; dhe
 - (iii) Balancat e mbetura në rezervën mbrojtëse të flukseve monetare dhe rezervën e përkthimit në monedhë të huaj nga çdo marrëdhënie mbrojtëse për të cilën kontabiliteti mbrojtës nuk zbatohet më.
- 28C. Një njësi do të japë, në një format tabelor, shumat e mëposhtme veç sipas kategorisë së rrezikut për llojet e mbrojtjeve si më poshtë:
- (a) Për mbrojtjet ndaj vlerës së drejtë:
 - (I) Inefektshmërinë e mbrojtjes - d.m.th., diferencën midis fitimeve ose humbjeve mbrojtëse të instrumentit mbrojtës dhe elementit të mbrojtur - i njohur në sufiçit ose defiçit (ose aktiveve/kapitalit neto për mbrojtjen e një instrumenti të kapitalit për të cilin një njësi ka zgjedhur të prezantojë ndryshimet në vlerën e drejtë në aktivet/kapitalin neto në përputhje me paragrafin 106 të SNKSP 41); dhe
 - (ii) Zërin përkatës në pasqyrën e performancës financiare që përfshin inefektivitetin e njohur të mbrojtjes.
 - (b) Për mbrojtjet ndaj flukseve monetare dhe mbrojtjet e një investimi neto në një operacion të huaj:
 - (i) Fitimet ose humbjet mbrojtëse të periudhës së raportimit që janë njohur në aktivet/kapitalin neto;
 - (ii) Inefektivitetin e mbrojtjes së njohur në sufiçit ose defiçit;

- (iii) Zërin përkatës në pasqyrën e performancës financiare që përfshin mosefektivitetin e njohur të mbrojtjes;
 - (iv) Shumën e riklasifikuar nga rezerva mbrojtëse e flukseve monetare ose rezerva e përkthimit në monedhë të huaj në sufiçit ose defiçit si një rregullim riklasifikimi (shih SNKSP 1) (duke diferencuar midis shumave për të cilat ishte përdorur më parë kontabiliteti mbrojtës, por për të cilat flukset monetare të ardhshëm të mbrojtur nuk pritet të ndodhin më, dhe shumat që janë transferuar për shkak se elementi i mbrojtur ka ndikuar te sufiçiti ose defiçiti);
 - (v) Zërin përkatës në pasqyrën e performancës financiare që përfshin rregullimin e riklasifikimit (shih SNKSP 1); dhe
 - (vi) Për mbrojtjen e pozicioneve neto, fitimet ose humbjet e mbrojtjes të njohura në një zërin përkatës në pasqyrën e performancës financiare (shih paragrafin 149 të SNKSP 41).
- 28D. Kur volumi i marrëdhënieve mbrojtëse për të cilat zbatohet përjashtimi në paragrafin 27C nuk përfaqëson volumet normale gjatë periudhës (d.m.th., volumi në datën e raportimit nuk pasqyron volumet gjatë periudhës), një njësi duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe arsyen pse beson se volumet nuk janë përfaqësuese.
28. Një njësi do të japë një rakordim të secilit përbërës të aktiveve/kapitalit neto dhe një analizë të aktiveve/kapitalit neto në përputhje me SNKSP 1 që, marrë së bashku:
- (a) Diferencon, si minimum, ndërmjet shumave që lidhen me informacionet shpjeguese në paragrafin 28C(b)(i) dhe (b)(iv), si dhe shumat e kontabilizuara në përputhje me paragrafin 140(d)(i) dhe (iii) të SNKSP 41;
 - (b) Diferencon midis shumave të shoqëruara me vlerën në kohë të opsioneve që mbrojnë elementët e mbrojtur të lidhur me transaksionin dhe shumat e shoqëruara me vlerën në kohë të opsioneve që mbrojnë artikujt e mbrojtur të lidhur me periudhën kohore kur një njësi ekonomike kontabilizon për vlerën në kohë të një opsioni në përputhje me paragrafin 144 i SNKSP 41; dhe
 - (c) Diferencon midis shumave të shoqëruara me elementët e ardhshëm të kontratave të ardhshme dhe shpërndarjet me bazë monedhat e huaja të instrumenteve financiare që mbrojnë elementët e mbrojtur të lidhur me transaksionin, dhe shumat e lidhura me elementët e ardhshëm të kontratave të ardhshme dhe diferencat/shpërndarjet me bazë monedhat e huaja të instrumenteve financiare që mbrojnë elementët e mbrojtur të lidhur me periudhën kohore kur një njësi kontabilizon për ato shuma në përputhje me paragrafin 145 të SNKSP 41.

28F. Një njësi duhet të japë informacionin e kërkuar në paragrafin 28E veç sipas kategorisë së rrezikut. Kjo ndarje sipas rrezikut mund të jepet në shënimet e pasqyrave financiare.

Opsioni për të Përcaktuar një Ekspozim Krediti të Matur me Vlerën e Drejtë përmes Sufiçitit ose Defiçitit

28G. Nëse një njësi cakton një instrument financiar, ose një pjesë të tij, si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit për shkak se përdor një derivativ kredie për të menaxhuar rrezikun e kredisë së atij instrumenti financiar, ajo do të paraqesë:

- (a) Për derivativët e kreditit që janë përdorur për të menaxhuar rrezikun e kreditit së instrumenteve financiare të përcaktuar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit në përputhje me paragrafin 152 të SNKSP 41, një rakordim i secilës prej shumës nominale dhe vlerës së drejtë në fillim dhe në fund të periudhës;
- (b) Fitimin ose humbjen e njohur në sufiçit ose defiçit në përcaktimin/klasifikimin e një instrumenti financiar, ose një pjesë të tij, si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit në përputhje me paragrafin 152 të SNKSP 41; dhe
- (c) Në rast të ndërprerjes së matjes së një instrumenti financiar, ose një pjese të tij, me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit, vlera e drejtë e atij instrumenti financiar që është bërë vlera e re e mbartur në përputhje me paragrafin 155 të SNKSP 41 dhe shumën nominale ose principale përkatëse (përveç dhënies së informacionit krahasues në përputhje me SNKSP 1, një njësi nuk ka nevojë të vazhdojë këtë dhënie informacionesh shpjeguese në periudhat pasuese).

Vlera e Drejtë

29. Përveç siç përcaktohet në paragrafin 35 për çdo klasë aktivesh financiare dhe detyrimesh financiare (shih paragrafin 9), një njësi ekonomike do të japë informacion për vlerën e drejtë të asaj klase aktivesh dhe detyrimesh në një mënyrë që e lejon atë të krahasohet me vlerën e saj të mbartur.

30. Në dhënien e informacioneve për vlerat e drejta, një njësi ekonomike do të grupojë aktivet financiare dhe detyrimet financiare në klasa, por duhet t'i kompensojë ato vetëm në masën që vlerat e tyre të mbartura kompensohen në pasqyrën e pozicionit financiar.

31. Një njësi duhet të japë informacione për secilën klasë të instrumenteve financiare metodat dhe, kur përdoret një teknikë vlerësimi, supozimet e zbatuara në përcaktimin e vlerës së drejtë të çdo klase të aktiveve financiare ose detyrimeve financiare. Për shembull, nëse është e zbatueshme, një njësi ekonomike jep informacione për supozimet që lidhen me normat e parapagimit, normat e humbjeve të vlerësuar të kreditit, dhe normat e interesit ose normat e

skontimit. Nëse ka pasur një ndryshim në teknikën e vlerësimit, njësia do të japë informacion shpjegues për atë ndryshim dhe arsyet e kryerjes së tij.

32. Për të dhënë informacionet shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 33, një njësi duhet të klasifikojë matjet e vlerës së drejtë duke përdorur një hierarki të vlerës së drejtë që pasqyron rëndësinë e të dhënave të përdorura në kryerjen e matjeve. Hierarkia e vlerës së drejtë do të ketë nivelet e mëposhtme:

- (a) Çmimet e kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktive ose detyrime identike (Niveli 1);
- (b) Të dhëna të ndryshme nga çmimet e kuotuar të përfshira në Nivelin 1 që janë të vëzhgueshme për aktivin ose detyrimin, qoftë drejtpërdrejt (d.m.th., si çmim) ose indirekt (d.m.th., që vijnë nga çmimet) (Niveli 2); dhe
- (c) Informacione për aktivin ose detyrimin që nuk bazohen në të dhënat e vëzhgueshme të tregut (të dhëna të pavëzhgueshme) (Niveli 3).

Niveli në hierarkinë e vlerës së drejtë brenda të cilit matja e vlerës së drejtë kategorizohet në tërësinë e saj do të përcaktohet në bazë të të dhënave të nivelit më të ulët që janë të rëndësishme për matjen e vlerës së drejtë në tërësinë e saj. Për këtë qëllim, rëndësia e një të dhëne vlerësohet kundrejt matjes së vlerës së drejtë në tërësinë e saj. Nëse një matje e vlerës së drejtë përdor të dhëna të vëzhgueshme që kërkojnë rregullime të rëndësishme bazuar në të dhëna të pavëzhgueshme, kjo matje është një matje e Nivelit 3. Vlerësimi i rëndësisë së një të dhëne të veçantë për matjen e vlerës së drejtë në tërësinë e saj kërkon gjykim, duke marrë parasysh faktorët specifikë për aktivin ose detyrimin.

33. Për matjet e vlerës së drejtë të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, një njësi do të paraqesë për secilën klasë të instrumenteve financiare:

- (a) Nivelin në hierarkinë e vlerës së drejtë në të cilin matjet e vlerës së drejtë janë kategorizuar në tërësinë e tyre, duke veçuar matjet e vlerës së drejtë në përputhje me nivelet e përcaktuar në paragrafin 32.
- (b) Çdo transferim të rëndësishëm ndërmjet Nivelit 1 dhe Nivelit 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë dhe arsyet për këto transferime. Transferimet në çdo nivel do të paraqiten dhe diskutohen veç nga transfertat jashtë çdo niveli. Për këtë qëllim, rëndësia do të gjykohet në lidhje me sufiçitin ose defiçitin, dhe totalin e aktiveve ose totalit të detyrimeve.
- (c) Për matjet e vlerës së drejtë në Nivelin 3, një rakordim nga tepricat e fillimit me tepricat përfundimtare, duke paraqitur veç ndryshimet gjatë periudhës që i atribuohen të mëposhtmeve:
 - (i) Fitimet ose humbjet totale për periudhën të njohur në sufiçit ose defiçit dhe një përshkrim se ku janë prezantuar në pasqyrën e performancës financiare;

- (ii) Fitimet ose humbjet totale të njohura në aktivet/kapitalin neto;
 - (iii) Blerjet, shitjet, emetimet, dhe shlyerjet (çdo lloj lëvizjeje të paraqitur veç); dhe
 - (iv) Transferimet brenda ose jashtë Nivelit 3 (p.sh., transferimet që i atribuohen ndryshimeve në vëzhgueshmërinë e të dhënave të tregut) dhe arsyet për këto transferime. Për transferime të rëndësishme, transferimet në Nivelin 3 do të paraqiten dhe diskutohen veç nga transfertat jashtë Nivelit 3.
- (d) Shumën e fitimeve ose humbjeve totale për periudhën në (c)(i) më sipër, të përfshirë në sufiçit ose defiçit që i atribuohet fitimeve ose humbjeve në lidhje me ato aktive dhe detyrime të mbajtura në fund të periudhës së raportimit dhe një përshkrim se ku ato fitime ose humbje prezantohen në pasqyrën e performancës financiare.
- (e) Për matjet e vlerës së drejtë në Nivelin 3, nëse ndryshimi i një ose më shumë të dhënave për supozime alternative të arsyeshme të mundshme do të ndryshonte ndjeshëm vlerën e drejtë, njësia do ta deklarojë këtë fakt dhe të paraqesë informacion për efektin e këtyre ndryshimeve. Njësia do të japë informacione shpjeguese se si është llogaritur efekti i një ndryshimi në një supozim alternativ të arsyeshëm të mundshëm. Për këtë qëllim, rëndësia do të gjykohet në lidhje me sufiçitin ose defiçitin, dhe aktivet totale ose detyrimet totale, ose, kur ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në aktivet/kapitalin neto, kapitalin total.

Një njësi do të paraqesë informacionet shpjeguese sasiore të kërkuara nga ky paragraf në formatin tabelor, përveç rasteve kur një format tjetër është më i përshtatshëm.

34. Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, një njësi përcakton vlerën e tij të drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi (shih paragrafët AG149–AG154 të SNKSP 41). Megjithatë, evidenca më e mirë e vlerës së drejtë në njohjen fillestare është çmimi i transaksionit (d.m.th., vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë), përveç rasteve kur plotësohen kushtet e përshkruara në paragrafin AG151 të SNKSP 41. Nga kjo rrjedh se mund të ketë një diferencë midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe shumës që do të përcaktohej në atë datë duke përdorur teknikën e vlerësimit. Nëse ekziston një ndryshim i tillë, një njësi ekonomike do të japë informacione shpjegues për, sipas klasës së instrumentit financiar:

- (a) Politikën e saj të kontabilitetit për njohjen e asaj difference në sufiçit ose defiçit për të reflektuar një ndryshim në faktorët (përfshirë kohën) që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në përcaktimin e një çmimi (shih paragrafin AG117(b) të SNKSP 41); dhe
- (b) Diferencën totale ende për t'u njohur në sufiçit ose defiçit në fillim dhe në

fund të periudhës dhe një rakordim të ndryshimeve në tepricën e kësaj diference.

35. Informacionet shpjeguese të vlerës së drejtë nuk kërkohen/janë të detyrueshme:
- (a) Kur vlera e mbartur është një përafrim i arsyeshëm i vlerës së drejtë, për shembull, për instrumente financiare të tillë si llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme tregtare afatshkurtra; dhe
 - (b) [Fshirë]
 - (c) Për një kontratë që përmban një tipar të pjesëmarrjes diskrecional nëse vlera e drejtë e këtij tipari nuk mund të matet me besueshmëri.
36. Në rastin e përshkruar në paragrafin 35(c), një njësi do të japë informacion shpjegues për të ndihmuar përdoruesit e pasqyrave financiare të bëjnë gjykimet e tyre rreth shkallës së diferencave të mundshme midis vlerës së mbartur të këtyre kontratave dhe vlerës së tyre të drejtë, duke përfshirë:
- (a) Faktin që informacioni për vlerën e drejtë nuk është paraqitur për këto instrumente sepse vlera e tyre e drejtë nuk mund të matet me besueshmëri;
 - (b) Një përshkrim të instrumenteve financiare, vlerën e mbartur të tyre, dhe një shpjegim se përse vlera e drejtë nuk mund të matet me besueshmëri;
 - (c) Informacion për tregun e instrumenteve;
 - (d) Informacion nëse dhe si njëسيا synon të shesë instrumentet financiare; dhe
 - (e) Nëse instrumentet financiare, vlera e drejtë e të cilëve më parë nuk mund të matej në mënyrë të besueshme çregjistrohen, ky fakt, vlerën e tyre të mbartur në kohën e çregjistrimit, dhe shumën e fitimit ose humbjes së njohur.

Kreditë Koncesionare

37. Kreditë koncesionare jepen nga njësitë me kushte më të ulëta se të tregut. Shembuj të kredive koncesionare që zakonisht kanë kushte nën atyre të tregut përfshijnë kredi për vendet në zhvillim, ferma të vogla, kredi studentore të dhëna për studentët e kualifikuar për arsimin universitar ose kolegji, dhe kredi për strehim të dhëna për familjet me të ardhura të ulëta. Për kreditë koncesionare të dhëna dhe të matura me kosto të amortizuar në përputhje me paragrafin 40 të SNKSP 41, një njësi ekonomike duhet të paraqesë:
- (a) Një rakordim midis vlerave të mbartura të hapjes dhe mbylljes së kredive, duke përfshirë:
 - (i) Vlerën nominale të kredive të reja të dhëna gjatë periudhës;
 - (ii) Rregullimin e vlerës së drejtë në njohjen fillestare;

- (iii) Kreditë e ripaguara gjatë periudhës;
 - (iv) Humbjet e njohura nga zhvlerësimi;
 - (v) Çdo rritje gjatë periudhës në shumën e skontuar që vjen nga kalimi i kohës; dhe
 - (vi) Ndryshime të tjerë.
- (b) Vlerën nominale të kredisë në fund të periudhës;
 - (c) Qëllimin dhe kushtet e llojeve të ndryshme të kredive; dhe
 - (d) Supozimet e vlerësimit.
37. Për kreditë konçesionare të matura me vlerën e drejtë në përputhje me paragrafin 41 ose 43 të SNKSP 41, një njësi ekonomike duhet të paraqesë:
- (a) Një rakordim midis vlerave të mbartura të hapjes dhe mbylljes së kredive, duke përfshirë:
 - (i) Vlerën nominale të kredive të reja të dhëna gjatë periudhës;
 - (ii) Rregullimin e vlerës së drejtë në njohjen fillestare;
 - (iii) Kreditë e ripaguara gjatë periudhës;
 - (iv) Rregullimin e vlerës së drejtë gjatë periudhës (të ndarë nga njohja fillestare); dhe
 - (v) Ndryshime të tjerë.
 - (b) Vlerën nominale të kredisë në fund të periudhës;
 - (c) Qëllimin dhe kushtet e llojeve të ndryshme të kredive, duke përfshirë natyrën e konçesionit; dhe
 - (d) Supozimet e vlerësimit.

Natyra dhe Masa e Rreziqeve që Vijnë nga Instrumentet Financiare

38. **Një njësi do të paraqesë informacion që u mundëson përdoruesve të pasqyrave të saj financiare të vlerësojnë natyrën dhe masën e rreziqeve që vijnë nga instrumentet financiare ndaj të cilave njësia është e ekspozuar në fund të periudhës së raportimit.**
39. Dhënia e informacioneve shpjegues të kërkuar nga paragrafët 40-49 fokusohen në rreziqet që lindin nga instrumentet financiare dhe mënyra se si ata janë menaxhuar. Këta rreziqe zakonisht përfshijnë, por nuk kufizohen në, rrezikun e kreditit/kredisë, rrezikun e likuiditetit, dhe rrezikun e tregut.
- 39A. Dhënia e informacioneve shpjegues cilësorë në kontekstin e informacioneve shpjegues sasiore u mundëson përdoruesve të lidhin informacionet e ngjashëm dhe kështu të formojnë një pamje të përgjithshme të natyrës dhe masës së

rreziqeve që vijnë nga instrumentet financiare. Ndërveprimi midis informacioneve shpjegues cilësorë dhe sasiorë kontribuon në paraqitjen e informacioneve në një mënyrë që u mundëson përdoruesve të vlerësojnë ekspozimin e një njësie ekonomike ndaj rreziqeve.

Dhënia e Informacioneve Cilësore

40. Për çdo lloj rreziku që vjen nga instrumentet financiare, një njësi do të paraqesë:
- (a) Ekspozimet ndaj rrezikut dhe si lindin ata;
 - (b) Objektivat, politikat, dhe proceset e tij për menaxhimin e rrezikut dhe metodat e përdorura për të matur rrezikun; dhe
 - (c) Çdo ndryshim në (a) ose (b) nga periudha e mëparshme.

Dhënia Informacioneve Sasiore

41. Për çdo lloj rreziku që vjen nga instrumentet financiare, një njësi do të paraqesë:
- (a) Të dhëna sasiore përmbledhëse rreth ekspozimit të saj ndaj këtij rreziku në fund të periudhës së raportimit. Këto informacione shpjegues do të bazohen në informacionin e dhënë brenda për personelin drejtues kryesor të njësisë ekonomike (siç përcaktohet në SNKSP 20, *Paraqitja e Informacioneve për Palët e Ndërlidhura*), për shembull, organin drejtues të njësisë ekonomike ose zyrtarin ekzekutiv.
 - (b) Dhënia e informacioneve shpjegues të kërkuar nga paragrafët 43–49, në masën që nuk jepet në përputhje me (a).
 - (c) Përqendrimet e rrezikut nëse nuk janë të dukshëm nga informacionet shpjegues të dhënë në përputhje me (a) dhe (b).
42. Nëse të dhënat sasiore të paraqitura në fund të periudhës së raportimit nuk përfaqësojnë ekspozimin e një njësie ekonomike ndaj rrezikut gjatë periudhës, një njësi ekonomike do të japë informacion të mëtejshëm që është përfaqësues.

Rreziku i Kreditit

Objekti dhe Objektivat

- 42A. Një njësi do të zbatojë kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafët 42F–42N për instrumentet financiare për të cilat zbatohen kërkesat për zhvlerësim në SNKSP 41. Megjithatë:
- (a) Për llogaritë e arkëtueshme që rezultojnë nga transaksionet këmbyes që janë brenda fushëveprimit të SNKSP 9 dhe transaksionet pa këmbim brenda fushëveprimit të SNKSP 23 dhe të llogarive të arkëtueshme nga qiratë, paragrafi 42J(a) zbatohet për ato të arkëtueshme ose të arkëtueshme nga qiratë në të cilat njihen humbjet e pritshme të kreditit gjatë gjithë jetës. në përputhje me paragrafin 87 të SNKSP 41, nëse këta

aktive financiare modifikohen ndërkohë që kanë kaluar afatin e pagesës me më shumë se 30 ditë; dhe

(b) Paragrafi 42K(b) nuk zbatohet për llogaritë e arkëtueshme të qirave.

42B. Informacionet shpjegues për rrezikun e kreditit të dhënë në përputhje me paragrafët 42F–42N do t'u mundësojë përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë efektin e rrezikut të kreditit në shumën, kohën dhe pasigurinë e flukseve monetare të ardhshëm. Për të arritur këtë objektivi, informacioneve e rrezikut të kreditit do të japin:

(a) Informacion për praktikatat e menaxhimit të rrezikut të kreditit/kredisë të një njësie ekonomike dhe se si ata lidhen me njohjen dhe matjen e humbjeve të pritshme të kreditit, duke përfshirë metodat, supozimet dhe informacionin e përdorur për të matur humbjet e pritshme të kreditit;

(b) Informacion sasiore dhe cilësor që u lejon përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë shumat në pasqyrat financiare që vijnë nga humbjet e pritshme të kreditit, duke përfshirë ndryshimet në shumën e humbjeve të pritshme të kreditit dhe arsytet për këta ndryshime; dhe

(c) Informacion për ekspozimin ndaj rrezikut të kreditit/kredisë të një njësie (d.m.th., rreziku i kreditit i natyrshëm në aktivet financiare të një njësie ekonomike dhe angazhimet për të dhënë kredit), duke përfshirë përqendrimet e rëndësishme të rrezikut të kreditit.

42C. Një njësi nuk ka nevojë të kopjojë informacionin që është prezantuar tashmë diku tjetër, me kusht që informacioni të përfshihet me referencë të kryqëzuar nga pasqyrat financiare në pasqyra të tjera, të tilla si një dokument komentesh nga drejtimi ose raporti i rrezikut që është i disponueshëm për përdoruesit e pasqyrave financiare në të njëjtat kushte si pasqyrat financiare dhe në të njëjtën kohë. Pa informacionin e përfshirë me referencë të kryqëzuar, pasqyrat financiare janë të paplota.

42D. Për të përmbushur objektivat në paragrafin 42B, një njësi do të (përveç rasteve kur specifikohet ndryshe) marrë në konsideratë se sa detaje duhet të jepen, sa theks duhet t'i kushtohet aspekteve të ndryshme të kërkesave për dhënie informacionesh, nivelin e duhur të grupimit ose ndarjes dhe nëse përdoruesit e pasqyrave financiare kanë nevojë për shpjegime shtesë për të vlerësuar informacionin sasiore të paraqitur.

42E. Nëse informacionet shpjegues të dhënë në përputhje me paragrafët 42F–42N janë të pamjaftueshëm për të përmbushur objektivat në paragrafin 42B, një njësi do të japë informacione shtesë që janë të nevojshëm për të përmbushur këta objektiva.

Praktikat e Menaxhimit të Rrezikut të Kreditit

42F. Një njësi do të shpjegojë praktikatat e saj të menaxhimit të rrezikut të kreditit dhe

mënyrën se si ato lidhen me njohjen dhe matjen e humbjeve të pritshme të kreditit. Për të përmbushur këtë objektiv, një njësi do të japë informacion shpjegues që u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë dhe vlerësojnë:

- (a) Si përcaktoi një njësi nëse rreziku i kreditit i instrumenteve financiare është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, duke përfshirë, nëse dhe si:
 - (i) Instrumentet financiare konsiderohen të kenë rrezik të ulët krediti në përputhje me paragrafin 82 të SNKSP 41, duke përfshirë klasat e instrumenteve financiare për të cilat zbatohet; dhe
 - (ii) Prezumimi në paragrafin 83 të SNKSP 41, se ka pasur rritje të konsiderueshme në rrezikun kreditit që nga njohja fillestare, kur aktiveve financiare u ka kaluar afati i pagesës me më shumë se 30 ditë, është hedhur poshtë;
- (b) Përkufizimet e një njësie për mospagesën në kohë, duke përfshirë arsyet për përzgjedhjen e këtyre përkufizimeve;
- (c) Si janë grupuar instrumentet nëse humbjet e pritshme të kreditit maten mbi baza kolektive;
- (d) Si përcaktoi një njësi se aktivet financiare janë aktive financiare që janë kredit-zhvlerësuar;
- (e) Politikën e eliminimit të tepricave të një njësie, duke përfshirë treguesit se nuk ka pritshmëri të arsyeshme rikuperimi dhe informacion për politikën për aktivet financiare që janë eliminuar, por që janë ende subjekt i aktivitetit përmbarimor; dhe
- (f) Si janë zbatuar kërkesat në paragrafin 84 të SNKSP 41 për modifikimin e flukseve monetare kontraktuale të aktiveve financiare, duke përfshirë mënyrën se si një njësi:
 - (i) Përcakton nëse rreziku i kreditit për një aktiv financiar që është modifikuar ndërsa shuma e lejuar për kompensimin e humbjes është matur me një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kreditit gjatë gjithë jetës, është përmirësuar në masën që shuma e lejuar për kompensimin e humbjes kthehet në matje në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kreditit 12-mujore në përputhje me paragrafin 77 të SNKSP 41; dhe
 - (ii) Monitoron masën në të cilën shuma e lejuar për kompensimin e humbjes për aktivet financiare që plotësojnë kriteret në (i) rimatet më pas me një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kreditit gjatë gjithë jetës në përputhje me paragrafin 75 të SNKSP 41.

- 42G. Një njësi do të shpjegojë të dhënat, supozimet dhe teknikat e vlerësimit të përdorura për të zbatuar kërkesat në paragrafët 73–93 të SNKSP 41. Për këtë qëllim një njësi duhet të paraqesë:
- (a) Bazën e të dhënave e supozimeve dhe teknikat e vlerësimit të përdorura për të:
 - (i) Matur humbjet e pritshme të kreditit 12-mujore dhe gjatë gjithë jetës;
 - (ii) Përcaktuar nëse rreziku i kreditit të instrumenteve financiare është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare; dhe
 - (iii) Përcaktuar nëse një aktiv financiar është një aktiv financiar është kredit-zhvlerësuar.
 - (b) Si është përfshirë informacioni largpamës në përcaktimin e humbjeve të pritshme të kreditit, duke përfshirë përdorimin e informacionit makroekonomik; dhe
 - (c) Ndryshimet në teknikat e vlerësimit ose supozimet e rëndësishme të bëra gjatë periudhës së raportimit dhe arsyet e atyre ndryshimeve.

Informacion Sasior dhe Cilësor për Shumat që Vijnë nga Humbjet e Pritshme të Kreditit

- 42H. Për të shpjeguar ndryshimet në shumën ndihmëse të lejuar të humbjes dhe arsyt e këtyre ndryshimeve, një njësi duhet të japë, sipas kategorisë së instrumentit financiar, një rakordim nga teprica e çeljes në batë të mbylljes së shumës ndihmëse të lejuar të humbjes, në një tabelë, që tregon veçmas ndryshimet gjatë periudhës për:
- (a) Shumën e lejuar për kompensimin e humbjes të matur në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kreditit 12-mujore;
 - (b) Shumën e lejuar për kompensimin e humbjes të matur në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kreditit gjatë gjithë jetës për:
 - (i) Instrumentet financiare për të cilat rreziku i kreditit është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, por që nuk janë aktive financiare kredit-zhvlerësuar;
 - (ii) Aktivet financiare që janë kredit-zhvlerësuar në datën e raportimit (por që nuk janë blerë ose janë fillimisht kredit-zhvlerësuar); dhe
 - (iii) Llogaritë e arkëtueshme që rezultojnë nga transaksionet e këmbimit që janë brenda fushëveprimit të SNKSP 9 ose transaksionet pa këmbim që janë brenda fushëveprimit të SNKSP 23 ose llogaritë e arkëtueshme nga qiratë për të cilat shumat e lejuara për kompensimin e humbjeve maten në përputhje me paragrafin 87 të SNKSP 41.
 - (c) Aktivet financiare që janë blerë ose janë fillimisht kredit-zhvlerësuar.

Krahas rakordimit, një njësi duhet të paraqesë shumën totale të humbjeve të pritshme të kreditit të paskontuara në njohjen fillestare të aktiveve financiare të njohur fillimisht gjatë periudhës së raportimit.

- 42I. Për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë ndryshimet në shumën e lejuar për kompensimin e humbjeve të paraqitur në përputhje me paragrafin 42H, një njësi do të japë një shpjegim se si ndryshimet e rëndësishme në vlerën e mbartur bruto të instrumenteve financiare gjatë periudhës kanë kontribuar në ndryshimet në shumën e lejuar për kompensimin e humbjeve. Informacioni do të jepet veç për instrumentet financiare që përfaqësojnë shumën e lejuar për kompensimin e humbjeve siç renditet në paragrafin 42H(a)–(c) dhe do të përfshijë informacionin cilësor dhe sasior përkatës. Shembuj të ndryshimeve në vlerën e mbartur bruto të instrumenteve financiare që kontribuan në ndryshimet në shumën e lejuar për kompensimin e humbjeve mund të përfshijnë:
- (a) Ndryshimet për shkak të instrumenteve financiare të krijuar ose të blerë gjatë periudhës së raportimit
 - (b) Modifikimin e flukseve monetare kontraktuale mbi aktivet financiare që nuk rezultojnë në çregjistrimin e këtyre aktiveve financiare në përputhje me SNKSP 41;
 - (c) Ndryshimet për shkak të instrumenteve financiare që janë çregjistruar (përfshirë ata që janë eliminuar - zeruar) gjatë periudhës së raportimit; dhe
 - (d) Ndryshimet që vijnë nga fakti nëse shuma e lejuar për kompensimin e humbjes matet me një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kreditit 12-mujore ose gjatë gjithë jetës.
- 42J. Për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare që të kuptojnë natyrën dhe efektin e modifikimeve të flukseve monetare kontraktuale mbi aktivet financiare që nuk kanë rezultuar në çregjistrim dhe efektin e këtyre modifikimeve në matjen e humbjeve të pritshme të kredisë, një njësi do të paraqesë:
- (a) Koston e amortizuar përpara modifikimit dhe fitimin ose humbjen neto të modifikimit të njohur për aktivet financiare për të cilat flukset monetare kontraktuale janë modifikuar gjatë periudhës së raportimit ndërkohë që ata kishin një shumë të lejuar për kompensimin e humbjeve të matur në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kreditit gjatë gjithë jetës; dhe
 - (b) Vlerën e mbartur bruto në fund të periudhës së raportimit të aktiveve financiare që janë modifikuar që nga njohja fillestare në një kohë kur shuma e lejuar për kompensimin e humbjes është matur me një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kreditit gjatë gjithë jetës dhe për të

cilën shuma e lejuar për kompensimin e humbjes ka ndryshuar gjatë periudhës së raportimit në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kreditit 12-mujore.

42K. Për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë efektin e kolateralit dhe përmirësimeve të tjerë të kreditit mbi shumat që vijnë nga humbjet e pritshme të kreditit, një njësi do të paraqesë sipas klasës së instrumentit financiar:

- (a) Shumën që përfaqëson më mirë ekspozimin e saj maksimal ndaj rrezikut të kreditit në fund të periudhës së raportimit, pa marrë parasysh ndonjë kolateral të mbajtur ose përmirësime të tjera të kreditit (p.sh., marrëveshjet e ndërthurura që nuk kualifikohen për kompensim në përputhje me SNKSP 28).
- (b) Një përshkrim narrativ të kolateralit të mbajtur si siguri dhe përmirësime të tjera krediti, duke përfshirë:
 - (i) Një përshkrim të natyrës dhe cilësisë së kolateralit të mbajtur;
 - (ii) Një shpjegim të çdo ndryshimi të rëndësishëm në cilësinë e atij kolaterali ose përmirësimit të kreditit si rezultat i përkeqësimit ose ndryshimeve në politikat e kolateralit të njësisë gjatë periudhës së raportimit; dhe
 - (iii) Informacionin rreth instrumenteve financiare për të cilët një njësi nuk ka njohur një shumë të lejuar për kompensimin e humbjeve për shkak të kolateralit.
- (c) Informacion sasior për kolateralin të mbajtur si siguri dhe përmirësime të tjera të kreditit (për shembull, përcaktimi sasior i masës në të cilën kolaterali dhe përmirësimet e tjerë të kredisë zbutin rrezikun e kreditit) për aktivet financiare që janë kredit-zhvlerësuar në datën e raportimit.

42L. Një njësi do të japë informacion shpjegues për shumën kontraktuale të papaguar për aktivet financiare që janë eliminuar gjatë periudhës së raportimit dhe që janë ende subjekt i aktivitetit të përmbartimit.

Ekspozimi ndaj Rrezikut të Kreditit

42M. Për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë ekspozimin ndaj rrezikut të kreditit të një njësie dhe të kuptojnë përqendrimet e rëndësishme të rrezikut të kreditit, një njësi do të paraqesë, sipas klasave të vlerësimit të rrezikut të kreditit, vlerën e mbartur bruto të aktiveve financiare dhe ekspozimin ndaj rrezikut të kreditit për angazhimet e kredisë dhe kontratat e garancisë financiare. Ky informacion do të jepet veç për instrumentet financiare:

- (a) Për të cilët shuma e lejuar për kompensimin e humbjes matet me një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kreditit 12-mujore;

- (b) Për të cilët shuma e lejuar për kompensimin e humbjes matet me një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kreditit gjatë gjithë jetës dhe që janë:
- (i) Instrumentet financiare për të cilat rreziku i kreditit është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, por që nuk janë aktive financiare kredit-zhvlërësuar;
 - (ii) Aktivitetet financiare që janë kredit-zhvlërësuar në datën e raportimit (por që nuk janë blerë ose janë fillimisht kredit-zhvlërësuar); dhe
 - (iii) Llogaritë e arkëtueshme që rezultojnë nga transaksionet e këmbimit që janë brenda fushëveprimit të SNKSP 9 ose transaksionet pa këmbim që janë brenda fushëveprimit të SNKSP 23 ose llogaritë e arkëtueshme nga qiratë për të cilat shumat e lejuara për kompensimin e humbjeve maten në përputhje me paragrafin 87 të SNKSP 41.
- (c) Që janë aktive financiare të blerë ose të krijuar fillimisht kredit-zhvlërësuar.
- 42N. Për llogaritë e arkëtueshme që rezultojnë nga transaksionet e këmbimit që janë brenda fushëveprimit të SNKSP 9 ose transaksionet pa këmbim që janë brenda fushëveprimit të SNKSP 23 ose llogaritë e arkëtueshme të qirave për të cilat një njësi ekonomike zbaton paragrafin 87 të SNKSP 41, informacioni i dhënë në përputhje me paragrafin 42M mund të bazohet në një matricë provizioni (shih paragrafin AG199 të SNKSP 41).
43. Për të gjithë instrumentet financiare brenda fushëveprimit të këtij Standardi, por për të cilët nuk zbatohen kërkesat për zhvlërësim në SNKSP 41, një njësi ekonomike do të paraqesë sipas klasës së instrumentit financiar:
- (a) Shumën që përfaqëson më së miri ekspozimin e saj maksimal ndaj rrezikut të kreditit në fund të periudhës raportuese, pa marrë parasysh ndonjë kolateral të mbajtur ose përmirësime të tjera të kreditit (p.sh., marrëveshjet e ndërthurura që nuk kualifikohen për kompensim në përputhje me SNKSP 28); ky informacion shpjegues nuk kërkohet/është i detyrueshëm për instrumentet financiare, vlera e mbartur e të cilëve përfaqëson më së miri ekspozimin maksimal ndaj rrezikut të kreditit;
 - (b) Një përshkrim të kolateralit të mbajtur si siguri dhe përmirësime të tjerë të kreditit, dhe efektin e tyre financiar (p.sh., sasinë e masës në të cilën kolaterali dhe përmirësimet e tjera të kreditit zbutin rrezikun e kreditit) në lidhje me shumën që përfaqëson më së miri ekspozimin maksimal ndaj rrezikut të kreditit (qoftë i paraqitur në përputhje me (a) ose i përfaqësuar nga vlera e mbartur e një instrumenti financiar);
 - (c) [Fshirë]

(d) [Fshirë]

44. [Fshirë]

Kolaterali dhe Përmirësime të Tjerë të Kreditit të Marrë

45. Kur një njësi merr aktive financiare ose jofinanciare gjatë periudhës duke marrë në zotërim kolateralin që ajo mban si siguri ose duke kërkuar përmirësime të tjerë krediti (p.sh. garanci), dhe këta aktive plotësojnë kriteret e njohjes në Standarde të tjera, një njësi do të paraqesë për aktive të tillë të mbajtur në datën e raportimit:

- (a) Natyrën dhe vlerën e mbartur të aktiveve; dhe
- (b) Kur aktivet nuk janë lehtësisht të konvertueshëm në para, politikat e saj për shitjen/nxjerrjen jashtë përdorimit të këtyre aktiveve ose për përdorimin e tyre në operacionet e saj.

Rreziku i Likuiditetit

46. Një njësi do të paraqesë:

- (a) Një analizë maturimi për detyrimet financiare joderivativë (përfshirë kontratat e garancisë financiare të emetuara) që tregon maturimet e mbetura kontraktuale.
- (b) Një analizë maturimi për detyrimet financiare derivativë. Analiza e maturimit do të përfshijë maturimet e mbetura kontraktuale për ata detyrime financiare derivativë për të cilët maturimet kontraktuale janë thelbësore për të kuptuar kohën e flukseve monetare (shih paragrafin AG14).
- (c) Një përshkrim se si e menaxhon rrezikun e likuiditetit të qenësishëm në pikat (a) dhe (b).

Rreziku i Tregut

Analiza e Sensitivitetit

47. Përveç nëse një njësi është në përputhje me paragrafin 48, ajo do të paraqesë:

- (a) Një analizë të sensitivitetit për çdo lloj rreziku tregu ndaj të cilit njësia ekonomike është e ekspozuar në fund të periudhës së raportimit, duke treguar se si sufiçiti ose defiçiti dhe aktivet/kapitali neto do të ishin ndikuar nga ndryshimet në variablin përkatës të rrezikut që ishin të mundshëm në mënyrë të arsyeshme në atë datë;
- (b) Metodat dhe supozimet e përdorura në përgatitjen e analizës së sensitivitetit; dhe
- (c) Ndryshimet nga periudha e mëparshme në metodat dhe supozimet e përdorura, dhe arsyet për ndryshime të tilla.

48. Nëse një njësi pregatit një analizë sensitiviteti, të tillë si vlera në rrezik, që pasqyron ndërvlerësinë ndërmjet variablave të rrezikut (p.sh., normat e interesit dhe kurset e këmbimit) dhe e përdor atë për të menaxhuar rreziqet financiare, ajo mund të përdorë atë analizë sensitiviteti në vend të analizës së specifikuar në paragrafin 47. Njësia do të paraqesë gjithashtu:
- (a) Një shpjegim të metodës së përdorur në pregatitjen e një analize të tillë sensitiviteti, si dhe të parametrave dhe supozimeve kryesore që qëndrojnë në themel të të dhënave të ofruara; dhe
 - (b) Një shpjegim të objektivit të metodës së përdorur dhe i kufizimeve që mund të rezultojnë në informacionin që nuk pasqyron plotësisht vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve të përfshirë.

Dhënia e Informacioneve të Tjera për Rrezikun e Tregut

49. Kur analizat e sensitivitetit të paraqitura në përputhje me paragrafin 47 ose 48 nuk përfaqësojnë një rrezik të qenësishëm në një instrument financiar (p.sh., për shkak se ekspozimi në fund të vitit nuk pasqyron ekspozimin gjatë vitit), njësia ekonomike do të japë informacion për këtë fakt dhe arsyen pse ajo beson se analizat e sensitivitetit nuk janë përfaqësuese.

Transfertat e Aktiveve Financiare

- 49A. Kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafët 49B–49H në lidhje me transferimet e aktiveve financiare plotësojnë kërkesat e tjera për dhënie informacionesh shpjeguese të këtij Standardi. Një njësi do të prezantojë informacionet shpjegues të kërkuar nga paragrafët 49B–49H në një shënim të vetëm në pasqyrat e saj financiare. Një njësi do të japë informacionet e kërkuar për të gjithë aktivet financiare të transferuar që nuk janë çregjistruar dhe për çdo përfshirje të vazhdueshme në një aktiv të transferuar, që ekziston në datën e raportimit, pavarësisht se kur ka ndodhur transaksioni i transferimit përkatës. Për qëllimet e zbatimit të kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese në këta paragrafë, një njësi transferon të gjithë ose një pjesë të një aktivi financiar (aktivi financiar i transferuar) nëse dhe vetëm nëse ai ose:
- (a) Transferon të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare të atij aktivi financiar; ose
 - (b) Ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare të atij aktivi financiar, por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'i paguar flukset monetare një ose më shumë marrësve në një marrëveshje.
49. Një njësi do të paraqesë informacion (shpjegues) që u mundëson përdoruesve të pasqyrave të saj financiare:
- (a) Të kuptojë marrëdhënien ndërmjet aktiveve financiare të transferuar që nuk çregjistrohen në tërësi dhe detyrimeve të shoqëruar me ta; dhe
 - (b) Për të vlerësuar natyrën dhe rreziqet që shoqërohen me përfshirjen e

vazhdueshme të njësisë në aktivet financiare të çregjistruar.

49C. Për qëllimet e zbatimit të kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafët 49E–49H, një njësi ka përfshirje të vazhdueshme në një aktiv financiar të transferuar nëse, si pjesë e transferimit, njësia ekonomike ruan ndonjë nga të drejtat ose detyrimet kontraktuale të qenësishme në aktivin financiar të transferuar ose merr ndonjë të drejtë ose detyrim të ri kontraktual në lidhje me aktivin financiar të transferuar. Për qëllimet e zbatimit të kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafët 49E–49H, sa vijon nuk përbën përfshirje të vazhdueshme:

- (a) Përfaqësimet dhe garancitë normale që lidhen me transferimin mashtrues dhe konceptet e arsyeshmërisë, mirëbesimit dhe marrëdhënieve të drejta që mund të bëjnë jo të vlefshëm një transferim si rezultat i veprimeve/vendimeve ligjore;
- (b) Kontratat e ardhshme, opsionet dhe kontrata të tjera për të rimarrë aktivin financiar të transferuar për të cilin çmimi i kontratës (ose çmimi i ushtrimit) është vlera e drejtë e aktivit financiar të transferuar; ose
- (c) Një marrëveshje ku një njësi ekonomike ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare të një aktivi financiar, por merr një detyrim kontraktual për t'i paguar flukset monetare një ose më shumë njësisive dhe kushtet në paragrafin 16(a)–(c) të SNKSP 41 plotësohen.

Aktivet Financiare të Transferuar që nuk Çregjistrohen në Tërësinë e Tyre

49D. Një njësi mund të ketë transferuar aktive financiare në atë mënyrë që një pjesë ose të gjithë aktivet financiare të transferuar të mos kualifikohen për çregjistrim. Për të përmbushur objektivat e përcaktuar në paragrafin 49B(a), njësia duhet të japë informacione shpjeguese në çdo datë raportimi për secilën klasë të aktiveve financiare të transferuara që nuk çregjistrohen në tërësinë e tyre:

- (a) Natyrën e aktiveve të transferuar.
- (b) Natyrën e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë ndaj të cilave është e ekspozuar njësia.
- (c) Një përshkrim të natyrës së marrëdhënies midis aktiveve të transferuar dhe detyrimeve të shoqëruar me ta, duke përfshirë kufizimet që vijnë nga transferimi në përdorimin e aktiveve të transferuara të njësisë raportuese.
- (d) Kur kundërpala (kundërpalët) ndaj detyrimeve të shoqëruar ka (kanë) rekurs (opsion ndihmës) vetëm për aktivet e transferuar, një skemë që përcakton vlerën e drejtë të aktiveve të transferuar, vlerën e drejtë të detyrimeve të lidhura me ta dhe pozicionin neto (diferencën midis vlerës së drejtë të aktiveve të transferuar dhe e detyrimeve të shoqëruara me ta).
- (e) Kur njësia vazhdon të njohë të gjithë aktivet e transferuar, vlerat e

mbartura të aktiveve të transferuar dhe detyrimet shoqërues.

- (f) Kur njësia vazhdon të njohë aktivet në masën e përfshirjes së saj të vazhdueshme (shih paragrafët 17(c)(ii) dhe 27 të SNKSP 41), vlerën totale të mbartur të aktiveve origjinale përpara transferimit, vlerën e mbartur të aktiveve që njësia vazhdon të njohë dhe vlerën e mbartur të detyrimeve shoqërues.

Aktivët Financiare të Transferuar që Çregjistrohen në Tërësinë e Tyre

49E. Për të përmbushur objektivat e përcaktuar në paragrafin 49B(b), kur një njësi çregjistron aktivet financiare të transferuar në tërësinë e tyre (shih paragrafin 17(a) dhe 17(c)(i) të SNKSP 41), por ka një përfshirje të vazhdueshme në ta, njësia ekonomike do të paraqesë, si minimum, për çdo lloj përfshirjeje të vazhdueshme në çdo datë raportimi:

- (a) Vlerën e mbartur të aktiveve dhe detyrimeve që njihen në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë dhe përfaqësojnë përfshirjen e vazhdueshme të njësisë ekonomike në aktivet financiar të çregjistruar dhe zërat përkatës në të cilët njihet vlera e mbartur e këtyre aktiveve dhe detyrimeve.
- (b) Vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve që përfaqësojnë përfshirjen e vazhdueshme të njësisë në aktivet financiare të çregjistruar.
- (c) Shumën që përfaqëson më së miri ekspozimin maksimal të njësisë ndaj humbjes nga përfshirja e saj e vazhdueshme në aktivet financiare të çregjistruar dhe informacionin që tregon se si përcaktohet ekspozimi maksimal ndaj humbjes.
- (d) Flukset dalës të mjeteve monetare të paskontuar që do të kërkoheshin ose mund të kërkohen për të riblerë aktivet financiare të çregjistruar (p.sh., çmimi fiks në një marrëveshje opsioni) ose shuma të tjera që i paguhen marrësit të transferimit në lidhje me aktivet e transferuar. Nëse fluksi dalës i mjeteve monetare është i ndryshueshëm, atëherë shuma e paraqitur duhet të bazohet në kushtet që ekzistojnë në çdo datë raportimi.
- (e) Një analizë maturimi të flukseve monetare dalës të paskontuar që do ose mund të kërkohen për të riblerë aktivet financiare të çregjistruar ose shuma të tjera të pagueshme për marrësin e transferuarimit në lidhje me aktivet e transferuar, duke treguar maturimet e mbetura kontraktuale të përfshirjes së vazhdueshme të njësisë.
- (f) Informacionin cilësor që shpjegon dhe mbështet informacionet shpjegues sasiore të kërkuar në (a)–(e).

49F. Një njësi mund të grupojë informacionin e kërkuar nga paragrafi 49E në lidhje me një aktiv të caktuar nëse njësia ka më shumë se një lloj përfshirjeje të vazhdueshme në atë aktiv financiar të çregjistruar, dhe ta raportojë atë sipas një lloji të përfshirjes së vazhdueshme.

- 49G. Krahas kësaj, një njësi do të paraqesë për çdo lloj përfshirje të vazhdueshme:
- (a) Fitimin ose humbjen e njohur në datën e transferimit të aktiveve.
 - (b) Të ardhurat dhe shpenzimet e njohura, si në periudhën e raportimit, ashtu edhe në mënyrë kumulative, nga përfshirja e vazhdueshme e njësisë ekonomike në aktivet financiare të çregjistruar (p.sh., ndryshimet në vlerën e drejtë në instrumentet derivative).
 - (c) Nëse shuma totale e të ardhurave nga aktiviteti i transferimit (që kualifikohet për çregjistrim) në një periudhë raportimi nuk shpërndahe në mënyrë të barabartë gjatë gjithë periudhës së raportimit (p.sh., nëse një pjesë e konsiderueshme e shumës totale të aktivitetit të transferimit ndodh në ditët e mbylljes së një periudhe raportimi):
 - (i) Kur aktiviteti më i madh i transferimit ka ndodhur brenda asaj periudhe raportimi (p.sh., pesë ditët e fundit para përfundimit të periudhës së raportimit),
 - (ii) Shumën (p.sh., fitimet ose humbjet e lidhura) të njohura nga aktiviteti i transferimit në atë pjesë të periudhës së raportimit, dhe
 - (iii) Shumën totale të të ardhurave nga aktiviteti i transferimit në atë pjesë të periudhës së raportimit.

Një njësi do të japë këtë informacion për çdo periudhë për të cilën prezantohet një pasqyrë e aktiveve/kapitalit neto.

Informacion Suplementar

- 49H. Një njësi do të paraqesë çdo informacion shtesë që e konsideron të nevojshëm për të përmbushur objektivat e dhënies së informacioneve shpjeguese në paragrafin 49B.

Zbatimi Fillestar i SNKSP 41

- 49I. Në periudhën e raportimit që përfshin datën e zbatimit fillestar të SNKSP 41, njësia do të japë informacionin e mëposhtëm për secilën klasë të aktiveve dhe detyrimeve financiare në datën e zbatimit fillestar:
- (a) Kategorinë origjinale të matjes dhe vlerën e mbartur të përcaktuar në përputhje me SNKSP 29;
 - (b) Kategorinë e re të matjes dhe vlerën e mbartur të përcaktuar në përputhje me SNKSP 41;
 - (c) Shumën e çdo aktivi dhe detyrimi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar që më parë ishin përcaktuar/klasifikuar si të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit, por nuk janë më të përcaktuara në këtë mënyrë, duke bërë dallimin midis atyre që SNKSP 41 kërkon që një njësi të riklasifikojë dhe atyre që një njësi zgjedh të

riklasifikojë në datën e zbatimit fillestar.

49J. Në periudhën e raportimit që përfshin datën e zbatimit fillestar të SNKSP 41, një njësi do të japë informacione cilësore për t'u mundësuar përdoruesve të kuptojnë:

- (a) Si i zbatoi kërkesat e klasifikimit në SNKSP 41 për ato aktive financiare, klasifikimi i të cilave ka ndryshuar si rezultat i zbatimit të SNKSP 41.
- (b) Arsytet për çdo përcaktim ose mospërcaktim të aktiveve ose detyrimeve financiare të matur me vlerën e drejtë përmes sufiçitit ose defiçitit në datën e zbatimit fillestar.

49K. Në periudhën e raportimit që një njësi zbaton në fillim kërkesat e klasifikimit dhe matjes për aktivet financiare në SNKSP 41 (d.m.th., kur njësia kalon nga SNKSP 29 në SNKSP 41 për aktivet financiare), ajo do të prezantojë informacionet shpjeguese të përcaktuara në paragrafët 49L–49O. të këtij Standardi siç kërkohet nga paragrafi 173 i SNKSP 41.

49L. Kur kërkohet nga paragrafi 49K, një njësi do të paraqesë informacion për ndryshimet në klasifikimet e aktiveve dhe detyrimeve financiare në datën e zbatimit fillestar të SNKSP 41, duke treguar veç:

- (a) Ndryshimet në vlerat e mbartura në bazë të kategorive të tyre të matjes në përputhje me SNKSP 29 (d.m.th., që nuk rezultojnë nga një ndryshim në atributin/cilësinë e matjes në kalimin në SNKSP 41); dhe
- (b) Ndryshimet në vlerën e mbartur që vijnë nga një ndryshim në atributin/cilësinë e matjes në kalimin në SNKSP 41.

Informacionet shpjeguese në këtë paragraf nuk duhet të jepen pas periudhës së raportimit në të cilën njësi zbaton fillimisht kërkesat e klasifikimit dhe matjes për aktivet financiare në SNKSP 41.

49M. Kur kërkohet nga paragrafi 49K, një njësi do të paraqesë këto më poshtë për aktivet financiare dhe detyrimet financiare që janë riklasifikuar në mënyrë që ata të maten me koston e amortizuar dhe, në rastin e aktiveve financiare, që janë riklasifikuar nga vlera e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit në mënyrë që ata të maten me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto, si rezultat i kalimit në SNKSP 41:

- (a) Vlerën e drejtë të aktiveve ose detyrimeve financiare në fund të periudhës së raportimit; dhe
- (b) Fitimin ose humbjen e vlerës së drejtë që do të ishte njohur në sufiçit ose defiçit ose aktive/kapital neto gjatë periudhës së raportimit nëse aktivet financiare ose detyrimet financiare nuk do të ishin riklasifikuar.

Informacionet shpjeguese në këtë paragraf nuk janë të nevojshëm të jepen pas periudhës së raportimit në të cilën njësi zbaton fillimisht kërkesat e klasifikimit

dhe matjes për aktivet financiare në SNKSP 41.

49N. Kur kërkohet nga paragrafi 49K, një njësi do të paraqesë informacionet më poshtë për aktivet financiare dhe detyrimet financiare që janë riklasifikuar jashtë vlerës së drejtë nëpërmjet kategorisë së sufiçitit ose deficietit si rezultat i kalimit në SNKSP 41:

- (a) Normën efektive të interesit të përcaktuar në datën e zbatimit fillestar; dhe
- (b) Të ardhurat ose shpenzimet nga interesi të njohura.

Nëse një njësi trajton vlerën e drejtë të një aktivi financiar ose një detyrimi financiar si vlerën e re të mbartur bruto në datën e zbatimit fillestar (shih paragrafin 168 të SNKSP 41), informacionet shpjegues në këtë paragraf do të jepen për çdo periudhë raportimi deri në çregjistrimin. Përndryshe, informacionet shpjegues në këtë paragraf nuk është e nevojshme të jepen pas periudhës së raportimit në të cilën njësi zbaton fillimisht kërkesat e klasifikimit dhe matjes për aktivet financiare në SNKSP 41.

49O. Kur një njësi paraqet informacionet shpjegues të përcaktuar në paragrafët 49K–49N, këta informacione shpjegues dhe paraqitjet e informacioneve në paragrafin 29 të këtij Standardi, duhet të lejojnë rakordimin ndërmjet:

- (a) Kategorive të matjeve të prezantuara në përputhje me SNKSP 29 dhe SNKSP 41; dhe
- (b) Klasës së instrumenteve financiare

si janë në datën e zbatimit fillestar.

49P. Në datën e zbatimit fillestar të paragrafëve 73–93 të SNKSP 41, një njësi i kërkohet të japë informacion që do të lejonte rakordimin e shumave përfundimtare të lejuara për kompensimin e zhvlerësimit në përputhje me SNKSP 29 dhe provizioneve në përputhje me SNKSP 19 me shumë fillestare të lejuara për kompensimin e humbjeve të përcaktuara në përputhje me SNKSP 41. Për aktivet financiare, ky informacion do të jepet nga kategoritë e matjes së aktiveve financiare përkatës në përputhje me SNKSP 29 dhe SNKSP 41, dhe do të tregojë veç efektin e ndryshimeve në kategorinë e matjes në shumën e lejuar për kompensimin e humbjeve në atë datë.

49Q. Në periudhën e raportimit që përfshin datën e zbatimit fillestar të SNKSP 41, një njësi nuk i kërkohet të paraqesë shumë e zërave që do të ishin raportuar në përputhje me kërkesat e klasifikimit dhe matjes (që përfshin kërkesat e lidhura me matjen e kostos së amortizuar të aktiveve financiare dhe zhvlerësimit në paragrafët 69–72 dhe 73–93 të SNKSP 41) të:

- (a) SNKSP 41 për periudhat e mëparshme; dhe
- (b) SNKSP 29 për periudhën aktuale.

49R. Në përputhje me paragrafin 161 të SNKSP 41, nëse është e papraktikueshme

(siç përcaktohet në SNKSP 3) në datën e zbatimit fillestar të SNKSP 41 që një njësi të vlerësojë një element të parasë me vlerë kohore të modifikuar në përputhje me paragrafët AG68-AG70 të SNKSP 41 bazuar në faktet dhe rrethanat që ekzistojnë në njohjen fillestare të aktivitetit financiar, një njësi do të vlerësojë karakteristikat kontraktuale të fluksit monetar të atij aktiviteti financiar bazuar në faktet dhe rrethanat që ekzistojnë në njohjen fillestare të aktivitetit financiar pa marrë parasysh kërkesat e lidhura me modifikimin e vlerës kohore të elementit të parasë në paragrafët AG68-AG70 të SNKSP 41. Një njësi do të paraqesë vlerën e mbartur në datën e raportimit të aktiveve financiare, karakteristikat kontraktuale të fluksit monetar të të cilave janë vlerësuar bazuar në faktet dhe rrethanat që ekzistojnë në njohjen fillestare të aktivitetit financiar pa marrë parasysh kërkesat e lidhura me modifikimin e vlerës në kohë (kohore) të elementit të parasë në paragrafët AG68-AG70 të SNKSP 41 derisa këta aktive financiare të çregjistrohen.

- 49S. Në përputhje me paragrafin 162 të SNKSP 41, nëse është e papraktikueshme (siç përcaktohet në SNKSP 3) në datën e zbatimit fillestar që një njësi të vlerësojë nëse vlera e drejtë e një veçorie/tipari/cilësie të parapagimit ishte e parëndësishme në përputhje me paragrafët AG74(c) të SNKSP 41 bazuar në faktet dhe rrethanat që ekzistojnë në njohjen fillestare të aktivitetit financiar, një njësi do të vlerësojë karakteristikat kontraktuale të fluksit monetar të aktivitetit financiar bazuar në faktet dhe rrethanat që ekzistojnë në njohjen fillestare të atij aktiviteti financiar pa marrë parasysh përjashtimin për tiparet/cilësitë e parapagimit në paragrafin AG74 të SNKSP 41. Një njësi duhet të paraqesë informacion për vlerën e mbartur në datën e raportimit të aktiveve financiare, karakteristikat kontraktuale të fluksit monetar të të cilëve janë vlerësuar bazuar në faktet dhe rrethanat që ekzistojnë në njohjen fillestare të aktivitetit financiar pa marrë parasysh përjashtimin për tiparet/cilësitë e parapagimit në paragrafin AG74 të SNKSP 41 derisa këta aktive financiare të çregjistrohen.

Data Efektive dhe Periudha Kalimtare

50. **Një njësi do të zbatojë këtë Standard për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2013. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2013, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.**
51. **Një njësi nuk do të zbatojë këtë Standard përpara datës 1 janar, 2013, përveçse kur zbaton SNKSP 28 dhe SNKSP 29.**
52. Nëse një njësi zbaton këtë Standard për periudhat vjetore që fillojnë përpara datës 1 janar, 2013, ajo nuk ka nevojë të prezantojë informacion krahasues për informacionet shpjeguese të kërkuar nga paragrafët 38-49 për natyrën dhe shtrirjen e rreziqeve që vijnë nga instrumentet financiare.
- 52A. **Paragrafi 53 u ndryshua nga SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i***

Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara botuar në janar 2015. Një njësi do ta zbatojë këtë ndryshim për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2017. Zbatimi i mëparshëm lejohet. Nëse një njësi zbaton SNKSP 33 për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2017, ndryshimi do të zbatohet edhe për atë periudhë të mëparshme.

- 52B. SNKSP 35, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara*, SNKSP 37, *Marrëveshjet e Përbashkëta*, dhe SNKSP 38, *Paraqitjet e Informacioneve për Interesat në Njësitë e Tjera*, të publikuara në janar 2015, ndryshuan paragrafët 3(a) dhe AG6. Një njësi do të zbatojë atë ndryshim kur zbaton SNKSP 35, SNKSP 37 dhe SNKSP 38.
- 52C. Paragrafi AG7 u ndryshua nga *Përmirësime të SNKSP-ve 2015* botuar në prill 2016. Një njësi do të zbatojë këtë ndryshim për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2017. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimin për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2017, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.
- 52D. Paragrafët 6 dhe 7 u fshinë nga *Zbatueshmëria e SNKSP-ve*, botuar në prill 2016. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2018. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.
- 52E. Paragrafi 3 u ndryshua nga SNKSP 39, *Përfitimet e Punonjësve*, botuar në korrik 2016. Një njësi do të zbatojë këtë ndryshim për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2018. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimin për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 39 në të njëjtën kohë.
- 52F. Paragrafët 2, 3, 4, 5, 8, 11, 12, 13, 14, 18, 24, 34, 35, 36, 37, 41, 43, 45, AG1, AG5, AG9, AG10, AG24 dhe AG29 u ndryshuan, paragrafët 16, 17, 20, 26, 27, 28 dhe 44 u fshinë dhe disa tituj dhe paragrafët 5A, 13A, 14A, 14B, 15A, 15B, 15C, 17A, 17B, 17C, 17D, 17E, 17F, 20A, 24A, 25A, 25B, 25C, 25D, 26A, 26B, 26C, 27A, 27B, 27C, 27D, 27E, 27F, 28A, 28B, 28C, 28D, 28E, 28F, 28G, 37A, 39A, 42A, 42B, 42C, 42D, 42E, 42F, 42G, 42H, 42I, 42J, 42K, 42L, 42M, 42N, 49A, 49B, 49C, 49D, 49E, 49F, 49G, 49H, 49I, 49J, 49K, 49L, 49M, 49N, 49O, 49P, 49Q, 49R, 49S, 52C, 52D, AG8A, AG8B, AG8C, AG8D, AG8E, AG8F, AG8G, AG8H, AG8I, AG8J, AG31, AG32, AG32A, AG33, AG34, AG35, AG36, AG37, AG38, AG39, AG40, AG41, AG42, AG43, AG44, AG45, AG46, AG47, AG48, AG49, AG50, AG51,

AG52, AG53, AG54 dhe AG55 u shtuan nga **SNKSP 41**, botuar në gusht **2018**. Një njësi do të zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës **1 janar, 2022**. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës **1 janar, 2022**, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe të zbatojë **SNKSP 41** në të njëjtën kohë.

53. Kur një njësi adopton **SNKSP-të** e kontabilitetit sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, siç përcaktohet në **SNKSP 33**, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP)* sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara për qëllime të raportimit financiar pas kësaj date efektive, ky Standard zbatohet për pasqyrat financiare vjetore të njësisë ekonomike që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës së adoptimit të **SNKSP-ve**.

Shfuqizimi dhe Zëvendësimi i SNKSP 15 (2001)

54. Ky Standard dhe **SNKSP 28** zëvendësojnë **SNKSP 15**, *Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjegues dhe Paraqitja* botuar në 2001. **SNKSP 15** mbetet i zbatueshëm derisa **SNKSP 28** dhe **SNKSP 30** të zbatohen ose të hyjnë në fuqi, cilado qoftë më herët.

SNKSP 31—AKTIVET AFATGJATË JO MATERIALE

Shënime të Mirënjohjes

Ky Standard Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) është hartuar kryesisht nga Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit (SNK) 38, *Aktivet Afatgjatë Jomateriale* publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Ai përmban gjithashtu ekstrakte nga Interpretimi 32 i Komitetit të Përhershëm të Interpretimeve (IKPI 32), *Aktivet Afatgjatë Jomateriale—Kostot e Faqes së Internetit*. Ekstraktet nga SNK 38 dhe IKPI 32 janë riprodhuar në këtë publikim të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) me lejen e Fondacionit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Teksti i aprovuar i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) është ai i publikuar nga BSNK në gjuhën angleze, dhe kopjet mund të merren direkt nga IFRS Foundation, Costumer Service, Columbus Building, 7 Westferry Circus, Canary Wharf, London E14 4HD, United Kingdom.

E-mail: publications@ifrs.org

Internet: www.ifrs.org

Të drejtat e autorit për SNRF-të, SNK-të, Draftet e Paraqitura dhe publikime të tjera të BSNK-së i përkasin Fondacionit SNRF.

"SNRF", "SNK", "BSNK", "Fondacioni SNRF", "Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit" dhe "Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar" janë marka tregtare të Fondacionit SNRF dhe nuk duhet të përdoren pa aprovimin e Fondacionit SNRF.

SNKSP 31—AKTIVET AFATGJATË JOMATERIALE

Historia e SNKSP

Ky version përfshin ndryshime që rezultojnë nga SNKSP-të e botuara deri në 31 janar 2019.

SNKSP 31, *Aktivet Afatgjatë Jomateriale* u publikua në janar 2010.

Që atëherë, SNKSP 31 është ndryshuar nga SNKSP-të e mëposhtme:

- *Përmirësime të SNKSP-ve 2018* (botuar në tetor 2018)
- SNKSP 40, *Kombinimet e Sektorit Publik* (botuar në janar 2017)
- SNKSP 39, *Përfitimet e Punonjësve* (botuar në korrik 2016)
- *Zhvlerësimi i Aktiveve të Rivlerësuar (Ndryshimet në SNKSP 21, Zhvlerësimi i Aktiveve që nuk Gjenerojnë Mjete Monetare, dhe SNKSP 26, Zhvlerësimi i Aktiveve që Gjenerojnë Mjete Monetare)* (botuar në korrik 2016)
- *Zbatueshmëria e SNKSP-ve* (botuar në prill 2016)
- *Përmirësime të SNKSP-ve 2015* (botuar në prill 2016)
- SNKSP 37, *Marrëveshjet e Përbashkëta* (botuar në janar 2015)
- SNKSP 35, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara* (botuar janar 2015)
- SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara* (botuar në janar 2015)
- *Përmirësime të SNKSP-ve 2014* (botuar në janar 2015)
- SNKSP 32, *Marrëveshjet Koncesionare të Shërbimit: Grantdhënësi* (botuar në tetor 2011)
- *Përmirësime të SNKSP-ve 2011* (botuar në tetor 2011)

Tabela e Paragrafëve të Ndryshuar në SNKSP 31

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
Seksioni i parathënies	U Fshi	Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2011

AKTIVET AFATGJATË JO MATERIALE

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
3	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Prill 2016 SNKSP 40 Janar 2017
4	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
5	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
6	U Ndryshua	SNKSP 37 Janar 2015 SNKSP 35 Janar 2015 SNKSP 32 Tetor 2011 SNKSP 39 Korrik 2016 SNKSP 40 Janar 2017
18	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017
18A	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
24	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017
26A	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
28	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Prill 2016
35	U Ndryshua	SNKSP 39 Korrik 2016
39A	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
39B	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017

AKTIVET AFATGJATË JO MATERIALE

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
39C	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
39D	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
39E	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
40	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017
41	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017
64	U Ndryshua	SNKSP 39 Korrik 2016
66	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017
67	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017
79	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Janar 2015
91	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Janar 2015
93A	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
96	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Prill 2016
97	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Janar 2015
97A	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Janar 2015

AKTIVET AFATGJATË JO MATERIALE

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
97B	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Janar 2015
97C	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Janar 2015
109	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018
110	U Ndryshua	Zhvlerësimi i Aktiveve të Rivlerësuar Korrik 2016
114A	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
116	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Prill 2016
117	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Prill 2016 SNKSP 40 Janar 2017
129	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
130	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
131	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
131A	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Janar 2015
132A	I Ri	SNKSP 32 Tetor 2011

AKTIVET AFATGJATË JO MATERIALE

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
132B	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Janar 2015
132C	I Ri	SNKSP 33 Janar 2015
132D	I Ri	SNKSP 37 Janar 2015 SNKSP 35 Janar 2015
132E	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Prill 2016
132F	I Ri	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
132G	I Ri	Zhvlerësimi i Aktiveve të Rivlerësuar Korrik 2016
132H	I Ri	SNKSP 39 Korrik 2016
132I	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
132J	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018
133	U Ndryshua	SNKSP 33 Janar 2015

SNKSP 31—AKTIVET AFATGJATË JOMATERIALE

PËRMBAJTJA

	Paragrafi
Objektivi	1
Fushëveprimi	2–15
Aktivet Afatgjatë Jomateriale të Trashëgimisë	11–15
Përkufizime	16–25
Aktivet Afatgjatë Jomateriale	17–25
Identifikimi	18–20
Kontrolli i një Aktivi	21–24
Përfitimet e Ardhshme Ekonomike ose Potenciali i Shërbimit..	25
Njohja dhe Matja	26–65
Blerje të Veçanta.....	32–39
Marrja e një aktivi afatgjatë jomaterial si pjesë e një blerjeje (kombinimi i sektorit publik)	39A-39 E
Shpenzimet e Mëpasshme në Një Projekt të Blerë të Kërkimit dhe Zhvillimit në Proces e Sipër	40–41
Aktivet Afatgjatë Jomateriale të Marrë përmes Transaksioneve pa Këmbim	42–43
Shkëmbimet e Aktiveve	44–45
Emri i Mirë i Gjeneruar së Brendshmi	46–48
Aktivet Afatgjatë Jomateriale të Gjeneruar së Brendshmi	49–65
Faza e Kërkimit	52–54
Faza e Zhvillimit.....	55–62
Kostoja e një Aktivi afatgjatë jomaterial të Gjeneruar së Brendshmi.....	63–65
Njohja e një Shpenzimi	66–70
Shpenzimet e Kaluara që nuk do të Njihen si një Aktiv	70
Matja e Mëpasshme	71–86

AKTIVET AFATGJATË JO MATERIALE

Modeli i Kostos.....	73
Modeli i Rivlerësimit	74–86
Jeta e Dobishme	87–95
Aktivitet Afatgjatë Jomateriale me Jetë të Dobishme të Fundme	96–105
Periudha e Amortizimit dhe Metoda e Amortizimit	96–98
Vlera e Mbetur	99–102
Rishikimi i Periudhës së Amortizimit dhe Metodës së Amortizimit	103–105
Aktive Jomaterialë me Jetë të Dobishme të Pacaktuar	106–109
Rishikimi i Vlerësimit të Jetës së Dobishme	108–109
Rikuperimi i Shumës së Mbartur—Humbjet nga Zhvlerësimi	110
Tërheqjet nga Përdorimi dhe Shitjet	111–116
Dhënia e Informacioneve Shpjeguese	117–127
Të Përgjithshëm	117–122
Aktivitet Afatgjatë Jomateriale të Matur pas Njohjes Duke Përdorur Modelin e Rivlerësimit	123–124
Shpenzimet për Kërkim dhe Zhvillim.....	125–126
Informacion Tjetër	127
Dispozita Kalimtare	128–131
Data Efektive	132–133

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik 31, *Aktivitet Afatgjatë Jomateriale*, është përcaktuar në paragrafët 1–133. Të gjithë paragrafët kanë autoritet të barabartë. SNKSP 31 duhet të lexohet në kontekstin e objektivit të tij, Bazës për Konkluzione, *Parathënies së Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar me Qëllim të Përgjithshëm nga Njësitë e Sektorit Publik*. SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, jep një bazë për zgjedhjen dhe zbatimin e politikave të kontabilitetit në mungesë të udhëzimeve të qarta.

Objektivi

1. Objektivi i këtij Standardi është të përshkruajë/rekomandojë trajtimin kontabël për aktivet afatgjatë jomateriale që nuk trajtohen në mënyrë specifike në një Standard tjetër. Ky Standard kërkon që një njësi të njohë një aktiv afatgjatë jomaterial nëse, dhe vetëm nëse, plotësohen kriteret e specifikuar. Standardi specifikon gjithashtu se si duhet të matet vlera e mbartur e aktiveve afatgjatë jomaterialë, dhe kërkon dhëniet e informacioneve shpjegues të specifikuar për aktivet afatgjatë jomateriale.

Objekti

2. **Një njësi që përgatit dhe paraqet pasqyrat financiare sipas kontabilitetit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara do të zbatojë këtë Standard në kontabilitetin për aktivet afatgjatë jomateriale.**
3. **Ky Standard do të zbatohet në kontabilitetin për aktivet afatgjatë jomateriale, përveç:**
 - (a) **Aktiveve afatgjatë jomateriale të cilët janë brenda objektit të një Standardi tjetër;**
 - (b) **Aktiveve financiare, siç përkufizohen në SNKSP 28, *Instrumentet Financiare: Paraqitja*;**
 - (c) **Njohjes dhe matjes së aktiveve të eksplorimit dhe vlerësimit (shih standardin përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që merret me eksplorimin për, dhe vlerësimin e, burimeve minerale);**
 - (d) **Shpenzimeve për zhvillimin dhe nxjerrjen e mineraleve, naftës, gazit natyror, dhe burimeve të ngjashëm jo të rigjenerueshëm;**
 - (e) [Fshirë]
 - (f) [Fshirë]
 - (g) **Kompetencave dhe të drejtave të dhëna nga legjislacioni, kushtetuta, ose mjete ekuivalente;**
 - (h) **Aktiveve tatimore të shtyra (shih standardin përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton tatimet mbi të ardhurat);**
 - (i) **Kostove të shtyra të blerjes, dhe aktiveve afatgjatë jomateriale, që krijohen nga të drejtat kontraktuale të një siguruesi sipas kontratave të siguracionit brenda fushëveprimit të standardit përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton kontratat e siguracionit. Në rastet kur standardi përkatës ndërkombëtar ose kombëtar i kontabilitetit nuk përcakton kërkesa specifike për dhënien e informacioneve (shpjegues) për ata aktive afatgjatë jomateriale, kërkesat për dhënie informacionesh shpjegues në këtë**

Standard zbatohen për ato aktive afatgjatë jomateriale; dhe

- (j) [Fshirë]
- (k) **Aktiveve afatgjatë jomateriale të trashëgimisë. Megjithatë, kërkesat për dhënie informacionesh të paragrafëve 115-127 zbatohen për ata aktive të trashëgimisë që njihen.**
4. [Fshirë]
5. [Fshirë]
6. Nëse një SNKSP tjetër përshkruan/rekomandon kontabilitetin për një lloj të caktuar aktivi afatgjatë jomaterial, një njësi zbaton atë SNKSP në vend të këtij Standardi. Për shembull, ky Standard nuk zbatohet për:
- (a) Aktivet afatgjatë jomateriale të mbajtur nga një njësi ekonomike për shitje në rrjedhën e zakonshme të operacioneve (shih SNKSP 11, *Kontratat e Ndërtimit* dhe SNKSP 12, *Inventarët*);
- (b) Qiratë që janë brenda fushëveprimit të SNKSP 13, *Kontratat e Qirave*;
- (c) Aktivet që vijnë nga përfitimet e punonjësve (shih SNKSP 39, *Përfitimet e Punonjësve*);
- (d) Aktivet financiare siç përcaktohen në SNKSP 28. Njohja dhe matja e disa aktiveve financiare mbulohet nga SNKSP 34, *Pasqyrat Financiare të Veçanta*, SNKSP 35, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara* dhe SNKSP 36, *Investimet në Shoqëri dhe Sipërmarrje të Përbashkëta*;
- (e) Njohjen dhe matjen fillestare e aktiveve të koncesionit të shërbimit që janë brenda fushëveprimit të SNKSP 32, *Aktivitetet e Koncesionit të Shërbimeve: Grantdhënësi*. Megjithatë, ky Standard zbatohet për matjen dhe paraqitjen e informacioneve pasuese të këtyre aktiveve; dhe
- (f) Emrin e mirë (shih SNKSP 40, *Kombinimet e Sektorit Publik*).
7. Disa aktive afatgjatë jomateriale mund të përmbahen në ose brenda një substance fizike të tillë si një disk kompakt (në rastin e softuerit kompjuterik), dokumentacion ligjor (në rastin e një liçence ose patente) ose film. Në përcaktimin nëse një aktiv që përfshin elemente jomaterialë dhe materialë duhet të trajtohet sipas SNKSP 17, *Ndërtesa, Makineri, dhe Pajisje* ose si një aktiv afatgjatë jomaterial sipas këtij Standardi, një njësi ekonomike përdor gjykimin për të vlerësuar se cili element është më i rëndësishëm. Për shembull, softueri i navigimit për një avion luftarak është pjesë përbërëse e avionit dhe trajtohet si ndërtesa, makineri dhe pajisje. E njëjta gjë vlen edhe për sistemin operativ të një kompjuteri. Kur softueri nuk është pjesë integrale e harduerit përkatës, softueri kompjuterik trajtohet si një aktiv afatgjatë jomaterial.
8. Ky Standard zbatohet, ndër të tjera, për shpenzimet për reklamat, trajnimin, fillimin, aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit. Aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit janë të drejtuara në zhvillimin e njohurive. Prandaj, megjithëse këto

aktivitete mund të rezultojnë në një aktiv me substancë fizike (p.sh., një prototip), elementi fizik i aktivitet është dytësor ndaj përbërësit të tij jomaterial, d.m.th., njohuritë e personifikuar nga ai.

9. Në rastin e një qiraje financiare, aktivi bazë mund të jetë ose material ose jomaterial. Pas njohjes fillestare, një qiramarrës kontabilizon një aktiv afatgjatë jomaterial të mbajtur nën një qira financiare në përputhje me këtë Standard. Të drejtat në bazë të marrëveshjeve të licencimit për artikuj të tillë si filmat, regjistrimet në video, shfaqjet, dorëshkrimet, patentat, dhe të drejtat e autorit përjashtohen nga fushëveprimi i SNKSP 13 dhe janë brenda fushëveprimit të këtij Standardi.
10. Përjashtimet nga fushëveprimi i një Standardi mund të ndodhin nëse aktivitetet ose transaksionet janë aq të specializuara saqë ato shkaktojnë probleme të kontabilitetit që mund të kenë nevojë të trajtohen në një mënyrë tjetër. Çështje të tilla lindin në kontabilizimin e shpenzimeve për eksplorimin e ose zhvillimin dhe nxjerrjen e depozitave të naftës, gazit dhe mineraleve në industritë nxjerrëse, dhe në rastin e kontratave të siguracionit. Prandaj, ky Standard nuk zbatohet për shpenzimet për aktivitete dhe kontrata të tilla. Megjithatë, ky Standard zbatohet për aktivet e tjerë jomateriale të përdorur (të tillë si programet kompjuterike), dhe shpenzimet e tjerë të shkaktuar (të tillë si kostot e fillimit), në industritë nxjerrëse ose nga siguruesit.

Aktivët Afatgjatë Jomateriale të Trashëgimisë

11. Ky Standard nuk kërkon që një njësi ekonomike të njohë aktive afatgjatë jomateriale të trashëgimisë që përndryshe do të plotësonin përkufizimin dhe kriteret e njohjes për aktivet afatgjatë jomateriale. Nëse një njësi ekonomike njeh aktive afatgjatë jomateriale të trashëgimisë, ajo duhet të zbatojë kërkesat e këtij Standardi për paraqitjen e informacioneve dhe mundet, por nuk i kërkohej, të zbatojë kërkesat e matjes të këtij Standardi.
12. Disa aktive afatgjatë jomateriale përshkruhen si aktive afatgjatë jomateriale të trashëgimisë për shkak të rëndësisë së tyre kulturore, mjedisore ose historike. Shembuj të aktiveve afatgjatë jomateriale të trashëgimisë përfshijnë regjistrimet e ngjarjeve të rëndësishme historike dhe të drejtat për të përdorur ngjashmërinë/figurën e një personi të rëndësishëm publik në, për shembull, pulla postare ose monedha koleksioni. Disa karakteristika, duke përfshirë sa vijon, shfaqen shpesh nga aktivet afatgjatë jomateriale të trashëgimisë (megjithëse këto karakteristika nuk janë ekskluzive për aktive të tillë):
 - (a) Vlera e tyre në aspektin kulturor, mjedisor dhe historik nuk ka gjasa të pasqyrohet plotësisht në një vlerë financiare të bazuar vetëm në një çmim tregu;
 - (b) Detyrimet ligjore dhe/ose statutores mund të vendosin ndalime ose kufizime të rënda për asgjësimin/nxjerrjen jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes;

- (c) Vlera e tyre mund të rritet me kalimin e kohës; dhe
 - (d) Mund të jetë e vështirë të vlerësohet jeta e tyre e dobishme, e cila në disa raste mund të jetë disa qindra vjet.
13. Njësitë e sektorit publik mund mbajnë në sasi të mëdha aktive afatgjatë jomateriale të trashëgimisë që janë marrë gjatë shumë viteve dhe me mjete të ndryshme, duke përfshirë blerjen, dhurimin, trashëgiminë, dhe sekuestrimin. Këta aktive mbahen rrallë për aftësinë e tyre për të gjeneruar flukse hyrëse monetare, dhe mund të ketë pengesa ligjore ose sociale për përdorimin e tyre për qëllime të tilla.
14. Disa aktive afatgjatë jomateriale të trashëgimisë kanë përfitime ekonomike të ardhshme ose potencial shërbimi, të ndryshëm nga vlera e tyre e trashëgimisë, për shembull, honorare që i paguhen njësisë për përdorimin e një regjistrimi historik. Në këta raste, një aktiv afatgjatë jomaterial i trashëgimisë mund të njihet dhe matet në të njëjtën bazë si artikujt e tjerë të aktiveve afatgjatë jomateriale që gjenerojnë mjete monetare. Për aktive të tjerë jomaterialë të trashëgimisë, përfitimi i tyre i ardhshëm ekonomik ose potenciali i shërbimit kufizohet në karakteristikat e tyre të trashëgimisë. Ekzistenca e përfitimeve të ardhshme ekonomike dhe e potencialit të shërbimit mund të ndikojë në zgjedhjen e bazës së matjes.
15. Kërkesat për paraqitje informacionesh në paragrafët 117-124 kërkojnë që njësitë të japin informacione për aktivet afatgjatë jomateriale të njohur. Prandaj, njësitë që njohin aktive afatgjatë jomateriale të trashëgimisë u kërkohet të paraqesin në lidhje me ata aktive çështje të tilla si, për shembull:
- (a) Bazën e matjes të përdorur;
 - (b) Metodën e amortizimit të përdorur, nëse ka;
 - (c) Vlerën e mbartur bruto;
 - (d) Amortizimin e akumuluar në fund të periudhës, nëse ka; dhe
 - (e) Një rakordim të vlerës së mbartur në fillim dhe në fund të periudhës që tregon disa përbërës të saj.

Përkufizime

16. **Termet e mëposhtëm përdoren në këtë Standard me kuptimet e specifikuara:**

Amortizimi është shpërndarje sistematike e shumës së zhvlerësuar të një aktivi afatgjatë jomaterial gjatë jetës së tij të dobishme.

Vlera e mbartur është shuma me të cilën një aktiv njihet pas zbritjes së çdo amortizimi të akumuluar dhe humbjeve të akumuluar nga zhvlerësimi.

Zhvillimi është zbatimi i gjetjeve të kërkimit ose njohurive të tjera në një

plan ose dizajn për prodhimin e materialeve, pajisjeve, produkteve, proceseve, sistemeve ose shërbimeve të reja ose të përmirësuara ndjeshëm përpara fillimit të prodhimit ose përdorimit komercial.

Një **aktiv afatgjatë jomaterial** është një aktiv jomonetar i identifikueshëm pa substancë fizike.

Kërkimi është një investigim original dhe i planifikuar i ndërmarrë me perspektivën e përfitimit të njohurive dhe kuptueshmërive të reja shkencore ose teknike.

Termet e përcaktuar në SNKSP të tjera përdoren në këtë Standard me të njëjtin kuptim si në ato Standarde dhe riprodhohen në Fjalorin e Termave të Përkufizuar publikuar veçmas.

Aktivët Afatgjatë Jomateriale

17. Njësitë shpesh shpenzojnë burime ose shkaktojnë/krijojnë detyrime për blerjen, zhvillimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e burimeve jomaterialë si njohuritë shkencore ose teknike, projektimin dhe zbatimin e proceseve të reja ose sistemeve, licencave, pronës intelektuale dhe markave tregtare (përfshirë emrat e markave dhe titujt publikues). Shembuj të zakonshëm të artikujve të përfshirë nga këta tituj të gjerë janë programet kompjuterike, patentat, të drejtat e autorit, filmat, listat e përdoruesve të një shërbimi, licencat e fituara të peshkimit, kuotat e fituara të importit, dhe marrëdhëniet me përdoruesit e një shërbimi.

Identifikimi

18. Jo të gjithë artikujt e përshkruar në paragrafin 17 plotësojnë përkufizimin e një aktivi afatgjatë jomaterial, d.m.th., identifikueshmërinë, kontrollin mbi një burim, dhe ekzistencën e përfitimeve ekonomike të ardhshme ose potencialit të shërbimit. Nëse një element brenda fushëveprimit të këtij Standardi nuk plotëson përkufizimin e një aktivi afatgjatë jomaterial, shpenzimet për blerjen ose gjenerimin e tij të brendshëm njihen si shpenzim kur ata ndodhin. Megjithatë, nëse elementi është marrë në një blerje, ai është pjesë e emrit të mirë të njohur në datën e blerjes (shih paragrafin 66).
- 18A. Përkufizimi i një aktivi afatgjatë jomaterial kërkon që një aktiv afatgjatë jomaterial të jetë i identifikueshëm për të dalluar atë nga emri i mirë. Emri i mirë i njohur në një blerje është një aktiv që përfaqëson përfitimet ekonomike të ardhshme që vijnë nga aktive të tjerë të marrë në një blerje që nuk janë identifikuar dhe njohur veç. Përfitimet e ardhshme ekonomike mund të rezultojnë nga sinergjia midis aktiveve të identifikueshëm të blerë ose nga aktivet që, individualisht, nuk kualifikohen për t'u njohur në pasqyrat financiare.
19. **Një aktiv është i identifikueshëm nëse:**
- (a) **Është i ndashëm, d.m.th., mund të veçohet ose ndahet nga njësia dhe të shitet, transferohet, liqenohet, jepet me qira, ose shkëmbehet,**

individualisht ose së bashku me një kontratë, aktiv ose detyrim të identifikueshëm, pavarësisht nëse njësia synon ta bëjë këtë. ; ose

- (b) **Të vijë nga marrëveshjet detyruese (përfshirë të drejtat nga kontratat ose të drejta të tjera ligjore), pavarësisht nëse ato të drejta janë të transferueshme ose të ndashme nga njësia ose nga të drejta dhe obligime të tjera.**

20. Për qëllimet e këtij Standardi, një marrëveshje detyruese përshkruan një marrëveshje që u jep palëve të drejta dhe detyrime të ngjashme sikur të ishin në formën e një kontrate.

Kontrolli i një Aktivi

21. Një njësi kontrollon një aktiv nëse njësia ka fuqinë për të marrë përfitimet e ardhshme ekonomike ose potencialin e shërbimit që vijnë nga burimi bazë dhe të kufizojë kontrollin e të tjerëve në ato përfitime ose në atë potencial shërbimi. Kapaciteti i një njësie për të kontrolluar përfitimet e ardhshme ekonomike ose potencialin e shërbimit nga një aktiv afatgjatë jomaterial normalisht do të buronte nga të drejtat ligjore që janë të imponueshme në një gjykatë. Në mungesë të të drejtave ligjore, është më e vështirë të demonstrohet kontrolli. Megjithatë, imponueshmëria ligjore e një të drejte nuk është një kusht i domosdoshëm për kontroll, sepse një njësi ekonomike mund të jetë në gjendje të kontrollojë përfitimet e ardhshme ekonomike ose potencialin e shërbimit në një mënyrë tjetër.
22. Njohuritë shkencore ose teknike mund të sjellin përfitime ekonomike ose potencial shërbimi në të ardhmen. Një njësi kontrollon ato përfitime ose atë potencial shërbimi nëse, për shembull, njohuria mbrohet nga të drejta ligjore si të drejtat e autorit, një kufizim i marrëveshjes tregtare (aty ku lejohet), ose nga një detyrë ligjore për punonjësit për të ruajtur konfidencialitetin.
23. Një njësi mund të ketë një ekip personeli të kualifikuar dhe mund të jetë në gjendje të identifikojë aftësitë shtesë të stafit që çojnë në përfitime ekonomike të ardhshme ose potencial shërbimi nga trajnimi. Njësia mund të presë gjithashtu që personeli do të vazhdojë t'i vërë aftësitë e tij në dispozicion të njësisë. Megjithatë, një njësi zakonisht nuk ka kontroll të mjaftueshëm mbi përfitimet e ardhshme ekonomike të pritshme ose potencialin e shërbimit që vijnë nga një ekip personeli i kualifikuar dhe nga trajnimi për këta artikuj për të përmbushur përkufizimin e një aktivi afatgjatë jomaterial. Për një arsye të ngjashme, talenti specifik menaxherial ose teknik nuk ka gjasa të përmbushë përkufizimin e një aktivi afatgjatë jomaterial, përveç nëse ai mbrohet nga të drejtat ligjore për ta përdorur atë dhe për të marrë përfitimet e ardhshme ekonomike ose potencialin e shërbimit që priten prej tij, dhe gjithashtu përmbush pjesë të tjera të përkufizimit.
24. Një njësi mund të ketë një portofol të përdoruesve të shërbimeve të saj ose shkallën e suksesit të saj në arritjen e përdoruesve të synuar të shërbimeve të saj

dhe të presë që, për shkak të përpjekjeve të saj në ndërtimin e marrëdhënieve me përdoruesit e shërbimeve të saj, këta përdorues do të vazhdojnë të përdorin shërbimet e saj. Megjithatë, në mungesë të të drejtave ligjore për të mbrojtur, ose mënyrave të tjera për të kontrolluar marrëdhëniet me përdoruesit e një shërbimi ose besnikërinë e këtyre përdoruesve, njësia zakonisht nuk ka kontroll të njafuëshëm mbi përfitimet e pritshme ekonomike ose potencialin e shërbimit nga marrëdhëniet me përdoruesit e një shërbimi dhe besnikëria për artikuj të tillë (p.sh. portofoli i përdoruesve të një shërbimi, pjesët e kontrolluara ë tregut ose normat e suksesit të një shërbimi, marrëdhëniet dhe besnikëria e përdoruesve të një shërbimi) për të përmbushur përkufizimin e aktiveve afatgjatë jomateriale. Në mungesë të të drejtave ligjore për të mbrojtur marrëdhënie të tilla, transaksionet e këmbimit për të njëjtat ose marrëdhënie të ngjashme jokontraktuale me klientët (të ndryshme nga ato si pjesë e një blerjeje) japin evidencë se njësia është megjithatë në gjendje të kontrollojë përfitimet e ardhshme ekonomike ose potencialin e shërbimit që vjen nga marrëdhëniet me përdoruesit e një shërbimi. Për shkak se transaksione të tillë këmbimi ofrojnë gjithashtu evidencë se marrëdhëniet me përdoruesit e një shërbimi janë të ndashme, këto marrëdhënie plotësojnë përkufizimin e një aktivi afatgjatë jomaterial.

Përfitimet e Ardhshme Ekonomike ose Potenciali i Shërbimit

25. Përfitimet e ardhshme ekonomike ose potenciali i shërbimit që vijnë nga një aktiv afatgjatë jomaterial mund të përfshijnë të ardhura nga shitja e produkteve ose shërbimeve, kursimet e kostos, ose përfitime të tjera që rezultojnë nga përdorimi i aktivitetit nga njësia. Për shembull, përdorimi i pronësisë intelektuale në një proces prodhimi ose shërbimi mund të reduktojë kostot e ardhshme të prodhimit ose shërbimit ose të përmirësojë dhënien e shërbimeve në vend që të rrisë të ardhurat në të ardhmen (p.sh., një sistem online që lejon qytetarët të rinovojnë patentën e shoferit më shpejt në internet, duke rezultuar në një reduktim të stafit të zyrës që kërkohet për të kryer këtë funksion duke rritur shpejtësinë e përpunimit).

Njohja dhe Matja

26. Njohja e një elementi si një aktiv afatgjatë jomaterial kërkon që një njësi të demonstrojë se elementi plotëson:
- (a) Përkufizimin e një aktivi afatgjatë jomaterial (shih paragrafët 17–25); dhe
 - (b) Kriteret e njohjes (shih paragrafët 28–30).

Kjo kërkesë zbatohet për koston e matur në njohje (kostoja në një transaksion këmbimi ose për të gjeneruar brenda një aktivi afatgjatë jomaterial, ose vlerën e drejtë të një aktivi afatgjatë jomaterial të marrë nëpërmjet një transaksioni pa këmbim) dhe ato të shkaktuara më pas për t'i shtuar, zëvendësuar një pjesë të, ose shërbyer atij.

- 26A. Paragrafët 32-39 trajtojnë zbatimin e kritereve të njohjes për aktivet afatgjatë jomateriale të blerë veç, dhe paragrafët 39A-41 trajtojnë zbatimin e tyre për aktivet afatgjatë jomateriale të blerë në një kombinim të sektorit publik. Paragrafët 42-43 trajtojnë matjen fillestare të aktiveve afatgjatë jomateriale të blerë nëpërmjet transaksioneve pa këmbim, paragrafët 44-45 me shkëmbimet e aktiveve afatgjatë jomateriale dhe paragrafët 46-48 me trajtimin e emrit të mirë të krijuar së brendshmi. Paragrafët 49–65 trajtojnë njohjen fillestare dhe matjen e aktiveve afatgjatë jomateriale të krijuar së brendshmi.
27. Natyra e aktiveve afatgjatë jomateriale është e tillë që, në shumë raste, nuk ka shtesa në një aktiv të tillë ose zëvendësime të një pjese të tij. Prandaj, shumica e shpenzimeve të mëvonshme ka gjasa të ruajnë përfitimet e ardhshme ekonomike ose potencialin e shërbimit të personifikuar nga një aktiv afatgjatë jomaterial ekzistues në vend që të përmbushin përkufizimin e një aktivi afatgjatë jomaterial dhe kriteret e njohjes në këtë Standard. Për më tepër, shpesh është e vështirë t'i atribuohen shpenzimet e mëvonshme drejtpërdrejt një aktivi afatgjatë jomaterial të caktuar dhe jo operacioneve të njësisë në tërësi. Prandaj, vetëm rrallë shpenzimet e mëvonshme – shpenzimet e shkaktuara pas njohjes fillestare të një aktivi afatgjatë jomaterial të blerë ose pas përfundimit të një aktivi afatgjatë jomaterial të gjeneruar së brendshmi – do të njihen në vlerën e mbartur të një aktivi. Në përputhje me paragrafin 61, shpenzimet e mëvonshme për markat, titujt kryesorë të gazetave ose revistave, titujt publikues, listat e përdoruesve të një shërbimi, dhe artikujt e ngjashëm në thelb (qoftë të blerë nga jashtë ose të gjeneruar së brendshmi) njihen gjithmonë në sufitin ose deficitin kur ndodhin/shkaktohen. Kjo ndodh për shkak se shpenzimet e tilla nuk mund të dallohen nga shpenzimet për zhvillimin e operacioneve të njësisë në tërësi.
28. **Një aktiv afatgjatë jomaterial do të njihet nëse, dhe vetëm nëse:**
- (a) **Ka probabilitet që përfitimet e ardhshme ekonomike ose potenciali i shërbimit që i atribuohen aktivit do të vijnë tek njësia; dhe**
 - (b) **Kostoja ose vlera e drejtë e aktivit mund të matet me besueshmëri.¹**
29. **Një njësi do të vlerësojë probabilitetin e përfitimeve të ardhshme ekonomike ose të potencialit të shërbimit duke përdorur supozime të arsyeshme dhe të mbështetura që përfaqësojnë vlerësimin më të mirë të drejtimit për grupin e kushteve ekonomike që do të ekzistojnë gjatë jetës së dobishme të aktivit.**
30. Një njësi përdor gjykimin për të vlerësuar shkallën e sigurisë që i bashkëngjitet kalimit të përfitimeve ekonomike të ardhshme ose potencialit të shërbimit që i atribuohen përdorimit të aktivit në bazë të evidencës së disponueshme në kohën e njohjes fillestare, duke i dhënë peshë më të madhe evidencës së jashtme.
31. **Një aktiv afatgjatë jomaterial do të matet fillimisht me kosto në përputhje me paragrafët 32–43. Kur një aktiv afatgjatë jomaterial është marrë nëpërmjet një transaksioni pa këmbim, kostoja e tij fillestare në datën e**

marrjes, do të matet me vlerën e drejtë në atë datë.

Blerje të Veçanta

32. Normalisht, çmimi që paguan një njësi për të blerë veç një aktiv afatgjatë jomaterial do të pasqyrojë pritshmëritë për probabilitetin që përfitimet e ardhshme ekonomike ose potenciali i shërbimit të personifikuar në aktiv do të kalojnë tek njësia. Në fjalë të tjera, njësia ekonomike pret që të ketë një fluks hyrës përfitimesh ekonomike ose potencial shërbimi, edhe nëse ka pasiguri për kohën ose shumën e fluksit hyrës. Prandaj, kriteri i njohjes së probabilitetit në paragrafin 28(a) konsiderohet gjithmonë se plotësohet për aktivet afatgjatë jomateriale të blerë veç.
33. Përveç kësaj, kostoja e një aktivi afatgjatë jomaterial të blerë veç zakonisht mund të matet me besueshmëri. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur shumata e blerjes është në formën e mjeteve monetare ose aktiveve të tjerë monetare.
34. Kostoja e një aktivi afatgjatë jomaterial të blerë veç përfshin:
- (a) Çmimin e tij të blerjes, duke përfshirë detyrimet e importit dhe taksat e pakthyeshme të blerjes, pas zbritjes së skontove dhe shumave të tjera të kthyera; dhe
 - (b) Çdo kosto që i atribuohet drejtpërdrejt përgatitjes së aktivit për përdorimin e synuar.
35. Shembuj të kostove drejtpërdrejt të atribueshme janë:
- (a) Kostot e përfitimeve të punonjësve (siç përcaktohen në SNKSP 39) që vijnë drejtpërdrejt nga sjellja e aktivit në gjendjen e tij të punës;
 - (b) Tarifat profesionale që krijohen drejtpërdrejt nga sjellja e aktivit në gjendjen e tij të punës; dhe
 - (c) Kostot e testimi nëse aktivi po funksionon siç duhet.
36. Shembuj të shpenzimeve që nuk janë pjesë e kostos së një aktivi afatgjatë jomaterial janë:
- (a) Kostot e prezantimit të një produkti ose shërbimi të ri (duke përfshirë kostot e reklamave dhe aktiviteteve promovuese);
 - (b) Kostot e kryerjes së operacioneve në një vend të ri ose me një klasë të re përdoruesish të një shërbimi (përfshirë kostot e trajnimit të stafit); dhe
 - (c) Kostot e administrimit dhe kosto të tjera të përgjithshme.
37. Njohja e kostove në vlerën mbartur të një aktivi afatgjatë jomaterial pushon kur aktivi është në gjendjen e nevojshme që ai të mundë të funksionojë në mënyrën e synuar nga drejtimi. Prandaj, kostot e krijuara gjatë përdorimit ose riinstalimit/rivënies në punë të një aktivi afatgjatë jomaterial nuk përfshihen në vlerën e mbartur të atij aktivi. Për shembull, kostot e mëposhtme nuk përfshihen

në vlerën e mbartur të një aktivi afatgjatë jomaterial:

- (a) Kostot e shkaktuara ndërkohë që një aktiv i aftë për të operuar në mënyrën e synuar nga drejtimi nuk është vënë ende në përdorim; dhe
- (b) Defiçitet fillestare operative, të tilla si ata që krijohen gjatë rritjes së kërkesës për prodhimin e aktivit.

38. Disa operacione ndodhin në lidhje me zhvillimin e një aktivi afatgjatë jomaterial, por nuk janë të nevojshëm për ta sjellë aktivin në gjendjen e nevojshme që ai të mund të funksionojë në mënyrën e synuar nga drejtimi. Këta operacione të rastësishëm mund të ndodhin para ose gjatë aktiviteteve të zhvillimit. Për shkak se operacionet e rastësishme nuk janë të nevojshëm për të sjellë një aktiv në gjendjen e nevojshme që ai të mund të funksionojë në mënyrën e synuar nga drejtimi, të ardhurat dhe shpenzimet e lidhura me operacionet e rastësishme njihen menjëherë në sufiçit ose defiçit dhe përfshihen në klasifikimet e tyre përkatëse të të ardhurave dhe shpenzimeve.
39. Nëse pagesa për një aktiv afatgjatë jomaterial shtyhet përtej kushteve normale të kredisë, kostoja e tij është ekuivalenti i çmimit në para. Diferenca ndërmjet kësaj shume dhe totalit të pagesave njihet si shpenzim interesi gjatë periudhës së kredisë, përveç rastit kur kapitalizohet në përputhje me trajtimin e kapitalizimit të lejuar në SNKSP 5, *Kostot e Huamarrjes*.

Marrja e një aktivi afatgjatë jomaterial si pjesë e një blerje (kombinimi i sektorit publik)

- 39A. Në përputhje me SNKSP 40, nëse një aktiv afatgjatë jomaterial merret në një blerje, kostoja e atij aktivi afatgjatë jomaterial është vlera e tij e drejtë në datën e blerjes. Vlera e drejtë e një aktivi afatgjatë jomaterial do të pasqyrojë pritshmëritë e pjesëmarrësve të tregut në datën e blerjes për probabilitetin që përfitimet e ardhshme ekonomike ose potenciali i shërbimit të personifikuara në aktiv do të kalojnë tek njësia. Në fjalë të tjera, njësia pret që të ketë një fluks hyrës përfitimesh ekonomike ose potencial shërbimi, edhe nëse ka pasiguri për kohën ose shumën e fluksit hyrës. Prandaj, kriteri i njohjes së probabilitetit në paragrafin 28(a) konsiderohet gjithmonë i plotësuar për aktivet afatgjatë jomateriale të marrë në blerje. Nëse një aktiv i marrë në një blerje është i ndashëm ose lind nga marrëveshjet detyruese (përfshirë të drejtat nga kontratat ose të drejta të tjera ligjore), ekziston informacion i mjaftueshëm për të matur me besueshmëri vlerën e drejtë të aktivit. Kështu, kriteri i matjes së besueshme në paragrafin 28(b) konsiderohet gjithmonë i plotësuar për aktivet afatgjatë jomateriale të marrë në blerje.
- 39B. Në përputhje me këtë Standard dhe SNKSP 40, një blerës njihet në datën e blerjes, veç nga emri i mirë, një aktiv afatgjatë jomaterial të operacionit të blerë, pavarësisht nëse aktivi ishte njohur nga operacioni i marrë përpara blerjes. Kjo do të thotë që blerësi njihet si një aktiv veç nga emri i mirë një projekt kërkimi dhe zhvillimi në proces e sipër të operacionit të marrë/blerë nëse projekti

plotëson përkufizimin e një aktivi afatgjatë jomaterial. Projekti i kërkimit dhe zhvillimit në proces e sipër i një operacioni të blerë plotëson përkufizimin e një aktivi afatgjatë jomaterial kur ai:

- (a) Plotëson përkufizimin e një aktivi; dhe
- (b) Është i identifikueshëm, d.m.th., është i ndashëm ose lind nga marrëveshjet detyruese (përfshirë të drejtat nga kontratat ose të drejta të tjera ligjore).

Aktivi jomaterial i marrë në një blerje (kombinim i sektorit publik)

- 39C. Nëse një aktiv afatgjatë jomaterial i marrë në një blerje është i ndashëm ose lind nga një marrëveshje detyruese (duke përfshirë të drejtat nga kontratat ose të drejta të tjera ligjore), ekziston informacion i mjaftueshëm për të matur me besueshmëri vlerën e drejtë të aktivitetit. Kur, për vlerësimet e përdorura për të matur vlerën e drejtë të një aktivi afatgjatë jomaterial, ekziston një interval rezultatesh të mundshme me probabilitete të ndryshme që pasiguria të hyjë në matjen e vlerës së drejtë të aktivitetit.
- 39D. Një aktiv afatgjatë jomaterial i marrë në një blerje mund të jetë i ndashëm, por vetëm së bashku me një marrëveshje detyruese, aktiv ose detyrim të identifikueshëm. Në raste të tilla, blerësi njeh aktivin afatgjatë jomaterial veç nga emri i mirë, por së bashku me elementin përkatës.
- 39E. Blerësi mund të njohë një grup aktivesh jomateriale plotësues si një aktiv të vetëm me kusht që aktivet individuale të kenë jetë të dobishme të ngjashme. Për shembull, termat "markë" dhe "emri i markës" përdoren shpesh si sinonime për markat tregtare dhe markat e tjera. Megjithatë, të parat janë terma të përgjithshëm marketingu që përdoren zakonisht për t'iu referuar një grupi aktivesh plotësues si marka tregtare (ose marka e shërbimit) dhe emri tregtar, formula, receta dhe ekspertizë teknologjike të lidhura me ta.

Shpenzimet e Mëpasshme në një Projekt të Blerë të Kërkimit dhe Zhvillimit në Proces e Sipër

- 40. **Shpenzimet e kërkimit ose zhvillimit që:**
 - (a) **Lidhen me një projekt kërkimi ose zhvillimi në proces e sipër të marrë veç ose në një blerje dhe të njohur si një aktiv afatgjatë jomaterial; dhe**
 - (b) **Krijohen pas blerjes së atij projekti;****do të kontabilizohen në përputhje me paragrafët 52–60.**
- 41. Zbatimi i kërkesave në paragrafët 52–60 do të thotë që shpenzimet e mëvonshme për një projekt kërkimi ose zhvillimi në proces e sipër të marrë veç ose në një blerje dhe të njohur si një aktiv afatgjatë jomaterial janë:
 - (a) Njohur si shpenzime kur shkaktohen nëse janë shpenzime kërkimore;

- (b) Njohur si shpenzim kur shkaktohen nëse janë shpenzime zhvillimi që nuk plotësojnë kriteret për njohjen si aktiv afatgjatë jomaterial në paragrafin 55; dhe
- (c) Shtuar në vlerën e mbartur të projektit të kërkimit ose zhvillimit në proces e sipër të blerë, nëse janë shpenzime zhvillimi që plotësojnë kriteret e njohjes në paragrafin 55.

Aktivitet Afatgjatë Jomateriale të Blerë përmes Transaksioneve pa këmbim

- 42. Në disa raste, një aktiv afatgjatë jomaterial mund të merret nëpërmjet një transaksioni pa këmbim. Kjo mund të ndodhë kur një njësi tjetër e sektorit publik transferon te një njësi në një transaksion pa këmbim, aktive afatgjatë jomateriale si të drejtat e uljes në aeroport, liçencat për të operuar stacione radioje ose televizive, licenca importi ose kuota ose të drejta për të pasur të drejtë në burime të tjera të kufizuara. Një qytetar privat, për shembull një fitues i çmimit Nobel, mund të lërë trashëgimi dokumentet e saj/tij personale, duke përfshirë të drejtën e autorit për botimet e saj/tij në arkivat kombëtare (një njësi të sektorit publik) në një transaksion pa këmbim.
- 43. Në këto rrethana, kostoja e elementit është vlera e drejtë e tij në datën e marrjes. Për qëllimet e këtij Standardi, matja në njohjen e një aktivi afatgjatë jomaterial të marrë nëpërmjet një transaksioni pa këmbim, me vlerën e tij të drejtë në përputhje me kërkesat e paragrafit 74, nuk përbën një rivlerësim. Prandaj, kërkesat e rivlerësimit në paragrafin 74, dhe komentet mbështetës në paragrafët 75-86 zbatohen vetëm kur një njësi ekonomike zgjedh të rivlerësojë një element jomaterial në periudhat pasuese të raportimit.

Shkëmbime të Aktiveve

- 44. Një ose më shumë aktive afatgjatë jomateriale mund të merren në këmbim të një aktivi ose aktiveve jomonetare, ose një kombinim të aktiveve monetare dhe jomonetare. Diskutimi i mëposhtëm i referohet thjesht një shkëmbimi të një aktivi jomonetar me një tjetër, por ai gjithashtu zbatohet për të gjitha shkëmbimet e përshkruara në fjalinë e mëparshme. Kostoja e një aktivi të tillë jomaterial matet me vlerën e drejtë, përveç rastit kur vlera e drejtë as e aktivitet të marrë dhe as e aktivitet të dhënë nuk është e matshme me besueshmëri. Aktivi i marrë matet në këtë mënyrë edhe nëse një njësi ekonomike nuk mund ta çregjistrojë menjëherë aktivin e dhënë. Nëse aktivi i marrë nuk matet me vlerën e drejtë, kostoja e tij matet me vlerën e mbartur të aktivitet të dhënë.
- 45. Paragrafi 28(b) specifikon se një kusht për njohjen e një aktivi afatgjatë jomaterial është që kostoja e aktivitet të mund të matet me besueshmëri. Vlera e drejtë e një aktivi afatgjatë jomaterial për të cilin nuk ekzistojnë transaksione të krahasueshme tregu është e matshme në mënyrë të besueshme nëse:
 - (a) Ndryshueshmëria në intervalin e vlerësimeve të arsyeshme të vlerës së drejtë nuk është domethënëse për atë aktiv: ose

- (b) Probabilitetet e vlerësimeve të ndryshme brenda intervalit mund të vlerësohen në mënyrë të arsyeshme dhe të përdoren për të vlerësuar vlerën e drejtë.

Nëse një njësi është në gjendje të përcaktojë me besueshmëri vlerën e drejtë ose të aktivit të marrë ose të aktivit të dhënë, atëherë vlera e drejtë e aktivit të dhënë përdoret për të matur koston, përveç rastit kur vlera e drejtë e aktivit të marrë është më e qartë e evidente.

Emri i Mirë i Gjeneruar së Brendshmi

46. **Emri i mirë i gjeneruar së brendshmi nuk do të njihet si aktiv.**

47. Në disa raste, shpenzimet kryhen për të gjeneruar përfitime ekonomike të ardhshme ose potencial shërbimi, por nuk rezultojnë në krijimin e një aktivi afatgjatë jomaterial që plotëson kriteret e njohjes në këtë Standard. Shpenzime të tilla shpesh përshkruhen si kontribut në emrin e mirë të gjeneruar së brendshmi. Emri i mirë i krijuar së brendshmi nuk njihet si një aktiv sepse nuk është një burim i identifikueshëm (d.m.th., nuk është i ndashëm dhe as nuk krijohet nga marrëveshjet detyruese përfshirë të drejtat nga kontratat ose të drejta të tjera ligjore) të kontrolluara nga njësia që mund të matet me besueshmëri sipas koston.

48. Ndryshimet ndërmjet vlerës së tregut të një njësie dhe vlerës së mbartur të aktiveve neto të identifikueshëm të saj në çdo kohë mund të kapin një sërë faktorësh që ndikojnë në vlerën e njësisë. Megjithatë, këto diferenca nuk përfaqësojnë koston e aktiveve afatgjatë jomateriale të kontrolluar nga njësia.

Aktive Afatgjatë Jomateriale të Gjeneruar së Brendshmi

49. Ndonjëherë është e vështirë të vlerësohet nëse një aktiv afatgjatë jomaterial i gjeneruar së brendshmi kualifikohet për njohje për shkak të problemeve në:

- (a) Identifikimin nëse dhe kur ka një aktiv të identifikueshëm që do të gjenerojë përfitime të pritshme të ardhshme ekonomike ose potencial shërbimi; dhe
- (b) Përcaktimin e besueshëm të koston së aktivit. Në disa raste, kostoja e gjenerimit të një aktivi afatgjatë jomaterial së brendshmi nuk mund të dallohet nga kostoja e mbajtjes ose përmirësimit të emrit të mirë të gjeneruar brenda njësisë ose e kryerjes së operacioneve të përditshme.

Prandaj, krahas pajtueshmërisë me kërkesat e përgjithshme për njohjen dhe matjen fillestare të një aktivi afatgjatë jomaterial, një njësi zbaton kërkesat dhe udhëzimet në paragrafët 50-65 për të gjithë aktivet afatgjatë jomateriale të krijuar së brendshmi.

50. Për të vlerësuar nëse një aktiv afatgjatë jomaterial i gjeneruar së brendshmi plotëson kriteret për njohje, një njësi ekonomike e klasifikon gjenerimin e aktivit në:

- (a) Një fazë të kërkimit/hulumtimit; dhe
- (b) Një fazë të zhvillimit.

Megjithëse termat "kërkim/hulumtim" dhe "zhvillim" janë të përcaktuara, termat "fazë kërkimi" dhe "fazë zhvillimi" kanë një kuptim më të gjerë për qëllimin e këtij Standardi.

51. Nëse një njësi nuk mund të dallojë fazën e kërkimit nga faza e zhvillimit të një projekti të brendshëm për të krijuar një aktiv afatgjatë jomaterial, njësi i trajton shpenzimet për atë projekt sikur të ishin kryer vetëm në fazën e kërkimit.

Faza e Kërkimit

52. **Asnjë aktiv afatgjatë jomaterial që lind nga kërkimi (ose nga faza e kërkimit të një projekti të brendshëm) nuk do të njihet. Shpenzimet për kërkimin (ose në fazën e kërkimit të një projekti të brendshëm) do të njihen si shpenzim kur ata ndodhin.**
53. Në fazën e kërkimit të një projekti të brendshëm, një njësi nuk mund të demonstrojë se ekziston një aktiv afatgjatë jomaterial që do të gjenerojë përfitime të mundshme ekonomike në të ardhmen ose potencial shërbimi. Prandaj, ky shpenzim njihet si shpenzim kur ndodh.
54. Shembuj të aktiviteteve të kërkimit/hulumtimit janë:
- (a) Aktivitete që synojnë marrjen e njohurive të reja;
 - (b) Kërkimi, vlerësimi dhe përzgjedhja përfundimtare e zbatimeve të gjetjeve të kërkimit ose njohurive të tjera;
 - (c) Kërkimi i alternativave për materiale, pajisje, produkte, procese, sisteme, ose shërbime; dhe
 - (d) Formulimi, projektimi, vlerësimi, dhe përzgjedhja përfundimtare e alternativave të mundshme për materiale, pajisje, produkte, procese, sisteme ose shërbime të reja ose të përmirësuara.

Faza e Zhvillimit

55. **Një aktiv afatgjatë jomaterial që krijohet nga zhvillimi (ose nga faza e zhvillimit të një projekti të brendshëm) do të njihet nëse, dhe vetëm nëse, një njësi mund të demonstrojë të gjitha sa vijon:**
- (a) **Mundësinë teknike të përfundimit të aktivitetit afatgjatë jomaterial në mënyrë që ai të jetë i disponueshëm për përdorim ose shitje;**
 - (b) **Synimin e tij për të përfunduar aktivitetin afatgjatë jomaterial dhe për ta përdorur ose shitur atë;**
 - (c) **Aftësinë e tij për të përdorur ose shitur aktivitetin afatgjatë jomaterial;**
 - (d) **Si do të gjenerojë aktiviteti afatgjatë jomaterial përfitime të mundshme**

ekonomike në të ardhmen ose potencial shërbimi. Ndër të tjera, njësia mund të demonstrojë ekzistencën e një tregu për prodhimin e aktivit afatgjatë jomaterial ose të vetë aktivit afatgjatë jomaterial ose, nëse ai do të përdoret brenda, dobinë e aktivit afatgjatë jomaterial;

- (e) **Disponueshmërinë e burimeve adekuate teknike, financiare, dhe të tjera për të përfunduar zhvillimin dhe për të përdorur ose shitur aktivin afatgjatë jomaterial; dhe**
- (f) **Aftësinë e saj për të matur me besueshmëri shpenzimet që i atribuohen aktivit afatgjatë jomaterial gjatë zhvillimit të tij.**

56. Në fazën e zhvillimit të një projekti të brendshëm, një njësi, në disa raste, mund të identifikojë një aktiv afatgjatë jomaterial dhe të demonstrojë se aktivi do të gjenerojë përfitime të mundshme ekonomike në të ardhmen ose potencial shërbimi. Kjo është për shkak se faza e zhvillimit të një projekti është më e avancuar se faza e kërkimit.

57. Shembuj të aktiviteteve të zhvillimit janë:

- (a) Projektimi, ndërtimi, dhe testimi i prototipeve dhe modeleve të para-prodimit ose para-përdorimit;
- (b) Skicimet e veglave, pajisjeve mbajtëse, kallëpeve dhe pajisjeve prerëse që përfshijnë teknologji të re;
- (c) Projektimi, ndërtimi, dhe operimi i një impianti pilot ose operimi që nuk është i një shkalle ekonomikisht të realizueshme për prodhim komercial ose përdorim në ofrimin e shërbimeve;
- (d) Projektimi, ndërtimi, dhe testimi i një alternative të zgjedhur për materiale, pajisje, produkte, procese, sisteme ose shërbime të reja ose të përmirësuara; dhe
- (e) Kostot e faqes së internetit dhe kostot e zhvillimit të softuerit.

58. Për të demonstruar se si një aktiv afatgjatë jomaterial do të gjenerojë përfitime të mundshme ekonomike në të ardhmen ose potencial shërbimi, një njësi vlerëson përfitimet e ardhshme ekonomike ose potencialin e shërbimit që do të merret nga aktivi duke përdorur parimet në SNKSP 21, *Zhvlerësimi i Aktiveve që nuk Gjenerojnë Mjete Monetare* ose SNKSP 26, *Zhvlerësimi i Aktiveve që Gjenerojnë Mjete Monetare* sipas rastit. Nëse aktivi do të gjenerojë përfitime ekonomike ose potencial shërbimi vetëm në kombinim me aktive të tjerë, njësia zbaton konceptin e njësisive gjeneruese të mjeteve monetare në SNKSP 26.

59. Disponueshmëria e burimeve për të plotësuar, përdorur, dhe marrë përfitimet nga një aktiv afatgjatë jomaterial mund të demonstrohet, për shembull, nga një plan operativ që tregon burimet teknike, financiare dhe të tjera të nevojshme dhe aftësinë e njësisë për t'i siguruar ata burime. Në disa raste, një njësi demonstroi disponueshmërinë e financave të jashtme duke marrë treguesin e një huadhënësi

ose financuesi për gatishmërinë e tij për të financuar planin.

60. Sistemet e përcaktimit të kostos së një njësie shpesh mund të matin me besueshmëri koston e gjenerimit të një aktivi afatgjatë jomaterial së brendshmi, të tilla si paga dhe shpenzime të tjera të shkaktuara për sigurimin e logove, të drejtave të autorit ose liçencave, ose zhvillimin e softuerit kompjuterik.
61. **Markat e gjeneruara së brendshmi, titujt kyesorë të gazetave ose revistave, titujt e botimit, listat e përdoruesve të një shërbimi, dhe artikuj të ngjashëm në thelb nuk do të njihen si aktive afatgjatë jomateriale.**
62. Shpenzimet për markat e krijuara së brendshmi, titujt kyesorë të gazetave ose revistave, titujt publikues, listat e përdoruesve të një shërbimi dhe artikuj të ngjashëm në thelb nuk mund të dallohen nga kostoja e zhvillimit të operacioneve të njësisë në tërësi. Prandaj, artikuj të tillë nuk njihen si aktive afatgjatë jomateriale.

Kostoja e një Aktivi Afatgjatë Jomaterial të Gjeneruar së Brendshmi

63. Kostoja e një aktivi afatgjatë jomaterial të krijuar së brendshmi për qëllimin e paragrafit 31 është shuma e shpenzimeve të shkaktuara nga data kur aktivi afatgjatë jomaterial plotëson për herë të parë kriteret e njohjes në paragrafët 28, 29 dhe 55. Paragrafi 70 ndalon rivendosjen e shpenzimeve të njohura më parë si një shpenzim.
64. Kostoja e një aktivi afatgjatë jomaterial të gjeneruar së brendshmi përfshin të gjitha kostot e atribueshme drejtpërdrejt, të nevojshme për të krijuar, prodhuar, dhe përgatitur aktivin për të qenë në gjendje të funksionojë në mënyrën e synuar nga drejtimi. Shembuj të kostove drejtpërdrejt të atribueshme janë:
- (a) Kostot e materialeve dhe shërbimeve të përdorura ose të konsumuara në gjenerimin e aktivit afatgjatë jomaterial;
 - (b) Kostot e përfitimeve të punonjësve (siç përcaktohen në SNKSP 39) që shkaktohen nga gjenerimi i aktivit afatgjatë jomaterial;
 - (c) Tarifat për të regjistruar një të drejtë ligjore; dhe
 - (d) Amortizimi i patentave dhe licencave që përdoren për të gjeneruar aktivin afatgjatë jomaterial.

SNKSP 5 specifikon kriteret për njohjen e interesit si një element i kostos së një aktivi që është një aktiv kualifikues.

65. Nuk janë komponentë të kostos së një aktivi afatgjatë jomaterial të gjeneruar së brendshmi sa më poshtë:
- (a) Shpenzimet e shitjes, administrative dhe shpenzime të tjera të përgjithshme, përveç rasteve kur këto shpenzime mund t'i atribuohen drejtpërdrejt përgatitjes së aktivit për përdorim;

- (b) Identifikimi i mungesës së efikasiteteve dhe deficienteve operative fillestare të shkaktuar përpara se aktivi të arrijë performancën e planifikuar; dhe
- (c) Shpenzimet për trajnimin e stafit për përdorimin e aktivitetit.

Njohja e një Shpenzimi

66. **Shpenzimet për një aktiv jomaterial do të njihen si shpenzim kur ato ndodhin, përveç rasteve kur:**

- (a) **Ata janë pjesë e kostos së një aktivi afatgjatë jomaterial që plotëson kriteret e njohjes (shih paragrafët 26–65); ose**
- (b) **Aktivi është marrë në një blerje dhe nuk mund të njihet si një aktiv afatgjatë jomaterial. Nëse është kështu, ai është pjesë e shumës së njohur si emri i mirë në datën e blerjes (shih SNKSP 40).**

67. Në disa raste, shpenzimet kryhen për të dhënë përfitime të ardhshme ekonomike ose potencial shërbimi për një njësi, por asnjë aktiv afatgjatë jomaterial ose aktiv tjetër nuk merret/blihet ose krijohet që mund të njihet. Në rastin e furnizimit të të mirave, njësia e një shpenzim të tillë si shpenzim kur ka të drejta në ato të mira. Në rastin e dhënies së shërbimeve, njësia e një shpenzimit si shpenzim kur merr shërbimet. Për shembull, shpenzimet për kërkimin njihen si shpenzim kur ata shkaktohen (shih paragrafin 52), me përjashtim të rasteve kur ata merren si pjesë e një blerjeje. Shembuj të tjerë të shpenzimeve që njihen si shpenzim kur ata ndodhin përfshijnë:

- (a) Shpenzimet për aktivitetet e fillimit (d.m.th., kostot e fillimit), përveç rasteve kur ky shpenzim përfshihet në koston e një elementi të ndërtesave, makinerive, dhe pajisjeve në përputhje me SNKSP 17. Kostot e fillimit mund të përbëhen nga kostot e themelimit si p.sh. kostot ligjore dhe sekretare të shkatuara në themelimin e një njësie juridike, shpenzimet për hapjen e një objekti ose operacioni të ri (dmth., kostot para hapjes), ose shpenzimet për fillimin e operacioneve të reja ose prezantimin e produkteve ose proceseve të reja (dmth., kostot para operimit);
- (b) Shpenzimet për aktivitetet e trajnimit;
- (c) Shpenzimet për reklamat dhe aktivitetet promovuese (duke përfshirë katalogët e porosive me postë dhe pamflete informative); dhe
- (d) Shpenzime për zhvendosjen ose riorganizimin e një pjese ose të të gjithë njësisë.

68. Një njësi ka të drejtë të përdorë të mirat kur i zotëron ato. Në mënyrë të ngjashme, ajo ka të drejtë të përdorë të mirat kur ato janë ndërtuar nga një furnizues në përputhje me kushtet e një kontrate furnizimi dhe njësia mund të kërkojë dorëzimin e tyre në këmbim të pagesës. Shërbimet merren kur kryhen nga një furnizues në përputhje me një kontratë për t'ia dhënë ato njësisë dhe jo kur njësia i përdor ato për të dhënë një shërbim tjetër, për shembull, për të dhënë

informacion për një shërbim për përdoruesit e atij shërbimi.

69. Paragrafi 66 nuk e përjashton një njësi nga njohja e një parapagimi si një aktiv kur pagesa për të mirat është bërë përpara se njësia të marrë të drejtën për t'i përdorur ato të mira. Në mënyrë të ngjashme, paragrafi 66 nuk e përjashton një njësi ekonomike nga njohja e një parapagimi si aktiv kur pagesa për shërbimet është bërë përpara se njësie të marrë ato shërbime.

Shpenzimet e Kaluara që nuk do të Njihen si një Aktiv

70. **Shpenzimet për një aktiv afatgjatë jomaterial që fillimisht u njoh si shpenzim sipas këtij Standardi nuk do të njihen si pjesë e kostos së një aktivi afatgjatë jomaterial në një datë të mëvonshme.**

Matja e Mëpasshme

71. **Një njësi do të zgjedhë ose modelin e kostos në paragrafin 73 ose modelin e rivlerësimit në paragrafin 74 si politikën e saj të kontabilitetit. Nëse një aktiv afatgjatë jomaterial kontabilizohet duke përdorur modelin e rivlerësimit, të gjitha aktivet e tjera në klasën e tij gjithashtu do të kontabilizohen duke përdorur të njëjtin model, përveç rastit kur nuk ka treg aktiv për ata aktive.**
72. Një klasë aktivesh jomaterialë është një grupim aktivesh me natyrë dhe përdorim të ngjashëm në operacionet e një njësie. Artikujt brenda një klase të aktiveve afatgjatë jomateriale rivlerësohen njëkohësisht për të shmangur rivlerësimin selektiv të aktiveve dhe raportimin e shumave në pasqyrat financiare që përfaqësojnë një përzjerje kostosh dhe vlerash në data të ndryshme.

Modeli i Kostos

73. **Pas njohjes fillestare, një aktiv afatgjatë jomaterial do të mbahet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.**

Modeli i Rivlerësimit

74. **Pas njohjes fillestare, një aktiv afatgjatë jomaterial do të mbahet me një shumë të rivlerësuar, që është vlera e drejtë e tij në datën e rivlerësimit minus çdo amortizim të akumuluar të mëvonshëm dhe humbjet e akumuluar të mëvonshme nga zhvlerësimi. Për qëllimin e rivlerësimeve sipas këtij Standardi, vlera e drejtë do të përcaktohet duke iu referuar një tregu aktiv. Rivlerësimet do të bëhen me një rregullsi të tillë që në datën e raportimit vlera e mbartur e aktivitetit të mos ndryshojë materialisht nga vlera e drejtë e tij.**

75. Modeli i rivlerësimit nuk lejon:
- (a) Rivlerësimin e aktiveve afatgjatë jomateriale që nuk janë njohur më parë si aktive; ose
 - (b) Njohjen fillestare të aktiveve afatgjatë jomateriale në shumën të ndryshme nga kostoja.
76. Modeli i rivlerësimit zbatohet pasi një aktiv është njohur fillimisht me kosto. Megjithatë, nëse vetëm një pjesë e koston së një aktivi afatgjatë jomaterial njihet si një aktiv për shkak se aktivi nuk i plotëson kriteret për njohje deri në një pjesë të procesit (shih paragrafin 63), modeli i rivlerësimit mund të zbatohet për të gjithë aktivin. Gjithashtu, modeli i rivlerësimit mund të zbatohet për një aktiv afatgjatë jomaterial që është marrë nëpërmjet një transaksioni pa këmbim (shih paragrafët 42–43).
77. Është e pazakontë që një treg aktiv të ekzistojë për një aktiv afatgjatë jomaterial, megjithëse kjo mund të ndodhë. Për shembull, në disa juridiksione, një treg aktiv mund të ekzistojë për klasa homogjene të liqencave të transferueshme lirisht ose kuotave të prodhimit që njësi ka marrë nga një njësi tjetër. Megjithatë, një treg aktiv nuk mund të ekzistojë për markat, titujt kryesorë të gazetave ose revistave, të drejtat e botimit të muzikës dhe filmave, patentat ose markat tregtare, sepse çdo aktiv i tillë është unik. Gjithashtu, megjithëse aktivet afatgjatë jomateriale blihen dhe shiten, kontratat negociohen ndërmjet blerësve dhe shitësve individualë, dhe transaksionet janë relativisht të rralla. Për këto arsye, çmimi i paguar për një aktiv mund të mos japë evidencë të mjaftueshme për vlerën e drejtë të një tjetri. Për më tepër, çmimet shpesh nuk janë të disponueshëm për publikun.
78. Frekuenca e rivlerësimeve varet nga paqëndrueshmëria e vlerës së drejtë të aktiveve afatgjatë jomateriale që rivlerësohen. Nëse vlera e drejtë e një aktivi të rivlerësuar ndryshon materialisht nga vlera e tij e mbartur, një rivlerësim i mëtejshëm është i nevojshëm. Disa aktive afatgjatë jomateriale mund të përjetojnë lëvizje domethënëse dhe të paqëndrueshme në vlerën e drejtë, duke bërë të nevojshëm rivlerësimin vjetor. Rivlerësime të tillë të shpeshtë janë të panevojshëm për aktivet afatgjatë jomateriale me vetëm lëvizje jo-domethënëse në vlerën e drejtë.
79. Kur një aktiv afatgjatë jomaterial rivlerësohet, vlera e mbartur e atij aktivi rregullohet me shumën e rivlerësuar. Në datën e rivlerësimit, aktivi trajtohet në një nga mënyrat e mëposhtme:
- (a) Vlera e mbartur bruto rregullohet në një mënyrë që është në përputhje me rivlerësimin e vlerës së mbartur të aktivitetit. Për shembull, vlera e mbartur bruto mund të rideklarohet duke iu referuar të dhënave të vëzhgueshme të tregut ose mund të rideklarohet proporcionalisht me ndryshimin në vlerën e mbartur. Amortizimi i akumuluar në datën e rivlerësimit është rregulluar për të barazuar diferencën ndërmjet vlerës së mbartur bruto dhe vlerës së

mbartur të aktivitet pas marrjes parasysh të humbjeve të akumuluar nga zhvlerësimi; ose

- (b) Amortizimi i akumuluar eliminohet kundrejt vlerës së mbartur bruto të aktivitet.

Shuma e rregullimit të amortizimit të akumuluar është pjesë e rritjes ose uljes së vlerës së mbartur që kontabilizohet në përputhje me paragrafët 84 dhe 85.

80. **Nëse një aktiv afatgjatë jomaterial në një klasë aktivesh jomaterialë të rivlerësuar nuk mund të rivlerësohet sepse nuk ka treg aktiv për këtë aktiv, aktivi do të mbahet me koston e tij minus çdo amortizim të akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi.**
81. **Nëse vlera e drejtë e një aktivitet afatgjatë jomaterial të rivlerësuar nuk mund të përcaktohet më duke iu referuar një tregu aktiv, vlera e mbartur e aktivitet do të jetë shuma e rivlerësuar e tij në datën e rivlerësimit të fundit duke iu referuar tregut aktiv minus çdo amortizim të akumuluar të mëvonshëm dhe çdo humbje të akumuluar të mëpasshme nga zhvlerësimi.**
82. Fakti që një treg aktiv nuk ekziston më për një aktiv afatgjatë jomaterial të rivlerësuar mund të tregojë se aktivi mund të jetë i zhvlerësuar dhe se ai duhet të testohet në përputhje me SNKSP 21 ose SNKSP 26, sipas rastit.
83. Nëse vlera e drejtë e aktivitet mund të përcaktohet duke iu referuar një tregu aktiv në një datë matjeje të mëvonshme, modeli i rivlerësimit zbatohet nga ajo datë.
84. **Nëse vlera e mbartur e një aktivitet afatgjatë jomaterial rritet si rezultat i një rivlerësimi, rritja do të kreditohet drejtpërdrejt te sufiçiti i rivlerësimit. Megjithatë, rritja do të njihet në sufiçit ose defiçit në masën që ajo anulon një ulje të rivlerësimit të të njëjtit aktiv të njohur më parë në sufiçit ose defiçit.**
85. **Nëse vlera e mbartur e një aktivitet afatgjatë jomaterial zvogëlohet si rezultat i një rivlerësimi, rënia do të njihet në sufiçit ose defiçit. Megjithatë, rënia do të njihet drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto në masën e çdo balance kreditore në sufiçitin e rivlerësimit në lidhje me atë aktiv. Rënia e njohur drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto redukton shumën e akumuluar në aktivet/kapitalin neto nën titullin e sufiçitit të rivlerësimit.**
86. Sufiçiti i akumuluar i rivlerësimit i përfshirë në aktivet/kapitalin neto mund të transferohet drejtpërdrejt në sufiçitet ose defiçitet e akumuluar kur sufiçiti të realizohet. I gjithë sufiçiti mund të realizohet me lënien ose nxjerrjen jashtë përdorimit të aktivitet. Megjithatë, një pjesë e sufiçitit mund të realizohet kur aktivi përdoret nga njësia ekonomike; në një rast të tillë, shuma e sufiçitit të realizuar është diferenca midis amortizimit bazuar në vlerën e mbartur të rivlerësuar të aktivitet dhe amortizimit që do të ishte njohur në bazë të kostos historike të aktivitet. Transferimi nga sufiçiti i rivlerësimit në tepricat ose defiçitet e akumuluar nuk bëhet nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit.

Jeta e Dobishme

87. Një njësi do të vlerësojë nëse jeta e dobishme e një aktivi afatgjatë jomaterial është e kufizuar ose e pacaktuar dhe, nëse është e kufizuar, gjatësia ose numri i njësive të prodhimit ose të ngjashme që përbëjnë atë jetë të dobishme. Një aktiv afatgjatë jomaterial do të konsiderohet nga njësia se ka një jetë të dobishme të pacaktuar kur, bazuar në një analizë të të gjithë faktorëve përkatës, nuk ka asnjë kufi të parashikueshëm për periudhën gjatë së cilës aktivi pritet të gjenerojë flukse monetare neto, ose japë potencial shërbimi, për njësinë.
88. Kontabiliteti për një aktiv afatgjatë jomaterial bazohet në jetën e tij të dobishme. Një aktiv afatgjatë jomaterial me një jetë të dobishme të kufizuar amortizohet (shih paragrafët 96-105), dhe një aktiv afatgjatë jomaterial me një jetë të dobishme të pacaktuar nuk amortizohet (shih paragrafët 106-109). Shembujt ilustrues që shoqërojnë këtë Standard ilustrjnë përcaktimin e jetës së dobishme për aktive të ndryshëm jomaterialë dhe kontabilizimin e mëpasshëm për këta aktive bazuar në përcaktimet e jetës së dobishme.
89. Shumë faktorë merren parasysh në përcaktimin e jetës së dobishme të një aktivi afatgjatë jomaterial, duke përfshirë:
- (a) Përdorimin e pritshëm të aktivitetit nga njësia dhe nëse aktivi mund të menaxhohet me efikasitet nga një ekip tjetër drejtues;
 - (b) Ciklet tipike të jetës së produktit për aktivin dhe informacion publik mbi vlerësimet e jetës së dobishme të aktiveve të ngjashme që përdoren në mënyrë të ngjashme;
 - (c) Vjetërsimin teknik, teknologjik, komercial ose i tipeve të tjera;
 - (d) Stabilitetin e industrisë në të cilën operon aktivi dhe ndryshimet në kërkesën e tregut për produktet ose shërbimet që dalin nga aktivi;
 - (e) Veprimet e pritshme nga konkurrentët ose konkurrentët e mundshëm;
 - (f) Nivelin e shpenzimeve të mirëmbajtjes që kërkohet për të marrë përfitimet e ardhshme ekonomike ose potencialin e shërbimit nga aktivi dhe aftësinë dhe synimin e njësisë për të arritur një nivel të tillë;
 - (g) Periudhën e kontrollit mbi aktivin dhe kufizimet ligjore ose të ngjashme në përdorimin e aktivitetit, të tilla si datat e skadimit të kontratave të qirave të lidhura me periudhën; dhe
 - (h) Nëse jeta e dobishme e aktivitetit varet nga jeta e dobishme e aktiveve të tjerë të njësisë.
90. Termi "jetë e pacaktuar" nuk do të thotë "jetë e pafund." Jeta e dobishme e një aktivi afatgjatë jomaterial pasqyron vetëm atë nivel të shpenzimeve të ardhshme të mirëmbajtjes që kërkohet për të mbajtur aktivin në standardin e performancës

së tij të vlerësuar në kohën e vlerësimit të jetës së dobishme të aktivitetit, dhe aftësinë dhe synimin e njësisë ekonomike për të arritur një nivel të tillë. Konkluzioni se jeta e dobishme e një aktivi afatgjatë jomaterial është e pacaktuar nuk duhet të varet nga shpenzimet e ardhshme të planifikuara që tejkalojnë atë që kërkohet për të mbajtur aktivin në atë standard të performancës.

91. Duke pasur parasysh historinë e ndryshimeve të shpejta në teknologji, programet kompjuterike dhe shumë aktive të tjerë jomaterialë janë të ndjeshëm ndaj vjetërsimit teknologjik. Prandaj, shpesh do të ndodhë që jeta e tyre e dobishme të jetë e shkurtër. Uljet e pritshme në të ardhmen në çmimin e shitjes së një elementi që është prodhuar duke përdorur një aktiv afatgjatë jomaterial mund të tregojnë pritshmërinë e vjetërsimit teknologjik ose tregtar të aktivitetit, i cili, nga ana tjetër, mund të reflektojë një reduktim të përfitimeve të ardhshme ekonomike ose të potencialit të shërbimit të personifikuar nga aktivi.
92. Jeta e dobishme e një aktivi afatgjatë jomaterial mund të jetë shumë e gjatë ose edhe e pacaktuar. Pasiguria justifikon vlerësimin e jetës së dobishme të një aktivi afatgjatë jomaterial mbi një bazë të kujdesshme, por nuk justifikon zgjedhjen e një jete jorealiste të shkurtër.
93. **Jeta e dobishme e një aktivi afatgjatë jomaterial që lind nga marrëveshjet detyruese (duke përfshirë të drejtat nga kontratat ose të drejtat e tjera ligjore) nuk do të tejkalojnë periudhën e marrëveshjes detyruese (përfshirë të drejtat nga kontratat ose të drejta të tjera ligjore), por mund të jetë më e shkurtër në varësi të periudhës gjatë të cilës njësia pret të përdorë aktivin. Nëse marrëveshjet detyruese (përfshirë të drejtat nga kontratat ose të drejta të tjera ligjore) barten për një afat të kufizuar që mund të rinovohet, jeta e dobishme e aktivitetit afatgjatë jomaterial do të përfshijë periudhën(at) e rinovimit vetëm nëse ka evidencë për të mbështetur rinovimin nga njësia pa kosto të konsiderueshme.**

93A. **Jeta e dobishme e:**

- (a) **Një liçence ose të drejta të ngjashme të dhënë më parë nga një operacion i kombinuar ndaj një operacioni tjetër të kombinuar që njihet nga njësia rezultuese në një proces shkrirje; ose**
- (b) **Një të drejta të rifituar të njohur si një aktiv afatgjatë jomaterial në një blerje**

është periudha e mbetur e marrëveshjes detyruese (përfshirë të drejtat nga kontratat ose të drejta të tjera ligjore) në të cilën është dhënë e drejta dhe nuk do të përfshijë periudha rinovimi.

94. Mund të ketë faktorë ekonomikë, politikë, socialë, dhe ligjorë që ndikojnë në jetën e dobishme të një aktivi afatgjatë jomaterial. Faktorët ekonomikë, politikë, ose socialë përcaktojnë periudhën gjatë të cilës përfitimet e ardhshme ekonomike ose potenciali i shërbimit do të merren nga njësia. Faktorët ligjorë

mund të kufizojnë periudhën gjatë së cilës njësia kontrollon aksesin në këta përfitime ekonomike ose potencial shërbimi. Jeta e dobishme është më e shkurtra nga periudhat e përcaktuara nga këta faktorë.

95. Ekzistenca e faktorëve të mëposhtëm, ndër të tjera, tregon se një njësi do të jetë në gjendje të rinovoj marrëveshjet detyruese (përfshirë të drejtat nga kontratat ose të drejta të tjera ligjore) pa kosto të konsiderueshme:

- (a) Ka evidencë, ndoshta të bazuar në përvojë, se marrëveshjet detyruese (përfshirë të drejtat nga kontratat ose të drejta të tjera ligjore) do të rinovohen. Nëse rinovimi varet nga miratimi i një pale të tretë, kjo përfshin evidencë se pala e tretë do të japë miratimin e saj;
- (b) Ka evidencë se çdo kusht i nevojshëm për të marrë rinovimin do të plotësohet; dhe
- (c) Kostoja e rinovimit për njësinë nuk është domethënëse/e konsiderueshme kur krahasohet me përfitimet e ardhshme ekonomike ose potencialin e shërbimit që pritet të kalojë tek njësia nga rinovimi.

Nëse kostoja e rinovimit është e konsiderueshme kur krahasohet me përfitimet e ardhshme ekonomike ose potencialin e shërbimit që pritet të kalojë tek njësia nga rinovimi, kostoja e "rinovimit" përfaqëson, në thelb, koston për të blerë një aktiv të ri jomaterial në datën e rinovimit.

Aktivët Afatgjatë Jomateriale me Jetë të Dobishme të Fundme

Periudha e Amortizimit dhe Metoda e Amortizimit

96. Shuma e amortizueshme e një aktivi afatgjatë jomaterial me një jetë të dobishme të kufizuar do të shpërndahet në mënyrë sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Amortizimi do të fillojë kur aktivi është i disponueshëm për përdorim, d.m.th., kur është në vendndodhjen dhe gjendjen e nevojshme që të mundë të funksionojë në mënyrën e synuar nga drejtimi. Amortizimi do të ndalojë në datën që aktivi çregjistrohet. Metoda e përdorur e amortizimit duhet të pasqyrojë modelin në të cilin përfitimet e ardhshme ekonomike ose potenciali i shërbimit të aktivitetit pritet të konsumohen nga njësia. Nëse ky model nuk mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme, do të përdoret metoda lineare. Shuma e amortizimit për çdo periudhë do të njihet në sufiçit ose deficiet, përveç rastit kur ky ose një Standard tjetër e lejon ose kërkon që ai të përfshihet në vlerën e mbartur të një aktivi tjetër.

97. Një shumëllojshmëri metodash amortizimi mund të përdoren për të alokuar shumën e amortizueshme të një aktivi sipas bazës sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Këto metoda përfshijnë metodën lineare, metodën e tepricës së mbetur, dhe metodën e njërive të prodhimit. Metoda e përdorur zgjidhet në bazë të modelit të pritshëm të konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të pritshme ose potencialit të shërbimit të personifikuar në aktiv dhe zbatohet

vazhdimisht nga periudha në periudhë, përveç nëse ka një ndryshim në modelin e pritshëm të konsumit të atyre përfitimeve të ardhshme ekonomike ose potencialit të shërbimit.

- 97A. Ekziston një supozim i kundërshtueshëm që një metodë amortizimi që azohet në të ardhurat e gjeneruara nga një aktivitet që përfshin përdorimin e një aktivi afatgjatë jomaterial është e papërshtatshme. Të ardhurat e gjeneruara nga një aktivitet që përfshin përdorimin e një aktivi afatgjatë jomaterial zakonisht pasqyron faktorë që nuk janë të lidhur drejtpërdrejt me konsumin e përfitimeve ekonomike ose potencialin e shërbimit të personifikuar në aktivin afatgjatë jomaterial. Për shembull, të ardhurat ndikohen nga të dhënat hyrëse dhe proceset e tjera, aktivitetet e shitjes dhe ndryshimet në volumin dhe çmimet e shitjeve. Komponenti i çmimit të të ardhurave mund të ndikohet nga inflacioni, i cili nuk ka asnjë ndikim në mënyrën në të cilën një aktiv është konsumuar. Ky supozim mund të kapërcehet vetëm në rrethanat e kufizuara:
- (a) Në të cilat aktivi afatgjatë jomaterial shprehet si një masë e të ardhurave, siç përshkruhet në paragrafin 97C; ose
 - (b) Kur mund të demonstrohet se të ardhurat dhe konsumi i përfitimeve ekonomike ose potencialit të shërbimit të aktivitetit afatgjatë jomaterial janë shumë të lidhura.
- 97B. Në zgjedhjen e një metode të përshtatshme amortizimi në përputhje me paragrafin 97, një njësi mund të përcaktojë faktorin kufizues mbizotërues që është i natyrshëm në brendinë e aktivitetit afatgjatë jomaterial. Për shembull, kontrata që përcakton të drejtat e njësisë mbi përdorimin e një aktivi afatgjatë jomaterial mund të specifikojë përdorimin nga njësia të aktivitetit afatgjatë jomaterial si një numër të paracaktuar vitesh (d.m.th., kohë), si një numër njësisish të prodhuara ose si një total fiks të të ardhurave që do të gjenerohen. Identifikimi i një faktori të tillë kufizues mbizotërues mund të shërbejë si pikënisje për identifikimin e bazës së duhur të amortizimit, por një bazë tjetër mund të zbatohet/zbatohet nëse pasqyron më afër modelin e pritshëm të konsumit të përfitimeve ekonomike ose potencialit të shërbimit.
- 97C. Në rrethanat në të cilat faktori kufizues mbizotërues që është i natyrshëm në brendinë e një aktivi afatgjatë jomaterial është arritja e një pragu të të ardhurave, të ardhurat që do të gjenerohen mund të jenë një bazë e përshtatshme për amortizimin. Për shembull, e drejta për të operuar një rrugë me pagesë mund të bazohet në një shumë fikse totale të të ardhurave që do të gjenerohet nga tarifat kumulative që do të paguhen (për shembull, një kontratë mund të lejojë funksionimin e rrugës me pagesë derisa shuma kumulative e tarifave të gjeneruara nga funksionimi i rrugës arrin 100 milionë NJM). Në rastin kur të ardhurat janë përcaktuar si faktori kufizues mbizotërues në kontratën për përdorimin e aktivitetit afatgjatë jomaterial, të ardhurat që do të gjenerohen mund të jenë një bazë e përshtatshme për amortizimin e aktivitetit afatgjatë jomaterial, me kusht që kontrata të specifikojë një shumë totale të të ardhurave që do të gjenerohen mbi të cilat do të përcaktohet amortizimi.

98. Amortizimi zakonisht njihet në sufiçit ose defiçit. Megjithatë, ndonjëherë përfitimet e ardhshme ekonomike ose potenciali i shërbimit të personifikuar në një aktiv absorbohen në prodhimin e aktiveve të tjerë. Në këtë rast, shuma e amortizimit përbën pjesë të kostos së aktivit tjetër dhe përfshihet në vlerën e tij të mbartur. Për shembull, amortizimi i aktiveve afatgjatë jomateriale të përdorur në një proces prodhimi përfshihet në vlerën e mbartur të inventarëve (shih SNKSP 12).

Vlera e Mbetur

99. **Vlera e mbetur e një aktivi afatgjatë jomaterial me një jetë të dobishme të kufizuar do të supozohet të jetë zero, përveç nëse:**

- (a) **Ekziston një angazhim nga një palë e tretë për të blerë aktivin në fund të jetës së tij të dobishme; ose**
- (b) **Ekziston një treg aktiv për aktivin, dhe:**
 - (i) **Vlera e mbetur mund të përcaktohet duke iu referuar atij tregu; dhe**
 - (ii) **Ka gjasa që një treg i fillë të ekzistojë në fund të jetës së dobishme të aktivit.**

100. Shuma e amortizueshme e një aktivi me një jetë të dobishme të fundme përcaktohet pas zbritjes së vlerës së tij të mbetur. Një vlerë e mbetur e ndryshme nga zero nënkupton që një njësi pret të shesë aktivin afatgjatë jomaterial përpara përfundimit të jetës së tij ekonomike.

101. Një vlerësim i vlerës së mbetur të një aktivi bazohet në shumën e rikuperueshme nga shitja duke përdorur çmimet që mbizotërojnë në datën e vlerësimit për shitjen e një aktivi të ngjashëm që ka arritur fundin e jetës së tij të dobishme dhe ka operuar në kushte të ngjashme me ato në të cilat aktivi do të përdoret. Vlera e mbetur rishikohet të paktën në çdo datë raportimi. Një ndryshim në vlerën e mbetur të aktivit kontabilizohet si një ndryshim në një vlerësim kontabël në përputhje me SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*.

102. Vlera e mbetur e një aktivi afatgjatë jomaterial mund të rritet në një shumë të barabartë ose më të madhe se vlera e mbartur e aktivit. Nëse rritet, shuma e amortizimit të aktivit është zero, përveç nëse dhe derisa vlera e tij e mbetur të ulet më pas në një shumë nën vlerën e mbartur të aktivit.

Rishikimi i Periudhës së Amortizimit dhe Metodës së Amortizimit

103. **Periudha e amortizimit dhe metoda e amortizimit për një aktiv afatgjatë jomaterial me jetë të dobishme të fundme do të rishikohen të paktën në çdo datë raportimi. Nëse jeta e dobishme e pritshme e aktivit është e ndryshme nga vlerësimet e mëparshme, periudha e amortizimit do të ndryshohet në përputhje me rrethanat. Nëse ka pasur një ndryshim në modelin e pritshtëm**

të konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike ose potencialit të shërbimit të personifikuar në aktiv, metoda e amortizimit duhet të ndryshohet për të pasqyruar modelin e ndryshuar. Këta ndryshime do të kontabilizohen si ndryshime në vlerësimet e kontabilitetit në përputhje me SNKSP 3.

104. Gjatë jetës së një aktivi afatgjatë jomaterial, mund të bëhet e qartë se vlerësimi i jetës së tij të dobishme është i papërshtatshëm. Për shembull, njohja e një humbjeje nga zhvlerësimi mund të tregojë se periudha e amortizimit duhet të ndryshohet.
105. Me kalimin e kohës, modeli i përfitimeve ekonomike të ardhshme ose i potencialit të shërbimit që pritet të kalojnë në një njësi nga një aktiv afatgjatë jomaterial mund të ndryshojë. Për shembull, mund të bëhet e qartë se një metodë e balancës së zvogëluar të amortizimit është e përshtatshme dhe jo një metodë lineare. Një shembull tjetër është nëse përdorimi i të drejtave të përfaqësuara nga një licencë shtyhet në pritje të veprimeve për komponentë të tjerë të planit strategjik të njësisë. Në këtë rast, përfitimet ekonomike ose potenciali i shërbimit që kalojnë nga aktivi mund të mos merren deri në periudha të mëvonshme.

Aktivët Afatgjatë Jomateriale më Jetë të Dobishme të Pacaktuar

106. **Një aktiv afatgjatë jomaterial me një jetë të dobishme të pacaktuar nuk do të amortizohet.**
107. Në përputhje me SNKSP 21 dhe SNKSP 26, një njësi e kërkuar të testojë një aktiv afatgjatë jomaterial me jetë të dobishme të pacaktuar ose një aktiv afatgjatë jomaterial që nuk është ende i disponueshëm për përdorim për zhvlerësim, duke krahasuar shumën e rikuperueshme të shërbimit ose shumën e tij të rikuperueshme, sipas rastit, me vlerën e tij të mbartur:
- (a) Çdo vit; dhe
 - (b) Sa herë që ka një tregues se aktivi afatgjatë jomaterial mund të jetë zhvlerësuar.

Rishikimi i Vlerësimit të Jetës së Dobishme

108. **Jeta e dobishme e një aktivi afatgjatë jomaterial që nuk amortizohet do të rishikohet çdo periudhë raportimi për të përcaktuar nëse ngjarjet dhe rrethanat vazhdojnë të mbështesin një vlerësim të jetës së dobishme të pacaktuar për atë aktiv. Nëse nuk e mbështesin, ndryshimi në vlerësimin e jetës së dobishme nga e pacaktuar në të fundme do të kontabilizohet si një ndryshim në një vlerësim kontabël në përputhje me SNKSP 3.**
109. Në përputhje me SNKSP 21 ose SNKSP 26, sipas rastit, rivlerësimi i jetës së dobishme të një aktivi afatgjatë jomaterial si i kufizuar dhe jo si i pa kufizuar është një tregues se aktivi mund të jetë zhvlerësuar. Si rezultat, njësi teston

aktivin për zhvlerësim duke krahasuar shumën e tij të rikuperueshme të shërbimit ose shumën e tij të rikuperueshme, të përcaktuar në përputhje me SNKSP 21 ose SNKSP 26, sipas rastit, me vlerën e tij të mbartur, dhe duke njohur çdo tejkalim të vlerës së mbartur mbi shumën e rikuperueshme të shërbimit ose shumën e rikuperueshme sipas rastit, si një humbje nga zhvlerësimi.

Rikuperimi i Shumës së Mbartur—Humbjet nga Zhvlerësimi

110. Për të përcaktuar nëse një aktiv afatgjatë jomaterial është i zhvlerësuar, një njësi zbaton SNKSP 21 ose SNKSP 26, sipas rastit. Këta Standarde shpjegojnë kur dhe si një njësi rishikon vlerën e mbartur të aktiveve të saj, si përcakton shumën e rikuperueshme të shërbimit ose shumën e rikuperueshme të një aktivi, sipas rastit, dhe kur njuh ose anulon një humbje nga zhvlerësimi.

Tërheqjet nga Përdorimi dhe Shitjet

111. **Një aktiv afatgjatë jomaterial do të çregjistrohet:**
- (a) **Në rast shitje ose nxjerrje jashtë përdorimit (përfshirë nxjerrjen jashtë përdorimit nëpërmjet një transaksioni pa këmbim); ose**
 - (b) **Kur nuk priten përfitime ekonomike në të ardhmen ose potencial shërbimi nga përdorimi ose shitja e tij.**
112. **Fitimi se humbja që vijnë nga çregjistrimi i një aktivi afatgjatë jomaterial do të përcaktohet si diferencë midis të ardhurave neto të shitjes, nëse ka, dhe vlerës së mbartur të aktivit. Ai do të njihet në sufiçit ose defiçit kur aktiv i çregjistrohet (përveç rastit kur SNKSP 13 kërkon ndryshe për një shitje dhe rimarrje me qira).**
113. Shitja dhe nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivi afatgjatë jomaterial mund të ndodhë në mënyra të ndryshme (p.sh., me shitje, duke hyrë në një qira financiare, ose nëpërmjet një transaksioni pa këmbim). Në përcaktimin e datës së shitjes së një aktivi të tillë, një njësi ekonomike zbaton kriteret në SNKSP 9, zbatohet për nxjerrjen nga përdorimi me shitje dhe rimarrje me qira. *Të Ardhurat nga Transaksionet e Këmbimit* për njohjen e të ardhurave nga shitja e të mirave. SNKSP 13 zbatohet për nxjerrjen nga përdorimi me shitje dhe qira riverse.
114. Nëse, në përputhje me parimin e njohjes në paragrafin 28, një njësi njuh në vlerën e mbartur të një aktivi koston e një zëvendësimi për një pjesë të një aktivi afatgjatë jomaterial, atëherë ajo çregjistron vlerën e mbartur të pjesës së zëvendësuar. Nëse nuk është praktike që një njësi të përcaktojë vlerën e mbartur të pjesës së zëvendësuar, ajo mund të përdorë koston e zëvendësimit si një tregues se cila ishte kostoja e pjesës së zëvendësuar në kohën kur ajo u ble ose u krijua së brendshmi.

114A. Në rastin e:

- (a) Një licence ose të drejtë të ngjashme të dhënë më parë nga një operacion kombinues ndaj një operacioni tjetër kombinues që njihet nga njësia rezultuese në një bashkim; ose
- (b) Një të drejtë të rimarrë të njohur si një aktiv afatgjatë jomaterial në një blerje,

nëse e drejta i rijepet (shitet) më pas një pale të tretë, vlera e mbartur përkatëse, nëse ka, do të përdoret në përcaktimin e fitimit ose humbjes nga ridhënia.

115. Shuma e arkëtueshme nga shitja e një aktivi afatgjatë jomaterial njihet fillimisht me vlerën e tij të drejtë. Nëse pagesa për aktivin afatgjatë jomaterial shtyhet, shumta e marrë njihet fillimisht me ekuivalentin e çmimit në mjete monetare. Diferenca ndërmjet shumës nominale të pagesës dhe ekuivalentit të çmimit në mjete monetare njihet si e ardhur nga interesi në përputhje me SNKSP 9 duke reflektuar shumën efektive të të arkëtueshmeve.

116. Amortizimi i një aktivi afatgjatë jomaterial me një jetë të dobishme të kufizuar/të fundme nuk ndërpritet kur aktivi afatgjatë jomaterial nuk përdoret më, përveç rastit kur aktivi është zhvlerësuar plotësisht.

Dhënia e Informacioneve Shpjeguese

Të Përgjithshëm

117. Një njësi do të paraqesë informacione për secilën klasë të aktiveve afatgjatë jomateriale, duke bërë dallimin midis aktiveve afatgjatë jomateriale të gjeneruar së brendshmi dhe aktiveve të tjerë jomaterialë:

- (a) Nëse jetët e dobishme janë të pakufizuara ose të kufizuara (të fundme) dhe, në rastet kur janë të fundme, afatin e jetës së dobishme ose normat e amortizimit të përdorura;
- (b) Metodatat e amortizimit të përdorura për aktivet afatgjatë jomateriale me jetë të dobishme të fundme;
- (c) Vlerën e mbartur bruto dhe çdo amortizim të akumuluar (së bashku me humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi) në fillim dhe në fund të periudhës;
- (d) Zërat përkatës të pasqyrës së performancës financiare në të cilën përfshihet çdo amortizim i aktiveve afatgjatë jomateriale;
- (e) Një rakordim të vlerës së mbartur në fillim dhe në fund të periudhës që tregon:
 - (i) Shtesat, që tregojnë veç ato nga zhvillimi i brendshëm, nga ato të fituara veç dhe ato të marra nëpërmjet blerjeve;

- (ii) **Shitjet;**
 - (iii) **Zmadhimet ose pakësimet gjatë periudhës që rezultojnë nga rivlerësimet sipas paragrafëve 74, 84 dhe 85 (nëse ka);**
 - (iv) **Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në sufiçit ose deficiçit gjatë periudhës në përputhje me SNKSP 21 ose SNKSP 26 (nëse ka);**
 - (v) **Humbjet nga zhvlerësimi të anuluar në sufiçit ose deficiçit gjatë periudhës në përputhje me SNKSP 21 ose SNKSP 26 (nëse ka);**
 - (vi) **Çdo amortizimin të njohur gjatë periudhës;**
 - (vii) **Diferencat neto të këmbimit që lindin nga konvertimi i pasqyrave financiare në monedhën e prezantimit dhe nga konvertimi i një operacioni të huaj në monedhën e prezantimit të njësisë; dhe**
 - (viii) **Ndryshime të tjera në vlerën e mbartur gjatë periudhës.**
118. Një klasë aktivesh afatgjatë jomateriale është një grupim aktivesh me natyrë dhe përdorim të ngjashëm në operacionet e një njësie. Shembuj të klasave të veçanta mund të përfshijnë:
- (a) Emrat e markave të regjistruara;
 - (b) Titujt kryesorë të gazetave ose revistave dhe tituj botues;
 - (c) Softueret kompjuterikë;
 - (d) Liçencat;
 - (e) Të drejtat e autorit, patentat, dhe të drejtat e tjera të pronësisë industriale, të drejtat e shërbimit, dhe funksionimit;
 - (f) Receta, formula, modele, projekte, e prototipe; dhe
 - (g) Aktivët afatgjatë jomateriale në zhvillim e sipër.
- Klasat e përmendura më sipër zërthehen (përmblihen) në klasa më të vogla (më të mëdha), nëse kjo rezulton në informacion më relevant për përdoruesit e pasqyrave financiare.
119. Një njësi jep informacion për aktivët afatgjatë jomateriale të zhvlerësuar në përputhje me SNKSP 21 ose SNKSP 26, krahas informacionit të kërkuar nga paragrafi 117(e)(iii)–(v).
120. SNKSP 3 kërkon që një njësi të japë informacion për natyrën dhe shumën e një ndryshimi në një vlerësim kontabël që ka një efekt material në periudhën aktuale ose që pritet të ketë një efekt material në periudhat pasuese. Një dhënie e tillë e informacionit mund të lindë nga ndryshimet në:

- (a) Vlerësimin e jetës së dobishme të një aktivi afatgjatë jomaterial;
- (b) Metodën e amortizimit; ose
- (c) Vlerat e mbetura.

121. **Një njësi do të paraqesë gjithashtu:**

- (a) **Për një aktiv afatgjatë jomaterial të vlerësuar që ka një jetë të dobishme të pacaktuar, vlerën e mbartur të atij aktivi dhe arsyet që mbështesin vlerësimin e një jete të dobishme të pacaktuar. Në dhënien e këtyre arsyeve, njësia do të përshkruajë faktorin(ët) që luajtën një rol të rëndësishëm në përcaktimin se aktivi ka një jetë të dobishme të pacaktuar.**
- (b) **Një përshkrim, vlerën e mbartur dhe periudhën e mbetur të amortizimit të çdo aktivi afatgjatë jomaterial individual që është material për pasqyrat financiare të njësisë.**
- (c) **Për aktivet afatgjatë jomateriale të marrë nëpërmjet një transaksioni pa këmbim dhe të njohur fillimisht me vlerën e drejtë (shih paragrafët 42–43):**
 - (i) **Vlerën e drejtë të njohur fillimisht për këta aktive;**
 - (ii) **Vlerën e tyre të mbartur; dhe**
 - (iii) **Nëse ata maten pas njohjes sipas modelit të kostos ose modelit të rivlerësimit.**
- (d) **Ekzistencën dhe vlerën e mbartur të aktiveve afatgjatë jomateriale, titulli i të cilëve është i kufizuar dhe vlerat e mbartura të aktiveve afatgjatë jomateriale të lënë si garanci për detyrimet.**
- (e) **Shumën e angazhimeve kontraktuale për blerjen e aktiveve afatgjatë jomateriale.**

122. Kur një njësi përshkruan faktorin(ët) që luajtën një rol të rëndësishëm në përcaktimin se jeta e dobishme e një aktivi afatgjatë jomaterial është e pacaktuar, njësia merr parasysh listën e faktorëve në paragrafin 89.

Aktivët Afatgjatë Jomateriale të Matur pas Njohjes Duke Përdorur Modelin e Rivlerësimit

123. **Nëse aktivet afatgjatë jomateriale kontabilizohen me shumën e rivlerësuar, një njësi do të japë informacionet në vijim:**

- (a) **Sipas klasës së aktiveve afatgjatë jomateriale:**
 - (i) **Datën efektive të rivlerësimit;**
 - (ii) **Vlerën e mbartur të aktiveve afatgjatë jomateriale të rivlerësuar; dhe**

- (iii) **Vlerën e mbartur që do të ishte njohur nëse kategoria/klasa e rivlerësuar e aktiveve afatgjatë jomateriale do të matej pas njohjes duke përdorur modelin e kostos në paragrafin 73;**
 - (b) **Shumën e suficitit të rivlerësimit që lidhet me aktivet afatgjatë jomateriale në fillim dhe në fund të periudhës së raportimit, duke treguar ndryshimet gjatë periudhës së raportimit dhe çdo kufizim në shpërndarjen e balancës tek pronarët; dhe**
 - (c) **Metodat dhe supozimet e rëndësishme të zbatuara në vlerësimin e vlerës së drejtë të aktiveve.**
124. Mund të jetë e nevojshme të grupohen klasat e aktiveve të rivlerësuara në klasa më të mëdha për qëllime të dhënies së informacioneve. Megjithatë, klasat nuk grupohen nëse kjo do të rezultonte në kombinimin e një klase aktivesh afatgjatë jomateriale që përfshin shumën të matura si sipas modelit të kostos, ashtu edhe sipas modelit të rivlerësimit.

Shpenzimet për Kërkim dhe Zhvillim

125. **Një njësi duhet të paraqesë shumën e përgjithshme të shpenzimeve për kërkim dhe zhvillim të njohur si shpenzim gjatë periudhës.**
126. Shpenzimet e kërkimit dhe zhvillimit përfshijnë të gjithë shpenzimet që i atribuohen drejtpërdrejt aktiviteteve të kërkimit ose zhvillimit (shih paragrafët 64 dhe 65 për udhëzim mbi llojin e shpenzimeve që do të përfshihet për qëllimin e kërkesës për dhënie informacionesh në paragrafin 125).

Informacion Tjetër

127. Një njësi inkurajohet, por nuk është e detyruar, të japë informacionin e mëposhtëm:
- (a) Një përshkrim të çdo aktivi afatgjatë jomaterial plotësisht të amortizuar që është ende në përdorim; dhe
 - (b) Një përshkrim të shkurtër të aktiveve afatgjatë jomateriale të rëndësishëm të kontrolluar nga njësi, por që nuk njihen si aktive sepse nuk plotësonin kriteret e njohjes në këtë Standard.

Dispozita Kalimtare

128. **Një njësi që ka njohur më parë aktive afatgjatë jomateriale do të zbatojë këtë Standard në mënyrë retrospektive në përputhje me SNKSP 3.**
129. [Fshirë]
130. [Fshirë]
131. [Fshirë]

113. Paragrafi 79 u ndryshua nga *Përmirësimet e SNKSP-ve 2014* botuar në janar 2015. Një njësi do ta zbatojë këtë ndryshim për të gjithë rivlerësimet e njohura në periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës së zbatimit fillestar të atij ndryshimi dhe në periudhën vjetore menjëherë paraardhëse.

Data Efektive

132. Një njësi do të zbatojë këtë Standard për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 prill, 2011. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 prill, 2011, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe të zbatojë SNKSP 21 dhe SNKSP 26 në të njëjtën kohë.
- 132A. Paragrafi 6 u ndryshua nga SNKSP 32, *Marrëveshjet e Koncesionit të Shërbimit: Grantdhënësi* botuar në tetor 2011. Një njësi do të zbatojë këtë ndryshim për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2014. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2014, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe në të njëjtën kohë të zbatojë SNKSP 32, ndryshimet në paragrafët 6 dhe 42A të SNKSP 5, ndryshimet në paragrafët 25-27 dhe 85B të SNKSP 13, ndryshimet në paragrafët 5, 7 dhe 107C të SNKSP 17 dhe ndryshimet në paragrafët 2 dhe 125A të SNKSP 29.
- 132B. Paragrafët 79, 91 dhe 97 u ndryshuan dhe paragrafët 97A, 97B, 97C dhe 131A u shtuan nga *Përmirësimet e SNKSP-ve 2014* botuar në janar 2015. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime në mënyrë prospektive për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit 2015. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2015, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.
- 132C. Paragrafët 129, 130, 131 dhe 133 u ndryshuan nga SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara* botuar në janar 2015. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2017. Zbatimi i mëparshëm lejohet. Nëse një njësi zbaton SNKSP 33 për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2017, ndryshimet do të zbatohen gjithashtu për atë periudhë të mëparshme.
- 132D. SNKSP 35, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara* dhe SNKSP 37, *Marrëveshjet e Përbashkëta* botuar në janar 2015, ndryshuan paragrafin 6(d). Një njësi do ta zbatojë atë ndryshim kur zbaton SNKSP 35 dhe SNKSP 37.
- 132E. Paragrafët 3, 96, 116 dhe 117 u ndryshuan nga *Përmirësimet e SNKSP-ve*

2015 publikuara në prill 2016. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2017. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2017, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.

- 132F. Paragrafët 4 dhe 5 u fshinë nga *Zbatueshmëria e SNKSP-ve*, botuar në prill 2016. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2018. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.
- 132G. *Zhvlerësimi i Aktiveve të Rivlerësuar* (Ndryshimet në SNKSP 21 dhe 26) ndryshuan paragrafin 110. Një njësi do ta zbatojë atë ndryshim për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2018. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi e zbaton këtë ndryshim për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.
- 132H. Paragrafët 6, 35 dhe 64 u ndryshuan nga SNKSP 39, *Përfutimet e Punonjësve*, botuar në korrik 2016. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2018. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe të zbatojë SNKSP 39 në të njëjtën kohë.
- 132I. Paragrafët 3, 6, 18, 24, 40, 41, 66, 67 dhe 117 u ndryshuan dhe paragrafët 18A, 26A, 39A–39E, 93A dhe 114A u shtuan nga SNKSP 40, *Kombinimet e Sektorit Publik*, botuar në janar 2017. Njësia do t'i zbatojë këta ndryshime në mënyrë prospektive për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2019. Prandaj, shumat e njohura për aktivet afatgjatë jomateriale dhe emrin e mirë në kombinimet e mëparshme të sektorit publik nuk do të rregullohen. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2019, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe të zbatojë SNKSP 40 në të njëjtën kohë.
- 132J. Paragrafi 109 u ndryshua nga *Përmirësimi të SNKSP-ve, 2018*, botuar në tetor 2018. Një njësi do ta zbatojë këtë ndryshim në mënyrë prospektive për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2019. Zbatimi i mëparshëm lejohet. Nëse një njësi e zbaton këtë ndryshim për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2019, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe në të njëjtën kohë do të zbatojë *Zhvlerësimin e Aktiveve të Rivlerësuar* (Ndryshimet në SNKSP 21, *Zhvlerësimi i Aktiveve që nuk Gjenerojnë Mjete Monetare* dhe SNKSP 26,

Zhvlerësimi i Aktiveve që Gjenerojnë Mjete Monetare).

133. Kur një njësi adopton SNKSP-të e kontabilitetit sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, siç përcaktohet në SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (SNKSP-të)* për qëllime të raportimit financiar pas kësaj date efektive, ky Standard zbatohet për pasqyrat financiare vjetore të njësisë që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës së adoptimit të SNKSP-ve.

SNKSP 32—MARRËVESHJET KONÇESIONARE TË SHËRBIMIT: GRANTDHËNËSI

Shënime të Mirënjohjes

Ky Standard Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) përcakton kërkesat e kontabilitetit të grantdhënësit në një marrëveshje konçesionare të shërbimit. Ai është përshtatur nga Interpretimi 12 (KINRF 12), *Marrëveshjet Konçesionare të Shërbimit*, i zhvilluar nga Komiteti i Interpretimeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe i publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). IKINRF 12 përcakton kërkesat e kontabilitetit të operatorit në një marrëveshje konçesionare shërbimi. Ky SNKSP përmban gjithashtu ekstrakte nga Interpretimi 29 (KPI-29), *Marrëveshjet Konçesionare të Shërbimit: Paraqitja e Informacioneve*, të zhvilluara nga Komiteti i Përhershëm i Interpretimeve dhe të publikuara nga BSNK. Ekstraktet nga IKINRF 12 dhe KPI-29 janë riprodhuar në këtë publikim të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) me lejen e Fondacionit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Teksti i aprovuar i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) është ai i publikuar nga BSNK në gjuhën angleze dhe kopjet mund të merren direkt nga IFRS Foundation, Customer Service, Columbus Building, 7 Westferry Circus, Canary Wharf, London E14 4HD, United Kingdom.

E-mail: publications@ifrs.org

Internet: www.ifrs.org

Të drejtat e autorit për SNRF-të, SNK-të, Draftet e Paraqitura dhe publikime të tjera të BSNK-së i përkasin Fondacionit SNRF.

"SNRF", "SNK", "BSNK", "Fondacioni SNRF", "Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit" dhe "Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar" janë marka tregtare të Fondacionit SNRF dhe nuk duhet të përdoren pa aprovimin e Fondacionit SNRF.

SNKSP 32—MARRËVESHJET KONÇESIONARE TË SHËRBIMIT: GRANTDHËNËSI

Historia e SNKSP

Ky version përfshin ndryshime që rezultojnë nga SNKSP-të e botuara deri më 31 janar, 2019.

SNKSP 32, *Marrëveshjet Konçesionare të Shërbimit: Grantdhënësi* u botua në tetor 2011.

Që atëherë, SNKSP 32 është ndryshuar nga SNKSP-të e mëposhtme:

- SNKSP 41, *Instrumentet Financiare* (botuar në gusht 2018)
- *Zbatueshmëria e SNKSP-ve* (botuar në prill 2016)
- *Përmirësime të SNKSP-ve 2015* (botuar në prill 2016)
- *SNKSP 33, Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara* (botuar në janar 2015)

Tabela e Paragrafëve të Ndryshuar në SNKSP 32

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
3	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
4	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
13	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Prill 2016
20	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
29	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018

MARRËVESHJET KONÇESIONARE TË SHËRBIMIT: GRANTDHËNËSI

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
32	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Prill 2016
33	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Prill 2016
35	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
35A	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Prill 2016
35B	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Prill 2016
36A	I Ri	SNKSP 33 Janar 2015
36B	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Prill 2016
36C	I Ri	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
36D	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
37	U Ndryshua	SNKSP 33 Janar 2015
AG20	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Prill 2016
AG35	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Prill 2016
AG37	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018

MARRËVESHJET KONÇESIONARE TË SHËRBIMIT: GRANTDHËNËSI

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
AG45	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
AG52	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
AG53	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
AG68	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
AG69	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
AG70	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
AG71	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
AG72	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
AG73	U Fshi	SNKSP 33 Janar 2015
IG2	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018

**SNKSP 32—MARRËVESHJET KONÇESIONARE TË
SHËRBIMIT:
GRANTDHËNËSI
PËRMBAJTJA**

	Paragrafi
Objektivi	1
Objekti	2–7
Përkufizime	8
Njohja dhe Matja e një Aktivi të Konçesionit të Shërbimit	9–13
Njohja dhe Matja e Detyrimeve	14–28
Modeli i Detyrimit Financiar	18–23
Modeli i Dhënies së të Drejtës ndaj Operatorit	24–26
Ndarja e Marrëveshjes	27–28
Detyrime, Angazhime, Detyrime të Kushtëzuara dhe Aktive të Kushtëzuara të Tjera	29
Të Ardhura të Tjera.....	30
Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese	31–33
Dispozita Kalimtare	34–35
Data Efektive	36–37

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik 32, *Marrëveshjet Konçesionare të Shërbimit: Grantdhënësi* përcaktohet në paragrafët 1–37. Të gjitha paragrafët kanë autoritet të barabartë. SNKSP 32 duhet lexuar në kontekstin e objektivit të tij, Bazës për Konkluzione, *Parathënies së Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar me Qëllim të Përgjithshëm nga Njësitë e Sektorit Publik*. . SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, jep një bazë për zgjedhjen dhe zbatimin e politikave të kontabilitetit në mungesë të udhëzimeve të qarta.

Objektivi

1. Objektivi i këtij Standardi është të përshkruajë/rekomandojë kontabilitetin për marrëveshjet konçesionare të shërbimit nga grantdhënësi, një njësi e sektorit publik.

Objekti (shiko paragrafët AG1–AG2)

2. Një njësi ¹ që përgatit dhe paraqet pasqyrat financiare sipas kontabilitetit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara do të zbatojë këtë Standard në kontabilitetin për marrëveshjet konçesionare të shërbimit.
3. [Fshirë]
4. [Fshirë]
5. Marrëveshjet brenda fushëveprimit të këtij Standardi përfshijnë operatorin që jep shërbime publike që lidhen me aktivin e konçesionit të shërbimit në emër të grantdhënësit.
6. Marrëveshjet jashtë fushëveprimit të këtij Standardi janë ato që nuk përfshijnë dhënieve të shërbimeve publike dhe marrëveshjet që përfshijnë komponentë shërbimi dhe menaxhimi ku aktivi nuk kontrollohet nga grantdhënësi (p.sh., kontraktimet e shërbimeve ose privatizimi).
7. Ky Standard nuk specifikon kontabilitetin sipas operatorëve (udhëzimet për kontabilitetin për marrëveshjet e konçesionit të shërbimit nga operatori mund të gjenden në standardin përkatës ndërkombëtar ose kombëtar të kontabilitetit që trajton marrëveshjet konçesionare të shërbimit).

Përkufizime (shih paragrafët AG3-AG4)

8. Termat e mëposhtëm përdoren në këtë Standard me kuptimet e specifikuar:

Një **marrëveshje detyruese**, për qëllimet e këtij Standardi, përshkruan kontratat dhe marrëveshjet e tjera që u japin palëve të drejta dhe detyrime të ngjashme sikur të ishin në formën e një kontrate.

Një **grantdhënës**, për qëllimet e këtij Standardi, është njësi që i jep operatorit të drejtën për të përdorur aktivin konçesionar të shërbimit.

Një **operator**, për qëllimet e këtij Standardi, është njësi që përdor aktivin e konçesionit të shërbimit për të ofruar shërbime publike që i nënshtrohen kontrollit të aktivitetit nga grantdhënësi.

Një **marrëveshje konçesionare të shërbimit** është një marrëveshje detyruese midis një grantdhënësi dhe një operatori në të cilën:

- (a) Operatori përdor aktivin e konçesionit të shërbimit për të dhënë një

shërbim publik në emër të grantdhënësit për një periudhë të specifikuar kohe; dhe

- (b) Operatori kompensohet për shërbimet e tij gjatë periudhës së marrëveshjes konçesionare të shërbimit.

Një **aktiv i konçesionit të shërbimit** është një aktiv që përdoret për të dhënë shërbime publike në një marrëveshje konçesionare të shërbimit që:

- (a) Jepet nga operatori i cili:
- (i) Operatori e ndërton, zhvillon, ose e blen nga një palë e tretë; ose
 - (ii) Është një aktiv ekzistues i operatorit; ose
- (b) Jepet nga grantdhënësi i cili:
- (i) Është një aktiv ekzistues i grantdhënësit; ose
 - (ii) Është një përmirësim i një aktivi ekzistues të grantdhënësit.

Termet e përkufizuar në SNKSP-të e tjera përdoren në këtë Standard me të njëjtin kuptim si në ato Standarde, dhe riprodhohen në *Fjalorin e Termave të Përkufizuar të publikuar veç*.

Njohja dhe Matja e një Aktivi të Konçesionit të Shërbimit (shih paragrafët AG5–AG35)

9. Grantdhënësi do të njohë një aktiv të ofruar nga operatori dhe një përmirësim në një aktiv ekzistues të grantdhënësit si një aktiv të konçesionit të shërbimit nëse:
- (a) Grantdhënësi kontrollon ose rregullon se cilat shërbime duhet të ofrojë operatori me aktivin, kujt duhet t'ia ofrojë ato, dhe me çfarë çmimi; dhe
 - (b) Grantdhënësi kontrollon – nëpërmjet pronësisë, të drejtës përfituese ose ndryshe – çdo interes të rëndësishëm të mbetur në aktiv në fund të kohëzgjatjes së marrëveshjes.
10. Ky Standard zbatohet për një aktiv të përdorur në një marrëveshje konçesionare të shërbimit për të gjithë jetën e tij të dobishme (një “aktiv i përjetshëm”) nëse plotësohen kushtet në paragrafin 9(a).
11. Grantdhënësi fillimisht do të masë aktivin e konçesionit të shërbimit të njohur në përputhje me paragrafin 9 (ose paragrafin 10 për një aktiv të përjetshëm) me vlerën e tij të drejtë, përveç siç përmendet në paragrafin 12.
12. Kur një aktiv ekzistues i grantdhënësit plotëson kushtet e specifikuar në paragrafin 9(a) dhe 9(b) (ose paragrafin 10 për një aktiv të përjetshëm),

grantdhënësi do të riklasifikojë aktivin ekzistues si një aktiv të konçesionit të shërbimit. Aktivi i riklasifikuar i konçesionit të shërbimit do të kontabilizohet në përputhje me SNKSP 17, *Ndërtesa, Makineri dhe Pajisje* ose SNKSP 31, *Aktivët Afatgjatë Jomateriale*, sipas rastit.

13. Pas njohjes fillestare ose riklasifikimit, aktivet e konçesionit të shërbimit do të kontabilizohen në përputhje me SNKSP 17 ose SNKSP 31, sipas rastit.

Njohja dhe Matja e Detyrimeve (shih paragrafët AG36–AG50)

14. Kur grantdhënësi njeht një aktiv të konçesionit të shërbimit në përputhje me paragrafin 9 (ose paragrafin 10 për një aktiv të përjetshëm), grantdhënësi do të njohë gjithashtu një detyrim. Grantdhënësi nuk do të njohë një detyrim kur një aktiv ekzistues i grantdhënësit riklasifikohet si aktiv i konçesionit të shërbimit në përputhje me paragrafin 12, përveç në rrethanat kur jepet një konsideratë shtesë nga operatori, siç përmendet në paragrafin 15.
15. Detyrimi/përgjegjësia e njohur në përputhje me paragrafin 14 do të matet fillimisht në të njëjtën shumë si aktivi i konçesionit të shërbimit i matur në përputhje me paragrafin 11, i rregulluar me shumën e çdo pagese tjetër (p.sh. kesh) nga grantdhënësi tek operatori, ose nga operatori te grantdhënësi.
16. Natyra e detyrimit të njohur bazohet në natyrën e shumës së shkëmbyer ndërmjet grantdhënësit dhe operatorit. Natyra e shumës së dhënë nga grantdhënësi për operatorin përcaktohet duke iu referuar kushteve të marrëveshjes detyruese dhe, kur është e përshtatshme, ligjit të kontratës.
17. Në këmbim të aktivitetit të konçesionit të shërbimit, grantdhënësi mund të kompensojë operatorin për aktivin e konçesionit të shërbimit me çdo kombinim të:
- (a) Kryerjes së pagesave për operatorin (modeli i "detyrimit financiar");
 - (b) Kompensimit të operatorit me mjete të tjera (modeli i "dhënies së të drejtës ndaj operatorit") si p.sh.
 - (i) Dhënia ndaj operatorit e të drejtës për të fituar të ardhura nga përdoruesit e palëve të treta të aktivitetit të konçesionit të shërbimit; ose
 - (ii) Dhënia ndaj operatorit e të drejtës në një aktiv tjetër gjenerues të të ardhurave për përdorim nga operatori (p.sh., një departament privat i një spitali ku pjesa e mbetur e spitalit përdoret nga grantdhënësi për të trajtuar pacientët publikë ose një objekt parkimi privat ngjitur me një strukturë publike).

Modeli i Detyrimit Financiar (shih paragrafët AG37–AG46)

18. **Kur grantdhënësi ka një obligim të pakushtëzuar për t'i paguar mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar operatorit për ndërtimin, zhvillimin, blerjen, ose përmirësimin e një aktivi të konçesionit të shërbimit, grantdhënësi do të kontabilizojë detyrimin e njohur në përputhje me paragrafin 14 si një detyrim financiar.**
19. Grantdhënësi ka një obligim të pakushtëzuar për të paguar mjete monetare nëse ka garantuar se do t'i paguajë operatorit:
 - (a) Shumat e specifikuar ose të përcaktueshme; ose
 - (b) Defiçitin, nëse ka, ndërmjet shumave të marra nga operatori nga përdoruesit e shërbimit publik dhe çdo shume të specifikuar ose të përcaktueshme të përmendur në paragrafin 19(a), edhe nëse pagesa kushtëzohet nga fakti nëse operatori siguron që aktivi i konçesionit të shërbimit të përmbushë kërkesat e specifikuar të cilësisë ose efikasitetit.
20. SNKSP 28, *Instrumentet Financiare: Paraqitja*, SNKSP 30, *Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjegues* dhe kërkesat për çregjistrim në SNKSP 41, *Instrumentet Financiare* zbatohen për detyrimin financiar të njohur sipas paragrafit 14, përveç rasteve kur ky Standard jep kërkesa dhe udhëzime.
21. **Grantdhënësi do t'i alokojë pagesat operatorit dhe do t'i kontabilizojë ato sipas përmbajtjes së tyre si një reduktim në detyrimin e njohur në përputhje me paragrafin 14, një tarifë financimi dhe tarifa për shërbimet e dhëna nga operatori.**
22. **Tarifa e financimit dhe tarifat për shërbimet e dhëna nga operatori në një marrëveshje konçesionare të shërbimit të përcaktuar në përputhje me paragrafin 21 do të kontabilizohen si shpenzime.**
23. **Kur aktivi dhe komponentët e shërbimit të një marrëveshjeje të konçesionit të shërbimit janë të identifikueshëm veç, komponentët e shërbimit të pagesave nga grantdhënësi te operatori do të alokohen duke iu referuar vlerave të drejta relative të aktivitetit të konçesionit të shërbimit dhe shërbimeve. Aty ku aktivi dhe komponentët e shërbimit nuk janë të identifikueshëm veç, komponenti i shërbimit i pagesave nga dhënësi ndaj operatorit përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit.**

Modeli i Dhënies së të Drejtës ndaj Operatorit (shih paragrafët AG47–AG49)

24. **Kur grantdhënësi nuk ka një obligim të pakushtëzuar për të paguar mjete monetare ose një aktiv tjetër financiar operatorit për ndërtimin, zhvillimin, blerjen, ose përmirësimin e një aktivi të konçesionit të shërbimit, dhe i jep operatorit të drejtën për të fituar të ardhura nga përdoruesit e palëve të treta ose një aktiv tjetër që gjeneron të ardhura, grantdhënësi do të**

kontabilizojë detyrimin e njohur në përputhje me paragrafin 14 si pjesë e pafituar e të ardhurave që krijohen nga shkëmbimi i aktiveve ndërmjet grantdhënësit dhe operatorit.

25. **Grantdhënësi do të njohë të ardhurat dhe do të reduktojë detyrimin e njohur në përputhje me paragrafin 24 sipas substancës ekonomike të marrëveshjes së konçesionit të shërbimit.**
26. Kur grantdhënësi kompenson operatorin për aktivin e konçesionit të shërbimit dhe ofrimin e shërbimeve duke i dhënë operatorit të drejtën për të fituar të ardhura nga përdoruesit e palëve të treta të aktivitetit të konçesionit të shërbimit ose një aktivi tjetër që gjeneron të ardhura, shkëmbimi konsiderohet si një transaksion që gjeneron të ardhura. Duke qenë se e drejta që i jepet operatorit është efektive për periudhën e marrëveshjes së konçesionit të shërbimit, grantdhënësi nuk njeh të ardhurat nga shkëmbimi menjëherë. Në vend të kësaj, një detyrim njihet për çdo pjesë të të ardhurave që nuk është fituar ende. Të ardhurat njihen sipas substancës ekonomike të marrëveshjes së konçesionit të shërbimit dhe detyrimi reduktohet kur të ardhurat njihen.

Ndarja e Marrëveshjes (shih paragrafin AG50)

27. **Nëse grantdhënësi paguan për ndërtimin, zhvillimin, blerjen, ose përmirësimin e një aktivi të konçesionit të shërbimit, pjesërisht duke shkaktuar një detyrim financiar dhe pjesërisht duke i dhënë një të drejtë operatorit, është e nevojshme të kontabilizojë veç për secilën pjesë të detyrimit total të njohur në përputhje me paragrafin 14. Shuma e njohur fillimisht për detyrimin total do të jetë e njëjta shumë me atë të specifikuar në paragrafin 15.**
28. **Grantdhënësi do të kontabilizojë për secilën pjesë të detyrimit të referuar në paragrafin 27 në përputhje me paragrafët 18-26.**

Detyrime, Angazhime, Detyrime të Kushtëzuara dhe Aktive të Kushtëzuara të Tjera (shih paragrafët AG51–AG54)

29. **Grantdhënësi do të kontabilizojë detyrimet, angazhimet, detyrimet e kushtëzuara dhe aktivet e kushtëzuara të tjera që vijnë nga një marrëveshje konçesionare të shërbimit në përputhje me SNKSP 19, *Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivet e Kushtëzuara*, SNKSP 28, SNKSP 30 dhe SNKSP 41.**

Të Ardhura të Tjera (shih paragrafët AG55–AG64)

30. **Grantdhënësi do të kontabilizojë të ardhurat nga një marrëveshje konçesionare të shërbimit, të ndryshme nga ato të specifikuar në paragrafët 24-26, në përputhje me SNKSP 9, *Të Ardhurat nga Transaksionet e Këmbimit*.**

Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese (shih paragrafët AG65–AG67)

31. **Konçesiondhënësi (ose grantdhënësi) do të paraqesë informacionin në përputhje me SNKSP 1.**
32. **Të gjithë aspektet e një marrëveshjeje të konçesionit të shërbimit do të merren parasysh në përcaktimin informacioneve të duhura që do të paraqiten në shënime. Grantdhënësi do të paraqesë informacionin e mëposhtëm në lidhje me marrëveshjet konçesionare të shërbimit në çdo periudhë raportimi:**
- (a) **Një përshkrim të marrëveshjes;**
 - (b) **Kushtet e rëndësishme të marrëveshjes që mund të ndikojnë në shumën, kohën, dhe sigurinë e flukseve monetare të ardhshëm (p.sh., periudha e konçesionit, datat e ripërcaktimit të çmimit, dhe baza mbi të cilën përcaktohet çmimi i ri ose rinegociimi);**
 - (c) **Natyrën dhe shtrirjen (p.sh., sasinë, periudhën kohore, ose shumën, sipas rastit) e:**
 - (i) **Të drejtave për të përdorur aktivet e specifikuar;**
 - (ii) **Të drejtave për të pritur që operatori të japë shërbime të specifikuar në lidhje me marrëveshjen e konçesionit të shërbimit;**
 - (iii) **Vlerës së mbartur të aktiveve të konçesionit të shërbimit të njohur në fund të periudhës së raportimi, duke përfshirë aktivet ekzistuese të grantdhënësit të riklasifikuar si aktive të konçesionit të shërbimit;**
 - (iv) **Të drejtave për të marrë aktive të specifikuar në fund të marrëveshjes së konçesionit të shërbimit;**
 - (v) **Opsioneve të rinovimit dhe përfundimit/ndërprerjes;**
 - (vi) **Të drejtave dhe detyrimeve të tjera (p.sh., rishikim i përgjithshëm i aktiveve të konçesionit të shërbimeve); dhe**
 - (vii) **Detyrimeve për t'i dhënë operatorit të drejta në aktivet e konçesionit të shërbimit ose aktivet e tjera që gjenerojnë të ardhura; dhe**
 - (d) **Ndryshimet në marrëveshjet që ndodhin gjatë periudhës së raportimit.**
33. **Informacionet shpjeguese të kërkuara në përputhje me paragrafin 32 jepen individualisht për çdo marrëveshje konçesionare të shërbimit materiale ose të grupuara për marrëveshjet e konçesionit të shërbimeve që përfshijnë shërbime të**

një natyre të ngjashme (p.sh., arkëtimet e tarifave, shërbimet e telekomunikacionit ose të trajtimit të ujit). Ky informacion shpjegues është si shtesë ndaj informacioneve shpjegues të kërkuar në SNKSP 17 dhe/ose SNKSP 31 sipas klasave të aktiveve. Aktivitetet e konçesionit të shërbimit brenda marrëveshjeve të konçesionit të shërbimeve të një natyre të ngjashme që raportohen në tërësi/të grupuara mund të formojnë një nëngrup të një klase aktivesh të paraqitura në përputhje me SNKSP 17 dhe/ose SNKSP 31 ose mund të përfshihen në më shumë se një klasë aktivesh të paraqitura në përputhje me SNKSP 17 dhe/ose SNKSP 31. Për shembull, për qëllimet e SNKSP 17, një urë me pagesë mund të përfshihet në të njëjtën klasë si urat e tjera. Për qëllimet e këtij paragrafi, ura me pagesë mund të përfshihet në marrëveshjet e konçesionit të shërbimit të raportuara në tërësi/të grupuara si rrugë me pagesë.

Dispozita Kalimtare

34. **Grantdhënësi që ka njohur më parë aktivitetet e konçesionit të shërbimit dhe detyrimet, të ardhurat, e shpenzimet përkatëse, do të zbatojë këtë Standard në mënyrë retrospektive në përputhje me SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet.***
35. [Fshirë]
- 35A. Paragrafët 13, 32, 33 dhe AG35 u ndryshuan nga *Përmirësimet e SNKSP-ve 2015* botuar në prill 2016. Një njësi që ka zbatuar më parë SNKSP 32 do të rivlerësojë klasifikimin e aktiveve të konçesionit të shërbimit në përputhje me paragrafin 13. Njësia duhet të prezantojë aktivitetet e konçesionit të shërbimit në klasifikimin e redaktuar në mënyrë retrospektive në përputhje me SNKSP 3.
- 35B. Kur aktivitetet e konçesionit të shërbimit riklasifikohen në përputhje me paragrafin 35A, një njësi do të kontabilizojë aktivitetet e konçesionit të shërbimit si më poshtë:
- (a) Nëse aktivitetet e konçesionit të shërbimit janë matur më parë duke përdorur modelin e kostos, dhe klasa e aktiveve në të cilën janë riklasifikuar ata aktive të konçesionit të shërbimit matet duke përdorur modelin e kostos, njësia do të vazhdojë të zbatojë modelin e kostos. Njësia do të bartë në të ardhmen koston e aktiveve të konçesionit të shërbimit, së bashku me çdo zhvlerësim ose amortizim të akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.
 - (b) Nëse aktivitetet e konçesionit të shërbimit janë matur më parë duke përdorur modelin e kostos dhe klasa e aktiveve në të cilën janë riklasifikuar ata aktive të konçesionit të shërbimit matet duke përdorur modelin e rivlerësimit, njësia ekonomike ose:
 - (i) Rivlerëson aktivitetet e konçesionit të shërbimit; ose
 - (ii) Në varësi të kërkesave në SNKSP 3 që trajtojnë ndryshimet në politikatat e kontabilitetit, zbaton në mënyrë retrospektive modelin e

kostos për aktivet e mbetura në klasën e aktivit në të cilën ata aktive të konçesionit të shërbimit janë riklasifikuar. Kur informacioni rreth kostos së aktiveve nuk është i disponueshëm, njësia mund të përdorë vlerën e mbartur të aktiveve si kosto të supozuar/të përcaktuar.

- (c) Nëse aktivet e konçesionit të shërbimit janë matur më parë duke përdorur modelin e rivlerësimit, dhe klasa e aktiveve në të cilën janë riklasifikuar ata aktive të konçesionit të shërbimit matet duke përdorur modelin e kostos, njësia ekonomike ose:
 - (i) Zbaton në mënyrë retrospektive modelin e kostos për aktivet e konçesionit të shërbimit. Kur informacioni për koston e aktiveve nuk është i disponueshëm, njësia mund të përdorë vlerën e mbartur të aktiveve të konçesionit të shërbimit si kosto të supozuar/të përcaktuar; ose
 - (ii) Në varësi të kërkesave në SNKSP 3 që trajtojnë ndryshimet në politikat e kontabilitetit, rivlerëson aktivet e mbetura në klasën e aktivit në të cilën janë riklasifikuar ato aktive të konçesionit të shërbimit.
- (d) Nëse aktivet e konçesionit të shërbimit janë matur më parë duke përdorur modelin e rivlerësimit, dhe klasa e aktiveve në të cilën janë riklasifikuar ata aktive të konçesionit të shërbimit matet duke përdorur modelin e rivlerësimit, njësia do të rregullojë sufiçitin e rivlerësimit për secilën klasë të aktivit. Kur uljet e mëparshme të rivlerësimit janë njohur për, ose një aktiv të konçesionit të shërbimit, ose një ose më shumë aktive në klasën në të cilën është transferuar aktivi i konçesionit të shërbimit, njësia do të marrë parasysh nëse kërkohen transferime ndërmjet sufiçitit të rivlerësimit dhe sufiçiteve ose defiçiteve të akumuluar.

Data Efektive

- 36. Një njësi do të zbatojë këtë Standard për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2014. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2014, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 5, *Kostot e Huamarrjes*, SNKSP 13, *Kontratat e Qirave*, SNKSP 17, SNKSP 29 dhe SNKSP 31 në të njëjtën kohë.
- 36A. Paragrafët 35 dhe 37 u ndryshuan nga SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara* botuar në janar 2015. Një njësi do t'i zbatojë këto ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2017. Zbatimi i

- mëparshëm lejohet. Nëse një njësi zbaton SNKSP 33 për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2017, ndryshimet do të zbatohen edhe për atë periudhë të mëparshme.
- 36B. Paragrafët 13, 32, 33 dhe AG35 u ndryshuan dhe paragrafët 35A dhe 35B u shtuan nga *Përmirësime të SNKSP-ve 2015* botuar në prill 2016. Një njësi do t'i zbatojë këto ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2017. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2017, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.
- 36C. Paragrafët 3 dhe 4 u fshinë nga *Zbatueshmëria e SNKSP-ve*, botuar në prill 2016. Një njësi do t'i zbatojë ata ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2018. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.
- 36D. Paragrafët 20, 29, AG37, AG45, AG52 dhe AG53 u ndryshuan nga SNKSP 41, i publikuar në gusht 2018. Një njësi do t'i zbatojë këto ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2022. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2022, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe të zbatojë SNKSP 41 në të njëjtën kohë.
37. Kur një njësi adopton SNKSP-të e kontabilitetit sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, siç përkufizohet në SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (SNKSP-të)* për qëllime të raportimit financiar pas kësaj date efektive, ky Standard zbatohet për pasqyrat financiare vjetore të njësisë që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës së adoptimit të SNKSP-ve.

SNKSP 33—MIRATIMI PËR HERË TË PARË I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË KONTABILITETIT TË SEKTORIT PUBLIK (SNKSP) SIPAS TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE TË KONSTATUARA

Historia e SNKSP

Ky version përfshin ndryshime që rezultojnë nga SNKSP-të e botuara deri në 31 janar, 2019.

SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas të Drejtave dhe Detyrimeve të Konstatuara* u publikua në janar 2015.

Që atëherë, SNKSP 33 është ndryshuar nga SNKSP-të e mëposhtme:

- SNKSP 42, *Përfitimet Sociale* (botuar në janar 2019)
- Përmirësime të SNKSP-ve 2018 (botuar në tetor 2018)
- SNKSP 41, *Instrumentet Financiare* (botuar në gusht 2018)
- *SNKSP 40, Kombinimet e Sektorit Publik (botuar në janar 2017)*
- *SNKSP 39, Përfitimet e Punonjësve (botuar në korrik 2016)*
- *Zbatueshmëria e SNKSP-ve (botuar në prill 2016)*
- Përmirësime të SNKSP-ve 2015 (botuar në prill 2016)

Tabela e Paragrafëve të Ndryshuar në SNKSP 33

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
7	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
8	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
36	U Ndryshua	SNKSP 39 Korrik 2016 SNKSP 41 Gusht 2018 SNKSP 42 Janar 2019

MIRATIMI PËR HERË TË PARË I SNKSP

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
39	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Prill 2016
62A	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
62B	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
62C	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
64	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
72	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
78	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018
79	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018
85A	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018
86	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017
102	U Ndryshua	SNKSP 39 Korrik 2016
104	U Ndryshua	SNKSP 39 Korrik 2016
105	U Ndryshua	SNKSP 39 Korrik 2016
106	U Fshi	SNKSP 39 Korrik 2016

MIRATIMI PËR HERË TË PARË I SNKSP

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
107	U Fshi	SNKSP 39 Korrik 2016
Titulli para paragrafit 113	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
113	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
114	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
114A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
115	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
116	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
117	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
118	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
119	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
119A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
119B	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
119C	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
119D	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
120	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
122	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018

MIRATIMI PËR HERË TË PARË I SNKSP

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
122A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
122B	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
122C	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
Titulli para paragrafit 122D	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
122D	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
123	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP- ve Tetor 2018
124	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
129	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017
130	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017
132	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017
Titulli para paragrafit 134A	I Ri	SNKSP 42 Janar 2019
134A	I Ri	SNKSP 42 Janar 2019
134B	I Ri	SNKSP 42 Janar 2019
142	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP- ve Tetor 2018

MIRATIMI PËR HERË TË PARË I SNKSP

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
154A	I Ri	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
154B	I Ri	SNKSP 39 Korrik 2016
154C	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
154D	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
154E	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018
154F	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018
154G	I Ri	SNKSP 42 Janar 2019
IG29	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018
IG35	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018
Titulli para paragrafit IG67	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
IG67	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
IG68	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
IG69	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
IG70	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018

MIRATIMI PËR HERË TË PARË I SNKSP

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
IG71	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
IG74	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
IG91	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018 Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018 SNKSP 42 Janar 2019
Shtojca	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018

Janar 2015

**SNKSP 33— MIRATIMI PËR HERË TË PARË I STANDARDEVE
NDËRKOMBËTARE TË KONTABILITETIT TË SEKTORIT
PUBLIK (SNKSP) SIPAS TË DREJTAVE DHE DETYRIMEVE TË
KONSTATUARA**

PËRMBAJTJA

	Paragrafi
Objektivi	1
Objekti	2–8
Përkufizime	9–14
Data e Miratimit Fillestar të SNKSP-ve	10
Pasqyrat e Para Financiare sipas SNKSP-ve.....	11
Baza e Mëparshme Kontabël	12
Pasqyrat Financiare Kalimtare të SNKSP-ve.....	13–14
Njohja dhe Matja	15–22
Deklarimi Fillestar i Pozicionit Financiar në Momentin e Miratimit të SNKSP-ve.....	15
Politikat Kontabël	16–22
Përgjashtimet nga Zbatimi Retrospektiv i SNKSP-ve	23–26
Paraqitja e Drejtë dhe Përputhshmëria me SNKSP-të	27–32
Përgjashtimet që Ndikojnë në Paraqitjen e Drejtë dhe Përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të Drejtave dhe Detyrimeve të Konstatuara gjatë Periudhës Kalimtare	33–62
Periudha Trevjeçare e Lehtësimit Kalimtar për Njohjen dhe/ose Matjen e Aktiveve dhe/ose e Detyrimeve	36–62
Përgjashtimet që Nuk Ndikojnë në Paraqitjen e Drejtë dhe Përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të Drejtave dhe Detyrimeve të Konstatuara gjatë Periudhës së Zbatimit	63–134
Përdorimi i Kostos së Supozuar për të Matur Aktivet dhe/ose Detyrimet.....	64–70
Përdorimi i Kostos së Supozuar për të Matur Aktivet e Marra Nëpërmjet një Transaksioni pa Këmbim.....	71
Përdorimi i Kostos së Supozuar për Investime në Njësi të Kontrolluara, Sipërmarrjet e Përbashkëta dhe Shoqëritë (SNKSP 34)	72–73
Data në të Cilën Kostoja e Supozuar Mund të Përcaktohet	74–76

MIRATIMI PËR HERË TË PARË I SNKSP

SNKSP 1, Paraqitja e Pasqyrave Financiare	77–84
SNKSP 4, Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit në Monedhë të Huaj	85–87
SNKSP 5, Kostot e Huamarrjes	88–90
SNKSP 10, Raportimi Financiar në Ekonomitë Hiperinflacionare.....	91–94
SNKSP 13, Kontratat e Qirave	95–96
SNKSP 18, Raportimi i Segmenteve	97
SNKSP 21, Zhvlerësimi i Aktiveve që nuk Gjenerojnë Mjete Monetare	98–100
SNKSP 25, Përfitimet e Punonjësve	101–107
SNKSP 26, Zhvlerësimi i Aktiveve që Gjenerojnë Mjete Monetare	108–110
SNKSP 28, Instrumentet Financiare: Paraqitja.....	111–112
SNKSP 29, Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja	113–122
SNKSP 30, Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese.....	123–124
SNKSP 31, Aktivet Afatgjatë Jomateriale	125–126
SNKSP 32, Marrëveshjet Konçesionare të Shërbimit.....	127–128
SNKSP 34, Pasqyrat Financiare të Veçanta, SNKSP 35, Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe SNKSP 36, Investime në Shoqëri dhe Sipërmarrje të Përbashkëta	129–130
SNKSP 35, Pasqyrat Financiare të Konsoliduara	131
SNKSP 37, Marrëveshjet e Përbashkëta	132–134
Dhënia e Informacioneve Shpjeguese.....	135–152
Shpjegimi i Periudhës Kalimtare në SNKSP	141
Rakordime	142–147
Dhënia e Informacioneve Shpjegues Ku Kostoja e Supozuar Përdoret për Inventarin, Pronat e Investuara, Ndërtesat, Makineritë dhe Pajisjet, Aktivet Afatgjatë Jomateriale, Instrumentet Financiare ose Aktivet Konçesionare të Shërbimit	148
Dhënia e Informacioneve Shpjegues Ku Përdoret Kostoja e Supozuar për Investime në Njësitë e Kontrolluara, Sipërmarrjet e Përbashkëta ose Shoqëritë	149–150
Përfundimet nga Kërkesat për Dhënie Informacioni Shpjegues sipas SNKSP-ve gjatë Periudhës Kalimtare	151–152
Dispozita Kalimtare	153
Data Efektive	154

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas të Drejtave dhe Detyrimeve të Konstatuara* është përcaktuar në paragrafët 1–154. Të gjithë paragrafët kanë autoritet të barabartë. SNKSP 33 duhet lexuar në kontekstin e objektivit të tij, Bazës për Konkluzione, *Parathënies së Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar me Qëllim të Përgjithshëm nga Njësitë e Sektorit Publik..* SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet* jep një bazë për zgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabël në mungesë të udhëzimeve të qarta.

Objektivi

1. Objektivi i këtij Standardi është të japë udhëzime për një zbatues për herë të parë që pregatit dhe paraqet pasqyrat financiare pas zbatimit të SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në mënyrë që të paraqesin informacion me cilësi të lartë:
 - (a) Kjo siguron raportim transparent për kalimin e një zbatuesi për herë të parë në SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara;
 - (b) Kjo jep një pikënisje të përshtatshme për kontabilitetin sipas SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, pavarësisht nga baza e kontabilitetit që zbatuesi për herë të parë ka përdorur përpara datës së zbatimit; dhe
 - (c) Aty ku përfitimet pritet të tejkalojnë kostot.

Objekti

2. **Një njësi do të zbatojë këtë SNKSP kur pregatit dhe paraqet pasqyrat e saj financiare vjetore në momentin e miratimit fillestar dhe gjatë kalimit në SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.**
3. Ky SNKSP zbatohet kur një njësi miraton fillimisht SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe gjatë periudhës kalimtare të lejuar në këtë SNKSP. Ai nuk zbatohet për shembull, kur një zbatues për herë të parë:
 - (a) Ndalon paraqitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e përcaktuara, pasi i ka paraqitur më parë ato si edhe një grup tjetër të pasqyrave financiare që përmbanin një deklaratë të qartë dhe të paz rezervuar të përputhshmërisë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara;
 - (b) Paraqet pasqyrat financiare në periudhën e mëparshme të raportimit në përputhje me kërkesat e rekomanduara dhe ato pasqyra financiare përmbanin një deklaratë të qartë dhe të paz rezervuar të përputhshmërisë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara; ose
 - (c) Paraqet pasqyrat financiare në periudhën e mëparshme të raportimit që përmbanin një deklaratë të qartë dhe të paz rezervuar të përputhshmërisë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, edhe nëse audituesit kanë dhënë një opinion të modifikuan raportin e tyre të auditimit për ato pasqyra financiare.
4. Ky Standard do të zbatohet nga data në të cilën një zbatues për herë të parë zbaton SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe gjatë periudhës kalimtare. Ky standard lejon një zbatues për herë të parë të zbatojë përjashtime dhe dispozita kalimtare që mund të ndikojnë në paraqitjen e drejtë.

Aty ku zbatohen këto përjashtime dhe dispozita kalimtare, një zbatuesi për herë të parë i kërkohet të japë informacione për përjashtimet dhe dispozitat kalimtare të zbatuara, si dhe progresin drejt prezantimit të drejtë dhe përputhshmërisë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

5. Në fund të periudhës kalimtare, një zbatues për herë të parë duhet të jetë në përputhshmëri me kërkesat e njohjes, matjes, paraqitjes dhe dhënies së informacioneve shpjegues në SNKSP-të e tjera sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në mënyrë që të pohohet përputhshmëria me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara siç kërkohet në SNKSP 1, *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*.
6. Ky SNKSP nuk zbatohet për ndryshimet në politikat kontabël të bëra nga një njësi që tashmë zbaton SNKSP-të. Ndryshime të tilla janë subjekt i:
 - (a) Kërkesave për ndryshimet në politikat kontabël në SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*; dhe
 - (b) Kërkesave specifike kalimtare në SNKSP-të e tjera. Dispozitat kalimtare në SNKSP-të e tjera zbatohen vetëm për ndryshimet në politikat kontabël të bëra nga një njësi që tashmë zbaton SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara; ato nuk zbatohen për kalimin e një zbatuesi për herë të parë tek SNKSP-të, përveç siç specifikohet në këtë SNKSP.
7. [Fshirë]
8. [Fshirë]

Përkufizime

9. Termat e mëposhtëm përdoren në këtë standard me kuptimet e specifikuar:

Data e miratimit të SNKSP-ve është data kur një njësi zbaton SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara për herë të parë dhe është fillimi i periudhës së raportimit në të cilën zbatuesi për herë të parë zbaton SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe për të cilën njësitia ekonomike paraqet pasqyrat e saj të para kalimtare financiare sipas SNKSP-ve ose pasqyrat e para financiare sipas SNKSP.

Kostoja e supozuar është një shumë e përdorur si një zëvendësim për koston e blerjes ose koston e amortizuar në një datë të caktuar.

Pasqyrat e para financiare sipas SNKSP-ve janë pasqyrat e para vjetore financiare në të cilat një njësi i përmbahet SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe mund të bëjë një deklaratë të qartë dhe të parrezervuar të përputhshmërisë me ato SNKSP, sepse ka zbatuar një ose më shumë nga përjashtimet kalimtare në këtë SNKSP që nuk ndikojnë në prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare dhe aftësinë e saj për të pohuar përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Zbatuesi për herë të parë është një njësi që zbaton për herë të parë SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe paraqet pasqyrat financiare të para kalimtare sipas SNKSP-ve ose pasqyrat e para financiare sipas SNKSP-ve.

Deklarimi fillestar i pozicionit financiar është deklarimi i pozicionit financiar të zbatuesit për herë të parë në datën e zbatimit të SNKSP-ve.

Periudha kalimtare është periudha gjatë së cilës një zbatues për herë të parë zbaton një ose më shumë nga përjashtimet në këtë SNKSP përpara se të jetë në përputhshmëri me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, dhe përpara se të jetë në gjendje të bëjë një deklaratë të qartë dhe të parezervuar për një përputhshmëri të tillë me SNKSP-të.

Baza e mëparshme kontabël është baza e kontabilitetit që një zbatues për herë të parë përdorte përpara se të zbatonte SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Pasqyrat financiare kalimtare sipas SNKSP janë pasqyrat financiare të pregatitura në përputhje me këtë SNKSP ku një zbatues për herë të parë nuk mund të bëjë një deklaratë të qartë dhe të parezervuar të përputhshmërisë me SNKSP të tjera, sepse ai ka zbatuar një ose më shumë nga përjashtimet kalimtare në këtë SNKSP që ndikojnë në paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare dhe aftësinë e tij për të pohuar përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Termat e përkufizuar në SNKSP-të e tjera përdoren në këtë Standard me të njëjtin kuptim si në ato Standarde dhe riprodhohen në *Fjalorin e Termave të Përkufizuar* të botuar veçmas.

Data e Miratimit të SNKSP-ve

10. Data e miratimit të SNKSP-ve është data që një njësi zbaton SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara për herë të parë. Ajo është fillimi i periudhës së raportimit në të cilën zbatuesi për herë të parë zbaton SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe për të cilën ai paraqet pasqyrat e tij financiare të para kalimtare sipas SNKSP-ve ose pasqyrat e tij të para financiare sipas SNKSP-ve. Nëse një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimet në këtë SNKSP që ndikojnë në prezantimin e drejtë dhe përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (shih paragrafët 36–62) në prodhimin e pasqyrave të tij financiare të para kalimtare sipas SNKSP-ve, ai mund të bëjë vetëm një deklaratë të qartë dhe të parezervuar të përputhshmërisë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara kur përjashtimet që dhanë lehtësimin të kenë skaduar dhe/ose kur zërat përkatës të njihen, maten dhe/ose informacioni përkatës të paraqitet dhe/ose shoqërohet me shënime shpjeguese në pasqyrat financiare në përputhje me SNKSP-të e zbatueshëm (cilado të jetë më herët). Pasqyrat financiare nuk do

të përshkruhen si në përputhje me SNKSP-të, përveç nëse ato janë në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e të gjithë SNKSP-ve të zbatueshëm.

Pasqyrat e Para Financiare sipas SNKSP

11. Pasqyrat e para financiare të një njësie sipas SNKSP janë pasqyrat e para financiare vjetore në të cilat zbatuesi për herë të parë mund të bëjë një deklaratë të qartë dhe të pazezruar në ato pasqyra financiare të përputhshmërisë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Nëse një zbatues për herë të parë nuk zbaton përjashtimet në këtë SNKSP që ndikojnë në prezantimin e drejtë dhe përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (shih paragrafët 36–62), pasqyrat e tij të para financiare pas zbatimit të SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara do të jenë gjithashtu pasqyrat e tij të para financiare sipas SNKSP-ve.

Baza e Mëparshme Kontabël

12. Baza e mëparshme e kontabilitetit është baza kontabël që një zbatues për herë të parë ka përdorur përpara se të zbatonte SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Kjo mund të jetë kontabiliteti sipas arkëtimeve dhe pagesave, kontabiliteti sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, një version i modifikuar i këtyre të dyja, ose një baze tjetër e rekomanduar.

Pasqyrat Financiare Kalimtare sipas SNKSP

13. Pasqyrat financiare kalimtare sipas SNKSP-ve të një njësie janë pasqyrat financiare vjetore në të cilat një njësi ekonomike kalon në SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe zbaton disa përjashtime në këtë SNKSP që ndikon në paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare dhe aftësinë e saj për të pohuar përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Nëse një zbatues për herë të parë zbaton përjashtimet në këtë SNKSP që ndikojnë në paraqitjen e drejtë dhe përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (shih paragrafët 36-62), ai nuk do të jetë në gjendje të bëjë një deklaratë të qartë dhe të pazezruar të përputhshmërisë me SNKSP-të e tjera sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara derisa përjashtimet që dhanë lehtësimin në këtë SNKSP të kenë skaduar dhe/ose kur zërat përkatës të njihen, maten dhe/ose informacioni përkatës të jetë paraqitur dhe/ose shoqëruar me shënime shpjeguese në përputhje me SNKSP-të e zbatueshëm (cilado të jetë më herët). Pasqyrat financiare nuk do të përshkruhen si në përputhje me SNKSP-të, përveç nëse ato përputhen me të gjitha kërkesat e të gjithë SNKSP-ve të zbatueshëm.
14. Pasqyrat financiare kalimtare sipas SNKSP-ve të një njësie janë ato pasqyra financiare, ku njësia kalon nga një bazë tjetër e kontabilitetit, si p.sh. Kur njësia:
 - (a) Ka pregatitur pasqyrat e mëparshme financiare më të fundit në përputhje me SNKSP, *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Arkëtimeve dhe Pagesave*;

- (b) Ka paraqitur pasqyrat e mëparshme financiare më të fundit:
 - (i) Sipas kërkesave të rekomanduara që nuk janë në përputhje me SNKSP-të në të gjitha aspektet;
 - (ii) Konform SNKSP-ve në të gjithë aspektet, por pasqyrat financiare nuk përmbajtën një deklaratë të qartë dhe të parazervuar se ato janë në përputhje me SNKSP-të;
 - (iii) Që përmbajnë një deklaratë të qartë përputhshmërie me disa, por jo të gjitha, SNKSP-të, duke përfshirë zbatimin e përjashtimeve të dhëna në këtë SNKSP që ndikojnë në paraqitjen e drejtë dhe përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (shih paragrafët 36–62);
 - (iv) Sipas kërkesave të rekomanduara në kundërshtim me SNKSP-të, duke përdorur disa SNKSP individuale për të kontabilizuar artikujt për të cilët kërkesat e rekomanduara nuk ekzistonin; ose
 - (v) Sipas kërkesave të rekomanduara, me një rakordim të disa shumave me shumat e përcaktuara në përputhje me SNKSP-të;
- (c) Ka përgatitur pasqyrat financiare në përputhje me SNKSP-të vetëm për përdorim të brendshëm, pa i vënë ato në dispozicion të përdoruesve të jashtëm;
- (d) Ka përgatitur një paketë raportimi në përputhje me SNKSP-të për qëllime konsolidimi pa përgatitur një grup të plotë të pasqyrave financiare siç përcaktohet në SNKSP 1; ose
- (e) Nuk ka paraqitur pasqyra financiare për periudhat e mëparshme.

Njohja dhe Matja

Deklarimi Fillestar i Pozicionit Financiar në Momentin e Zbatimit të SNKSP-ve

15. Një zbatues për herë të parë do të përgatisë dhe paraqesë një deklaram fillestar të pozicionit financiar në datën e zbatimit të SNKSP-ve. Kjo është pika fillestare për kontabilitetin e tij në përputhje me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Politikat Kontabël

16. Në datën e zbatimit të SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, një zbatues për herë të parë do të zbatojë kërkesat e SNKSP-ve në mënyrë retrospektive, përveç nëse kërkohet, ose ndryshe lejohet, në këtë SNKSP.
17. Një zbatues për herë të parë do të përdorë të njëjtat politika kontabël në deklaramin e tij fillestar të pozicionit financiar dhe gjatë të gjitha periudhave të paraqitura, përveç siç specifikohet në paragrafët 36-134. Politikat kontabël duhet të jenë në përputhje me çdo SNKSP që është në

fuqi në datën e zbatimit të SNKSP-ve, përveç siç specifikohet në paragrafët 36-134.

18. Një zbatuesi për herë të parë që përfiton nga përjashtimet në paragrafin 36-134 do t'i kërkohet të ndryshojë politikat e tij kontabël pasi të kenë skaduar përjashtimet që dhanë lehtësimin dhe/ose kur elementet përkatës të njihen, maten dhe/ose informacioni përkatës të paraqitet dhe/ose shoqërohet me shënime shpjeguese në pasqyrat financiare në përputhje me SNKSP-të e zbatueshëm (cilado të jetë më herët).
19. Një zbatues për herë të parë do të zbatojë versionet e SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara në fuqi në datën e zbatimit të SNKSP-ve. Një zbatues për herë të parë mund të zbatojë një SNKSP të ri që nuk është ende i detyrueshëm nëse ai SNKSP lejon zbatimin herët. Çdo SNKSP i ri që hyn në fuqi gjatë periudhës kalimtare do të zbatohet nga zbatuesi për herë të parë nga data kur hyn në fuqi.
20. Përveç siç përshkruhet në paragrafët 36-134, një zbatues për herë të parë, në deklaratën e tij fillestare të pozicionit financiar do të:
 - (a) Njohë të gjithë aktivet dhe detyrimet, njohja e të cilëve kërkohet nga SNKSP-të;
 - (b) Nuk do të njohë zëra si aktive ose detyrime nëse SNKSP-të nuk e lejojnë një njohje të tillë;
 - (c) Riklasifikojë zërat që ka njohur në përputhje me bazën e mëparshme të kontabilitetit si një lloj aktivi, detyrimi ose komponenti të aktiveve/kapitalit neto, por janë një lloj tjetër aktivi, detyrimi ose përbërës i aktiveve/kapitalit neto në përputhje me SNKSP-të; dhe
 - (d) Zbatojë SNKSP-të në matjen e të gjithë aktiveve dhe detyrimeve të njohura.
21. Politikat kontabël që një zbatues për herë të parë përdor në pasqyrat financiare mund të ndryshojnë nga ato që ai përdori në fund të periudhës së tij krahasuese sipas bazës së tij të mëparshme të kontabilitetit. Rregullimet që rezultojnë nga transaksione, ngjarje të tjera ose kushte përpara datës së zbatimit të SNKSP-ve. Prandaj, një zbatues për herë të parë do të njohë këta rregullime në tepicën e çeljes të sufiçitit ose defiçitit të akumuluar në periudhën në të cilën artikujt njihen dhe/ose maten (ose, nëse është e përshtatshme, një kategori tjetër aktivesh/kapitali neto). Zbatuesi për herë të parë do t'i njohë këta rregullime në periudhën më të hershme të paraqitur.
22. Përjashtimet dhe dispozitat kalimtare në SNKSP-të e tjera zbatohen për ndryshimet në politikat kontabël të bërë nga një njësi që tashmë zbaton SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Përjashtimet dhe dispozitat kalimtare në këtë SNKSP zbatohen për një zbatues për herë të parë i cili përgatit dhe paraqet pasqyrat e tij financiare vjetore në momentin e zbatimit, dhe gjatë

kalimit në SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Përfshajtjet nga Zbatimi Retrospektiv i SNKSP-ve

23. **Vlerësimet e një zbatuesi për herë të parë në përputhje me SNKSP-të në datën e zbatimit të SNKSP-ve, do të jenë të qëndrueshme me vlerësimet e bëra në përputhje me bazën e mëparshme të kontabilitetit (pas rregullimeve për të pasqyruar ndonjë ndryshim në politikat kontabël), përveç nëse ka evidencë objektive që ata vlerësime nuk ishin në përputhje me kërkesat e SNKSP-ve.**
24. Ky SNKSP ndalon zbatimin retrospektiv të disa aspekteve të SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Një zbatues për herë të parë mund të marrë informacion pas datës së zbatimit të SNKSP-ve për vlerësimet që ai kishte bërë sipas bazës së tij të mëparshme të kontabilitetit. Në përputhje me paragrafin 23, një zbatues për herë të parë do ta trajtojë marrjen e atij informacioni në të njëjtën mënyrë si ngjarjet jorregulluese pas periudhës së raportimit në përputhje me SNKSP 14, *Ngjarjet pas Periudhës së Raportimit*.
25. Një zbatues për herë të parë mund të ketë nevojë të bëjë vlerësime në përputhje me SNKSP-të në datën e zbatimit të SNKSP-ve ose gjatë periudhës kalimtare që nuk kërkoheshin në atë datë sipas bazës së mëparshme të kontabilitetit. Për të arritur përputhshmërinë me SNKSP 14, këta vlerësime në përputhje me SNKSP-të do të pasqyrojnë kushtet që kanë ekzistuar në datën e zbatimit të SNKSP-ve ose në datën gjatë periudhës kalimtare. Në veçanti, vlerësimet e përcaktuara në datën e zbatimit të SNKSP-ve ose gjatë periudhës kalimtare të çmimeve të tregut, normave të interesit ose kursit të këmbimit valutor duhet të pasqyrojnë kushtet e tregut në atë datë. Për aktivet jofinanciare, të tillë si ndërtesat, makineritë dhe pajisjet, vlerësimet për jetën e dobishme, vlerën e mbetur ose gjendjen e aktivitet pasqyrojnë pritshmëritë dhe gjykimin e drejtuesve në datën e zbatimit të SNKSP-ve ose datën gjatë periudhës kalimtare.
26. Paragrafët 23-25 zbatohen për deklarimin fillestar të pozicionit financiar. Ata zbatohen gjithashtu për një periudhë krahasuese ku një njësi zgjedh të paraqesë informacion krahasues në përputhje me paragrafin 78, në të cilin rast referencat në datën e zbatimit të SNKSP-ve zëvendësohen me referenca në fund të asaj periudhe krahasuese.

Paraqitja e Drejtë dhe Përputhshmëria me SNKSP-të

27. **Pasqyrat e para financiare sipas SNKSP të një zbatuesi për herë të parë do të paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar, performancën financiare, dhe flukset monetare të njësisë. Paraqitja e drejtë kërkon përfaqësimin besnik të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve të tjera, dhe kushteve në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet, detyrimet, të ardhurat, dhe shpenzimet e përcaktuara në SNKSP-të. Nëse një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimet në paragrafët 36-62, këta përjashtime do të ndikojnë në paraqitjen e drejtë të pasqyrave**

financiare dhe aftësinë e zbatuesit për herë të parë për të pohuar përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, derisa përjashtimet që dhanë lehtësimin të kenë skaduar dhe/ose kur zërat përkatës të njihen dhe/ose maten në përputhje me SNKSP-në e zbatueshëm (cilado të jetë më herët).

28. Një zbatues për herë të parë do të pretendojë përputhshmëri të plotë me SNKSP-të vetëm kur ai ka përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP-ve të zbatueshme në fuqi në atë datë, në varësi të paragrafit 11. Nëse një zbatues për herë të parë zbaton një ose më shumë nga përjashtimet në paragrafin 36–62, do të ndikohet paraqitja e drejtë i pasqyrave financiare dhe aftësia e tij për të pohuar përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Një njësi, pasqyrat financiare të së cilës përputhen me SNKSP-të, do të bëjë një deklaratë të qartë dhe pa rezerva për këtë përputhshmëri në shënime. Pasqyrat financiare nuk do të përshkruhen si në përputhje me SNKSP-të, përveç rasteve kur ato janë në përputhje me të gjitha kërkesat e SNKSP-ve, dhe do të kualifikohen si pasqyra financiare të ankesave sipas SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.
29. Në përputhje me paragrafin 29 të SNKSP 1, paraqitja e drejtë arrihet pothuajse në të gjitha rrethanat në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme. Që një zbatues për herë të parë të pretendojë përputhshmëri të plotë me SNKSP-të, duhet të respektohen të gjitha kërkesat e SNKSP-ve të zbatueshme për të siguruar që informacioni të paraqitet në një mënyrë që plotëson karakteristikat cilësore, subjekt i paragrafit 11.
30. Përjashtimet në paragrafët 36–62 ofrojnë lehtësim nga kërkesat e njohjes, matjes, paraqitjes dhe/ose dhënies së informacioneve në SNKSP në datën e zbatimit të SNKSP-ve dhe gjatë periudhës kalimtare. Një zbatues për herë të parë mund të zgjedhë të zbatojë këta përjashtime, por do të konsiderojë se zbatimi i këtyre përjashtimeve do të ndikojë në paraqitjen e drejtë të pasqyrave të tij financiare dhe aftësinë e tij për të pohuar përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara në përputhje me paragrafët 27 dhe 28 derisa përjashtimet që dhanë lehtësimin të kenë skaduar dhe/ose kur elementet përkatës të njihen, maten dhe/ose informacioni përkatës të paraqitet dhe/ose shoqërohet me shënime shpjeguese në pasqyrat financiare në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme (cilado të jetë më herët). Përpara se të përdorë këta përjashtime, një zbatues për herë të parë do të marrë në konsideratë të gjithë faktet dhe rrethanat përkatëse dhe efektin e mundshëm në pasqyrat e tij financiare.
31. Një zbatues për herë të parë do të vlerësojë nëse përjashtimet kalimtare të zbatuara ndikojnë në paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare dhe aftësinë e zbatuesit për herë të parë për të pohuar përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

32. Për shembull, një zbatues për herë të parë zbaton periudhën trevjeçare të lehtësimit kalimtar për njohjen dhe matjen e gjobave të trafikut sepse nuk disponohen të dhëna të mjaftueshme për vlerën e gjobave të vëna, gjobave të zeruara, kompromiset e arritura me shkelësit etj. Periudha e lehtësimit nuk zbatohet për asnjë klasë tjetër të të ardhurave pa këmbim. Të ardhurat e marra nga gjobat nuk janë materiale në lidhje me pasqyrat financiare në tërësi. Njësia arrin në përfundimin se, duke zbatuar përjashtimin dhe dispozitat kalimtare, paraqitja e drejtë dhe përputhshmëria me SNKSP-të nuk do të ndikohet. Si rezultat, zbatuesi për herë të parë do të jetë ende në gjendje të arrijë paraqitjen e drejtë dhe të pohojë përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara në datën e zbatimit të SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara ose gjatë periudhës kalimtare.

Përjashtimet që Ndikojnë në Paraqitjen e Drejtë dhe Përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të Drejtave dhe Detyrimeve të Konstatuara gjatë Periudhës Kalimtare

33. **Një zbatues për herë të parë mund të zbatojë përjashtimet në paragrafët 36-62. Këta përjashtime do të ndikojnë në paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të një zbatuesi për herë të parë dhe aftësinë e tij për të pohuar përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara gjatë periudhës kalimtare në përputhje me paragrafët 27 dhe 28 ndërsa ata zbatohen. Një zbatues për herë të parë nuk do t'i zbatojë këta përjashtime sipas analogjisë për artikujt e tjerë.**
34. **Pavarësisht nga përjashtimet e dhëna në paragrafët 36-62, një zbatues për herë të parë inkurajohet të përmbushë plotësisht të gjitha kërkesat e SNKSP-ve të zbatueshme sa më shpejt të jetë e mundur.**
35. **Në masën që një zbatues për herë të parë zbaton përjashtimet në paragrafin 36-62, atij nuk i kërkohet të zbatojë ndonjë kërkesë shoqëruese të paraqitjes dhe/ose dhënies së informacioneve në SNKSP-të e zbatueshme derisa përjashtimet që dhanë lehtësimin të kenë skaduar ose zërat përkatës të jenë njohur dhe/ose matur në pasqyrat financiare në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme (cilado të jetë më herët).**

Periudha Trevjeçare e Lehtësirave Kalimtare për Njohjen dhe/ose Matjen e Aktiveve dhe/ose Detyrimeve

Njohja dhe/ose Matja e Aktiveve dhe/ose e Detyrimeve

36. **Kur një zbatues për herë të parë nuk ka njohur aktive dhe/ose detyrime sipas bazës së tij të mëparshme të kontabilitetit, atij nuk i kërkohet të njohë dhe/ose të masë aktivet dhe/ose detyrimet e mëposhtëm për periudhat e raportimit që fillojnë në një datë brenda tre viteve pas datës së zbatimit të SNKSP-ve:**

- (a) **Inventarët (shih SNKSP 12, *Inventarët*);**
 - (b) **Pronat e investuara (shih SNKSP 16, *Prona të Investuara*);**
 - (c) **Ndërtesat, Makineritë dhe Pajisjet (shih SNKSP 17, *Ndërtesa, Makineri dhe Pajisje*);**
 - (d) **Planet me përfitime të përcaktuara dhe përfitimet e tjera afatgjata të punonjësve (shih SNKSP 39, *Përfitimet e Punonjësve*);**
 - (e) **Aktivitet biologjikë dhe prodhimet bujqësore (shih SNKSP 27, *Bujqësia*);**
 - (f) **Aktivitet Afatgjatë jomateriale (shih SNKSP 31,); *Aktivitet Afatgjatë Jomateriale*);**
 - (g) **Aktivitet e konçesionit të shërbimit dhe detyrimet e lidhura me ta, qoftë sipas modelit të detyrimit financiar ose modelit të dhënies së një të drejte ndaj operatorit (shih SNKSP 32, *Marrëveshjet Konçesionare të Shërbimit: Grantdhënësi*);**
 - (h) **Instrumentet financiare (shih SNKSP 41, *Instrumentet Financiare*); dhe**
 - (i) **Përfitimet sociale (shih SNKSP 42, *Përfitimet Sociale*).**
37. **Kur një zbatues për herë të parë zbaton përjashtimin në paragrafin 36(d), ai do të njohë detyrimin dhe çdo aktiv të planit të shoqëruar në të njëjtën kohë.**
38. **Kur një zbatues për herë të parë ka njohur aktivitet dhe/ose detyrimet e përfshira në paragrafin 36 sipas bazës së tij të mëparshme të kontabilitetit, atij nuk i kërkohet që të ndryshojë politikën(at) e tij kontabël në lidhje me matjen e këtyre aktiveve dhe/ose detyrimeve për periudhat e raportimit që fillojnë në një datë brenda tre viteve pas datës së zbatimit të SNKSP-ve.**
39. Në varësi të paragrafëve 36 dhe 38, një zbatuesi për herë të parë nuk i kërkohet të ndryshojë politikën(at) e tij kontabël në lidhje me njohjen dhe/ose matjen e aktiveve dhe/ose detyrimeve për periudhat e raportimit që fillojnë në një datë brenda tre viteve pas datës së zbatimit të SNKSP-ve. Përjashtimet kalimtare në paragrafët 36 dhe 38 synojnë t'i lejojnë një zbatuesi për herë të parë një periudhë për të zhvilluar modele të besueshme për njohjen dhe/ose matjen e aktiveve dhe/ose detyrimeve të tij gjatë periudhës kalimtare. Zbatuesi për herë të parë mund të zbatojë politika kontabël për njohjen dhe/ose matjen e aktiveve dhe/ose detyrimeve të tilla që nuk përputhen me dispozitat e SNKSP-ve të tjera.
40. **Subjekt i dispozitave të paragrafëve 36 dhe 38, një zbatues për herë të parë do të ndryshojë politikën e tij kontabël vetëm gjatë periudhës kalimtare për t'u përshtatur më mirë me politikën kontabël në SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, dhe mund të mbajë politikën e tij ekzistuese**

kontabël derisa përjashtimet që japin lehtësi të skadojnë ose kur artikujt përkatës të njihen dhe/ose maten në pasqyrat financiare në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme (cilado të jetë më herët). Një zbatues për herë të parë mund të ndryshojë politikën e tij kontabël në lidhje me njohjen dhe/ose matjen e aktiveve dhe/ose detyrimeve sipas klasës ose sipas kategorisë kur përdorimi i klasave ose kategorive lejohet në SNKSP-në e zbatueshëm.

41. Në masën që një zbatues për herë të parë zbaton përjashtimet në paragrafët 36 dhe 38 të cilat lejojnë një periudhë trevjeçare lehtësimi për të mos njohur dhe/ose matur aktivet financiare, atij nuk i kërkohet të njohë dhe/ose të masë ndonjë të ardhur të lidhur me ta sipas SNKSP 9, *Të Ardhurat nga Transaksionet me Këmbim*, ose llogari të arkëtueshme të tjera të shlyera në mjete monetare ose në një aktiv tjetër financiar sipas SNKSP 23, *Të Ardhurat nga Transaksionet pa Këmbim (Taksat dhe Transfertat)*.

Njohja dhe/ose Matja e të Ardhurave pa Këmbim

42. Një zbatuesi për herë të parë nuk i kërkohet të ndryshojë politikën e tij kontabël në lidhje me njohjen dhe matjen e të ardhurave pa këmbim për periudhat e raportimit që fillojnë në një datë brenda tre viteve pas datës së zbatimit të SNKSP-ve. Një zbatues për herë të parë mund të ndryshojë politikën e tij kontabël në lidhje me të ardhurat nga transaksionet pa këmbim sipas klasave.
43. Dispozita kalimtare në paragrafin 42 synon t'i lejojë një zbatuesi për herë të parë një periudhë për të zhvilluar modele të besueshme për njohjen dhe matjen e të ardhurave nga transaksionet pa këmbim në përputhje me SNKSP 23, *Të Ardhurat nga Transaksionet pa Këmbim (Taksat dhe Transfertat)* gjatë periudhës kalimtare. Zbatuesi për herë të parë mund të zbatojë politika kontabël për njohjen dhe/ose matjen e të ardhurave nga transaksionet pa këmbim që nuk përputhen me dispozitat e SNKSP 23. Dispozita kalimtare në paragrafin 42 lejon një zbatues për herë të parë të zbatojë SNKSP 23 në mënyrë rritëse në klasa të ndryshme të të ardhurave nga transaksionet pa këmbim. Për shembull, një zbatues për herë të parë mund të jetë në gjendje të njohë dhe të masë taksat e pronës dhe disa klasa të tjera transferimesh në përputhje me SNKSP 23 nga data e zbatimit të SNKSP-ve, por mund të duhen tre vite për të zhvilluar plotësisht një model të besueshëm për njohjen dhe matjen e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat.

Përjashtime të Tjerë

SNKSP 5, Kostot e Huamarrjes

44. Kur një zbatues për herë të parë zbaton përjashtimin në paragrafin 36, i cili lejon një periudhë trevjeçare lehtësimi për të mos njohur dhe/ose matur aktivet, dhe zgjedh të kontabilizojë kostot e huamarrjes në termat e

trajtimin alternativ të lejuar, nuk kërkohet të kapitalizohet ndonjë kosto huamarrjeje për aktivet kualifikuese për të cilat data e fillimit të kapitalizimit është para datës së zbatimit të SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, derisa përjashtimi që dha lehtësimin të ketë skaduar dhe/ose kur aktivet përkatëse të njihen dhe/ose maten në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme (cilado të jetë më herët).

45. Paragrafi 36 lejon një zbatues për herë të parë të mos njihë dhe/ose masë aktivet në përputhje me SNKSP 16, 17, 27, 31 dhe 32 për një periudhë deri në tre vjet nga data e zbatimit të SNKSP-ve. Gjatë kësaj periudhe, një zbatues për herë të parë mund t'i duhet të marrë në konsideratë kërkesat e atyre SNKSP-ve në të njëjtën kohë me kapitalizimin e kostove të huamarrjes kur ai zbaton metodën alternative të lejuar. Kur një zbatues për herë të parë përfiton nga periudha e përjashtimit kalimtar për njohjen dhe/ose matjen e aktiveve në përputhje me SNKSP 16, 17, 27, 31 dhe 32, atij nuk i kërkohet të kapitalizojë kostot e huamarrjes të krijuara për aktivet kualifikuese para, ose gjatë periudhës kalimtare. Vetëm kur përjashtimet që dhanë lehtësimin të kenë skaduar dhe/ose kur aktivet përkatëse të njihen dhe/ose maten në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme (cilado të jetë më herët) do t'i lejohet një zbatuesi për herë të parë të kapitalizojë kostot e huamarrjes të krijuara për aktivet kualifikuese në përputhje me trajtimin alternativ të lejuar.

SNKSP 13, Kontratat e Qirave

46. **Kur një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimi në paragrafin 36, i cili lejon një periudhë trevjeçare të lehtësimeve kalimtare për të mos njohur aktivet, atij nuk i kërkohet të zbatojë kërkesat që lidhen me qiratë financiare derisa të ketë skaduar përjashtimi që ka dhënë lehtësimin, dhe /ose kur aktivet përkatëse të njihen në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme (cilado të jetë më herët).**
47. Ky SNKSP i lejon zbatuesit për herë të parë një periudhë deri në tre vjet nga data e zbatimit të SNKSP-ve që të mos njihë aktivet në përputhje me SNKSP 16, 17, 27, 31 dhe 32. Gjatë kësaj periudhe, një zbatues për herë të parë mund të duhet të marrë në konsideratë kërkesat e njohjes së atyre SNKSP-ve në të njëjtën kohë me marrjen në konsideratë të njohjes së qirave financiare në këtë SNKSP. Kur një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimi në përputhje me SNKSP 16, 17, 27, 31 dhe 32, atij nuk i kërkohet të njohë aktivet dhe/ose detyrimet e qirasë financiare derisa të kenë skaduar përjashtimet që dhanë lehtësimin dhe/ose kur aktivet përkatëse të njihen në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme (cilado të jetë më herët).

SNKSP 19, Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivet e Kushtëzuara

48. **Kur një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimi në paragrafin 36, i cili lejon një periudhë trevjeçare kalimtare lehtësimi për të mos njohur dhe/ose matur ndërtesat, makineritë dhe pajisjet, atij nuk i kërkohet të**

njohë dhe/ose të masë detyrimin që lidhet me vlerësimin fillestar të kostove të çmontimit dhe heqjes së artikullit dhe restaurimit të vendit në të cilin ndodhet derisa të ketë skaduar përjashtimi për SNKSP 17, dhe/ose aktivi përkatës të njihet dhe/ose të matet në përputhje me SNKSP 17 (cilado të jetë më herët).

49. Ky SNKSP i lejon një zbatuesi për herë të parë një periudhë deri në tre vjet nga data e zbatimit të SNKSP-ve që të mos njohë dhe/ose matë ndërtesat, makineritë dhe pajisjet. SNKSP 17 kërkon që një njësi ekonomike të përfshijë si pjesë të kostos së një aktivi të ndërtesave, makinerive dhe pajisjeve, vlerësimin fillestar të kostove të çmontimit dhe heqjes së aktivitetit dhe restaurimit të vendit ku ai ndodhet. Kur një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimi që lejon një periudhë lehtësimi kalimtare trevjeçare për njohjen dhe/ose matjen e ndërtesave, makinerive, dhe pajisjeve, një zbatuesi për herë të parë nuk i kërkohet të zbatojë kërkesat që lidhen me vlerësimin fillestar të kostove të çmontimit dhe heqjes së aktivitetit dhe restaurimit të vendit në të cilin ndodhet derisa të skadojë përjashtimi që dha lehtësimin dhe/ose kur aktivi përkatës të njihet dhe/ose të matet në përputhje me SNKSP 17 (cilado të jetë më herët). Detyrimi do të matet në datën e zbatimit të SNKSP-ve, ose kur një zbatues për herë të parë ka përfituar nga përjashtimi që lejon një periudhë lehtësimi kalimtare trevjeçare për njohjen dhe/ose matjen e një aktivi, në datën në të cilën përjashtimi që jep lehtësimin ka skaduar dhe/ose aktivi është njohur dhe/ose matur në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme.
50. **Kur një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimi në paragrafin 48, ai do të njohë dhe/ose masë detyrimin dhe çdo aktiv të lidhur me të në të njëjtën kohë.**

SNKSP 20, Dhënia e Informacioneve për Palët e Lidhura

51. **Një zbatuesi për herë të parë nuk i kërkohet të paraqesë informacion për marrëdhëniet me palët e lidhura, transaksionet me palët e lidhura dhe informacion rreth personelit drejtues kryesor për periudhat e raportimit që fillojnë në një datë brenda tre viteve pas datës së zbatimit të SNKSP-ve.**
52. **Pavarësisht nga dispozita kalimtare në paragrafin 51, një zbatues për herë të parë inkurajohet të japë informacion për marrëdhëniet me palët e lidhura, transaksionet me palët e lidhura dhe informacion për personelin drejtues kryesor që dihet në datën e zbatimit të SNKSP.**

SNKSP 34, Pasqyrat Financiare të Veçanta, SNKSP 35, Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe SNKSP 36, Investime në Shoqëri dhe Sipërmarrje të Përbashkëta

53. **Kur një zbatues për herë të parë nuk i ka njohur interesat e tij në njësitë e kontrolluara, shoqëritë ose sipërmarrjet e përbashkëta sipas bazës së tij të mëparshme të kontabilitetit, atij nuk i kërkohet të njohë dhe/ose të masë interesat e tij në njësitë e tjera si një njësi të kontrolluara, shoqëri ose**

sipërmarrje të përbashkëta për periudhat e raportimit që fillojnë në një datë brenda tre viteve pas datës së zbatimit të SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

54. Sipas (subjekt i) paragrafit 53, një zbatuesi për herë të parë nuk i kërkohet të ndryshojë politikën e tij kontabël në lidhje me njohjen dhe/ose matjen e interesave të tij në njësitë e kontrolluara, shoqëritë ose sipërmarrjet e përbashkëta për periudhat e raportimit që fillojnë në një datë brenda tre viteve pas datës së zbatimit të SNKSP-ve. Përfundimisht kalimtare në paragrafin 53 synon t'i lejojë një zbatuesi për herë të parë një periudhë për të identifikuar dhe klasifikuar në mënyrë të përshtatshme interesat e tij në njësitë e tjera si ose njësi të kontrolluara, shoqëri ose sipërmarrje të përbashkëta gjatë periudhës kalimtare. Zbatuesi për herë të parë mund të zbatojë politika kontabël për njohjen dhe/ose matjen e interesave të tij në njësi të kontrolluara, shoqëri ose sipërmarrje të përbashkëta që nuk përputhen me dispozitat e SNKSP-ve të tjera.

SNKSP 35, Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

55. **Në varësi të (subjekt i) paragrafit 53, një zbatues për herë të parë do të paraqesë pasqyrat financiare të konsoliduara pas zbatimit të SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Megjithatë, një zbatuesi për herë të parë që paraqet pasqyrat financiare të konsoliduara nuk i kërkohet të eliminojë të gjitha balancat, transaksionet, të ardhurat dhe shpenzimet ndërmjet njësive brenda njësisë ekonomike për periudhat e raportimit që fillojnë në një datë brenda tre viteve pas datës së zbatimit të SNKSP-ve.**
56. Me zbatimin e SNKSP-ve, një njësi ekonomike mund të ketë njësi të kontrolluara me një numër të konsiderueshëm transaksionesh ndërmjet njësive të kontrolluara. Prandaj, mund të jetë e vështirë të identifikohen disa transaksione dhe balanca që nevojiten të eliminohen për qëllimin e përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara të njësive ekonomike. Për këtë arsye, paragrafi 55 jep lehtësim për një periudhë deri në tre vite për të eliminuar plotësisht balancat, transaksionet, të ardhurat dhe shpenzimet ndërmjet njësive brenda njësisë ekonomike.
57. **Pavarësisht nga përjashtimet kalimtare në paragrafin 55, një zbatues për herë të parë inkurajohet të eliminojë ato balanca, transaksione, të ardhura dhe shpenzime që janë të njohura në datën e zbatimit të SNKSP-ve në mënyrë që të jetë në përputhje të plotë me dispozitat e SNKSP 35 sa më shpejt të jetë e mundur.**
58. **Kur një zbatues për herë të parë ka përfituar nga përjashtimet kalimtare në paragrafin 53 dhe/ose paragrafin 55, ai nuk do të paraqesë pasqyrat financiare si pasqyra financiare të konsoliduara derisa:**
- (a) **Përjashtimet që dhanë lehtësimin të kenë skaduar; dhe**
 - (b) **Interesat e tij në njësitë e tjera të jenë njohur dhe/ose matur në**

mënyrë të përshtatshme si njësi të kontrolluara, shoqëri ose sipërmarrje të përbashkëta; ose

- (c) **Tepricat, transaksionet, të ardhurat dhe shpenzimet ndërmjet njësie brenda njësisë ekonomike të eliminohen (cilado të jetë më herët).**

SNKSP 36, Investime në Shoqëri dhe Sipërmarrje të Përbashkëta

59. **Kur një zbatues për herë të parë zbaton metodën e kapitalit në zbatimin e SNKSP 36, investuesit nuk i kërkohet të eliminojë pjesën e tij në sufiçitin dhe defiçitin që rezultojnë nga transaksionet nga njësia e varur tek njësia mëmë (upstream) dhe nga njësia mëmë tek njësia e varur (downstream) midis investuesit dhe shoqërisë ose sipërmarrjes së tij të përbashkët për periudhat e raportimit që fillojnë në një datë brenda tre viteve pas datës së zbatimit të SNKSP-ve.**
60. Me zbatimin e SNKSP-ve, një zbatues për herë të parë mund të jetë investues në një ose më shumë shoqëri ose sipërmarrje të përbashkëta me një numër të konsiderueshëm transaksionesh nga njësia e varur tek njësia mëmë dhe nga njësia mëmë tek njësia e varur ndërmjet investuesit dhe të investuarit. Prandaj, mund të jetë e vështirë të identifikohen disa transaksione nga njësia e varur tek njësia mëmë dhe/ose nga njësia mëmë tek njësia e varur, në të cilat pjesa e investuesit në sufiçitin ose defiçitin e shoqërisë ose sipërmarrjes së përbashkët duhet të eliminohet gjatë zbatimit të metodës së kapitalit. Për këtë arsye, paragrafi 59 i jep investuesit një lehtësim deri në tre vjet për të eliminuar plotësisht pjesën e tij në sufiçitin ose defiçitin e shoqërisë ose sipërmarrjes së përbashkët që rezultojnë nga transaksionet nga njësia e varur tek njësia mëmë dhe/ose nga njësia mëmë tek njësia e varur.
61. **Pavarësisht nga përjashtimi kalimtar në paragrafin 59, një zbatues për herë të parë inkurajohet të eliminojë pjesën e tij në sufiçitin dhe defiçitin e shoqërisë dhe sipërmarrjes së përbashkët që rezultojnë nga transaksionet upstream dhe downstream që janë njohur në datën e zbatimit të SNKSP-ve, në përputhje të plotë me dispozitat e SNKSP 36 sa më shpejt të jetë e mundur.**
62. **Kur një zbatues për herë të parë ka përfutur nga përjashtimi kalimtar në paragrafin 53 dhe/ose paragrafin 59, ai nuk do të paraqesë pasqyra financiare në të cilat investimet në shoqëri ose sipërmarrje të përbashkëta janë kontabilizuar duke përdorur metodën e kapitalit derisa:**
- (a) **Përjashtimet që dhanë lehtësimin të kenë skaduar; dhe**
- (b) **Interesi në njësitë e tjera të jetë njohur dhe/ose matur në mënyrë të përshtatshme si një shoqëri ose sipërmarrje e përbashkët; ose**
- (c) **Pjesa e tij në sufiçitin dhe defiçitin e shoqërisë që rezultojnë nga transaksionet upstream dhe downstream midis investuesit dhe të investuarit të jetë eliminuar (cilado të jetë më herët).**

SNKSP 40, Kombinimet e Sektorit Publik

- 62A. Kur një zbatues për herë të parë zbaton përjashtimin në paragrafin 36, i cili lejon një periudhë të lehtësimit kalimtar trevjeçar për të mos njohur dhe/ose matur aktivet dhe/ose detyrimet, zbatuesi për herë të parë mund të jetë palë në një kombinim të sektorit publik gjatë kësaj periudhe trevjeçare të lehtësimit kalimtar. Zbatuesit për herë të parë nuk i kërkohet të njohë dhe/ose të masë aktivet dhe/ose detyrimet që shoqërohen me kombinimin e sektorit publik, derisa të ketë skaduar përjashtimi që dha lehtësimin dhe/ose kur të njihen dhe /ose maten aktivet dhe/ose detyrimet përkatëse në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme (cilado të jetë më herët).
- 62B. Kur një zbatues për herë të parë zbaton përjashtimin në paragrafin 62A, ai nuk do të njohë emrin e mirë në lidhje me një blerje. Zbatuesi për herë të parë do të njohë diferencën midis (a) dhe (b) më poshtë në aktivet/kapitalin neto:
- (a) **Totalin e:**
 - (i) Çdo shume të transferuar;
 - (ii) Çdo interesi jokontrollues në një operacion të blerë; dhe
 - (iii) Çdo interesi të kapitalit të mbajtur më parë në një operacion të blerë.
 - (b) **Shumat neto të çdo aktivi të identifikueshëm të blerë dhe detyrimet e ndërmarra.**
- 62C. SNKSP 40 zbatohet në mënyrë prospektive. Rrjedhimisht, një zbatues për herë të parë nuk rregullon asnjë shumë të emrit të mirë të njohur si rezultat i një kombinimi të sektorit publik që ka ndodhur përpara zbatimit të SNKSP 40.

Përjashtimet që Nuk Ndikojnë në Paraqitjen e Drejtë dhe Përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të Drejtave dhe Detyrimeve të Konstatuara gjatë Periudhës së Zbatimit

63. Një zbatuesi për herë të parë i kërkohet, ose mund të zgjedhë, të zbatojë përjashtimet në paragrafët 64-134. Këta përjashtime nuk do të ndikojnë në paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të një zbatuesi për herë të parë dhe aftësinë e tij për të pohuar përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara gjatë periudhës kalimtare në përputhje me paragrafët 27 dhe 28 ndërsa ato zbatohen. Një zbatues për herë të parë nuk do t'i zbatojë këto përjashtime në analogji për zërat e tjerë.

Përdorimi i Kostos së Supozuar për të Matur Aktivet dhe/ose Detyrimet

64. Një zbatues për herë të parë mund të zgjedhë të masë aktivet dhe/ose

detyrimet e mëposhtme me vlerën e tyre të drejtë kur informacioni i besueshëm i kostos për aktivet dhe detyrimet nuk është i disponueshëm, dhe ta përdorë atë vlerë të drejtë si kosto të supozuar për:

- (a) Inventarin (shih SNKSP 12);
- (b) Pronën e investimit, nëse zbatuesi për herë të parë zgjedh të përdorë modelin e kostos në SNKSP 16;
- (c) Ndërtesat, makineritë, dhe pajisjet (shih SNKSP 17);
- (d) Aktivet afatgjatë jomaterialë, të ndryshëm nga aktivet afatgjatë jomaterialë të gjeneruar së brendshmi (shih SNKSP 31) që plotësojnë:
 - (i) Kriteret e njohjes në SNKSP 31 (me përjashtim të kriterit të matjes së besueshme); dhe
 - (ii) Kriteret në SNKSP 31 për rivlerësimin (duke përfshirë ekzistencën e një tregu aktiv);
- (e) Instrumentet Financiare (shih SNKSP 41); ose
- (f) Aktivet e konçesionit të shërbimit (shih SNKSP 32).

65. Kostoja e supozuar mund të përcaktohet vetëm kur kostoja e blerjes së aktivit dhe/ose detyrimit nuk është e disponueshme. Kostoja e supozuar supozon që njësia ekonomike e kishte njohur fillimisht aktivin dhe/ose detyrimin në datën e dhënë. Zhvlerësimi ose amortizimi i mëvonshëm bazohet në atë kosto të supozuar me premisën se kostoja e blerjes është e barabartë me koston e supozuar. Për shembull, një zbatues për herë të parë mund të zgjedhë të masë ndërtesat, makineritë dhe pajisjet me koston e supozuar në datën e zbatimit të SNKSP-ve sepse informacioni i kostos për aktivin e ndërtesave, makinerive, dhe pajisjeve nuk ishte i disponueshëm në atë datë, dhe të përdorë vlerën e drejtë si koston e tij të supozuar në atë datë. Çdo zhvlerësim i mëvonshëm bazohet në vlerën e drejtë të përcaktuar në atë datë dhe fillon nga data kur është përcaktuar kostoja e supozuar.
66. Përdorimi i kostos së supozuar nuk konsiderohet një rivlerësim ose zbatim i modelit të vlerës së drejtë për matjen e mëvonshme në përputhje me SNKSP-të e tjera.
67. **Një zbatues për herë të parë mund të zgjedhë të përdorë shumën e rivlerësimit të ndërtesave, makinerive, dhe pajisjeve sipas bazës së tij të mëparshme të kontabilitetit si kosto të supozuar nëse rivlerësimi ishte, në datën e rivlerësimit, gjerësisht i krahasueshëm me:**
- (a) Vlerën e drejtë; ose
 - (b) Koston ose koston e amortizuar, aty ku është e përshtatshme, në përputhje me SNKSP-të e rregulluara për të reflektuar, për

shembull, ndryshimet në një indeks çmimi të përgjithshëm ose specifik.

68. Një zbatues për herë të parë mund të ketë vendosur një kosto të supozuar në përputhje me bazën e tij të mëparshme të kontabilitetit për ndërtesat, makineritë, dhe pajisjet, duke e matur atë me vlerën e drejtë në një datë të caktuar për shkak të një ngjarjeje specifike:
- (a) Nëse data e matjes është në ose para datës së zbatimit të SNKSP-ve, një zbatues për herë të parë mund të përdorë matje të tilla të vlerës së drejtë të bazuara tek ngjarjet si kosto të supozuar për SNKSP-të në datën e asaj matjeje.
 - (b) Nëse data e matjes është pas datës së zbatimit të SNKSP-ve, por gjatë periudhës kalimtare ku zbatuesi për herë të parë përfiton nga përjashtimi që jep një periudhë lehtësime kalimtare trevjeçare për të mos njohur dhe/ose matur aktive të caktuar, matjet e vlerës së drejtë të bazuara në ngjarje mund të përdoren si kosto e supozuar kur ndodh ngjarja. Një zbatues për herë të parë do të njohë rregullimet që rezultojnë drejtpërdrejt në sufiçitin ose defiçitin e akumuluar kur aktivi njihet dhe/ose matet.
69. Në përcaktimin e vlerës së drejtë në përputhje me paragrafin 67, zbatuesi për herë të parë do të zbatojë përkufizimin e vlerës së drejtë dhe udhëzimet në SNKSP-të e tjera të zbatueshme në përcaktimin e vlerës së drejtë të aktivit në fjalë. Vlera e drejtë duhet të pasqyrojë kushtet që ekzistuan në datën në të cilën ajo u përcaktua.
70. **Nëse evidenca e besueshme e vlerës së drejtë e bazuar në treg nuk është e disponueshme për inventarin, ose pronën e investuar që është e një natyre të specializuar, një zbatues për herë të parë mund të marrë në konsideratë alternativat e mëposhtme të matjes në përcaktimin e një kostoje të supozuar:**
- (a) **Për inventarin, koston aktuale të zëvendësimit; dhe**
 - (b) **Për pronën e investuar të një natyre të specializuar, koston e zëvendësimit të amortizuar.**

Përdorimi i Kostos së Supozuar për të Matur Aktivet e Marra përmes një Transaksioni pa Këmbim

71. **Një zbatues për herë të parë mund të zgjedhë të masë me vlerën e drejtë një aktiv të marrë nëpërmjet një transaksioni pa këmbim kur informacioni i besueshëm i koston për aktivin nuk është i disponueshëm, dhe ta përdorë atë vlerë të drejtë si koston e tij të supozuar.**

Përdorimi i Kostos së Supozuar për Investime në Njësi të Kontrolluara, Sipërmarrje të Përbashkëta dhe Shoqëri (SNKSP 34)

72. **Kur një zbatues për herë të parë mat një investim në një njësi të**

kontrolluar, sipërmarrje të përbashkët ose shoqëri me kosto në pasqyrat e tij financiare të veçanta, ai, në datën e zbatimit të SNKSP-ve, mund të zgjedhë ta masë atë investim me një nga vlerat e mëposhtme në deklarimin e veçantë fillestar të pozicionit financiar:

- (a) **Koston; ose**
- (b) **Koston e supozuar. Kostoja e supozuar e një investimi të tillë do të jetë vlera e tij e drejtë (e përcaktuar në përputhje me SNKSP 41) në datën e zbatimit të SNKSP-ve nga zbatuesi për herë të parë në pasqyrat e tij financiare të veçanta.**

73. Një zbatues për herë të parë mund të ketë vendosur një kosto të supozuar në përputhje me bazën e tij të mëparshme të kontabilitetit për një investim në një njësi të kontrolluar, sipërmarrje të përbashkët ose shoqëri duke e matur atë me vlerën e drejtë në një datë të caktuar për shkak të një ngjarjeje specifike. Në raste të tilla, një zbatues për herë të parë zbaton paragrafin 72(a) dhe (b).

Data në të Cilën Kostoja e Supozuar Mund të Përcaktohet

74. **Data në të cilën përcaktohet kostoja e supozuar mund të ndryshojë në varësi të faktit nëse zbatuesi për herë të parë përfiton nga përjashtimet që japin një periudhë lehtësimi kalimtare trevjeçare për të mos njohur dhe/ose matur disa aktive dhe/ose detyrime. Kur zbatuesi për herë të parë përfiton nga përjashtimi, kostoja e supozuar mund të përcaktohet në çdo datë gjatë kësaj periudhe, ose në datën që skadon përjashtimi (cilado të jetë më herët) dhe do të njihet në përputhje me paragrafin 76. Nëse zbatuesi për herë të parë nuk zbaton përjashtimin, kostoja e supozuar do të përcaktohet në fillim të periudhës më të hershme për të cilën zbatuesi për herë të parë paraqet pasqyrat financiare sipas SNKSP-ve.**
75. Kur një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimi që ofron një periudhë lehtësimi kalimtare trevjeçare për të mos njohur dhe/ose matur disa aktive dhe/ose detyrime, ai mund të përcaktojë një kosto të supozuar për atë aktiv dhe/ose detyrim në çdo moment të kohës brenda periudhës kalimtare trevjeçare të lehtësimit.
76. **Kur një kosto e supozuar përcaktohet gjatë periudhës në të cilën një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimi që ofron një përjashtim kalimtar trevjeçar për të mos njohur dhe/ose matur një aktiv dhe/ose detyrim, një zbatues për herë të parë do të njohë rregullimin kundrejt suficitit ose deficitit të akumuluar fillestar në vitin në të cilin njihet dhe/ose matet kostoja e supozuar e aktivit dhe/ose pasivit.**

SNKSP 1, Paraqitja e Pasqyrave Financiare

Informacion Krahasues

77. Një zbatues për herë të parë inkurajohet, por nuk është i detyruar, të

paraqesë informacion krahasues në pasqyrat e tij financiare të para kalimtare sipas SNKSP-ve ose pasqyrat e tij të para financiare sipas SNKSP-ve të paraqitura në përputhje me këtë SNKSP. Kur një zbatues për herë të parë paraqet informacion krahasues, ai duhet të prezantohet në përputhje me kërkesat e SNKSP 1.

78. Kur një zbatues për herë të parë zgjedh të paraqesë informacion krahasues, pasqyrat e para kalimtare financiare sipas SNKSP-ve ose pasqyrat e para financiare sipas SNKSP-ve të paraqitura në përputhje me këtë SNKSP do të përfshijnë:

- (a) Një pasqyrë të pozicionit financiar me informacion krahasues për periudhën paraardhëse, dhe një deklaram fillestar të pozicionit financiar në fillim të periudhës së raportimit para datës së miratimit të SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara;
- (b) Një pasqyrë të performancës financiare me informacion krahasues për periudhën paraardhëse;
- (c) Një pasqyrë të ndryshimeve në aktivet/kapitalin neto me informacion krahasues për periudhën paraardhëse;
- (d) Një pasqyrë të flukseve monetare me informacion krahasues për periudhën paraardhëse;
- (e) Një krahasim të shumave të buxhetuara dhe aktuale për vitin aktual si një pasqyrë financiare shtesë e veçantë ose si një kolonë buxheti në pasqyrat financiare nëse zbatuesi për herë të parë e bën publikisht të disponueshëm buxhetin e tij të miratuar; dhe
- (f) Shënime përkatëse duke përfshirë informacionin krahasues, dhe paraqitjen e informacionit narrativ për rregullimet materiale siç kërkohet nga paragrafi 142.

79. Kur një zbatues për herë të parë zgjedh të mos paraqesë informacion krahasues, pasqyrat e tij financiare të para kalimtare sipas SNKSP-ve pas zbatimit të SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara ose pasqyrat e tij të para financiare sipas SNKSP-ve të paraqitura në përputhje me këtë SNKSP do të përfshijnë:

- (a) Një pasqyrë të pozicionit financiar, dhe një deklaram fillestar të pozicionit financiar në datën e miratimit të SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara;
- (b) Një pasqyrë të performancës financiare;
- (c) Një pasqyrë të ndryshimeve në aktivet/kapitalin neto;
- (d) Një pasqyrë të flukseve monetare;
- (e) Një krahasim shumave të buxhetuara dhe aktuale për vitin aktual si

një pasqyrë financiare shtesë e veçantë ose si një kolonë buxheti në pasqyrat financiare nëse zbatuesi për herë të parë e bën publikisht të disponueshëm buxhetin e tij të miratuar; dhe

(f) Shënimet përkatëse dhe paraqitjet e informacionit narrativ për rregullimet materiale siç kërkohet nga paragrafi 142.

80. **Kur një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimet në paragrafët 36-62, të cilët lejojnë një periudhë trevjeçare lehtësimi kalimtar për të mos njohur dhe/ose matur një zë, informacioni krahasues për vitin pas datës së zbatimit të SNKSP-ve do të rregullohet vetëm kur informacioni është i disponueshëm për zërat pas njohjes dhe/ose matjes së tyre gjatë periudhës së lehtësimit.**
81. SNKSP 1 kërkon që një njësi të paraqesë informacion krahasues në lidhje me periudhën e mëparshme për të gjitha shumatat e raportuara në pasqyrat financiare. Kur një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimi që ofron një përjashtim kalimtar trevjeçar për të mos njohur dhe/ose matur një zë, ai, gjatë periudhës kalimtare, do të paraqesë informacion krahasues për një zë të njohur dhe/ose të matur vetëm gjatë asaj periudhe, nëse disponohet informacion për zërin për periudhën krahasuese. Zbatuesi për herë të parë do të zbatojë kërkesat në SNKSP 1 pasi të ketë rregulluar pasqyrat e tij të para financiare sipas SNKSP-ve.

Informacion Krahasues që nuk vjen nga SNKSP-të

82. Një zbatues për herë të parë mund të paraqesë informacion krahasues në përputhje me bazën e tij të mëparshme të kontabilitetit. Në çdo pasqyrë financiare që përmban informacion krahasues në përputhje me bazën e mëparshme të kontabilitetit, zbatuesi për herë të parë duhet të emërtojë/etiketojë informacionin e pregatitur sipas bazës e mëparshme të informacionit kontabël si “të pregatitur jo në përputhje me SNKSP-të”, dhe të paraqesë natyrën e rregullimeve kryesore që do të kërkoheshin për të qenë në përputhje me SNKSP-të.
83. Kur një zbatues për herë të parë paraqet informacion krahasues jo-SNKSP në pasqyrat e tij të para financiare sipas SNKSP ose pasqyrat e tij të para financiare kalimtare sipas SNKSP pas zbatimit të SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, përjashtimet dhe dispozitat kalimtare të dhëna në këtë Standard nuk do të zbatohen për informacionin krahasues jo-SNKSP të prezantuar në pasqyrat e para financiare sipas SNKSP-ve ose në pasqyrat e para kalimtare financiare sipas SNKSP-ve.

Përmbledhjet Historike para zbatimit të SNKSP-ve

84. Një zbatues për herë të parë mund të zgjedhë të paraqesë përmbledhje historike

të të dhënave të përzgjedhura për periudhat përpara periudhës së parë për të cilën ai paraqet pasqyrat financiare në përputhje me SNKSP-të. Ky SNKSP nuk kërkon që përmbledhje të tilla të jenë në përputhje me kërkesat e njohjes dhe matjes të SNKSP-ve. Në çdo pasqyrë financiare që përmban përmbledhje historike në përputhje me bazën e mëparshme të kontabilitetit, zbatuesi për herë të parë do të etiketojë bazën e mëparshme të informacionit të kontabilitetit në mënyrë të dukshme si të papregatitur në përputhje me SNKSP-të dhe të do të paraqesë natyrën e rregullimeve kryesore që do të ishin kërkuar për të qenë në përputhje me SNKSP-të. Zbatuesi për herë të parë nuk ka nevojë të përcaktojë sasinë e këtyre rregullimeve.

SNKSP 4, Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit në Monedhë të Huaj

85. **Në datën e zbatimit të SNKSP-ve, një zbatues për herë të parë nuk duhet të përmbushë kërkesat për diferencat e akumuluar të konvertimit që ekzistojnë në atë datë. Nëse një zbatues për herë të parë përdor këtë përjashtim:**
- (a) **Diferencat e akumuluar të konvertimit për të gjitha operacionet e huaja konsiderohen të jenë zero në datën e zbatimit të SNKSP-ve; dhe**
 - (b) **Fitimi ose humbja nga një nxjerrje jashtë përdorimit pasuese e çdo operacioni të huaj do të përjashtojë diferencat e konvertimit që u krijuan përpara datës së zbatimit të SNKSP-ve dhe do të përfshijë diferencat e mëvonshme të konvertimit.**
- 85A. **Një zbatues për herë të parë nuk ka nevojë të zbatojë Shtojcën A të SNKSP 4 për aktivet, shpenzimet dhe të ardhurat në fushëveprimin e Shtojcës A të njohur fillimisht përpara datës së zbatimit të SNKSP-ve.**
86. **Një zbatues për herë të parë do të zbatojë kërkesën për të trajtuar çdo emër të mirë (shih SNKSP 40) që lind nga blerja e një operacioni të huaj dhe çdo rregullim të vlerës së drejtë ndaj vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve që lindin nga blerja e atij operacioni të huaj, si aktive dhe detyrime të operacionit të huaj, në mënyrë prospektive në datën e zbatimit të SNKSP-ve.**
87. Në zbatimin e përjashtimit kalimtar në paragrafin 85, një zbatues për herë të parë nuk duhet të riparaqesë vitet e mëparshme për blerjen e një operacioni të huaj të blerë përpara datës së zbatimit të SNKSP-ve, dhe në përputhje me rrethanat, kur është e përshtatshme, do të trajtojë emrin e mirë dhe rregullimet e vlerës së drejtë që krijohen në momentin e blerjes si aktive dhe detyrime të njësisë dhe jo si aktive dhe detyrime të operacionit të huaj. Prandaj, këta rregullime të emrit të mirë dhe vlerës së drejtë ose janë tashmë të shprehura në monedhën funksionale të njësisë ekonomike, ose janë artikuj në monedhë të huaj jomonetare, të cilët raportohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e blerjes.

SNKSP 5, Kostot e Huamarrjes

88. **Një zbatues për herë të parë inkurajohet, por nuk është i detyruar, të zbatojë kërkesat e SNKSP 5 në mënyrë retrospektive kur ai zbaton ose ndryshon politikën e tij kontabël sipas trajtimit standard të referimit.**
89. **Kur një zbatues për herë të parë zbaton ose ndryshon politikën e tij kontabël sipas trajtimit standard të referimit, lejohet të caktojë çdo datë përpara datës së zbatimit të SNKSP-ve dhe të zbatojë SNKSP 5 në mënyrë prospektive në ose pas asaj date të caktuar.**
90. **Kur një zbatues për herë të parë ndryshon politikën e tij kontabël në trajtimin alternativ të lejuar, çdo kosto huamarrjeje e krijuar para dhe pas datës së zbatimit të SNKSP-ve për aktivet kualifikuese për të cilat data e fillimit të kapitalizimit është përpara datës së zbatimit të SNKSP-ve. do të njihet në mënyrë retrospektive në përputhje me trajtimin alternativ të lejuar.**

SNKSP 10, Raportimi Financiar në Ekonomitë Hiperinflacioniste

Hiperinflacion i Theksuar

91. **Nëse një zbatues për herë të parë ka një monedhë funksionale që ishte, ose është, monedha e një ekonomie hiperinflacionare, ai do të përcaktojë nëse ai ka qenë subjekt i hiperinflacionit të theksuar përpara datës së zbatimit të SNKSP-ve.**
92. Monedha e një ekonomie hiperinflacionare i nënshtrohet hiperinflacionit të theksuar nëse ka të dyja karakteristikat e mëposhtme:
 - (a) Një indeks i përgjithshëm i besueshëm i çmimeve nuk disponohet për të gjitha njësitë me transaksione dhe balanca në monedhën; dhe
 - (b) Shkëmbyeshmëria ndërmjet monedhës vendase dhe një monedhe të huaj relativisht të qëndrueshme nuk ekziston.
93. Monedha funksionale e një zbatuesi për herë të parë ndalon së qeni subjekt i hiperinflacionit të theksuar në datën e normalizimit të monedhës funksionale. Ajo është data kur monedha funksionale nuk ka më njërën, ose të dyja, karakteristikat në paragrafin 92 ose kur ka një ndryshim në monedhën funksionale të zbatuesit për herë të parë në një monedhë që nuk i nënshtrohet hiperinflacionit të theksuar.
94. **Kur data e zbatimit të SNKSP-ve nga një zbatues për herë të parë është në, ose pas, datës së normalizimit të monedhës funksionale, zbatuesi për herë të parë mund të zgjedhë të masë të gjithë aktivet dhe detyrimet e mbajtura përpara datës së normalizimit të monedhës funksionale me vlerën e drejtë në datën e zbatimit të SNKSP-ve. Zbatuesi për herë të parë mund ta përdorë atë vlerë të drejtë si kosto të supozuar të këtyre aktiveve dhe**

detyrimeve në deklarimin fillestar të pozicionit financiar.

SNKSP 13, Kontratat e Qirave

95. Një zbatues për herë të parë në datën e zbatimit të SNKSP-ve, do të klasifikojë të gjitha qiratë ekzistuese si qira operative ose financiare në bazë të rrethanave ekzistuese në fillimin e kontratës së qirasë, në masën që këto janë të njohura në datën e zbatimit të SNKSP-ve.
96. Nëse, edhe pse, qiramarrësi dhe qiradhënësi kanë rënë dakord të ndryshojnë dispozitat e kontratës së qirasë midis datës së fillimit të qirasë dhe datës së zbatimit të SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara në një mënyrë që do të kishte rezultuar në një klasifikim të ndryshëm të qirasë në datën e zbatimit, marrëveshja e rishikuar do të konsiderohet si një marrëveshje e re. Një zbatues për herë të parë do të marrë në konsideratë dispozitat e marrëveshjes së re në datën e zbatimit të SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara në klasifikimin e qirasë si qira operative ose financiare.

SNKSP 18, Raportimi i Segmenteve

97. Një zbatuesi për herë të parë nuk i kërkohet të paraqesë informacion të segmentit për periudhat e raportimit që fillojnë në një datë brenda tre viteve pas datës së zbatimit të SNKSP-ve.

SNKSP 21, Zhvlerësimi i Aktiveve që nuk Gjenerojnë Mjete Monetare

98. Një zbatues për herë të parë do të zbatojë kërkesat në SNKSP 21 në mënyrë prospektive që nga data e zbatimit të SNKSP-ve, përveç në lidhje me ato aktive ku një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimi në paragrafin 36, i cili lejon një periudhë trevjeçare lehtësimi kalimtare për të mos njohu dhe/ose matur aktivet. Kur një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimi që ofron një periudhë lehtësimi kalimtare trevjeçare në SNKSP 16, 17, 27, 31 dhe 32, ai zbaton SNKSP 21 kur përjashtimi që dha lehtësimin të ketë skaduar dhe/ose aktivet përkatëse të njihen dhe/ose maten në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme (cilado të jetë më herët).
99. Në datën që ka skaduar përjashtimi kalimtar që dha lehtësimin, dhe/ose kur aktivet përkatëse njihen dhe/ose maten në pasqyrat financiare (cilado të jetë më herët), një zbatues për herë të parë do të vlerësojë nëse ka ndonjë tregues që aktivet jogjenerues të mjeteve monetare të njohur dhe/ose të matur janë zhvlerësuar. Çdo humbje nga zhvlerësimi do të njihet në sufiçitin ose defiçitin fillestar të akumuluar në datën e zbatimit të SNKSP-ve, ose në sufiçitin ose defiçitin fillestar të akumuluar në periudhën e raportimit në të cilën skadon përjashtimi kalimtar, dhe/ose aktivet përkatëse njihen dhe/ose maten (cilado të jetë më herët).
100. Një zbatues për herë të parë do të zbatojë kërkesat e SNKSP 21 në mënyrë

prospektive. Kjo do të thotë se në datën e zbatimit të SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, ose nëse zbatuesi për herë të parë ka zbatuar lehtësimin kalimtar në lidhje me njohjen dhe/ose matjen e aktiveve, vetëm kur skadon përjashtimi kalimtar trevjeçar, dhe/ose kur aktivet përkatëse njihen dhe/ose maten në pasqyrat financiare (cilado të jetë më herët), do t'i kërkohet një zbatuesi për herë të parë të vlerësojë nëse ka një tregues se ndonjë aktiv jogjenerues i mjeteve monetare i përfshirë në deklarinimin fillestar të pozicionit financiar, është zhvlerësuar.

SNKSP 39, Përfitimet e Punonjësve

101. **Një zbatues për herë të parë do të njohë dhe/ose masë të gjithë përfitimet e punonjësve në datën e zbatimit të SNKSP-ve, me përjashtim të planeve me përfitimet të përcaktuara dhe përfitimet të tjera afatgjata të punonjësve ku përfiton nga përjashtimi në paragrafin 36.**

Planet me Përfitimet të Përcaktuara dhe Përfitimet të Tjera Afatgjata Të Punonjësve

102. **Në datën e zbatimit të SNKSP-ve, ose kur një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimi kalimtar trevjeçar, data në të cilën skadon përjashtimi, ose kur detyrimet përkatëse njihen dhe/ose maten në pasqyrat financiare (cilado të jetë më herët), një zbatues për herë të parë do të përcaktojë detyrimin e tij fillestar për planet e përfitimet të përcaktuara dhe përfitimet të tjera afatgjata të punonjësve në atë datë si:**

- (a) **Vlerën aktuale të detyrimit në datën e zbatimit të SNKSP-ve, ose kur një zbatues për herë të parë përfiton nga periudha trevjeçare e lehtësimit kalimtar, datën në të cilën skadon përjashtimi, ose kur detyrimet përkatëse njihen dhe/ose maten në pasqyrat financiare (cilado të jetë më herët), duke përdorur metodën e kreditimit të njësisë së projektuar; dhe**
- (b) **Minus vlerën e drejtë, në datën e zbatimit të SNKSP-ve, ose kur një zbatues për herë të parë përfiton nga periudha trevjeçare e lehtësimit kalimtar, datën në të cilën skadon përjashtimi, ose kur detyrimet përkatëse njihen dhe/ose maten në pasqyrat financiare (cilado të jetë më herët) të aktiveve të planit (nëse ka) nga të cilat obligimet duhet të shlyhen drejtpërdrejt.**
- (c) [Fshirë]

103. **Nëse detyrimi fillestar në përputhje me paragrafin 102 është më shumë ose më pak se detyrimi që është njohur dhe/ose matur në fund të periudhës krahasuese sipas bazës së mëparshme kontabël të zbatuesit për herë të parë, zbatuesi për herë të parë do të njohë atë rritje/ulje në suficitin ose deficitin fillestar të akumuluar në periudhën në të cilën zërat njihen dhe/ose maten.**

104. Efekti i ndryshimit në politikën kontabël sipas SNKSP 39 përfshin çdo rimatje që ka ndodhur, nëse ka, në periudha të mëparshme. Sipas bazës së tij të mëparshme të kontabilitetit, një zbatues për herë të parë mund të mos ketë njohur dhe/ose matur ndonjë detyrim, në të cilin rast rritja e detyrimit do të përfaqësojë shumën e plotë të detyrimit minus vlerën e drejtë, në datën e zbatimit të SNKSP-ve ose aty ku një zbatues për herë të parë përfiton nga periudha trevjeçare e lehtësimit kalimtar, datën në të cilën skadon përjashtimi, ose kur detyrimet përkatëse njihen dhe/ose maten në pasqyrat financiare (cilado të jetë më herët), të ndonjë nga aktiveve të planit në përputhje me paragrafin 102(b). Ky detyrim i rritur njihet në sufiçitin ose defiçitin fillestar të akumuluar në periudhën në të cilën artikujt njihen dhe/ose maten.
105. **Një zbatues për herë të parë do të njohë të gjitha rimatjet e akumuluar në sufiçitin ose defiçitin fillestar të akumuluar në periudhën në të cilën zërat njihen dhe/ose maten.**
106. [Fshirë]
107. [Fshirë]

SNKSP 26, Zhvlerësimi i Aktiveve që Gjenerojnë Mjete Monetare

108. **Një zbatues për herë të parë do të zbatojë kërkesat në SNKSP 26 në mënyrë prospektive që nga data e zbatimit të SNKSP-ve, përveç në lidhje me ato aktive ku një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimi në paragrafin 36, i cili lejon një periudhë trevjeçare lehtësimi kalimtare për të mos njohur dhe/ose matur aktivet. Kur një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimi që jep një periudhë lehtësimi kalimtare trevjeçare në SNKSP 16, 17, 27, 31 dhe 32, ai zbaton SNKSP 26 kur përjashtimi që dha lehtësimin ka skaduar dhe/ose aktivet përkatëse njihen dhe/ose maten në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme (cilado të jetë më herët).**
109. **Në datën që ka skaduar përjashtimi kalimtar që dha lehtësimin dhe/ose kur aktivet përkatëse njihen dhe/ose maten në pasqyrat financiare (cilado të jetë më herët), një zbatues për herë të parë do të vlerësojë nëse ka ndonjë tregues që aktivet gjenerues të mjeteve monetare të njohur dhe/ose të matur janë zhvlerësuar. Çdo humbje nga zhvlerësimi do të njihet në sufiçitin ose defiçitin fillestar të akumuluar në datën e zbatimit të SNKSP-ve, ose në sufiçitin ose defiçitin fillestar të akumuluar në periudhën e raportimit në të cilën skadon përjashtimi kalimtar, dhe/ose aktivet përkatëse njihen dhe/ose maten (cilado të jetë më herët).**
110. Një zbatues për herë të parë do të zbatojë kërkesat e SNKSP 26 në mënyrë prospektive. Kjo do të thotë se në datën e zbatimit të SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, ose nëse zbatuesi për herë të parë ka zbatuar lehtësimin kalimtar në lidhje me njohjen dhe/ose matjen e aktiveve, vetëm kur skadon përjashtimi kalimtar trevjeçar, dhe/ose kur aktivet përkatëse njihen dhe/ose maten në pasqyrat financiare (cilado të jetë më herët), do t'i kërkohet një

zbatuesi për herë të parë të vlerësojë nëse ka një tregues se ndonjë aktiv që gjeneron mjete monetare i përfshirë në deklarinimin fillestar të pozicionit financiar, është zhvlerësuar.

SNKSP 28, Instrumentet Financiare: Paraqitja

111. **Në datën e zbatimit të SNKSP-ve, një zbatues për herë të parë do të vlerësojë kushtet e instrumentit financiar për të përcaktuar nëse ai përmban një element detyrimi dhe një element të aktivit/kapitalit neto. Nëse element i detyrimit nuk është më i papaguar në datën e zbatimit të SNKSP-ve, zbatuesi për herë të parë nuk ka nevojë të ndajë instrumentin financiar të përbërë në një element të detyrimit dhe një element të aktiveve/kapitalit neto.**
112. SNKSP 28 kërkon që një njësi të ndajë një instrument financiar të përbërë në fillim në komponentë të veçantë të detyrimit dhe aktivit/kapitalit neto. Nëse komponenti i detyrimit nuk është më i papaguar, zbatimi retrospektiv i SNKSP 28 përfshin ndarjen e dy pjesëve të aktiveve/kapitalit neto. Pjesa e parë është në sufitin dhe deficitin e akumuluar dhe përfaqëson interesin kumulativ të akumuluar në komponentin e detyrimit. Pjesa tjetër përfaqëson komponentin origjinal të aktiveve/kapitalit neto. Megjithatë, ky SNKSP lejon një zbatues për herë të parë të mos i ndajë këto dy pjesë nëse komponenti i detyrimit nuk është më i papaguar në datën e zbatimit të SNKSP-ve.

SNKSP 41, Instrumentet Financiare

Klasifikimi i Instrumenteve Financiare në Datën e Zbatimit të SNKSP-ve ose gjatë Periudhës Kalimtare

113. **Një zbatues për herë të parë mund të klasifikojë një aktiv financiar ose detyrim financiar si një aktiv financiar ose detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet sufitit ose deficitit që plotëson kriteret për klasifikim në SNKSP 41, në përputhje me paragrafin 114. Një zbatues për herë të parë do të paraqesë vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të klasifikuar në secilën kategori në datën e klasifikimit, klasifikimin e tyre dhe vlerën e mbartur.**
114. SNKSP 41 lejon që një aktiv financiar të klasifikohet në njohjen fillestare si një instrument financiar (me kusht që ai të plotësojë disa kriteret) të përcaktohet si një aktiv financiar ose pasiv financiar me vlerën e drejtë, përmes sufitit ose deficitit. Pavarësisht nga kjo kërkesë, përjashtimet zbatohen në rrethanat e mëposhtme:
- (a) [Fshirë]
 - (b) **Një zbatues për herë të parë lejohet të klasifikojë, në datën e zbatimit të SNKSP-ve, çdo aktiv financiar ose detyrim financiar me vlerën e drejtë nëpërmjet sufitit ose deficitit, me kusht që aktivi ose detyrimi**

të plotësojë kriteret në paragrafin 44, 46(a) ose 46(b) të SNKSP 41 në atë datë.

- 114A. Një njësi mund të klasifikojë një investim në një instrument të kapitalit si me vlerën e drejtë nëpërmjet aktiveve/kapitalit neto në përputhje me paragrafin 106 të SNKSP 41 mbi bazën e fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e zbatimit të SNKSP-ve.

Çregjistrimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare

115. Përveç siç lejohet nga paragrafi 116, një zbatues për herë të parë do të zbatojë kërkesat e çregjistrimit në SNKSP 41 në mënyrë të prospektive për transaksionet që ndodhin në ose pas datës së zbatimit të SNKSP-ve, ose kur një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimet për të mos njohur instrumentet financiare, data në të cilën përjashtimet që dhanë lehtësimin kanë skaduar dhe/ose instrumentet financiare janë njohur (cilado të jetë më herët). Për shembull, nëse një zbatues për herë të parë çregjistroi aktive financiare joderivative ose detyrime financiare joderivative në përputhje me bazën e tij të mëparshme të kontabilitetit si rezultat i një transaksioni që ndodhi përpara datës së zbatimit të SNKSP-ve, ai nuk do t'i njohë ata aktive dhe detyrime në përputhje me SNKSP 41, përveç rasteve kur ata kualifikohen për njohje si rezultat i një transaksioni ose ngjarjeje të mëvonshme.
116. Pavarësisht nga dispozita në paragrafin 115, një zbatues për herë të parë mund të zbatojë kërkesat e çregjistrimit në SNKSP 41 në mënyrë retrospektive nga data e zgjedhur nga zbatuesi për herë të parë, me kusht që informacioni i nevojshëm për të zbatuar SNKSP 41 për aktivet dhe detyrimet financiare të çregjistruar si rezultat i transaksioneve të kaluara, është marrë në momentin e kontabilizimit fillestar të këtyre transaksioneve.

Kontabiliteti Mbrojtës

117. Siç kërkohet nga SNKSP 41, një zbatues për herë të parë në datën e zbatimit të SNKSP-ve, ose kur një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimi që ofron një periudhë trevjeçare lehtësimi kalimtare për të mos njohur dhe/ose matur instrumentet financiare, data kur ka skaduar përjashtimi që ofroi lehtësimin dhe/ose instrumentet financiare përkatës njihen dhe/ose maten në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme (cilado të jetë më herët):
- (a) Mat të gjithë derivativët me vlerën e drejtë; dhe
 - (b) Eliminon të gjitha humbjet dhe fitimet e shtyra që lindin nga derivativët që janë raportuar në përputhje me bazën e mëparshme të kontabilitetit sikur të ishin aktive ose detyrime.
118. Një zbatues për herë të parë nuk duhet të pasqyrojë në deklarinimin e tij fillestar të pozicionit financiar një marrëdhënie mbrojtëse të një lloji që

nuk kualifikohet për kontabilitet mbrojtës në përputhje me SNKSP 41 (për shembull, shumë marrëdhënie mbrojtëse ku instrumenti mbrojtës është një opSION i shkruar më vete; ose kur elementi i mbrojtur është një pozicion neto në një mbrojtje të flukseve monetare për një rrezik tjetër të ndryshëm nga rreziku i monedhës së huaj). Megjithatë, nëse një zbatues për herë të parë ka përcaktuar një pozicion neto si një element të mbrojtur në përputhje me bazën e tij të mëparshme të kontabilitetit, ai mund të klasifikojë si një element të mbrojtur në përputhje me SNKSP-të një element individual brenda atij pozicioni neto, ose një pozicion neto nëse ai plotëson kërkesat në paragrafin 146 të SNKSP 41, me kusht që ta bëjë këtë jo më vonë se data e zbatimit të SNKSP-ve ose kur përfiton nga përjashtimi që ofron një periudhë lehtësimi kalimtare trevjeçare për të mos njohur dhe/ose matur instrumentet financiare; datën kur ka skaduar përjashtimi që dha lehtësimin, dhe/ose instrumentet financiare përkatës njihen dhe/ose maten në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme (cilado të jetë më herët).

119. Nëse, përpara datës së zbatimit të SNKSP-ve, ose kur një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimi që ofron një periudhë lehtësimi kalimtare trevjeçare për të mos njohur dhe/ose matur instrumentet financiare, datën në të cilën përjashtimi që dha lehtësimin ka skaduar dhe/ose instrumentet financiare përkatëse njihen dhe/ose maten në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme (cilado të jetë më herët), një zbatues për herë të parë ka klasifikuar një transaksion si një të mbrojtur, por mbrojtja nuk i plotëson kushtet për kontabilitetin mbrojtës në SNKSP 41, zbatuesi për herë të parë do të zbatojë paragrafët 135 dhe 136 të SNKSP 41 për të ndërprerë kontabilitetin mbrojtës. Transaksionet e kryera përpara datës së zbatimit të SNKSP-ve, ose kur një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimi që ofron një periudhë lehtësimi kalimtare trevjeçare për të mos njohur dhe/ose matur instrumentet financiare, datën kur skadon përjashtimi kalimtar dhe/ose instrumentet financiare përkatëse njihen dhe/ose maten në përputhje me SNKSP 41 (cilado të jetë më herët), nuk do të klasifikohen në mënyrë retrospektive si të mbrojtur.

Klasifikimi dhe Matja e Instrumenteve Financiare

- 119A. Një njësi do të vlerësojë nëse një aktiv financiar plotëson kushtet në paragrafin 40 ose kushtet në paragrafin 41 të SNKSP 41, bazuar në faktet dhe rrethanat që ekzistojnë në datën e zbatimit të SNKSP-ve.
- 119B. Nëse është e papraktikueshme të vlerësohet një element monetar i modifikuar i vlerës kohore në përputhje me paragrafët AG68-AG70 të SNKSP 41 mbi bazën e fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e kalimit tek SNKSP-të, një njësi do të vlerësojë karakteristikat kontraktuale të fluksit monetar të atij aktivi financiar në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e zbatimit të SNKSP-ve pa marrë parasysh kërkesat që lidhen me modifikimin e elementit monetar të vlerës kohore në paragrafët AG68–AG70 të SNKSP 41. (Në këtë në

rast, njësia do të zbatohet gjithashtu paragrafin 49J të SNKSP 30, por referencat e 'paragrafit 161 të SNKSP 41' do të lexohen për të nënkuptuar këtë paragraf dhe referencat për 'njohtjen fillestare të aktivitetit financiar' do të lexohen se nënkuptojnë 'në datën e zbatimit të SNKSP-ve'.)

- 119C. Nëse është e pamundur të vlerësohet nëse vlera e drejtë e një tipari të parapagimit nuk është domethënëse në përputhje me paragrafin AG74(c) të SNKSP 41 në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e zbatimit të SNKSP-ve, një njësi do të vlerësojë karakteristikat kontraktuale të flukseve monetare të atij aktivitetit financiar në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e zbatimit të SNKSP-ve, pa marrë parasysh përjashtimin për tiparet e parapagimit në paragrafin AG74 të SNKSP 41. (Në këtë rast, njësia gjithashtu do të zbatohet paragrafin 49K të SNKSP 30, por referencat ndaj 'paragrafit 162 të SNKSP 41' do të lexohen se nënkuptojnë këtë paragraf dhe referencat ndaj 'njohtjes fillestare të aktivitetit financiar' do të lexohen se nënkuptojnë 'në datën e zbatimit të SNKSP'.)
- 119D. Nëse është e papraktikueshme (siç përcaktohet në SNKSP 3) që një njësi ekonomike të zbatohet në mënyrë retrospektive metodën e interesit efektiv në SNKSP 41, vlera e drejtë e aktivitetit financiar ose detyrimit financiar në datën e zbatimit të SNKSP-ve do të jetë vlera e re e mbartur bruto e atij aktivitetit financiar ose kostoja e re e amortizuar të atij detyrimi financiar në datën e zbatimit të SNKSP-ve.

Zhvlerësimi i Aktiveve Financiare

120. **Një zbatues për herë të parë do të zbatohet kërkesat e zhvlerësimit në mënyrë prospektive nga data e zbatimit të SNKSP-ve, përveç në lidhje me ata aktive financiare ku ai përfiton nga përjashtimet në paragrafët 36, 38 dhe 42, të cilët lejojnë një periudhë trevjeçare lehtësimi për të mos njohur dhe/ose matur instrumentet financiare. Kur një zbatues për herë të parë zbaton periudhën trevjeçare të lehtësimit kalimtar të dhënë, ai zbaton dispozitat e zhvlerësimit kur përjashtimi që dha lehtësimin ka skaduar dhe/ose instrumentet financiare përkatës njihen dhe/ose maten në përputhje me SNKSP 41 (cilado të jetë më herët).**
121. Një zbatues për herë të parë, në datën e zbatimit të SNKSP-ve, ose kur përjashtimet që dhanë lehtësimin kanë skaduar dhe/ose kur instrumentet financiare përkatës njihen dhe/ose maten dhe informacioni përkatës paraqitet dhe/ose shoqërohet me shënime shpjeguese në pasqyrat financiare në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme (cilado të jetë më herët), do të vlerësojë në atë datë nëse ka ndonjë tregues se instrumenti financiar i njohur dhe/ose i matur në pasqyrën e pozicionit financiar është zhvlerësuar. Çdo humbje e shkaktuar nga zhvlerësimi do të njihet në sufiçitin ose defiçitin fillestar të akumuluar në periudhën në të cilën instrumenti financiar njihet dhe/ose matet.

122. Një zbatues për herë të parë do të zbatojë kërkesat e zhvlerësimit në mënyrë prospektive. Kjo do të thotë se në datën e zbatimit t SNKSP 41, kur përjashtimet që dhanë lehtësimin kanë skaduar dhe/ose kur instrumentet financiare përkatës njihen dhe/ose maten, një zbatuesi për herë të parë do t'i kërkohe të vlerësojë nëse ka një tregues se instrumenti financiar është zhvlerësuar. Çdo humbje nga zhvlerësimi do të njihet në sufiçitin ose defiçitin fillestar të akumuluar në datën e miratimit të SNKSP-ve, ose në sufiçitin ose defiçitin e akumuluar fillestar të periudhës së raportimit në të cilën kanë skaduar përjashtimet që dhanë lehtësimin dhe/ose instrumentet financiare përkatës njihen dhe/ose maten (cilado të jetë më herët).
- 122A. Në datën e zbatimit të SNKSP 41, kur përjashtimet që dhanë lehtësimin kanë skaduar dhe/ose kur instrumentet financiare përkatëse njihen dhe/ose maten, një zbatues për herë të parë do të përdorë informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetshëm që është i disponueshëm pa kosto ose përpjekje të panevojshme për të përcaktuar rrezikun e kreditit në datën që instrumentet financiare u njohën fillimisht (ose për angazhimet e kredisë dhe kontratat e garancisë financiare datën që njësia ekonomike u bë palë në angazhimin e pakthyeshëm në përputhje me paragrafin 78 të SNKSP 41) dhe krahasuar atë ndaj rrezikut të kreditit në datën e zbatimit të SNKSP-ve (shih gjithashtu paragrafët AG350–AG351 të SNKSP 41).
- 122B. Kur përcaktohet nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë/kreditit që nga njohja fillestare, një njësi mund të zbatojë:
- (a) Kërkesat në paragrafin 82 dhe AG179–AG182 të SNKSP 41; dhe
 - (b) Presupozimi i kundërshtueshëm në paragrafin 83 të SNKSP 41 për pagesat kontraktuale që janë më shumë se 30 ditë me vonesë nëse një njësi ekonomike do të zbatojë kërkesat e zhvlerësimit duke identifikuar rritje të konsiderueshme në rrezikun e kreditit që nga njohja fillestare për ato instrumente financiare në bazë të informacionit të vonesave.
- 122C. Nëse, në datën e zbatimit të SNKSP-ve, përcaktimi nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kreditit që nga njohja fillestare e një instrumenti financiar do të kërkonte kosto ose përpjekje të panevojshme, një njësi ekonomike do të njohë një shumë të lejuar për kompensimin e humbjes në një shumë të barabartë me humbjet e kreditit të pritura gjatë gjithë jetës në çdo datë raportimi derisa ai instrument financiar të çregjistrohet (përveç rastit kur ai instrument financiar është me rrezik të ulët krediti në një datë raportimi, në të cilin rast zbatohet paragrafi 122B(a)).

Derivatvët e Përfshirë

- 122E. Një zbatues për herë të parë do të vlerësojë nëse një derivativ i përfshirë duhet të ndahet nga kontrata bazë dhe të kontabilizohet si një derivativ në bazë të kushteve që ekzistonin në më të vonën e të datës kur u bë për herë të parë palë në kontratë dhe datës që kërkohe një rivlerësim nga paragrafi AG109 i SNKSP 41.

SNKSP 30, Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese

123. **Kur zbatuesi për herë të parë zgjedh të paraqesë informacion krahasues në përputhje me paragrafin 78, atij nuk i kërkohet të paraqesë informacion në lidhje me natyrën dhe shtrirjen e rreziqeve që vijnë nga instrumentet financiare për periudhën krahasuese në pasqyrat e tij financiare të para kalimtare sipas SNKSP-ve ose pasqyrat e tij të para financiare sipas SNKSP-ve.**
124. **Një zbatues për herë të parë do të zbatojë kërkesat në SNKSP 30 në mënyrë prospektive që nga data e zbatimit të SNKSP-ve, ose kur përjashtimet që dhanë lehtësimin kanë skaduar, dhe/ose kur instrumenti financiar përkatës të njihet dhe/ose matet në përputhje me SNKSP 41 (cilado të jetë më herët).**

SNKSP 31, Aktivët Afatgjatë Jomateriale

125. **Një zbatues për herë të parë do të njohë dhe/ose masë një aktiv afatgjatë jomaterial të gjeneruar së brendshmi nëse ai plotëson përkufizimin e një aktivi afatgjatë jomaterial dhe kriteret e njohjes në SNKSP 31, edhe nëse zbatuesi për herë të parë, sipas bazës së tij të mëparshme të kontabilitetit, ka shpenzuar kosto të tilla. Një kosto e supozuar nuk mund të përcaktohet për aktivët afatgjatë jomateriale të gjeneruar së brendshmi.**
126. Siç kërkohet nga paragrafi 20, një zbatuesi për herë të parë i kërkohet të njohë të gjithë aktivët për të cilët kërkohet njohja nga SNKSP-të. Prandaj, një zbatues për herë të parë do të njohë çdo aktiv afatgjatë jomaterial të krijuar së brendshmi nëse plotëson përkufizimin e një aktivi afatgjatë jomaterial dhe kriteret e njohjes në SNKSP 31, pavarësisht nëse këto kosto janë shpenzuar sipas bazës së tij të mëparshme të kontabilitetit.

SNKSP 32, Marrëveshjet Konçesionare të Shërbimit

Matja Fillestare e Detyrimit të Shoqëruar

127. **Kur një zbatues për herë të parë zgjedh të masë aktivët konçesionare të shërbimit duke përdorur koston e supozuar, detyrimet përkatëse do të maten si më poshtë:**
- (a) **Për detyrimin sipas modelit të detyrimit financiar, flukset monetare të mbetur kontraktualë të specifikuar në marrëveshjen detyruese dhe normën e përshkruar në SNKSP 32; ose**
 - (b) **Për detyrimin sipas modelit të dhënies së të drejtës ndaj operatorit, vlera e drejtë e aktivit minus çdo detyrim financiar, e rregulluar për të pasqyruar periudhën e mbetur të marrëveshjes konçesionare të shërbimit.**
128. **Një zbatues për herë të parë do të njohë dhe/ose masë çdo ndryshim midis vlerës së aktivit të konçesionit të shërbimit dhe detyrimit financiar sipas modelit të detyrimit financiar në paragrafin 127 në sufiçitin ose defiçitin**

fillestar të akumuluar në periudhën në të cilën zërat janë njohur dhe/ose të matur.

SNKSP 34, Pasqyrat Financiare të Veçanta, SNKSP 35, Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe SNKSP 36, Investime në Shoqëri dhe Sipërmarrje të Përbashkëta

129. Nëse një njësi e kontrolluar bëhet një zbatues për herë të parë më vonë se njësia e saj kontrolluese, me përjashtim të njësisë të kontrolluar të një njësie investuese, njësia e kontrolluar, në pasqyrat e saj financiare, do të matë aktivet dhe detyrimet e saj me ose:

- (a) Vlerën e mbartur të përcaktuar në përputhje me këtë SNKSP që do të përfshihej në pasqyrat financiare të konsoliduara të njësisë ekonomike, bazuar në datën e miratimit të SNKSP-ve nga njësia e kontrolluar, nëse nuk do të ishin bërë rregullime për procedurat e konsolidimit dhe për efektet e kombinimit të sektorit publik në të cilën njësia kontrolluese e bleu njësinë e kontrolluar; ose
- (b) Vlerat e mbartura të kërkuara nga pjesa tjetër e këtij SNKSP, bazuar në datën e miratimit të SNKSP-ve nga njësia e kontrolluar. Këto vlera të mbartura mund të ndryshojnë nga ato të përshkruara në (a):
 - (i) Kur përjashtimet në këtë SNKSP rezultojnë në matje që varen nga data e miratimit të SNKSP-ve.
 - (ii) Kur politikat kontabël të përdorura në pasqyrat financiare të njësisë së kontrolluar ndryshojnë nga ato në pasqyrat financiare të konsoliduara. Për shembull, njësia e kontrolluar mund të përdorë si politikë kontabël modelin e kostos në SNKSP 17, ndërsa njësia mund të përdorë modelin e rivlerësimit.

Një zgjedhje e ngjashme është e disponueshme për një shoqëri ose sipërmarrje të përbashkët që bëhet zbatuese për herë të parë më vonë se një njësi që ka ndikim të konsiderueshëm ose kontroll të përbashkët mbi të.

130. Megjithatë, nëse një njësi kontrolluese bëhet zbatuese për herë të parë më vonë se njësia e saj e kontrolluar (ose shoqëria ose sipërmarrja e përbashkët), njësia kontrolluese, në pasqyrat e saj financiare të konsoliduara, do të masë aktivet dhe detyrimet e njësisë së kontrolluar (ose shoqërisë ose sipërmarrjes së përbashkët) me të njëjtat vlera të mbartura si në pasqyrat financiare të njësisë së kontrolluar (ose shoqërisë ose sipërmarrjes së përbashkët), pas rregullimit për konsolidimin dhe rregullimet e kontabilitetit të kapitalit dhe për efektet e kombinimit të sektorit publik në të cilin njësia kontrolluese bleu njësinë e kontrolluar (ose shoqërinë ose sipërmarrjen e përbashkët), subjekt i përjashtimeve që mund të zbatohen në termat e këtij SNKSP. Në mënyrë të ngjashme, nëse një njësi

e kontrolluar bëhet një zbatues për herë të parë për pasqyrat e veta financiare të veçanta më herët ose më vonë se sa për pasqyrat e saj financiare të konsoliduara, ajo do të masë aktivet dhe detyrimet e saj me të njëjtat shuma në të dyja pasqyrat financiare, subjekt i përjashtimeve që mund të jenë zbatuar në këtë SNKSP, me përjashtim të rregullimeve të konsolidimit.

SNKSP 35, Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

131. Një zbatues për herë të parë që është një njësi e kontrolluar do të vlerësojë nëse është një njësi investuese në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e zbatimit të SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, dhe të masë investimin e tij në secilën njësi të kontrolluar me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit në datën e zbatimit të SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

SNKSP 37, Marrëveshjet e Përbashkëta

132. Kur një zbatues për herë të parë kontabilizoi investimin e tij në një sipërmarrje të përbashkët sipas bazës së mëparshme të kontabilitetit duke përdorur konsolidimin proporcional, investimi në sipërmarrjen e përbashkët do të matet në datën e zbatimit si totali i vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve që njësia i ka konsoliduar më parë në mënyrë proporcionale, duke përfshirë çdo emër të mirë të blerë që vjen nga transaksionet e blerjes (shih SNKSP 40).
133. Balanca fillestare e investimit e përcaktuar në përputhje me paragrafin 132 konsiderohet si kosto e supozuar e investimit në njohjen fillestare. Një zbatues për herë të parë do të testojë investimin për zhvlerësim në datën e miratimit, pavarësisht nëse ka ndonjë tregues se investimi mund të jetë zhvlerësuar. Çdo humbje nga zhvlerësimi do të rregullohet tek suficitit ose deficitit i akumuluar në datën e zbatimit.
134. Nëse grupimi i të gjitha aktiveve dhe detyrimeve të konsoliduara më parë në mënyrë proporcionale rezulton në aktive neto negative, zbatuesi për herë të parë duhet të vlerësojë nëse ka obligime ligjore ose konstruktive në lidhje me aktivet neto negative dhe, nëse po, zbatuesi për herë të parë do të njohë një detyrim përkatës. Nëse zbatuesi për herë të parë arrin në përfundimin se nuk ka obligime ligjore ose konstruktive në lidhje me aktivet neto negative, ai nuk do të njohë detyrimin përkatës, por do të rregullojë suficitin ose deficitin e akumuluar në datën e miratimit. Zbatuesi për herë të parë duhet të paraqesë këtë fakt, së bashku me pjesën e tij kumulative të panjohur të humbjeve të sipërmarrjeve të tij të përbashkëta në datën e zbatimit të SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

SNKSP 42, *Përfitimet Sociale*

- 134A. Në datën e miratimit të SNKSP-ve, ose kur një zbatues për herë të parë

përfiton nga përjashtimi kalimtar trevjeçar, data në të cilën skadon përjashtimi, ose kur detyrimet përkatëse njihen dhe/ose maten në pasqyrat financiare (cilado të jetë më herët), një zbatues për herë të parë do të përcaktojë detyrimin e tij fillestar për një skemë përfitimesh sociale në atë datë në përputhje me SNKSP 42.

- 134B. Nëse detyrimi fillestar në përputhje me paragrafin 134A është më shumë ose më pak se detyrimi që është njohur dhe/ose matur në fund të periudhës krahasuese sipas bazës së mëparshme të kontabilitetit të zbatuesit për herë të parë, zbatuesi për herë të parë do të njohë atë rritje/ulje në suficitin ose deficitin fillestar të akumuluar në periudhën në të cilën zërat/artikujt njihen dhe/ose maten.

Dhënia e Informacioneve Shpjegues

135. Një zbatues për herë të parë me pasqyra financiare që përputhen me kërkesat e këtij SNKSP duke përfituar nga përjashtimet dhe dispozitat kalimtare që ndikojnë në paraqitjen e drejtë dhe aftësinë e tij për të pohuar përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duhet të bëjë një deklaratë të qartë dhe të parezervuar të përputhshmërisë me këtë SNKSP në shënimet e pasqyrave financiare. Kjo deklaratë do të shoqërohet me një deklaratë se pasqyrat financiare nuk përputhen plotësisht me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.
136. Kur një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimet kalimtare në këtë SNKSP, zbatuesi për herë të parë do të paraqesë:
- (a) Masën në të cilën ajo ka përfituar nga përjashtimet kalimtare që ndikojnë në paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare dhe aftësinë e tij për të pohuar përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara; dhe/ose
 - (b) Masën në të cilën ai ka përfituar nga përjashtimet kalimtare që nuk ndikojnë në paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare dhe aftësinë e tij për të pohuar përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.
137. Në masën që një zbatues për herë të parë ka përfituar nga përjashtimet dhe dispozitat kalimtare në këtë SNKSP që ndikojnë në paraqitjen e drejtë dhe përputhshmërinë me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara në lidhje me aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe/ose shpenzimet, ai do të paraqesë:
- (a) Progresin e bërë drejt njohjes, matjes, paraqitjes dhe/ose shoqërimit me shënime shpjeguese të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe/ose shpenzimeve në përputhje me kërkesat e SNKSP-së së zbatueshme;

- (b) Aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe/ose shpenzimet që janë njohur dhe matur sipas një politike kontabël që nuk është në përputhje me kërkesat e SNKSP-së së zbatueshme;
 - (c) Aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe/ose shpenzimet që nuk janë matur, nuk janë paraqitur dhe/ose shoqëruar me shënime shpjeguese në periudhën e mëparshme të raportimit, por që tani njihen dhe/ose maten, dhe/ose paraqiten dhe/ose shoqërohen me shënime shpjeguese;
 - (d) Natyrën dhe shumën e çdo rregullimi të njohur gjatë periudhës së raportimit; dhe
 - (e) Një tregues se si dhe deri kur synon të përmbushë plotësisht kërkesat e SNKSP-së së zbatueshme.
138. Kur një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimi kalimtar për të mos eliminuar disa balanca, transaksione, të ardhura dhe shpenzime, dhe/ose kur zbaton lehtësimin kalimtar trevjeçar për njohjen dhe/ose matjen e interesit të tij në njësitë e kontrolluara, shoqëritë ose sipërmarrjet e përbashkëta në paragrafin 55, ai do të paraqesë informacion shpjegues për natyrën e balancave, transaksioneve, të ardhurave dhe shpenzimeve dhe/ose transaksioneve upstream (nga njësia e varur tek njësia mëmë) ose downstream (nga njësia mëmë tek njësia e varur) që janë eliminuar gjatë periudhës së raportimit.
139. Kur një zbatues për herë të parë nuk është në gjendje të paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara për shkak të përjashtimeve dhe dispozitave kalimtare të zbatuara në paragrafët 58 ose 62, ai duhet të paraqesë:
- (a) Arsyen pse pasqyrat financiare, investimet në shoqëritë ose interesat në sipërmarrjet e përbashkëta nuk mund të prezantohen si pasqyra financiare të konsoliduara; dhe
 - (b) Një tregues se kur zbatuesi për herë të parë do të jetë në gjendje të paraqesë pasqyrat financiare të konsoliduara.
140. Kërkesat për paraqitje informacionesh shpjegues të paragrafëve 135 dhe 139 do të ndihmojnë përdoruesit të gjurmojnë progresin e zbatuesit për herë të parë t'i përmbahet politikave të tij kontabël sipas kërkesave në SNKSP-të e zbatueshme gjatë periudhës kalimtare.

Shpjegimi i Periudhës Kalimtare në SNKSP

141. Një zbatues për herë të parë do të paraqesë:
- (a) Datën e miratimit të SNKSP-ve; dhe
 - (b) Informacion dhe shpjegime se si ka ndikuar kalimi nga baza e mëparshme e kontabilitetit tek SNKSP-të në pozicionin e raportuar

financiar dhe, kur është e përshtatshme, në performancën financiare të raportuar dhe flukset monetare.

Rakordime

142. **Një zbatues për herë të parë do të paraqesë në shënimet e pasqyrave të para financiare kalimtare sipas SNKSP-ve ose në pasqyrat e para financiare të tij sipas SNKSP:**
- (a) **Një rakordim të balancës së aktiveve/kapitalit neto të raportuar në përputhje me bazën e mëparshme të kontabilitetit me balancën fillestare të aktiveve/kapitalit neto në datën e zbatimit të SNKSP-ve; dhe**
 - (b) **Një rakordim të sufiçitit ose defiçitit të tij të akumuluar në përputhje me bazën e mëparshme të kontabilitetit me sufiçitin ose defiçitin e tij të akumuluar në datën e zbatimit të SNKSP-ve.**

Një njësie zbatuese për herë të parë që ka zbatuar kontabilitetin sipas pagesave dhe arkëtimeve në pasqyrat e tij financiare të mëparshme nuk i kërkohet të paraqesë rakordime të tilla.

143. Rakordimi i prezantuar në përputhje me paragrafin 142 do të japë detaje të mjaftueshme, si sasiore ashtu edhe cilësore, për t'u mundësuar përdoruesve të kuptojnë rregullimet materiale në deklarinimin fillestar të pozicionit financiar dhe, aty ku është e zbatueshme, pasqyrën krahasuese të riparaqitur të performancës financiare të paraqitura në përputhje me SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Kur shpjegimet narrative përfshihen në dokumente të tjera publike të dhëna së bashku me pasqyrat financiare, një referencë e kryqëzuar për ato dokumente do të përfshihet në shënime.
144. Nëse një njësi bëhet e vetëdijshme për gabimet e bëra sipas bazës së saj të mëparshme të kontabilitetit, rakordimet e kërkuara nga paragrafi 142 do të dallojnë korrigjimin e këtyre gabimeve nga ndryshimet në politikat kontabël.
145. **Nëse një njësi nuk ka paraqet pasqyrat financiare për periudhat e mëparshme, pasqyrat e saj financiare kalimtare sipas SNKSP-ve ose pasqyrat e para financiare sipas SNKSP-ve do të paraqesin informacion shpjegues për këtë fakt.**
146. **Kur një zbatues për herë të parë përfiton nga përjashtimet në paragrafin 36-43, të cilat lejojnë një periudhë lehtësimi kalimtare trevjeçare për të mos njohur dhe/ose matur zërat, ai do të paraqesë si pjesë të shënimeve, një rakordim të zërave që janë njohur dhe/ose matur gjatë periudhës së raportimit kur këta zëra nuk janë përfshirë në pasqyrat financiare të raportuara të mëparshme. Rakordimi do të prezantohet në çdo periudhë kur artikujt e rinj njihen dhe/ose maten në përputhje me këtë SNKSP.**
147. Rakordimi i paraqitur në përputhje me paragrafin 146 jep detaje të mjaftueshme

për t'u mundësuar përdoruesve të kuptojnë se cilët zërat janë njohur dhe/ose matur gjatë periudhës së raportimit ku zbatuesi për herë të parë zbaton një ose më shumë nga përjashtimet që ofrojnë një periudhë trevjeçare lehtësimi kalimtare për të mos njohur dhe/ose matur një zë. Rakordimi shpjegon rregullimet në pasqyrën e raportuar më parë të pozicionit financiar dhe, kur është e zbatueshme, pasqyrën e raportuar më parë të performancës financiare në çdo periudhë kur artikujt e rinj njihen dhe/ose maten në përputhje me këtë SNKSP.

Dhënia e Informacioneve Shpjegues Ku Kostoja e Supozuar Përdoret për Inventarin, Pronat e Investimit, Ndërtesat, Makineritë dhe Pajisjet, Aktivet Afatgjatë Jomateriale, Instrumentet Financiare ose Aktivet Konçesionare të Shërbimit

148. Nëse një zbatues për herë të parë përdor vlerën e drejtë, ose alternativën në paragrafët 64, 67 ose 70, si kosto të supozuar për inventarin, pronat e investimit, ndërtesat makineritë dhe pajisjet, aktivet aftagjatë jomateriale, instrumentet financiare ose aktivet konçesionare të shërbimit, pasqyrat e tij financiare do të paraqesin:
- (a) Totalin e atyre vlerave të drejta ose alternativave të tjera të matjes që janë marrë në konsideratë në përcaktimin e koston së supozuar;
 - (b) Rregullimin e përgjithshëm të vlerës së mbartur të njohur sipas bazës së mëparshme të kontabilitetit; dhe
 - (c) Nëse kostoja e supozuar është përcaktuar në datën e zbatimit të SNKSP-ve ose gjatë periudhës kalimtare.

Dhënia e Informacioneve Shpjegues ku Përdoret Kostoja e Supozuar për Investime në Njësitë e Kontrolluara, Sipërmarrjet e Përbashkëta ose Shoqëritë

149. Nëse një zbatues për herë të parë përdor vlerën e drejtë si kosto të supozuar në deklarin e tij fillestar të pozicionit financiar për një investim në një njësi ekonomike të kontrolluar, sipërmarrje të përbashkët ose shoqëri në pasqyrat e tij financiare të veçanta, pasqyrat e tij financiare të veçanta do të paraqesin:
- (a) Koston totale të supozuar të atyre investimeve për të cilat kostoja e supozuar është vlera e drejtë; dhe
 - (b) Rregullimin e përgjithshëm të vlerës së mbartur të raportuar sipas bazës së mëparshme të kontabilitetit.
150. Kërkesat për paraqitjen e informacioneve shpjegues të kërkuar në paragrafin 148 dhe 149 do të jepen në çdo periudhë kur njihen dhe/ose maten artikujt të rinj derisa të kenë skaduar përjashtimet që dhanë lehtësimin dhe/ose kur aktivet përkatëse të njihen dhe/ose maten në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme (cilado të jetë më herët).

Përfashtimet nga Kërkesat për Dhënie Informacionesh sipas SNKSP-ve gjatë Periudhës Kalimtare

151. Në masën që një zbatues për herë të parë përfiton nga përfashtimi që ofron një periudhë lehtësimi trevjeçar për të mos njohur dhe/ose matur zërat, atij nuk i kërkohet të zbatojë ndonjë kërkesë shoqëruese të paraqitjes dhe/ose shoqërimit me shënime shpjeguese në lidhje me zëra të tillë siç kërkohet në SNKSP 1, SNKSP 18 dhe/ose SNKSP-të e zbatueshme deri në momentin kur përfashtimet që dhanë lehtësimin të kenë skaduar dhe/ose kur zërat përkatës të jenë njohur dhe/ose matur në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme (cilado të jetë më herët).
152. Pavarësisht nga dispozita kalimtare në paragrafin 151, një zbatues për herë të parë inkurajohet të paraqesë informacionin e kërkuar nga SNKSP 1, SNKSP 18 dhe/ose SNKSP-të e zbatueshme sa më shpejt të jetë e mundur.

Dispozitat Kalimtare

153. Kur një zbatues për herë të parë ka zbatuar dispozitat kalimtare ekzistuese në SNKSP-të e tjera sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, ai do të vazhdojë të zbatojë këto dispozita kalimtare derisa ato të skadojnë dhe/ose zërat përkatës të njihen dhe/ose maten në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme (cilado të jetë më herët). Nëse zbatuesi për herë të parë zgjedh të zbatojë përfashtimet kalimtare në këtë SNKSP, periudha e lehtësimit që zbatohet në zbatimin e SNKSP-ve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, nuk mund të jetë më e gjatë se periudha e lehtësimit të dhënë në këtë SNKSP.

Data Efektive

154. Një zbatues për herë të parë do të zbatojë këtë Standard nëse pasqyrat financiare të tij të para sipas SNKSP janë për një periudhë që fillon në ose pas datës 1 janar, 2017. Zbatimi i mëparshëm lejohet.
- 154A. Paragrafët 7 dhe 8 u fshinë nga *Zbatueshmëria e SNKSP-ve*, botuar në prill 2016. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2018. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.
- 154B. Paragrafët 36, 102, 104 dhe 105 u ndryshuan dhe paragrafët 106 dhe 107 u fshinë nga SNKSP 39, *Përfutimet e Punonjësve*, botuar në korrik 2016. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2018. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi i zbaton këta ndryshime për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të paraqesë

informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatohet SNKSP 39 në të njëjtën kohë.

- 154C. Paragrafët 86, 129, 130 dhe 132 u ndryshuan dhe paragrafët 62A-62C u shtuan nga SNKSP 40, *Kombinimet e Sektorit Publik*, botuar në janar 2017. Një njësi do t'i zbatohet këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2019. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2019, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatohet SNKSP 40 në të njëjtën kohë.
- 154D. Paragrafët 36, 64, 72, 113, 114, 115, 116, 117, 118, 119, 120, 121, 122 dhe 124 u ndryshuan dhe paragrafët 114A, 119A, 119B, 119C, 119D, 122A, 122B, 122C, dhe 122D u shtuan nga SNKSP 41, i publikuar në gusht 2018. Një njësi do t'i zbatohet këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2022. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2022, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatohet SNKSP 41 në të njëjtën kohë.
- 154E. Paragrafët 78, 79, 123 dhe 142 u ndryshuan nga *Përmirësime të SNKSP-ve, 2018*, botuar në tetor 2018. Një njësi do t'i zbatohet këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2019. Zbatimi i mëparshëm lejohet.
- 154F. Paragrafi 85A u shtua nga *Përmirësime të SNKSP-ve, 2018*, botuar në tetor 2018. Një njësi do të zbatohet këtë ndryshim për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2019. Zbatimi i mëparshëm lejohet. Nëse një njësi e zbaton këtë ndryshim për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2019, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatohet ndryshimet në SNKSP 4 të përfshira në *Përmirësime të SNKSP-ve, 2018* në të njëjtën kohë.
- 154G. Paragrafi 36 u ndryshua dhe paragrafët 134A dhe 134B u shtuan nga SNKSP 42, *Përfitimet Sociale*, botuar në janar 2019. Një njësi do të zbatohet këtë ndryshim për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2019. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimin për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2019, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatohet SNKSP 42 në të njëjtën kohë.

SNKSP 34—PASQYRAT FINANCIARE TË VEÇANTA

Shënime të Mirënjohjes

Ky Standard Ndërkombëtar i Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) është hartuar kryesisht nga Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit (SNK) 27, *Pasqyrat Financiare të Veçanta* publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Ekstrakte nga SNK 27 janë riprodhuar në këtë publikim të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) me lejen e Fondacionit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Teksti i aprovuar i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) është ai i publikuar nga BSNK në gjuhën angleze dhe kopjet mund të merren direkt nga IFRS Foundation, Costumer Service, Columbus Building, 7 Westferry Circus, Canary Wharf, London E14 4HD, United Kingdom.

E-mail: publications@ifrs.org

Internet: www.ifrs.org

Të drejtat e autorit për SNRF-të, SNK-të, Draftet e Paraqitura dhe publikime të tjera të BSNK-së i përkasin Fondacionit SNRF.

"SNRF", "SNK", "BSNK", "Fondacioni SNRF", "Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit" dhe "Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar" janë marka tregtare të Fondacionit SNRF dhe nuk duhet të përdoren pa aprovimin e Fondacionit SNRF.

SNKSP 34—PASQYRAT FINANCIARE TË VEÇANTA**Historia e SNKSP**

Ky version përfshin ndryshime që rezultojnë nga SNKSP-të e botuara deri në 31 janar, 2019.

SNKSP 34, *Pasqyrat Financiare të Veçanta* u publikua në janar 2015.

Që atëherë, SNKSP 34 është ndryshuar nga SNKSP-të e mëposhtme:

- *Përmirësime të SNKSP-ve 2018* (botuar tetor 2018)
- *SNKSP 41, Instrumentet Financiare* (botuar në gusht 2018)
- *Zbatueshmëria e SNKSP-ve* (botuar në prill 2016)

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
4	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
5	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
6	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
12	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
13	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
14	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018 Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018
15	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018

PASQYRAT FINANCIARE TË VEÇANTA

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
22	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018 Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018
26	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
30	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018 Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018
32A	I Ri	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
32B	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
32C	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018

Janar 2015

SNKSP 34—PASQYRAT FINANCIARE TË VEÇANTA

PËRMBAJTJA

	Paragrafi
Objektivi	1
Objekti	2–5
Përkufizime	6–10
Pregatitja e Pasqyrave Financiare të Veçanta	11–18
Dhënia e Informacioneve Shpjeguese	19–23
Dispozita Kalimtare	24–31
Data Efektive	32–33
Shfuqizimi dhe Zëvendësimi i SNKSP 6 (Dhjetor 2006)	34

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik 34, *Pasqyrat Financiare të Veçanta*, është përcaktuar në paragrafët 1–34. Të gjithë paragrafët kanë autoritet të barabartë. SNKSP 34 duhet të lexohet në kontekstin e objektivit të tij, Bazave për Konkluzione, *Parathënies së Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik* dhe *Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar me Qëllim të Përgjithshëm nga Njësitë e Sektorit Publik*. SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, jep një bazë për zgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabël në mungesë të udhëzimeve të qarta.

Objektivi

1. Objektivi i këtij Standardi është të përshkruajë kërkesat e kontabilitetit dhe të paraqitjes së informacioneve për investimet në njësitë e kontrolluara, sipërmarrjet e përbashkëta dhe shoqëritë kur një njësi pregatit pasqyra financiare të veçanta.

Objekti

2. Një njësi që pregatit dhe paraqet pasqyrat financiare sipas kontabilitetit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara do të zbatojë këtë Standard në kontabilizimin e investimeve në njësitë e kontrolluara, sipërmarrjet e përbashkëta dhe shoqëritë kur zgjedh, ose është e detyruar nga rregulloret, të prezantojë pasqyra financiare të veçanta.
3. Ky Standard nuk vendos se cilat njësi ekonomike përgatisin pasqyra financiare të veçanta. Ai zbatohet kur një njësi ekonomike pregatit pasqyra financiare të veçanta që përputhen me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP).
4. [Fshirë]
5. [Fshirë]

Përkufizime

6. Termat e mëposhtëm përdoren në këtë Standard me kuptimet e specifikuara:

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë pasqyrat financiare të një njësie ekonomike në të cilat aktivet, detyrimet, aktivet/kapitali neto, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset monetare të njësisë kontrolluese dhe njërive të kontrolluara paraqiten si ato të një njësie ekonomike të vetme.

Pasqyrat financiare të veçanta janë ato të paraqitura nga një njësi, në të cilat njësia mund të zgjedhë, duke iu nënshtruar kërkesave në këtë Standard, të kontabilizojë investimet e saj në njësitë e kontrolluara, sipërmarrjet e përbashkëta dhe shoqëritë ose me kosto, në përputhje me SNKSP 41, *Instrumentet Financiare*, ose duke përdorur metodën e kapitalit siç përshkruhet në SNKSP 36, *Investimet në Shoqëri dhe Sipërmarrje të Përbashkëta*.

Termat e përkufizuar në SNKSP-të e tjera përdoren në këtë Standard me të njëjtin kuptim si në ato Standarde dhe riprodhohen në *Fjalorin e Termave të Përkufizuar publikuar* veçmas. Termat e mëposhtëm përkufizohen në SNKSP 35, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara*, SNKSP 36, *Investimet në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta* ose SNKSP 37, *Marrëveshjet e Përbashkëta*: shoqëri, kontroll, njësi e kontrolluar, njësi kontrolluese, njësi ekonomike, metoda e kapitalit, njësi investimi, kontroll i përbashkët,

operacion i përbashkët, sipërmarrje e përbashkët, sipërmarrës i përbashkët dhe ndikim i konsiderueshëm.

7. Pasqyrat financiare të veçanta janë ato të prezantuara krahas pasqyrave financiare të konsoliduara ose krahas pasqyrave financiare të një investuesi që nuk ka njësi ekonomike të kontrolluara, por ka investime në shoqëri ose sipërmarrje të përbashkëta në të cilat investimet në shoqëri ose sipërmarrje të përbashkëta kërkohen nga SNKSP 36 të kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit, në rrethana të ndryshme nga rrethanat e përcaktuara në paragrafët 9–10.
8. Pasqyrat financiare të një njësie që nuk ka një njësi të kontrolluar, shoqëri ose interes të një sipërmarrësi të përbashkët në një sipërmarrje të përbashkët nuk janë pasqyra financiare të veçanta.
9. Një njësi që përjashtohet në përputhje me paragrafin 5 të SNKSP 35, nga konsolidimi ose paragrafin 23 të SNKSP 36, nga zbatimi i metodës së kapitalit mund të prezantohet pasqyra financiare të veçanta si pasqyrat e saj financiare të vetme.
10. Një njësi investuese të cilës i kërkohet, gjatë periudhës aktuale dhe të gjitha periudhave krahasuese të prezantuara, të matë investimin e saj në të gjitha njësitë e saj të kontrolluara me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit në përputhje me paragrafin 56 të SNKSP 35, prezanton pasqyrat financiare të veçanta si pasqyrat e saj financiare të vetme.

Pregatitja e Pasqyrave Financiare të Veçanta

11. **Pasqyrat financiare të veçanta do të pregatiten në përputhje me të gjitha SNKSP-të e zbatueshme, përveç siç parashikohet në paragrafin 12.**
12. **Kur një njësi pregatit pasqyra financiare të veçanta, ajo do të kontabilizojë investime të ngjashme në njësi të kontrolluara, sipërmarrje të përbashkëta dhe shoqëri ose:**
 - (a) **Me kosto;**
 - (b) **Në përputhje me SNKSP 41; ose**
 - (c) **Duke përdorur metodën e kapitalit të përshkruar në SNKSP 36.**
13. **Nëse një njësi zgjedh, në përputhje me paragrafin 24 të SNKSP 36, të masë investimet e saj në shoqëri ose sipërmarrje të përbashkëta me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit në përputhje me SNKSP 41, ajo gjithashtu do t'i kontabilizojë ato investime në të njëjtën mënyrë në pasqyrat e saj financiare të veçanta.**
14. **Nëse një njësie kontrolluese i kërkohet, në përputhje me paragrafin 56 të SNKSP 35, të masë investimin e saj në një njësi të kontrolluar me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit në përputhje me SNKSP 29 (ose**

SNKSP 41 kur një njësi zbaton atë Standard), ajo duhet gjithashtu të kontabilizojë atë investim në të njëjtën mënyrë në pasqyrat e saj financiare të veçanta. Një njësi kontrolluese që nuk është në vetvete një njësi investuese, do të masë investimet e saj në një njësi të kontrolluar investimi në përputhje me paragrafin 12 në pasqyrat e saj financiare të veçanta.

15. Kur një njësi kontrolluese ndalon së qeni një njësi investuese, ose bëhet një njësi investuese, ajo do të kontabilizojë ndryshimin nga data kur ka ndodhur ndryshimi në status, si më poshtë:
- (a) Kur një njësi ndalon së qeni një njësi investuese, njësia do të kontabilizojë një investim në një njësi të kontrolluar në përputhje me paragrafin 12. Data e ndryshimit të statusit do të jetë data e supozuar e blerjes. Vlera e drejtë e njësisë së kontrolluar në datën e supozuar të blerjes do të përfaqësojë shumën e supozuar të transferuar kur kontabilizohet investimi në përputhje me paragrafin 12.
 - (b) Kur një njësi bëhet një njësi investuese, ajo do të kontabilizojë një investim në një njësi të kontrolluar me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit në përputhje me SNKSP 41. Diferenca midis vlerës së mbartur të mëparshme të njësisë së kontrolluar dhe vlerës së drejtë të saj në datën e ndryshimit të statusit të investuesit do të njihet si fitim ose humbje në suficit ose deficit. Shuma e akumuluar e çdo fitimi ose humbjeje të njohur më parë drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto në lidhje me ato njësi të kontrolluara do të trajtohet sikur njësia investuese t'i kishte nxjerrë nga operimi/përdorimi ato njësi të kontrolluara në datën e ndryshimit të statusit.
16. Dividendët ose shpërndarjet e ngjashme nga një njësi e kontrolluar, një sipërmarrje e përbashkët ose një shoqëri njihen në pasqyrat financiare të veçanta të një njësie kur vendoset e drejta e njësisë për të marrë dividendin ose shpërndarjen e ngjashme. Dividendi ose shpërndarja e ngjashme njihet në suficit ose deficit, përveç rasteve kur njësia zgjedh të përdorë metodën e kapitalit, rast në të cilin dividendi ose shpërndarja e ngjashme njihet si një reduktim nga vlera e mbartur e investimit.
17. Kur një njësi kontrolluese riorganizon strukturën e njësisë ekonomike të saj duke krijuar një njësi të re si njësinë e saj kontrolluese në një mënyrë që plotëson kriteret e mëposhtme:
- (a) Njësia e re kontrolluese merr kontrollin e njësisë fillestare kontrolluese ose (i) duke emetuar instrumente të kapitalit në këmbim të instrumenteve ekzistues të kapitalit të njësisë kontrolluese fillestare ose (ii) me ndonjë mekanizëm tjetër që rezulton në njësinë e re kontrolluese të ketë një interes pronësor kontrollues në njësinë kontrolluese origjinale;

- (b) Aktivët dhe detyrimet e njësisë së re dhe të njësisë origjinale janë të njëjta menjëherë para dhe pas riorganizimit; dhe
- (c) Pronarët e njësisë kontrolluese fillestare përpara riorganizimit kanë të njëjtat interesa absolute dhe relative në aktivet neto të njësisë origjinale dhe të njësisë të re menjëherë para dhe pas riorganizimit;

dhe njësia e re kontrolluese kontabilizon investimin e saj në njësinë origjinale kontrolluese në përputhje me paragrafin 12(a) në pasqyrat e saj financiare të veçanta, njësia e re kontrolluese do të matë koston me vlerën e mbartur të pjesës së saj të zërave të aktiveve/kapitalit neto të paraqitur në pasqyrat financiare të veçanta të njësisë origjinale kontrolluese në datën e riorganizimit.

18. Në mënyrë të ngjashme, një njësi që nuk është një njësi kontrolluese mund të krijojë një njësi ekonomike të re si njësinë e saj kontrolluese në një mënyrë që plotëson kriteret në paragrafin 17. Kërkesat në paragrafin 17 zbatohen njëjloj për riorganizime të tilla. Në raste të tilla, referencat për "njësinë kontrolluese origjinale" dhe "njësinë ekonomike origjinale" i referohen "njësisë origjinale."

Dhënia e Informacioneve Shpjeguese

19. Një njësi do të zbatojë të gjitha SNKSP-të e zbatueshme kur jep informacione shpjegues në pasqyrat e saj financiare të veçanta, duke përfshirë kërkesat në paragrafët 20-23.
20. Kur një njësi kontrolluese, në përputhje me paragrafin 5 të SNKSP 35, zgjedh të mos përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara dhe në vend të kësaj përgatit pasqyra financiare të veçanta, ajo duhet të paraqesë në ato pasqyra financiare të veçanta:
- (a) Faktin se pasqyrat financiare janë pasqyra financiare të veçanta; se është përdorur përjashtimi nga konsolidimi; emrin e njësisë, pasqyrat financiare të konsoliduara të së cilës, që janë në përputhje me SNKSP-të, janë prodhuar për përdorim publik; dhe adresën ku mund të merren këto pasqyra financiare të konsoliduara.
 - (b) Një listë të investimeve të rëndësishme në njësitë e kontrolluara, sipërmarrjet e përbashkëta dhe shoqëritë, duke përfshirë:
 - (i) Emrin e atyre njësisve të kontrolluara, sipërmarrjeve të përbashkëta dhe shoqërive.
 - (ii) Juridiksionin në të cilin veprojnë këto njësi të kontrolluara, sipërmarrje të përbashkëta dhe shoqëri (nëse është i ndryshëm nga ai i njësisë ekonomike kontrolluese).
 - (iii) Proporcionin e tij të interesit të pronësisë që mbahet në ato njësi dhe një përshkrim se si është përcaktuar ai interes i pronësisë.

- (c) Një përshkrim të metodës së përdorur për të kontabilizuar njësitë e kontrolluara, sipërmarrjet e përbashkëta dhe shoqëritë e renditura nën (b).
21. Kur një njësi investuese që është një njësi kontrolluese (e ndryshme nga një njësi kontrolluese e mbuluar nga paragrafi 20) pregatit, në përputhje me paragrafin 10, pasqyra financiare të veçanta si pasqyrat e saj financiare të vetme, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt. Njësia investuese do të prezantojë gjithashtu informacione shpjegues në lidhje me njësitë investuese të kërkuara nga SNKSP 38, *Paraqitja e Interesave në Njësitë e Tjera*.
22. Nëse një njësi kontrolluese që nuk është vetë një njësi investuese, kërkohet të zbatohet kërkesat e paragrafit 58 të SNKSP 35, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për zgjedhjen e politikës së kontabilitetit për matjen e investimit të saj në njësinë e investimit në pasqyrat e saj financiare të veçanta, dhe të prezantojë informacione shpjegues në lidhje me njësitë e investimit të kërkuara nga SNKSP 38.
23. Kur një njësi kontrolluese (e ndryshme nga një njësi kontrolluese e mbuluar nga paragrafët 20-21) ose një investues me kontroll të përbashkët të, ose ndikim të rëndësishëm mbi, një të investuari pregatit pasqyra financiare të veçanta, njësia kontrolluese ose investuesi duhet të identifikojë pasqyrat financiare të pregatitura në përputhje me SNKSP 35, SNKSP 36 ose SNKSP 37, me të cilin lidhen. Njësia kontrolluese ose investuesi do të paraqesë gjithashtu në pasqyrat e saj financiare të veçanta:
- (a) Faktin se pasqyrat janë pasqyra financiare të veçanta dhe arsytet pse ato pasqyra pregatiten, nëse nuk kërkohet nga legjislacioni ose autoriteti tjetër.
- (b) Një listë të njësive të rëndësishme të kontrolluara, sipërmarrjeve të përbashkëta dhe shoqërive, duke përfshirë:
- (i) Emrin e atyre njësive të kontrolluara, sipërmarrjeve të përbashkëta dhe shoqërive.
- (ii) Juridiksionin në të cilin veprojnë këto njësi të kontrolluara, sipërmarrje të përbashkëta dhe shoqëri (nëse është i ndryshëm nga ai i njësisë kontrolluese).
- (iii) Proporcionin e tij të interesit të pronësisë që mbahet në ato njësi dhe një përshkrim se si është përcaktuar ai interes i pronësisë.
- (c) Një përshkrim të metodës së përdorur për të kontabilizuar njësitë të kontrolluara, sipërmarrjet e përbashkëta dhe shoqëritë e renditura nën (b).

Dispozitat Kalimtare

24. Në datën e zbatimit fillestar, një njësi investuese që matë më parë investimin e saj në një njësi të kontrolluar me kosto, do ta masë, në vend të kësaj, atë investim me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit sikur kërkesat e këtij Standardi të kishin qenë gjithmonë efektive. Njësia investuese do të rregullojë në mënyrë retrospektive periudhën vjetore menjëherë përpara datës së zbatimit fillestar dhe do të rregullojë sufiçitin/defiçitin e akumuluar në fillim të periudhës menjëherë paraardhëse për çdo diferencë midis:
- (a) Vlerës së mbartur të mëparshme të investimit; dhe
 - (b) Vlerës së drejtë të investimit të investuesit në njësinë e kontrolluar.
25. Në datën e zbatimit fillestar, një njësi investuese që matë më parë investimin e saj në një njësi të kontrolluar me vlerën e drejtë drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto, do të vazhdojë ta masë atë investim me vlerën e drejtë. Shuma e akumuluar e çdo rregullimi të vlerës së drejtë të njohur më parë në aktivet/kapitalin neto do të transferohet te sufiçiti/defiçiti i akumuluar në fillim të periudhës vjetore menjëherë para datës së zbatimit fillestar.
26. Në datën e zbatimit fillestar, një njësi investuese nuk duhet të bëjë rregullime në kontabilitetin e mëparshëm për një interes në një njësi të kontrolluar që kishte zgjedhur më parë të matë me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit në përputhje me SNKSP 41, siç lejohet në paragrafin 12.
27. Një njësi investuese do të përdorë shumat e vlerës së drejtë të raportuara më parë tek investuesit ose te drejtimi.
28. Nëse matja e investimit në njësinë e kontrolluar në përputhje me paragrafët 24-27 është e pamundur (siç përcaktohet në SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet e Kontabilitetit dhe Gabimet*), një njësi investuese do të zbatojë kërkesat e këtij Standardi në fillim të periudhës më të hershme për të cilën është i praktikueshëm zbatimi i paragrafëve 24-27, e cila mund të jetë periudha aktuale. Investuesi do të rregullojë në mënyrë retrospektive periudhën vjetore menjëherë para datës së zbatimit fillestar, përveç rastit kur fillimi i periudhës më të hershme për të cilën zbatimi i këtij paragrafi është i praktikueshëm, është periudha aktuale. Kur data kur është e praktikueshme që njësia e investimit të matë vlerën e drejtë të njësisë së kontrolluar është më e hershme se fillimi i periudhës menjëherë paraardhëse, investuesi duhet të rregullojë aktivet/kapitalin neto në fillim të periudhës menjëherë paraardhëse për çdo diferencë ndërmjet:
- (a) Vlerës së mbartur të mëparshme të investimit; dhe
 - (b) Vlerës së drejtë të investimit të investuesit në njësinë e kontrolluar.

Nëse periudha më e hershme për të cilën zbatimi i këtij paragrafi është i praktikueshëm është periudha aktuale, rregullimi i aktiveve/kapitalit neto do të njihet në fillim të periudhës aktuale.

29. Nëse një njësi investuese ka nxjerrë jashtë përdorimit, ose ka humbur kontrollin e, një investimi në një njësi të kontrolluar përpara datës së zbatimit fillestar të këtij Standardi, njësisë investuese nuk i kërkohet të bëjë rregullime në kontabilitetin e mëparshëm për atë investim.
30. Në datën e zbatimit fillestar, një njësi kontrolluese që nuk është në vetvete një njësi investuese, por që kërkohet, në përputhje me paragrafin 58 të SNKSP 35, të matë investimin e saj në një njësi investimi të kontrolluar me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit në përputhje me SNKSP 41, do të përdorë dispozitat kalimtare në paragrafët 24-29 në kontabilizimin e investimit të saj në njësinë të investimit të kontrolluar në pasqyrat e saj financiare të veçanta.
31. Dispozitat kalimtare për ndryshimet në kontabilitet, në pasqyrat financiare të veçanta të një njësie ekonomike, për interesin e saj në një operacion të përbashkët përcaktohen në SNKSP 37, *Marrëveshjet e Përbashkëta*.

Data Efektive

32. Një njësi do të zbatojë këtë Standard për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2017. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi e zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2017, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 35, SNKSP 36, SNKSP 37 dhe SNKSP 38 në të njëjtën kohë.
- 32A. Paragrafët 4 dhe 5 u fshinë nga *Zbatueshmëria e SNKSP-ve*, botuar në prill 2016. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2018. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.
- 32B. Paragrafët 6, 12, 13, 14, 15, 22, 26 dhe 30 u ndryshuan nga SNKSP 41, publikuar në gusht 2018. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2022. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2022, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 41 në të njëjtën kohë.
- 32C. Paragrafët 14, 22 dhe 30 u ndryshuan nga Përmirësime të SNKSP-ve, 2018, publikuar në tetor 2018. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1

janarit, 2019. Zbatimi i mëparshëm lejohet. Zbatimi i mëparshëm lejohet. Nëse një njësi i zbaton këta ndryshime për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2019, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.

33. Kur një njësi adopton SNKSP-të sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara siç përcaktohet në SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas të Drejtave dhe Detyrimeve të Konstatuara* për qëllime të raportimit financiar pas kësaj date efektive, ky Standard zbatohet për pasqyrat financiare vjetore të njësisë që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës së adoptimit të SNKSP-ve.

Shfuqizimi dhe Zëvendësimi i SNKSP 6 (Dhjetor 2006)

34. Ky Standard publikohet njëkohësisht me SNKSP 35. Së bashku, të dy Standardet zëvendësojnë SNKSP 6, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe të Veçanta* (Dhjetor 2006). SNKSP 6 mbetet i zbatueshëm derisa SNKSP 34 dhe SNKSP 35 të zbatohen ose të hyjnë në fuqi, cilado të jetë më herët.

SNKSP 35—PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA

Shënime të Mirënjohjes

Ky Standard Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) është hartuar kryesisht nga Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar (SNRF) 10, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara* publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Ekstrakte nga SNRF 10 janë riprodhuar në këtë publikim të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) me lejen e Fondacionit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Teksti i aprovuar i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) është ai i publikuar nga BSNK në gjuhën angleze dhe kopjet mund të merren direkt nga IFRS Foundation, Customer Service, Columbus Building, 7 Westferry Circus, Canary Wharf, London E14 4HD, United Kingdom.

E-mail: publications@ifrs.org

Internet: www.ifrs.org

Të drejtat e autorit për SNRF-të, SNK-të, Draftet e Paraqitura dhe publikime të tjera të BSNK-së i përkasin Fondacionit SNRF.

"SNRF", "SNK", "BSNK", "Fondacioni SNRF", "Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit" dhe "Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar" janë marka tregtare të Fondacionit SNRF dhe nuk duhet të përdoren pa aprovimin e Fondacionit SNRF.

SNKSP 35—PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA

Historia e SNKSP

Ky version përfshin ndryshime që rezultojnë nga SNKSP-të e publikuara deri më 31 janar, 2019.

SNKSP 35, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara* u publikua në janar 2015.

Që atëherë, SNKSP 35 është ndryshuar nga SNKSP-të e mëposhtme:

- SNKSP 41, *Instrumentet Financiare* (botuar në gusht 2018)
- SNKSP 40, *Kombinimet e Sektorit Publik* (botuar në janar 2017)
- SNKSP 39, *Përfitimet e Punonjësve* (botuar në korrik 2016)
- *Zbatueshmëria e SNKSP-ve* (botuar në prill 2016)

Tabela e Paragrafëve të Ndryshuar në SNKSP 35

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
4	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017
6	U Ndryshua	SNKSP 39 Korrik 2016
8	U Ndryshua	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
11	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
12	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
13	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
22	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018

PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
40	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017
45	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
52	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017 SNKSP 41 Gusht 2018
55A	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017 SNKSP 41 Gusht 2018
56	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017 SNKSP 41 Gusht 2018
57	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017
58	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
63	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017
79A	I Ri	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
79B	I Ri	SNKSP 39 Korrik 2016
79C	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
79D	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
79E	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
AG105	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018

SNKSP 35—PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA**PËRMBAJTJA**

	Paragrafi
Objektivi	1–2
Objekti	3–13
Kombinimet e Sektorit Publik	4
Prezantimi i Pasqyrave Financiare të Konsoliduara.....	5–10
Ndërmarrjet Shtetërore të Biznesit.....	11–13
Përkufizime	14–17
Marrëveshje Detyruese	15
Njësi Ekonomike	16–17
Kontrolli.....	18–37
Fuqia/Kompetenca/Pushteti	23–29
Përfitimet	30–34
Lidhja ndërmjet Fuqisë dhe Përfitimeve.....	35–37
Kërkesat e Kontabilitetit	38–55
Procedura e Konsolidimit	40
Politikat Kontabël të Unifikuara	41
Matja.....	42
Të Drejtat Potenciale të Votimit	43–45
Datat e Raportimit.....	46
Interesat Jokontrolluese	47–51
Humbja e Kontrollit.....	52–55
Njësitë Investuese: Kërkesa e Vlerës së Drejtë.....	56–64
Përcaktimi nëse një Njësi është një Njësi Investuese.....	59–60
Gjykime dhe Hamendësime.....	61–62
Kontabiliteti për një Ndryshim në Statusin e Njësisë Investuese.....	63–64

PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA

Dispozitat Kalimtare	65–78
Data Efektive	79–80
Shfuqizimi dhe Zëvendësimi i SNKSP 6 (Dhjetor 2006)	81

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik 35, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara*, është përcaktuar në paragrafët 1–81. Të gjithë paragrafët kanë autoritet të barabartë. SNKSP 35 duhet të lexohet në kontekstin e objektivit të tij, Bazës për Konkluzione, *Parathënies së Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar me Qëllim të Përgjithshëm nga Njësitë e Sektorit Publik*. SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, jep një bazë për zgjedhjen dhe zbatimin e politikave të kontabilitetit në mungesë të udhëzimeve të qarta.

Objektivi

1. Objektivi i këtij Standardi është të vendosë parime për paraqitjen dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara kur një njësi ekonomike kontrollon një ose më shumë njësi të tjera.
2. Për të përmbushur objektivin në paragrafin 1, ky Standard:
 - (a) Kërkon që një njësi (njësia kontrolluese) që kontrollon një ose më shumë njësi të tjera (njësi të kontrolluara) të prezantojë pasqyrat financiare të konsoliduara;
 - (b) Përcakton parimin e kontrollit, dhe vendos kontrollin si bazë për konsolidimin;
 - (c) Përcakton se si të zbatohet parimi i kontrollit për të identifikuar nëse një njësi kontrollon një njësi tjetër dhe për këtë arsye duhet ta konsolidojë atë njësi;
 - (d) Përcakton kërkesat e kontabilitetit për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara; dhe
 - (e) Përkufizon një njësi investuese/investimi dhe përcakton një përjashtim për konsolidimin e njësive të veçanta të kontrolluara të një njësie investuese.

Objekti

3. **Një njësi që përgatit dhe paraqet pasqyrat financiare sipas kontabilitetit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara do të zbatojë këtë Standard në përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara për njësinë ekonomike.**

Kombinimet e Sektorit Publik

4. Ky Standard nuk trajton kërkesat e kontabilitetit për kombinimet e sektorit publik dhe efektin e tyre në konsolidim, duke përfshirë emrin e mirë që krijohet nga një kombinim i sektorit publik (shih SNKSP 40, *Kombinimet e Sektorit Publik*).

Paraqitja e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara

5. **Një njësi që është një njësi kontrolluese do të paraqesë pasqyrat financiare të konsoliduara. Ky Standard zbatohet për të gjitha njësitë, me përjashtim të rastit kur një njësi kontrolluese nuk ka nevojë të paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara nëse plotëson të gjitha kushtet e mëposhtëm:**
 - (a) Ajo është në vetvete një njësi e kontrolluar dhe nevojat për informacion të përdoruesve plotësohen nga pasqyrat financiare të konsoliduara të njësisë kontrolluese dhe, në rastin e një njësie të

kontrolluar pjesërisht në pronësi, të gjithë pronarët e tjerë të saj, përfshirë ata që nuk kanë të drejtë vote, janë informuar për, dhe nuk janë në kundërshtim me mospregatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara nga njësia;

- (b) Instrumentet e saj të borxhit ose të kapitalit nuk tregtohen në një treg publik (një bursë vendase ose e huaj ose një treg informal të pa mbikqyrur, duke përfshirë tregjet lokale dhe rajonale);
- (c) Ajo nuk ka depozituar, dhe as nuk është në proces depozitimi, të pasqyrave financiare pranë një komisioni të letrave me vlerë ose në një organizatë tjetër rregullatore për qëllimin e emetimit të ndonjë klase instrumentesh në një treg publik; dhe
- (d) Njësia e saj përfundimtare ose ndonjë njësi kontrolluese e ndërmjetme prodhon pasqyra financiare që janë të disponueshme për përdorim publik dhe janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP-ve), në të cilat njësitë e kontrolluara konsolidohen ose maten me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit në përputhje me këtë Standard.

6. Ky standard nuk zbatohet për planet e përfitimeve të pas-punësimit ose plane të tjera afatgjata të përfitimeve të punonjësve për të cilat zbatohet SNKSP 39, *Përfitimet e Punonjësve*.
7. Një njësi kontrolluese që është një njësi investuese nuk do të paraqitje pasqyra financiare të konsoliduara nëse kërkohet që, në përputhje me paragrafin 56 të këtij Standardi, të matë të gjitha njësitë e saj të kontrolluara me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit.
8. Një njësi e kontrolluar nuk përjashtohet nga konsolidimi sepse aktivitetet e saj janë të ndryshme nga ato të njësive të tjera brenda njësisë ekonomike, për shembull, konsolidimi i njësive të sektorit publik tregtar me njësitë në sektorin buxhetor. Informacioni përkatës jepet duke konsoliduar njësi të tilla të kontrolluara dhe duke paraqitur informacion shtesë në pasqyrat financiare të konsoliduara për aktivitetet e ndryshme të njësive të kontrolluara. Për shembull, informacionet e kërkuara nga SNKSP 18, *Raportimi i Segmenteve*, ndihmojnë për të shpjeguar rëndësinë e aktiviteteve të ndryshme brenda njësisë ekonomike.
9. Përjashtimi nga pregatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara në paragrafin 5 nuk zbatohet kur nevojat për informacion të përdoruesve të një njësie të kontrolluar nuk do të plotësoheshin nga pasqyrat financiare të konsoliduara të njësisë të saj kontrolluese. Për shembull, pasqyrat financiare të konsoliduara në një nivel të qeverisë në tërësi mund të mos plotësojnë nevojat e informacionit të përdoruesve në lidhje me sektorët ose aktivitetet kryesore të një qeverie. Në shumë juridiksione ka kërkesa të vendosura në ligj për raportimin financiar që synojnë të adresojnë nevojat e informacionit të këtyre përdoruesve.

10. Një njësi mund t'i kërkohej, (për shembull, nga legjislacioni, ose nga përdoruesit e jashtëm) të përgatisë pasqyra financiare të përmbledhura të cilat janë për një njësi ekonomike të ndryshme nga ato të kërkuara nga ky Standard. Edhe pse pasqyra të tilla financiare bien jashtë fushëveprimit të këtij Standardi dhe nuk do të ishin në përputhje me kërkesat e këtij Standardi, një njësi mund të përdorë udhëzimet në këtë Standard në përgatitjen e pasqyrave financiare të tilla të përmbledhura.

Ndërmarrjet Shtetërore të Biznesit

11. [Fshirë]
12. [Fshirë]
13. [Fshirë]

Përkufizime

14. **Termet e mëposhtëm përdoren në këtë Standard me kuptimet e specifikuar:**

Përfitimet janë avantazhet që një njësi merr nga përfshirja e saj me njësitë e tjera. Përfitimet mund të jenë financiare ose jofinanciare. Ndikimi aktual i përfshirjes së një njësie me një njësi tjetër mund të ketë aspekte pozitive ose negative.

Marrëveshje detyruese: Për qëllimet e këtij Standardi, një marrëveshje detyruese është një marrëveshje e cila u jep palëve të drejta dhe detyrime të imponueshëm sikur të ishte në formën e një kontrate. Ato përfshijnë të drejtat nga kontratat ose të drejta të tjera ligjore.

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë pasqyrat financiare të një njësie ekonomike në të cilat aktivet, detyrimet, aktivet/kapitali neto, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset monetare të njësisë kontrolluese dhe njësisive të kontrolluara prezantohen si ato të një njësie ekonomike të vetme.

Kontrolli: Një njësi kontrollon një njësi tjetër kur njësia është e ekspozuar, ose ka të drejta, ndaj përfitimeve të ndryshueshme nga përfshirja e saj me njësinë tjetër dhe ka aftësinë të ndikojë në natyrën ose shumën e këtyre përfitimeve nëpërmjet fuqisë së saj mbi njësinë tjetër.

Një **njësi e kontrolluar** është një njësi që kontrollohet nga një njësi tjetër.

Një **njësi kontrolluese** është një njësi që kontrollon një ose më shumë njësi.

Një **vendimmarrës** është një njësi me të drejta vendimmarrëse që është ose palë kryesore ose agjente për palët e tjera.

Një **njësi ekonomike** është një njësi kontrolluese dhe njësitë e saj të kontrolluara.

Një njësi investuese/investimi është një njësi që:

- (a) Merr fonde nga një ose më shumë investues me qëllimin e ofrimit të shërbimeve të menaxhimit të investimeve ndaj (këtyre) investuesit(ve);
- (b) Ka qëllim investimin e fondeve vetëm për fitime nga rritja në vlerë e kapitalit, të ardhurave nga investimi, ose të dyja; dhe
- (c) Mat dhe vlerëson performancën e kryesisht të gjitha investimeve të saj mbi bazën e vlerës së drejtë.

Një interes iokontrollues është aktivet/kapitali neto në një njësi të kontrolluar që nuk i atribuohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një njësie kontrolluese.

Fugia/kopetencat/pushteti përbëhet nga të drejta ekzistuese që japin aftësinë aktuale për të drejtuar aktivitetet përkatëse të një njësie tjetër.

Të drejtat mbrojtëse janë të drejta të projektuara për të mbrojtur interesat e palës që i ka ato të drejta pa i dhënë asaj pushtet mbi njësinë me të cilën lidhen këto të drejta.

Aktivitetet përkatëse: Për qëllimin e këtij Standardi, aktivitetet përkatëse janë aktivitetet e një njësie potencialisht të kontrolluar që ndikojnë ndjeshëm në natyrën ose shumën e përfitimeve që një njësi merr nga përfshirja e saj me atë njësi tjetër.

Të drejtat e privimit janë të drejta për të privuar vendimmarrësin nga autoriteti i tij vendimmarrës.

Termet e përkufizuar në SNKSP-të e tjera përdoren në këtë Standard me të njëjtin kuptim si në ata Standarde dhe riprodhohen në *Fjalorin e Termave të Përkufizuar* botuar veçmas. Termet e mëposhtëm përcaktohen ose në SNKSP 36, *Investimet në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta*, SNKSP 37, *Marrëveshjet e Përbashkëta*, ose SNKSP 38, *Paraqitja e Interesave në Njësitë e Tjera*: shoqëri, interes në një njësi tjetër, sipërmarrje e përbashkët dhe ndikim i konsiderueshëm.

Marrëveshje Detyruese

15. Marrëveshjet detyruese mund të evidentohen në disa mënyra. Një marrëveshje detyruese është shpesh, por jo gjithmonë, me shkrim, në formën e një kontrate ose diskutimesh të dokumentuara ndërmjet palëve. Mekanizmat ligjorë si autoriteti legjislativ ose ekzekutiv mund të krijojnë gjithashtu rregullime të imponueshëm, të ngjashëm me marrëveshjet kontraktuale, ose më vete ose në lidhje me kontratat ndërmjet palëve.

Njësi Ekonomike

16. Termi “njësi ekonomike” përdoret në këtë Standard për të përcaktuar, për qëllime të raportimit financiar, një grup njësisish që përfshin njësinë kontrolluese dhe çdo njësi të kontrolluar. Terma të tjerë që përdoren ndonjëherë për t’iu referuar një njësie ekonomike përfshijnë njësinë administrative, njësinë financiare, njësinë e konsoliduar, dhe grupin. Një njësi ekonomike mund të përfshijë njësi me objektiva të të dyjave politikës sociale dhe tregtare/komerciale.
17. Përcaktimi i njësisë ekonomike do të duhet të bëhet duke pasur parasysh rregullimet kushtetuese në një juridiksion, në veçanti mënyrat në të cilat fuqia e qeverisë është e kufizuar dhe e ndarë, dhe se si është ngritur dhe funksionon sistemi qeveritar. Për shembull, në juridiksionet me një ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, këto mund të formojnë kolektivisht një njësi ekonomike në lidhje me të cilën ekziston nevoja e përdoruesve për pasqyra financiare të konsoliduara. Pasqyrave të tilla financiare të konsoliduara zakonisht ju referohemi si pasqyra financiare të qeverisë në tërësi.

Kontrolli (shih paragrafët AG2-AG8)

18. **Një njësi, pavarësisht nga natyra e përfshirjes së saj me një njësi tjetër, do të përcaktojë nëse ajo është një njësi kontrolluese duke vlerësuar nëse ajo kontrollon njësinë tjetër.**
19. **Një njësi kontrollon një njësi tjetër kur është e ekspozuar ose ka të drejta ndaj përfitimeve të ndryshueshme nga përfshirja e saj me njësinë tjetër dhe ka aftësinë të ndikojë në natyrën ose shumën e këtyre përfitimeve nëpërmjet fuqisë së saj mbi njësinë tjetër.**
20. **Kështu, një njësi kontrollon një njësi tjetër nëse dhe vetëm nëse njësia ka të gjitha sa vijon:**
 - (a) **Fuqi mbi njësinë tjetër (shih paragrafët 23–29);**
 - (b) **Ekspozim, ose të drejta, ndaj përfitimeve të ndryshueshme nga përfshirja e saj me njësinë tjetër (shih paragrafët 30–34); dhe**
 - (c) **Aftësinë për të përdorur fuqinë e saj mbi njësinë tjetër për të ndikuar në natyrën ose shumën e përfitimeve nga përfshirja e saj me njësinë tjetër (shih paragrafët 35–37).**
21. **Një njësi do të marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat kur vlerëson nëse ajo kontrollon një njësi tjetër. Njësia do të rivlerësojë nëse kontrollon një njësi tjetër nëse faktet dhe rrethanat tregojnë se ka ndryshime në një ose më shumë nga tre elementët e kontrollit të renditur në paragrafin 20 (shih paragrafët AG82–AG87).**
22. **Dy ose më shumë njësi kontrollojnë kolektivisht një njësi tjetër kur duhet të veprojnë së bashku për të drejtuar aktivitetet përkatëse. Në raste të tilla, për shkak se asnjë njësi e vetme nuk mund të drejtojë aktivitetet pa bashkëpunimin e**

të tjerave, asnjë njësi e vetme nuk kontrollon njësinë tjetër. Secila njësi do të kontabilizonte interesin e saj në njësinë tjetër në përputhje me SNKSP-të përkatëse, të tilla si SNKSP 36, SNKSP 37, ose SNKSP-të që trajtojnë instrumentet financiare (SNKSP 28, *Instrumentet Financiare: Paraqitja*, SNKSP 30, *Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjegues, dhe* SNKSP 41, *Instrumentet Financiare*).

Fuqia, Kompetenca ose Pushteti

23. Një njësi ka fuqi ose pushtet mbi një njësi tjetër kur njësia ka të drejta ekzistuese që i japin asaj aftësinë aktuale për të drejtuar aktivitetet përkatëse, d.m.th., aktivitetet që ndikojnë ndjeshëm në natyrën ose shumën e përfitimeve nga përfshirja e saj me njësinë tjetër. E drejta për të drejtuar politikat financiare dhe operative të një njësie tjetër tregon se një njësi ka aftësinë të drejtojë aktivitetet përkatëse të një njësie tjetër dhe shpesh është mënyra në të cilën demonstrohet pushteti në sektorin publik.
24. Fuqia/kompetenca/pushteti krijohet nga të drejtat. Në disa raste, vlerësimi i fuqisë është i drejtpërdrejtë/i thjeshtë, si p.sh. kur fuqia mbi një njësi tjetër merret drejtpërdrejt dhe vetëm nga të drejtat e votës të dhëna nga instrumentet e kapitalit, si aksionet, dhe mund të vlerësohet duke marrë parasysh të drejtat e votës nga ato aksione. Megjithatë, njësitë e sektorit publik shpesh marrin pushtetin/fuqinë mbi një njësi tjetër nga të drejta të ndryshme nga të drejtat e votës. Ata gjithashtu mund të marrin fuqi/pushtet mbi një njësi tjetër pa pasur një instrument të kapitalit që ofron evidencë të një investimi financiar. Një njësi mund të ketë të drejta të dhëna nga marrëveshjet detyruese. Këto të drejta mund t'i japin një njësie fuqi për t'i kërkuar njësisë tjetër të vendosë aktive ose të ketë detyrime në një mënyrë që ndikon në natyrën ose shumën e përfitimeve të marra nga njësia e përmendur më parë. Vlerësimi nëse të drejta të tilla krijojnë fuqi/pushtet mbi një njësi tjetër mund të jetë kompleks dhe të kërkojë që të merret parasysh më shumë se një faktor.
25. Një njësi mund të ketë fuqi/pushtet mbi një njësi tjetër edhe nëse ajo nuk ka përgjegjësi për funksionimin e përditshëm të njësisë tjetër ose mënyrën në të cilën funksionet e përcaktuara/e rekomanduara kryhen nga ajo njësi tjetër. Legjislacioni mund t'u japë organeve statutores ose zyrtarëve ligjorë fuqi/kompetenca për të kryer funksionet e tyre në mënyrë të pavarur nga qeveria. Për shembull, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Instituti i Statistikave zakonisht kanë fuqi/kompetenca ligjore për të marrë informacion dhe për të publikuar raporte pa iu drejtuar qeverisë dhe gjyqësori shpesh ka fuqi/kompetenca të veçanta për t'i dhënë efekt konceptit të pavarësisë së gjyqësorit. Legjislacioni mund të përcaktojë gjithashtu parametrat e gjerë brenda të cilëve organi ligjor kërkohet të veprojë, dhe të rezultojë në funksionimin e organit ligjor në një mënyrë që është në përputhje me objektivat e vendosura nga Parlamenti ose një organ i ngjashëm. Ekzistenca e kompetencave statutores për të operuar në mënyrë të pavarur, në vetvete, nuk përjashton mundësinë e një njësie

për të drejtuar politikat operative dhe financiare të një njësie tjetër me fuqi/kompetenca ligjore në mënyrë që të përfitojë. Për shembull, pavarësia e një banke qendrore në lidhje me politikën monetare nuk e përjashton mundësinë e kontrollit të bankës qendrore. Të gjitha faktet dhe rrethanat ende duhet të konsiderohen.

26. Ekzistenca e të drejtave mbi një njësi tjetër nuk krijon domosdoshmërisht fuqi/pushtete për qëllimet e këtij Standardi. Një njësi nuk ka fuqinë/pushtet mbi një njësi tjetër vetëm për shkak të ekzistencës së:
- (a) Kontrollit rregullator (shih paragrafin AG12); ose
 - (b) Varësisë ekonomike (shih paragrafët AG41–AG42).
27. Një njësi me aftësinë aktuale për të drejtuar aktivitetet përkatëse ka fuqi edhe nëse të drejtat e saj për të drejtuar ende nuk janë ushtruar. Evidenca se njësi ka drejtuar aktivitetet përkatëse/relevante të njësisë që vlerësohet për kontroll mund të ndihmojë në përcaktimin nëse njësi ka fuqi/pushtet, por evidenca e tillë nuk është, në vetvete, përfundimtare në përcaktimin nëse njësi ekonomike ka fuqi/pushtet mbi njësinë që vlerësohet për kontroll. Në rastin e një njësie të themeluar me aktivitete të paracaktuara, e drejta për të drejtuar aktivitetet përkatëse mund të jetë ushtruar në kohën kur është krijuar njësi.
28. Nëse dy ose më shumë njësi kanë secila të drejta ekzistuese që u japin atyre aftësinë e njëanshme për të drejtuar aktivitete të ndryshme përkatëse, njësi që ka aftësinë aktuale për të drejtuar aktivitetet që ndikojnë konsiderueshëm në natyrën ose shumën e përfitimeve nga ajo njësi ka fuqi/pushtet mbi atë njësi tjetër.
29. Një njësi mund të ketë fuqi/pushtet mbi një njësi që vlerësohet për kontroll edhe nëse njësitë e tjera kanë të drejta ekzistuese që u japin atyre aftësinë aktuale për të marrë pjesë në drejtimin e aktiviteteve përkatëse, për shembull kur një njësi tjetër ka ndikim të konsiderueshëm. Megjithatë, një njësi që zotëron vetëm të drejta mbrojtëse nuk ka fuqi/pushtet mbi një njësi tjetër (shih paragrafët AG29–AG31) dhe për rrjedhojë nuk kontrollon njësinë tjetër.

Përfitimet

30. Një njësi është e ekspozuar, ose ka të drejta, ndaj përfitimeve të ndryshueshme nga përfshirja e saj me një njësi që vlerësohet për kontroll, kur përfitimet që ajo kërkon nga përfshirja e saj kanë potencialin të ndryshojnë si rezultat i performancës së njësisë tjetër. Njësitë përfshihen me njësi të tjera me pritjen e përfitimeve pozitive financiare ose jofinanciare me kalimin e kohës. Megjithatë, në një periudhë të caktuar raportimi, ndikimi aktual i përfshirjes së një njësie me njësinë që vlerësohet për kontroll mund të jetë vetëm pozitiv, vetëm negativ ose një përzierje e pozitives dhe negatives.
31. Përfitimet e njësisë nga përfshirja e saj me njësinë që vlerësohet për kontroll mund të jenë vetëm financiare, vetëm jofinanciare ose financiare dhe

jofinanciare. Përfitimet financiare përfshijnë fitimet nga investimi si dividendët ose shpërndarjet e ngjashme dhe ndonjëherë quhen "fitime". Përfitimet jofinanciare përfshijnë avantazhet që vijnë nga burimet e pakta që nuk maten në terma financiare dhe përfitimet ekonomike të marra drejtpërdrejt nga marrësit e shërbimeve të njësisë. Përfitimet jofinanciare mund të ndodhin kur aktivitetet e një njësie tjetër janë në harmoni të plotë me, (d.m.th., ato janë në përputhje me), objektivat e njësisë dhe mbështesin njësinë në arritjen e objektivave të saj. Për shembull, një njësi ekonomike mund të marrë përfitime kur një njësi tjetër me aktivitete të ngjashme jep shërbime që përndryshe njësia e parë do të ishte e detyruar t'i ofronte. Aktivitetet të tilla të ngjashme mund të ndërmerren vullnetarisht ose njësia mund të ketë fuqinë të drejtojë njësinë tjetër për të ndërmarrë ato aktivitete. Përfitimet jofinanciare mund të ndodhin gjithashtu kur dy njësi kanë objektiva plotësues (d.m.th., objektivat e një njësie u shtojnë dhe i bëjnë më të plotë objektivat e njësisë tjetër).

32. Shembujt e mëposhtëm ilustronë përfitimet financiare që një njësi mund të marrë nga përfshirja e saj me një njësi tjetër:

- (a) Dividendët, interesa të ndryshueshëm për letrat me vlerë të borxhit, shpërndarje të tjera të përfitimeve ekonomike;
- (b) Ekspozimi ndaj rritjes ose uljes së vlerës së një investimi në një njësi tjetër;
- (c) Ekspozimi ndaj humbjeve nga marrëveshjet për të dhënë mbështetje financiare, duke përfshirë mbështetjen financiare për projektet madhore;
- (d) Kursimet e kostos (për shembull, nëse një njësi do të arrinte ekonomi shkalle ose sinergji duke kombinuar operacionet ose aktivet e njësisë tjetër me operacionet ose aktivet e veta);
- (e) Interesat e mbetur në aktivet dhe detyrimet e njësisë tjetër në likuidimin e asaj njësie tjetër; dhe
- (f) Ekspozime të tjera ndaj përfitimeve të ndryshueshme që nuk janë të disponueshme për njësitë e tjera.

33. Shembuj të përfitimeve jofinanciare përfshijnë:

- (a) Aftësinë për të përfituar nga njohuritë e specializuara të një njësie tjetër;
- (b) Vlera për njësinë e njësisë tjetër që ndërmerr aktivitete që e ndihmojnë njësinë në arritjen e objektivave të saj;
- (c) Rezultatet e përmirësuar;
- (d) Ofrimi më efikas i rezultateve;
- (e) Prodhimi dhe ofrimi më efikas ose efektiv i të mirave dhe shërbimeve;
- (f) Të pasurit e një aktivi dhe shërbimeve të lidhura me të në dispozicion më

herët se do të ishte rasti; dhe

(g) Të pasurit e një niveli më të lartë të cilësisë së shërbimit sesa do të ndodhte ndryshe.

34. Edhe pse vetëm një njësi mund të kontrollojë një njësi tjetër, më shumë se një palë mund të ndajë përfitimet e asaj njësie tjetër. Për shembull, mbajtësit e interesave jokontrollues mund të ndajnë përfitimet financiare si tepricat/sufiçitet ose shpërndarjet nga një njësi ose përfitimet jofinanciare si p.sh. harmonizimi i aktiviteteve me rezultatet e dëshiruara.

Lidhja ndërmjet Fuqisë/Pushtetit dhe Përfitimeve

35. Një njësi kontrollon një njësi tjetër nëse njësia jo vetëm që ka fuqi mbi njësinë që vlerësohet për kontroll dhe ekspozim ose të drejta ndaj përfitimeve të ndryshueshme nga përfshirja e saj me njësinë tjetër, por gjithashtu ka aftësinë të përdorë fuqinë e saj për të ndikuar në natyrën ose shumën e përfitimeve nga përfshirja e saj me njësinë që vlerësohet për kontroll.

36. Vetëm ekzistenca e objektivave të përbashkët është e pamjaftueshme që një njësi të arrijë në përfundimin se kontrollon një njësi tjetër. Në mënyrë që të ketë kontroll, njësia do të duhet gjithashtu të ketë aftësinë për të përdorur fuqinë e saj mbi njësinë që vlerësohet për kontroll për ta drejtuar atë njësi tjetër që të punojë me të për të çuar përpara objektivat e saj.

37. **Një njësi me të drejta vendimmarrëse do të përcaktojë nëse është një palë kryesore apo një agjent. Një njësi do të përcaktojë gjithashtu nëse një njësi tjetër me të drejta vendimmarrëse po vepron si agjent për njësinë. Një agjent është një palë e angazhuar kryesisht për të vepruar në emër dhe për të mirën e një pale tjetër ose palëve të tjera kryesore dhe për këtë arsye nuk kontrollon njësinë tjetër kur ushtron autoritetin e saj vendimmarrës. Kështu, ndonjëherë fuqia e një drejtuesi mund të mbahet dhe ushtrohet nga një agjent, por në emër të drejtuesit.**

Kërkesat e Kontabilitetit

38. **Një njësi kontrolluese do të pregatisë pasqyra financiare të konsoliduara duke përdorur politika uniforme të kontabilitetit për transaksione të ngjashme dhe ngjarje të tjera në rrethana të ngjashme.**

39. **Konsolidimi i një njësie të kontrolluar do të fillojë nga data kur njësia merr kontrollin e njësisë tjetër dhe do të përfundojë kur njësia humbet kontrollin e njësisë tjetër.**

Procedurat e Konsolidimit

40. Pasqyrat financiare të konsoliduara:

(a) Kombinojnë zërat e ngjashëm të aktiveve, detyrimeve, aktiveve/kapitalit neto, të ardhurave, shpenzimeve dhe flukseve monetare të njësisë

kontrolluese me ato të njërive të saj të kontrolluara.

- (b) Eliminojnë vlerën e mbartur të investimit të njësisë kontrolluese në çdo njësi të kontrolluar me pjesën e aktiveve/kapitalit neto të njësisë kontrolluese të secilës njësi të kontrolluar (SNKSP 40 shpjegon se si të kontabilizohet emri i mirë përkatës).
- (c) Eliminojnë plotësisht aktivet, detyrimet, aktivet/kapitalin neto të njësisë, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset monetare të njësisë intra-ekonomike që lidhen me transaksionet ndërmjet njërive të njësisë ekonomike (suficitet ose deficitet që rezultojnë nga transaksionet e njësisë intra-ekonomike që njihen në aktive, si p.sh. inventari dhe aktivet fikse eliminohen plotësisht). Humbjet intra-ekonomike mund të tregojnë një zhvlerësim që kërkon njohje në pasqyrat financiare të konsoliduara.

Politikat Kontabël të Unifikuara

- 41. Nëse një anëtar i njësisë ekonomike përdor politika të kontabilitetit të ndryshme nga ato të adoptuara në pasqyrat financiare të konsoliduara për transaksione dhe ngjarje të ngjashme në rrethana të ngjashme, bëhen rregullime të përshtatshme në pasqyrat financiare të atij anëtari në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara për të siguruar konformitetin me politikat e kontabilitetit të njësisë ekonomike.

Matja

- 42. Një njësi përfshin të ardhurat dhe shpenzimet e një njësie të kontrolluar në pasqyrat financiare të konsoliduara nga data kur ajo fiton kontrollin deri në datën kur njëzia ndalon së kontrolluari njësinë e kontrolluar. Të ardhurat dhe shpenzimet e njësisë së kontrolluar bazohen në shumat e aktiveve dhe detyrimeve të njohura në pasqyrat financiare të konsoliduara në datën e blerjes. Për shembull, shpenzimet e amortizimit të njohura në pasqyrën e konsoliduar të performancës financiare pas datës së blerjes bazohen në vlerat e aktiveve të amortizueshme përkatëse të njohura në pasqyrat financiare të konsoliduara në datën e blerjes.

Të Drejtat Potenciale të Votimit

- 43. Kur ekzistojnë të drejta potenciale të votimit, ose derivativë të tjerë që përmbajnë të drejta potenciale të votimit, proporcioni/pjesa e suficitit ose deficitit dhe ndryshimeve në aktivet/kapitalin neto të alokuara për njësinë kontrolluese dhe interesat jokontrolluese në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara përcaktohet vetëm në bazë të interesave ekzistues të pronësisë dhe nuk pasqyrojnë ushtrimin ose konvertimin e mundshëm të të drejtave potenciale të votimit dhe derivativëve të tjerë, përveçse kur është i zbatueshëm paragrafi 44.
- 44. Në disa rrethana, një njësi ka, në thelb, një interes pronësie ekzistues si rezultat i një transaksioni që aktualisht i jep njësisë të drejtën në përfitimet që lidhen me

një interes pronësie. Në rrethana të tilla, proporcioni i alokuar për njësinë kontrolluese dhe interesat jokontrolluese në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara përcaktohet duke marrë parasysh ushtrimin eventual të atyre të drejtave potenciale të votimit dhe derivativëve të tjerë që aktualisht i japin njësisë të drejtë në përfitimet.

45. SNKSP 28 dhe SNKSP 41 nuk zbatohen për interesat në njësitë e kontrolluara që janë të konsoliduara. Kur instrumentet që përmbajnë të drejta potenciale votimi në thelb japin aktualisht të drejtë në përfitimet që lidhen me një interes pronësie në një njësi të kontrolluar, instrumentet nuk i nënshtrohen kërkesave të SNKSP 28 dhe SNKSP 41. Në të gjitha rastet e tjera, instrumentet që përmbajnë të drejta potenciale votimi në një njësi të kontrolluar kontabilizohen në përputhje me SNKSP 28 dhe SNKSP 41.

Datat e Raportimit

46. **Pasqyrat financiare të njësisë kontrolluese dhe njërive të saj të kontrolluara të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara do të përgatiten në të njëjtën datë raportimi. Kur fundi i periudhës së raportimit të njësisë kontrolluese është i ndryshëm nga ai i një njësie të kontrolluar, njësia kontrolluese ose:**
- (a) **Merr, për qëllime konsolidimi, informacion financiar shtesë në të njëjtën datë me pasqyrat financiare të njësisë kontrolluese; ose**
 - (b) **Përdor pasqyrat financiare më të fundit të njësisë së kontrolluar të rregulluara për efektet e transaksioneve ose ngjarjeve të rëndësishme që ndodhin midis datës së atyre pasqyrave financiare dhe datës së pasqyrave financiare të konsoliduara.**

Interesat Jokontrolluese

47. **Një njësi kontrolluese do të paraqesë interesat jokontrolluese në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar brenda aktiveve/kapitalit neto, veçmas nga aktivet/kapitali neto i pronarëve të njësisë kontrolluese.**
48. Ndryshimet në interesin e një njësie kontrolluese në një njësi të kontrolluar që nuk rezultojnë në humbjen e kontrollit të njësisë kontrolluese mbi njësinë e kontrolluar janë transaksione me pronarë në cilësinë e tyre si pronarë.
49. **Një njësi do t'ua atribuojë suficitin ose defiçitin dhe çdo fitim ose humbje të njohur drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto pronarëve të njësisë kontrolluese dhe interesave jokontrolluese. Njësia do t'ua atribuojë gjithashtu shumën totale të njohur në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet/kapitalin neto pronarëve të njësisë kontrolluese dhe interesave jokontrolluese, edhe nëse kjo rezulton që interesat jokontrolluese të kenë një balancë të defiçitit.**
50. **Nëse një njësi e kontrolluar ka aksione preferenciale të akumuluar të**

papaguara që klasifikohen si instrumente të kapitalit dhe mbahen nga interesa jokontrolluese, njësia do të llogarisë pjesën e saj të suficitit ose deficitit pas rregullimit për dividendët e këtyre aksioneve, pavarësisht nëse dividendë të tillë janë deklaruar apo jo.

Ndryshimet në Pjesën e Mbajtur nga Interesat Jokontrolluese

51. Kur ndryshon proporcioni i aktiveve/kapitalit neto të mbajtur nga interesat jokontrolluese, një njësi do të rregullojë vlerat e mbartura të interesave kontrolluese dhe jokontrolluese për të pasqyruar ndryshimet në interesat e tyre relativë në njësinë e kontrolluar. Njësia do të njohë drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto çdo diferencë ndërmjet shumës me të cilën janë rregulluar interesat jokontrolluese dhe vlerës së drejtë të shumës së paguar ose marrë, dhe ia atribuon atë pronarëve të njësisë kontrolluese.

Humbja e Kontrollit

52. Nëse një njësi kontrolluese humbet kontrollin e një njësie të kontrolluar, njësia kontrolluese:
- (a) Çregjistron aktivet dhe detyrimet e njësisë të kontrolluar më parë nga pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar;
 - (b) Njeh çdo investim të mbajtur në njësinë e kontrolluar më parë, dhe më pas e kontabilizon atë dhe për çdo shumë që i detyrohet ose ndaj ish njësisë së kontrolluar në përputhje me SNKSP-të përkatëse. Ai interes i mbajtur rimatet, siç përshkruhet në paragrafët 54(b)(iii) dhe 55A. Vlera e rimatur në datën kur humbet kontrolli do të konsiderohet si vlera e drejtë në njohjen fillestare të një aktivi financiar në përputhje me SNKSP 41 ose kostoja në njohjen fillestare të një investimi në një shoqëri ose sipërmarrje të përbashkët, nëse është e zbatueshme; dhe
 - (c) Njeh fitimin ose humbjen e shoqëruar me humbjen e kontrollit që i atribuohet interesit të mëparshëm kontrollues, siç specifikohet në paragrafët 54-55A.
53. Një njësi kontrolluese mund të humbasë kontrollin e një njësie të kontrolluar në dy ose më shumë transaksione. Megjithatë, ndonjëherë rrethanat tregojnë se një grup transaksionesh duhet të kontabilizohen si një transaksion i vetëm. Në përcaktimin nëse do të kontabilizohen transaksionet si një transaksion i vetëm, një njësi kontrolluese do të marrë parasysh të gjithë termat dhe kushtet e transaksioneve dhe efektet e tyre ekonomike. Një ose më shumë nga pikat e listuara më poshtë tregojnë se njësia kontrolluese duhet t'i kontabilizojë gupin e transaksioneve si një transaksion i vetëm:
- (a) Ata kanë ndodhur në të njëjtën kohë ose duke marrë në konsideratë njëri-tjetrin.

- (b) Ato formojnë një transaksion të vetëm me qëllimin për të arritur një efekt të përgjithshëm komercial.
- (c) Ndodhia e një transaksioni varet nga ndodhia e të paktën një transaksioni tjetër.
- (d) Një transaksion i konsideruar më vete nuk është i justifikuar ekonomikisht, por është i justifikuar ekonomikisht kur merret parasysh së bashku me transaksione të tjera. Një shembull është kur një shitje e një investimi vlerësohet nën çmimin e tregut dhe kompensohet nga një shitje me çmim mbi tregun.

54. Nëse një njësi kontrolluese humbet kontrollin e një njësie të kontrolluar, ajo do të:

- (a) Çregjistrojë:
 - (i) Aktivet (duke përfshirë emrin e mirë) dhe detyrimet e njësisë së kontrolluar në vlerën e tyre të mbartur në datën kur humbet kontrolli; dhe
 - (ii) Vlerën e mbartur të çdo interesi jokontrolluese në njësinë ekonomike të kontrolluar më parë në datën kur humbet kontrolli (duke përfshirë çdo fitim ose humbje të njohur drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto që i atribuohet atyre).
- (b) Njohë:
 - (i) Vlerën e drejtë të shumës së marrë, nëse ka, nga transaksioni, ngjarja ose rrethanat që rezultuan në humbjen e kontrollit;
 - (ii) Shpërndarjen e aksioneve, nëse transaksioni, ngjarja ose rrethanat që rezultuan në humbjen e kontrollit përfshijnë një shpërndarje të aksioneve të njësisë së kontrolluar tek pronarët në cilësinë/kapacitetin e tyre si pronarë; dhe
 - (iii) Çdo investim të mbajtur në njësinë e kontrolluar më parë me vlerën e drejtë të tij në datën kur humbet kontrolli.
- (c) Transferojë drejtpërdrejt te sufiçiti/defiçiti i akumuluar, nëse kërkohet nga SNKSP-të e tjera, shumat e njohura drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto në lidhje me njësinë e kontrolluar mbi bazën e përshkruar në paragrafin 55.
- (d) Njohë çdo diferencë që rezulton si një fitim ose humbje në sufiçit ose defiçit që i atribuohet njësisë ekonomike kontrolluese.

55. Nëse një njësi kontrolluese humbet kontrollin e një njësie ekonomike të kontrolluar, njësia kontrolluese do të kontabilizojë të gjitha shumat e

njohura më parë drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto në lidhje me atë njësi të kontrolluar në të njëjtën bazë siç do të kërkohej nëse njësi kontrolluese do të kishte shitur/nxjerë jashtë përdorimit drejtpërdrejt aktivet ose detyrimet e shoqëruara. Nëse një tepricë rivlerësimi e njohur më parë drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto do të transferohej drejtpërdrejt në sufiçitin/defiçitin e akumuluar në shitjen/nxjerrjen jashtë përdorimit të aktivitetit, njësi kontrolluese do ta transferojë tepricën e rivlerësimit drejtpërdrejt në sufiçitin/defiçitin e akumuluar kur humb kontrollin e njësisë së kontrolluar.

- 55A. Nëse një njësi kontrolluese humb kontrollin e një njësie të kontrolluar që nuk përmban një operacion, si përcaktohet në SNKSP 40, si rezultat i një transaksioni që përfshin një shoqëri ose një sipërmarrje të përbashkët që kontabilizohet duke përdorur metodën e kapitalit, njësi kontrolluese përcakton fitimin ose humbjen në përputhje me paragrafët 54–55. Fitimi ose humbja që rezulton nga transaksioni njihet në sufiçitin ose defiçitin e njësisë kontrolluese vetëm në masën e interesave të investuesve të palidhur me ta në atë shoqëri ose sipërmarrje të përbashkët. Pjesa e mbetur e fitimit eliminohet kundrejt vlerës së mbartur të investimit në atë shoqëri ose sipërmarrje të përbashkët. Përveç kësaj, nëse njësi kontrolluese ruan një investim në njësinë e kontrolluar më parë dhe njësi e kontrolluar më parë është tani një shoqëri ose një sipërmarrje e përbashkët që kontabilizohet duke përdorur metodën e kapitalit, njësi kontrolluese njeh pjesën e fitimit ose humbjes që rezulton nga rimatja me vlerën e drejtë të investimit të mbajtur në atë njësi të kontrolluar më parë në sufiçitin ose defiçitin e saj vetëm në masën e interesave të investuesve të palidhur me të në shoqërinë e re ose sipërmarrjen e përbashkët. Pjesa e mbetur e këtij fitimi eliminohet kundrejt vlerës së mbartur të investimit të mbajtur në njësinë e kontrolluar më parë. Nëse njësi kontrolluese ruan një investim në njësinë e kontrolluar më parë që tani kontabilizohet në përputhje me SNKSP 41, pjesa e fitimit ose humbjes që rezulton nga rimatja me vlerën e drejtë të investimit të mbajtur në njësinë e kontrolluar më parë njihet plotësisht në sufiçitin ose defiçitin e njësisë kontrolluese.

Njësitë Investuese: Kërkesa e Vlerës së Drejtë

56. **Me përjashtim të asaj që përshkruhet në paragrafin 57, një njësi investuese nuk do të konsolidojë njësitë e saj të kontrolluara ose të zbatojë SNKSP 40 kur merr kontrollin e një njësie tjetër. Në vend të kësaj, një njësi investuese do të masë një investim në një njësi të kontrolluar me vlerën e drejtë nëpërmjet sufiçitit ose defiçitit në përputhje me SNKSP 41.**
57. **Pavarësisht nga kërkesa në paragrafin 56, nëse një njësi investuese ka një njësi të kontrolluar e cila në vetvete nuk është një njësi investuese dhe qëllimi dhe aktivitetet kryesore të së cilës janë dhënia e shërbimeve që lidhen me aktivitetet e investimit të njësisë investuese (shih paragrafët AG98–AG100), ajo do të konsolidojë atë njësi të kontrolluar në përputhje**

me paragrafët 38–55 të këtij Standardi dhe do të zbatojë kërkesat e SNKSP 40 për blerjen e një njësie të tillë të kontrolluar.

58. Një njësi kontrolluese e një njësie investuese që nuk është në vetvete një njësi investuese do të prezantojë pasqyrat financiare të konsoliduara në të cilat (i) mat investimet e një njësie investuese të kontrolluar me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit në përputhje me SNKSP 41 dhe (ii) konsolidon aktivet dhe detyrimet e tjera dhe të ardhurat e shpenzimet e njësisë investuese të kontrolluar në përputhje me paragrafët 38-55 të këtij Standardi.

Përcaktimi nëse një Njësi është një Njësi Investuese

59. Një njësi duhet të marrë parasysh të gjithë faktet dhe rrethanat kur vlerëson nëse është një njësi investuese, duke përfshirë qëllimin dhe misionin e saj. Paragrafët AG89–AG106 përshkruajnë më në detaj aspekte të përkufizimit të një njësie investuese. Nëse faktet dhe rrethanat tregojnë se ka ndryshime në një ose më shumë nga tre elementët që përbëjnë përkufizimin e një njësie investuese, një njësi kontrolluese do të rivlerësojë nëse ajo është një njësi investuese.
60. Një njësi kontrolluese që ose ndalon së qeni një njësi investuese ose bëhet një njësi investuese do të kontabilizojë ndryshimin në statusin e saj në mënyrë prospektive nga data në të cilën ka ndodhur ndryshimi në status (shih paragrafët 63-64).

Gjykime dhe Hamendësime

61. Një njësi investuese do të japë informacionin e kërkuar nga paragrafi 15 i SNKSP 38 për gjykimet dhe supozimet e rëndësishme të bëra në përcaktimin se ajo është një njësi investuese, përveç rastit kur ajo ka të gjitha karakteristikat e mëposhtme:
- (a) Ajo ka marrë fonde nga më shumë se një investues (shih paragrafët AG89–AG90);
 - (b) Ajo ka interesa pronësie në formën e kapitalit ose interesave të ngjashëm (shih paragrafët AG91–AG92); dhe
 - (c) Ajo ka më shumë se një investim (shih paragrafët AG96–AG97).
62. Mungesa e ndonjëris prej këtyre karakteristikave nuk e skualifikon domosdoshmërisht një njësi ekonomike nga klasifikimi si një njësi investuese. Megjithatë, mungesa e ndonjë prej këtyre karakteristikave do të thotë se një njësi i kërkohet të paraqesë informacion shpjgues për gjykimet dhe supozimet e rëndësishme të bëra në përcaktimin se ajo është një njësi investuese.

Kontabiliteti për një Ndryshim në Statusin e Njësisë Investuese

63. Kur një njësi ndalon së qeni një njësi investuese, ajo do të zbatojë SNKSP

40 për çdo njësi të kontrolluar që është matur më parë me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit në përputhje me paragrafin 56. Data e ndryshimit të statusit do të jetë data e supozuar e blerjes. Vlera e drejtë e njësisë së kontrolluar në datën e supozuar të blerjes do të përfaqësojë shumën e supozuar të transferuar kur matni çdo emër të mirë ose fitim nga një blerje e volitshme që lind nga blerja e supozuar. Të gjitha njësitë e kontrolluara do të konsolidohen në përputhje me paragrafët 38-51 të këtij Standardi nga data e ndryshimit të statusit.

64. Kur një njësi bëhet një njësi investuese, ajo do të ndalojë së konsoliduari njësitë të saj të kontrolluara në datën e ndryshimit të statusit, me përjashtim të çdo njësie të kontrolluar që do të vazhdojë të konsolidohet në përputhje me paragrafin 57. Njësia investuese do të zbatojë kërkesat e paragrafëve 52 dhe 53 për ato njësi të kontrolluara që ajo ndalon së konsoliduari sikur njësia investuese të kishte humbur kontrollin e atyre njësisë të kontrolluara në atë datë.

Dispozita Kalimtare

65. Një njësi do të zbatojë këtë Standard në mënyrë retrospektive, në përputhje me SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, përveç siç specifikohet në paragrafët 66–78.
66. Pavarësisht nga kërkesat e paragrafit 33 të SNKSP 3, kur ky Standard zbatohet për herë të parë, një njësi do të prezantojë vetëm informacionin sasior të kërkuar nga paragrafi 33(f) i SNKSP 3 për periudhën vjetore menjëherë para datës së zbatimit fillestar të këtij Standardi ("periudha menjëherë paraardhëse"). Një njësi mund të prezantojë gjithashtu këtë informacion për periudhën aktuale ose për periudhat e mëparshme krahasuese, por nuk është e detyruar ta bëjë këtë.
67. Për qëllimet e këtij Standardi, data e zbatimit fillestar është fillimi i periudhës vjetore të raportimit për të cilën ky Standard zbatohet për herë të parë.
68. Në datën e zbatimit fillestar, një njësi nuk i kërkohet të bëjë rregullime në kontabilitetin e mëparshëm për përfshirjen e saj me ose:
- (a) Njësitë që do të konsolidoheshin në atë datë në përputhje me SNKSP 6, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe të Veçanta*, dhe janë ende të konsoliduara në përputhje me këtë Standard; ose
 - (b) Njësitë që nuk do të konsolidoheshin në atë datë në përputhje me SNKSP 6, dhe nuk janë konsoliduar në përputhje me këtë Standard.
69. Në datën e zbatimit fillestar, një njësi do të vlerësojë nëse është një njësi investuese në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në atë datë. Nëse, në datën e zbatimit fillestar, një njësi ekonomike arrin në përfundimin se është një njësi investuese, ajo do të zbatojë kërkesat e paragrafëve 70-73 në vend të paragrafëve 77-78.

70. Me përjashtim të ndonjë njësie të kontrolluar që konsolidohet në përputhje me paragrafin 57 (për të cilën zbatohet paragrafi 68 ose paragrafët 77-78, cilat do të jenë relevante), një njësi investuese do të matë investimin e saj në secilën njësi të kontrolluar me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit sikur kërkesat e këtij Standardi të kishin qenë gjithmonë efektive. Njësia investuese do të rregullojë në mënyrë retrospektive si periudhën vjetore që i paraprin menjëherë datës së zbatimit fillestar, ashtu edhe aktivet/kapitalin neto në fillim të periudhës menjëherë paraardhëse për çdo diferencë midis:

(a) Vlerës së mbartur të mëparshme të njësisë së kontrolluar; dhe

(b) Vlerës së drejtë të investimit të njësisë në njësinë e kontrolluar.

Shuma e akumuluar e çdo rregullimi të vlerës së drejtë të njohur më parë drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto do të transferohet në suficitin/deficitin e akumuluar në fillim të periudhës vjetore menjëherë para datës së zbatimit fillestar.

71. Një njësi investuese do të përdorë shumat e vlerës së drejtë që u raportuan më parë investuesve ose drejtuesve.

72. Nëse matja e një investimi në një njësi të kontrolluar në përputhje me paragrafin 70 është e papraktikueshme (siç përcaktohet në SNKSP 3), një njësi investuese do të zbatojë kërkesat e këtij Standardi në fillim të periudhës më të hershme për të cilën është i praktikueshëm zbatimi i paragrafit 70, e cila mund të jetë periudha aktuale. Investuesi do të rregullojë në mënyrë retrospektive periudhën vjetore që i paraprin menjëherë datës së zbatimit fillestar, përveç rastit kur fillimi i periudhës më të hershme për të cilën zbatimi i këtij paragrafi është i praktikueshëm është periudha aktuale. Nëse është kështu, rregullimi i aktiveve/kapitalit neto do të njihet në fillim të periudhës aktuale.

73. Nëse një njësi investuese ka hequr dorë nga, ose ka humbur kontrollin e një investimi në një njësi të kontrolluar përpara datës së zbatimit fillestar të këtij Standardi, njësisë investuese nuk i kërkohet të bëjë rregullime në kontabilitetin e mëparshëm për atë njësi të kontrolluar.

74. Nëse, në datën e zbatimit fillestar, një njësi arrin në përfundimin se do të konsolidojë një njësi tjetër që nuk ishte konsoliduar në përputhje me SNKSP 6, njësia do të matë aktivet, detyrimet dhe interesat jokontrolluese në atë njësi të pakonsoliduar më parë, sikur ajo njësi tjetër të ishte konsoliduar që nga data kur njësia mori kontrollin e asaj njësie tjetër në bazë të kërkesave të këtij Standardi. Njësia do të rregullojë në mënyrë retrospektive periudhën vjetore menjëherë para datës së zbatimit fillestar. Kur data e marrjes së kontrollit është më e hershme se fillimi i periudhës menjëherë paraardhëse, njësia do të njohë, si rregullim për aktivet/kapitalin neto në fillim të periudhës menjëherë paraardhëse, çdo diferencë midis:

- (a) **Shumës së aktiveve, detyrimeve dhe interesave jokontrolluese të njohur; dhe**
- (b) **Vlerës së mbartur të mëparshme të përfshirjes së njësisë me njësinë tjetër.**

75. Nëse matja e aktiveve, detyrimeve dhe interesave jokontrolluese të një njësie të kontrolluar në përputhje me paragrafin 74(a) ose (b) është e papraktikueshme (siç përcaktohet në SNKSP 3), një njësi do të masë aktivet, detyrimet dhe interesat jokontrolluese në atë një njësi të pakonsoliduar më parë sikur ajo njësi të ishte konsoliduar nga data e supozuar e blerjes. Data e supozuar e blerjes do të jetë fillimi i periudhës më të hershme për të cilën është i praktikueshëm zbatimi i këtij paragrafi, e cila mund të jetë periudha aktuale.

76. Njësia do të rregullojë në mënyrë retrospektive periudhën vjetore menjëherë para datës së zbatimit fillestar, përveç rastit kur fillimi i periudhës më të hershme për të cilën zbatimi i këtij paragrafi është praktikueshëm është periudha aktuale. Kur data e supozuar e blerjes është më e hershme se fillimi i periudhës menjëherë paraardhëse, njësia do të njohë, si rregullim ndaj aktiveve/kapitalit neto në fillim të periudhës menjëherë paraardhëse, çdo diferencë midis:

- (a) **Shumës së aktiveve, detyrimeve dhe interesave jokontrolluese të njohur; dhe**
- (b) **Vlerës së mbartur të mëparshme të përfshirjes së njësisë me njësinë tjetër.**

Nëse periudha më e hershme për të cilën zbatimi i këtij paragrafi është i praktikueshëm është periudha aktuale, rregullimi i aktiveve/kapitalit neto do të njihet në fillim të periudhës aktuale.

77. Nëse, në datën e zbatimit fillestar, një njësi ekonomike arrin në përfundimin se nuk do të konsolidojë më një njësi që ishte konsoliduar në përputhje me SNKSP 6, njësia do të masë interesin e saj në njësinë tjetër me shumën në të cilën do të ishte matur nëse kërkesat e këtij Standardi do të kishin qenë efektive kur njësia u përfshi ose humbi kontrollin e, njësisë tjetër. Njësia do të rregullojë në mënyrë retrospektive periudhën vjetore menjëherë para datës së zbatimit fillestar. Kur data në të cilën njësia u përfshi (por nuk e mori kontrollin në përputhje me këtë Standard), ose e humbi kontrollin e njësisë tjetër është më e hershme se fillimi i periudhës menjëherë paraardhëse, njësia do të njohë, si një rregullim për aktivet/kapitalin neto në fillim të periudhës menjëherë paraardhëse, çdo ndryshim midis:

- (a) **Vlerës së mbartur të mëparshme të aktiveve, detyrimeve dhe interesave jokontrolluese; dhe**

(b) Shumës së njohur të interesit të njësisë në njësinë tjetër.

78. Nëse matja e interesit në njësinë tjetër në përputhje me paragrafin 77 është e papraktikueshme (siç përcaktohet në SNKSP 3), një njësi do të zbatojë kërkesat e këtij Standardi në fillim të periudhës më të hershme për të cilën është i praktikueshëm zbatimi i paragrafit 77, e cila mund të jetë periudha aktuale. Njësia do të rregullojë në mënyrë retrospektive periudhën vjetore menjëherë para datës së zbatimit fillestar, përveç rastit kur fillimi i periudhës më të hershme për të cilën zbatimi i këtij paragrafi është praktikueshëm është periudha aktuale. Kur data në të cilën njësia u përfshi (por nuk e mori kontrollin në përputhje me këtë Standard), ose e humbi kontrollin e njësisë tjetër është më e hershme se fillimi i periudhës menjëherë paraardhëse, njësia do të njohë, si një rregullim për aktivet/kapitalin neto në fillim të periudhës menjëherë paraardhëse, çdo ndryshim midis:

(a) Vlerës së mbartur të mëparshme të aktiveve, detyrimeve dhe interesave jokontrolluese; dhe

(b) Shumës së njohur të interesit të njësisë në njësinë tjetër.

Nëse periudha më e hershme për të cilën zbatimi i këtij paragrafi është i praktikueshëm është periudha aktuale, rregullimi i aktiveve/kapitalit neto do të njihet në fillim të periudhës aktuale.

Data Efektive

79. Një njësi do të zbatojë këtë Standard për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2017. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi e zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2017, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 34, *Pasqyrat Financiare të Veçanta*, SNKSP 36, SNKSP 37 dhe SNKSP 38 në të njëjtën kohë.

79A. Paragrafët 11, 12 dhe 13 u fshinë dhe paragrafi 8 u ndryshua nga *Zbatueshmëria e SNKSP-ve*, botuar në prill 2016. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2018. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.

79B. Paragrafi 6 u ndryshua nga SNKSP 39, *Përfutimet e Punonjësve*, botuar në korrik 2016. Një njësi do të zbatojë këtë ndryshim për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2018. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimin për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 39 në të njëjtën kohë.

- 79C. Paragrafët 4, 40, 56, 57 dhe 63 u ndryshuan nga SNKSP 40, *Kombinimet e Sektorit Publik*, botuar në janar 2017. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2019. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2019, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 40 në të njëjtën kohë.
- 79D. Paragrafi 52 u ndryshua dhe paragrafi 55A u shtua nga SNKSP 40, *Kombinimet e Sektorit Publik*, botuar në janar 2017. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime në mënyrë prospektive për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNKSP. Zbatimi i mëparshëm lejohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet më herët, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe, nëse nuk e ka bërë tashmë këtë, do të zbatojë SNKSP 40 në të njëjtën kohë.
- 79E. Paragrafët 22, 45, 52, 55A, 56, 58 dhe AG105 u ndryshuan nga SNKSP 41, botuar në gusht 2018. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2022. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2022, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 41 në të njëjtën kohë.
80. Kur një njësi zbaton SNKSP-të sipas kontabilitetit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara siç përcaktohet në SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) të Drejtave dhe Detyrimeve të Konstatuara* për qëllime të raportimit financiar pas kësaj date efektive, ky Standard zbatohet për pasqyrat financiare vjetore të njësisë që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës së adoptimit të SNKSP-ve.

Shfuqizimi dhe Zëvendësimi i SNKSP 6 (Dhjetor 2006)

81. Ky Standard është publikuar njëkohësisht me SNKSP 34. Së bashku, të dy Standardet zëvendësojnë SNKSP 6 (dhjetor 2006). SNKSP 6 mbetet i zbatueshëm derisa SNKSP 34 dhe SNKSP 35 të zbatohen ose të hyjnë në fuqi, cilado të jetë më herët.

SNKSP 36—INVESTIMET NË PJESËMARRJE DHE SIPËRMARRJE TË PËRBASHKËTA

Shënime të Mirënjohjes

Ky Standard Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) është hartuar kryesisht nga Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit (SNK) 28, *Investimet në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta* publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Ekstrakte nga SNK 28 janë riprodhuar në këtë publikim të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) me lejen e Fondacionit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Teksti i aprovuar i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) është ai i publikuar nga BSNK në gjuhën angleze dhe kopjet mund të merren direkt nga IFRS Foundation, Customer Service, Columbus Building, 7 Westferry Circus, Canary Wharf, London E14 4HD, United Kingdom.

E-mail: publications@ifrs.org

Internet: www.ifrs.org

Të drejtat e autorit për SNRF-të, SNK-të, Draftet e Paraqitura dhe publikime të tjera të BSNK-së i përkasin Fondacionit SNRF.

"SNRF", "SNK", "BSNK", "Fondacioni SNRF", "Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit" dhe "Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar" janë marka tregtare të Fondacionit SNRF dhe nuk duhet të përdoren pa aprovimin e Fondacionit SNRF.

SNKSP 36—INVESTIMET NË PJESEMARRJE DHE SIPERMARRJE TË PËRBASHKËTA

Historia e SNKSP

Ky version përfshin ndryshime që rezultojnë nga SNKSP-të e botuara deri më 31 janar, 2019.

SNKSP 36, *Investimet në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta* u publikua në janar 2015.

Që atëherë, SNKSP 36 është ndryshuar nga SNKSP-të e mëposhtme:

- *Interesat Afatgjata në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41)*
- *Përmirësime të SNKSP-ve 2018 (botuar në tetor 2018)*
- *SNKSP 41, Instrumentet Financiare (botuar në gusht 2018)*
- *SNKSP 40, Kombinimet e Sektorit Publik (botuar në janar 2017)*
- *Zbatueshmëria e SNKSP-ve (botuar në prill 2016)*
- *Përmirësime të SNKSP-ve 2015 (botuar në prill 2016)*

Tabela e Paragrafëve të Ndryshuar në SNKSP 36

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
4	U Ndryshua	Përmirësime të SNKSP-ve Prill 2016
6	U fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
7	U fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
20	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
20A	I Ri	Interesat Afatgjata në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Ndryshimet

INVESTIMET NË PJESEMARRJE DHE SIPERMARRJE TË PËRBASHKËTA

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
		në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41) Janar 2019
24	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018 Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018
25	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
26	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017 SNKSP 41 Gusht 2018
31	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017
33	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017
34A	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
34B	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
43	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
44	U fshi	Interesat Afatgjata në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41) Janar 2019

INVESTIMET NË PJESËMARRJE DHE SIPËRMARRJE TË PËRBASHKËTA

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
44A	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
44B	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
44C	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
45	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
51A	I Ri	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
51B	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
51C	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
51D	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
51E	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018
51F	I Ri	Interesat Afatgjata në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41) Janar 2019
51G	I Ri	Interesat Afatgjata në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim

INVESTIMET NË PJESEMARRJE DHE SIPËRMARRJE TË PËRBASHKËTA

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
		Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41) Janar 2019
51H	I Ri	Interesat Afatgjata në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41) Janar 2019
51I	I Ri	Interesat Afatgjata në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41) Janar 2019
Shembull Ilustrues	I Ri	Interesat Afatgjata në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36) dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41) Janar 2019

Janar 2015

**IPSAS 36—INVESTIMET NË PJEËMARRJE DHE
SIPËRMARRJE TË PËRBASHKËTA**

PËRMBAJTJA

	Paragrafi
Objektivi	1
Objekti	2–7
Përkufizime	8–9
Marrëveshje Detyruese	9
Ndikim i Konsiderueshëm	10–15
Metoda e Kapitalit	16–21
Zbatimi i Metodës së Kapitalit	22–48
Përgjashtime nga Zbatimi i Metodës së Kapitalit	23–25
Ndalimi i Përdorimit të Metodës së Kapitalit	26–27
Ndryshime në Interesin e Pronësisë	28
Procedurat e Metodës së Kapitalit	29–42
Humbjet nga Zhvlerësimi	43–48
Pasqyrat Financiare të Veçanta	49
Dispozita Kalimtare	50
Data Efektive	51–52
Shfuqizimi dhe Zëvendësimi i SNKSP 7 (Dhjetor 2006)	53

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik 36, *Investimet në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta*, është përcaktuar në paragrafët 1–53. Të gjithë paragrafët kanë autoritet të barabartë. SNKSP 36 duhet lexuar në kontekstin e objektivit të tij, Bazës për Konkluzione, *Parathënies së Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik dhe Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar me Qëllim të Përgjithshëm nga Njësitë e Sektorit Publik*. SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, jep një bazë për zgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabël në mungesë të udhëzimeve të qarta.

Objektivi

1. Objektivi i këtij Standardi është të përshkruajë/rekomandojë kontabilitetin për Investimet në Pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta dhe të përcaktojë kërkesat për zbatimin e metodës së kapitalit kur kontabilizohen Investimet në Pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta.

Objekti

2. **Një njësi që pregatit dhe paraqet pasqyrat financiare sipas kontabilitetit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara do të zbatojë këtë Standard në kontabilizimin e investimeve në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta.**
3. **Ky Standard do të zbatohet nga të gjitha njësitë që janë investuese me ndikim të konsiderueshëm ose me kontroll të përbashkët mbi një të investuar, kur investimi çon në mbajtjen e një interesi të matshëm pronësie.**
4. Ky Standard jep bazën për kontabilizimin e interesave të pronësisë në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta. Kjo do të thotë, investimi në njësinë tjetër i jep njësisë rreziqet dhe përfitimet shoqëruese për një interes pronësie. Ky Standard zbatohet vetëm për interesat e matshëm të pronësisë. Kjo përfshin interesat e pronësisë që vijnë nga investimet në strukturën formale të kapitalit të një njësie tjetër. Një strukturë formale e kapitalit nënkupton kapitalin aksionar ose një formë ekuivalente kapitali, të tilla si njësitë në një trust pronësie. Interesat e matshëm të pronësisë mund të përfshijnë gjithashtu interesa pronësie që vijnë nga investime të tjera në të cilat interesi i pronësisë së njësisë mund të matet me besueshmëri (për shembull, interesat në një partneritet). Kur struktura e kapitalit të njësisë tjetër është e përcaktuar keq, mund të mos jetë e mundur të merret një matje e besueshme e interesit të pronësisë.
5. Disa kontribute të bëra nga njësitë e sektorit publik mund t'ju referohemi si "investim", por mund të mos krijojnë një interes pronësie. Për shembull, një njësi e sektorit publik mund të bëjë një investim të konsiderueshëm në zhvillimin e një spitali që është në pronësi dhe i operuar nga një organizatë bamirëse. Ndërsa kontribute të tilla janë të natyrës jokëmbyese, ato lejojnë njësinë e sektorit publik të marrin pjesë në funksionimin e spitalit dhe organizata bamirëse i përgjigjet/është përgjegjëse ndaj njësisë së sektorit publik për përdorimin e parave publike. Megjithatë, kontributet e bëra nga njësia e sektorit publik nuk përbëjnë një interes pronësie, pasi organizata bamirëse mund të kërkojë fonde alternative dhe në këtë mënyrë të pengojë njësinë e sektorit publik nga pjesëmarrja në funksionimin e spitalit. Prandaj, njësia e sektorit publik nuk është e ekspozuar ndaj rreziqeve, dhe as nuk gëzon shpërblimet/përfitimet që shoqërojnë interesat e pronësisë.
6. [Fshirë]

7. [Fshirë]

Përkufizime

8. Termat e mëposhtëm përdoren në këtë Standard me kuptimet e specifikuar:

Një **pjesëmarrje** është një njësi mbi të cilën investuesi ka ndikim të konsiderueshëm.

Marrëveshje detyruese: Për qëllimet e këtij Standardi, një marrëveshje detyruese është një marrëveshje e cila u jep palëve të drejta dhe obligime të imponueshme sikur të ishte në formën e një kontrate. Ajo përfshin të drejtat nga kontratat ose të drejta të tjera ligjore.

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë pasqyrat financiare të një njësie ekonomike në të cilat aktivet, detyrimet, aktivet/kapitali neto, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset monetare të njësisë kontrolluese dhe njërive të saj të kontrolluara prezantohen si ato të një njësie ekonomike të vetme.

Metoda e kapitalit është një metodë kontabiliteti ku investimi fillimisht njihet me kosto dhe rregullohet më pas për ndryshimin pas blerjes në pjesën e investuesit të aktiveve/kapitalit neto të investuarit të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët. Sufiçiti ose defiçiti i investuesit përfshin pjesën e tij në sufiçitin ose defiçitin e investuarit dhe aktivet/kapitali neto i investuesit përfshin pjesën e tij të ndryshimeve në aktivet/kapitalin neto të investuarit që nuk janë njohur në sufiçitin ose defiçitin e investuarit.

Një **marrëveshje e përbashkët** është një marrëveshje në të cilën dy ose më shumë palë kanë kontroll të përbashkët.

Kontrolli i përbashkët është ndarja e rënë dakord e kontrollit me anë të një marrëveshjeje detyruese, e cila ekziston vetëm kur vendimet për aktivitetet përkatëse/relevante kërkojnë lejen/pëlqimin unanimit të palëve që ndajnë kontrollin.

Një **sipërmarrje e përbashkët** është një marrëveshje e përbashkët ku palët që kanë kontroll të përbashkët të marrëveshjes kanë të drejta mbi aktivet neto të marrëveshjes.

Një **sipërmarrës i përbashkët** është një palë në një sipërmarrje të përbashkët që ka kontroll të përbashkët të asaj sipërmarrjeje të përbashkët.

Ndikim i konsiderueshëm është fuqia për të marrë pjesë në vendimet e politikave financiare dhe operative të një njësie tjetër, por nuk është kontroll ose kontroll i përbashkët i këtyre politikave.

Termat e përkufizuar në SNKSP-të e tjera përdoren në këtë Standard me të njëjtin kuptim si në ato Standarde, dhe riprodhohen në *Fjalorin e Termave*

të Përkufizuar të botuar veçmas. Termat e mëposhtëm përcaktohen ose në SNKSP 34, Pasqyrat Financiare të Veçanta, SNKSP 35, Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, ose SNKSP 37, Marrëveshjet e Përbashkëta: përfitimet, kontrolli, njësia e kontrolluar, njësia kontrolluese, njësia ekonomike, njësia investuese, operacioni i përbashkët, fuqia, dhe pasqyrat financiare të veçanta.

Marrëveshje Detyruese

9. Marrëveshjet detyruese mund të evidentohen në disa mënyra. Një marrëveshje detyruese është shpesh, por jo gjithmonë, me shkrim, në formën e një kontrate ose diskutimesh të dokumentuara ndërmjet palëve. Mekanizmat statutorë si autoriteti legjislativ ose ekzekutiv mund të krijojnë gjithashtu rregullime të imponueshme, të ngjashme me marrëveshjet kontraktuale, ose më vete, ose në lidhje me kontratat ndërmjet palëve.

Ndikim i Konsiderueshëm

10. Nëse një investues ka ndikim të konsiderueshëm mbi të investuarin është një çështje gjykimi e bazuar në natyrën e marrëdhënies ndërmjet investuesit dhe të investuarit, dhe në përkufizimin e influencës së konsiderueshme në këtë Standard. Ky Standard zbatohet vetëm për ato pjesëmarrje në të cilat një njësi zotëron një interes të matshëm pronësie ose në formën e një strukture aksionare ose të një strukture tjetër formale të kapitalit ose në një formë tjetër në të cilën interesi i njësisë mund të matet me besueshmëri.
11. Nëse një njësi zotëron një interes pronësie të matshëm dhe ajo zotëron, drejtpërdrejt ose tërthorazi (p.sh., nëpërmjet njësisë të kontrolluara), 20 përqind ose më shumë të fuqisë votuese të të investuarit, supozohet se njësia ka ndikim të konsiderueshëm, përveç rasteve kur mund të tregohet qartë se nuk është kështu. Në të kundërt, nëse njësia zotëron, drejtpërdrejtë ose tërthorazi (p.sh., nëpërmjet njësisë të kontrolluara), më pak se 20 përqind të fuqisë votuese të të investuarit, supozohet se njësia nuk ka influencë/ndikim të konsiderueshëm, përveç rasteve kur një ndikim i tillë mund të demonstrohet qartë. Një pronësi e konsiderueshme ose e shumicës nga një investues tjetër nuk përjashton domosdoshmërisht që një njësi ekonomike të ketë ndikim të konsiderueshëm.
12. Ekzistenca e ndikimit të konsiderueshëm nga një njësi zakonisht evidentohet në një ose më shumë nga mënyrat e mëposhtme:
- (a) Përfaqësimi në bordin e drejtuesve ose organin ekuivalent drejtues të të investuarit;
 - (b) Pjesëmarrja në proceset e hartimit të politikave, duke përfshirë pjesëmarrjen në vendime për dividendë ose shpërndarje të ngjashme;
 - (c) Transaksionet materiale ndërmjet njësisë dhe të investuarit të saj;

- (d) Shkëmbimi i personelit drejtues; ose
 - (e) Dhënia e informacionit teknik thelbësor.
13. Një njësi mund të zotërojë garanci për të blerë aksione me një çmim dhe datë të specifikuar, opsione për të blerë aksione me një çmim të caktuar para një date të caktuar, instrumente borxhi ose kapitali që janë të konvertueshme në aksione të zakonshme ose instrumente të tjera të ngjashme që kanë potencialin, nëse ushtrohen ose konvertohen, t'i japin njësisë fuqi shtesë votimi ose të reduktojnë fuqinë e votimit të një pale tjetër mbi politikat financiare dhe operative të një njësie tjetër (d.m.th. të drejtat potenciale të votës). Ekzistenca dhe efekti i të drejtave potenciale të votimit që janë aktualisht në fuqi për tu ushtruar ose për tu konvertuar, duke përfshirë të drejtat potenciale të votimit të zotëruara nga njësitë e tjera, merren parasysh kur vlerësohet nëse një njësi ka ndikim të konsiderueshëm. Të drejtat potenciale të votimit nuk janë aktualisht të ushtrueshme ose të konvertueshme kur, për shembull, ato nuk mund të ushtrohen ose konvertohen deri në një datë të ardhshme ose deri në ndodhjen e një ngjarjeje të ardhshme.
14. Në vlerësimin nëse të drejtat potenciale të votimit kontribuojnë në ndikim të konsiderueshëm, njësia ekzaminon të gjitha faktet dhe rrethanat (duke përfshirë kushtet e ushtrimit të të drejtave potenciale të votimit dhe çdo marrëveshje tjetër detyruese, qoftë të konsideruar individualisht ose në kombinim) që prekin të drejtat potenciale, me përjashtim të synimeve të menaxhimit dhe aftësisë financiare për të ushtruar ose konvertuar ato të drejta potenciale.
15. Një njësi humbet ndikimin e konsiderueshëm mbi një të investuar kur humbet fuqinë për të marrë pjesë në vendimet e politikës financiare dhe operative të atij të investuari. Humbja e ndikimit të konsiderueshëm mund të ndodhë me ose pa një ndryshim në nivelet absolute ose relative të pronësisë. Ajo mund të ndodhë, për shembull, kur një pjesëmarrje bëhet subjekt i kontrollit të një qeverie tjetër, një gjykatë ose një administratori. Ajo mund të ndodhë gjithashtu si rezultat i një marrëveshjeje detyruese.

Metoda e Kapitalit

16. Sipas metodës së kapitalit, në njohjen fillestare, investimi në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët njihet me kosto dhe vlera e mbartur rritet ose ulet për të njohur pjesën e investuesit në sufiçitin ose defiçitin e të investuarit pas datës së blerjes. Pjesa e investuesit në sufiçitin ose defiçitin e të investuarit njihet në sufiçitin ose defiçitin e investuesit. Shpërndarjet e marra nga një i investuar reduktojnë vlerën e mbartur të investimit. Rregullimet në vlerën e mbartur mund të jenë gjithashtu të nevojshme për ndryshimet në interesin proporcional të investuesit në të investuarin që vijnë nga ndryshimet në kapitalin e të investuarit që nuk janë njohur në sufiçitin ose defiçitin e të investuarit. Ndryshime të tilla përfshijnë ato që vijnë nga rivlerësimi i ndërtesave, makinerive, dhe pajisjeve dhe nga diferencat e të këmbimit valutor. Pjesa e

investuesit në këta ndryshime njihet në aktivet/kapitalin neto të investuesit.

17. Njohja e të ardhurave në bazë të shpërndarjeve të marra mund të mos jetë një masë adekuate e të ardhurave të fituara nga një investues nga një investim në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët, sepse shpërndarjet e marra mund të kenë pak lidhje me performancën e pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët. Për shkak se investuesi ka kontroll të përbashkët ose ndikim të konsiderueshëm mbi të investuarin, investuesi ka një interes në performancën e pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët dhe, si rezultat, fitimin e investimit të tij. Investuesi kontabilizon këtë interes duke zgjeruar fushëveprimin e pasqyrave të tij financiare për të përfshirë pjesën e tij të sufiçitit ose defiçitit të një të investuari të tillë. Si rezultat, zbatimi i metodës së kapitalit jep një raportim më informues të aktiveve/kapitalit neto dhe sufiçitit ose defiçitit të investuesit.
18. Kur ekzistojnë të drejta potenciale votimi ose derivativë të tjerë që përbajnë të drejta potenciale votimi, interesi i një njësie në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët përcaktohet vetëm në bazë të interesave ekzistuese të pronësisë dhe nuk pasqyron ushtrimin ose konvertimin e mundshëm të të drejtave potenciale të votimit dhe instrumenteve të tjerë derivativë, përveç nëse paragrafi 19 është i zbatueshëm.
19. Në disa rrethana, një njësi ka, në thelb, një interes pronësie ekzistues si rezultat i një transaksioni që aktualisht i jep të drejtë në përfitimet që shoqërohen me një interes pronësie. Në rrethana të tilla, proporcioni i alokuar për njësinë përcaktohet duke marrë parasysh ushtrimin eventual të atyre të drejtave potenciale të votimit dhe instrumenteve të tjerë derivative që aktualisht i japin njësisë të drejtë në përfitimet.
20. SNKSP 41, *Instrumentet Financiare* nuk zbatohet për interesat në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta që kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit. Kur instrumentet që përbajnë të drejta potenciale votimi në thelb japin aktualisht të drejtë në përfitimet e shoqëruara me një interes pronësie në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët, instrumentet nuk i nënshtrohen SNKSP 41. Në të gjitha rastet e tjera, instrumentet që përbajnë të drejta potenciale votimi në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët kontabilizohen në përputhje me SNKSP 41.
- 20A. Një njësi zbaton gjithashtu SNKSP 41 për instrumente të tjerë financiare në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, për të cilën nuk zbatohet metoda e kapitalit. Këta përfshijnë interesa afatgjatë që, në thelb, përbëjnë pjesë të investimit neto të njësisë në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët (shih paragrafin 41). Një njësi zbaton SNKSP 41 për interesa të tillë afatgjatë përpara se të zbatojë paragrafin 41 dhe paragrafët 43–48 të këtij Standardi. Në zbatimin e SNKSP 41, njësia ekonomike nuk merr parasysh ndonjë rregullim në vlerën e mbartur të interesave afatgjatë që lind nga zbatimi i këtij standardi.

21. Një investim në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët të kontabilizuar duke përdorur metodën e kapitalit do të klasifikohet si një aktiv afatgjatë.

Zbatimi i Metodës së Kapitalit

22. Një njësi me kontroll të përbashkët ose ndikim të konsiderueshëm mbi një të investuar do të kontabilizojë investimin e saj në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët duke përdorur metodën e kapitalit, përveç kur ky investim kualifikohet për përjashtim në përputhje me paragrafët 23-25.

Përjashtime nga Zbatimi i Metodës së Kapitalit

23. Një njësi nuk ka nevojë të zbatojë metodën e kapitalit për investimin e saj në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët nëse njësia është një njësi kontrolluese që përjashtohet nga përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara nga përjashtimi në fushëveprimin e paragrafit 5 të SNKSP 35 ose nëse janë të zbatueshme të gjitha pikat që vijojnë:
- (a) Vetë njësia është një njësi e kontrolluar dhe nevojat për informacion të përdoruesve plotësohen nga pasqyrat financiare të konsoliduara të njësisë kontrolluese dhe, në rastin e një njësie pjesërisht në pronësi, të gjithë pronarët e tjerë të saj, përfshirë ata që nuk kanë të drejtë vote, janë informuar për, dhe nuk janë në kundërshtim që njësia të mos zbatojë metodën e kapitalit.
 - (b) Instrumentet e borxhit ose të kapitalit të njësisë nuk tregtohen në një treg publik (një bursë e brendshme ose e huaj ose një treg jashtë bursës të pasupervizuar, duke përfshirë tregjet lokale dhe rajonale).
 - (c) Njësia nuk ka depozituar, dhe as nuk është në proces depozitimi të pasqyrave financiare pranë një komisioni të letrave me vlerë ose në një organizatë tjetër rregullatore, me qëllim emetimin e ndonjë klase instrumentesh në një treg publik.
 - (d) Njësia kontrolluese përfundimtare ose e ndërmjetme e njësisë prodhon pasqyra financiare të disponueshme për përdorim publik që janë në përputhje me SNKSP-të, në të cilat njësitë e kontrolluara konsolidohen ose maten me vlerën e drejtë në përputhje me SNKSP 35.
24. Kur një investim në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët mbahet nga, ose mbahet në mënyrë indirekte nëpërmjet, një njësie që është një organizatë kapitali të sipërmarrjes, ose një fond i përbashkët, njësi trustesh dhe njësi të ngjashme, duke përfshirë fondet e sigurimit të lidhura me investimet, njësia mund të zgjedhë të matë atë investim me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit në përputhje me SNKSP 41. Një njësi do ta bëjë këtë zgjedhje veç për çdo pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, në njohjen fillestare të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët. Një njësi investuese, sipas përkufizimit, do ta ketë bërë këtë zgjedhje për investimet e saj.

25. Kur një njësi ka një investim në një pjesëmarrje, një pjesë e të cilit mbahet në mënyrë indirekte nëpërmjet një organizate kapitali të sipërmarrjes, ose një fondi të përbashkët, njësie trustesh dhe njërive të ngjashme, duke përfshirë fondet e sigurimit të lidhura me investimet, njësia mund të zgjedhë të masë atë pjesë të investimit në pjesëmarrjen me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit në përputhje me SNKSP 41, pavarësisht nëse organizata e kapitalit të sipërmarrjes, ose fondi i përbashkët, njësia e trustit dhe njësitë e ngjashme, duke përfshirë fondet e sigurimit të lidhura me investimet, kanë ndikim të konsiderueshëm mbi atë pjesë të investimit. Nëse njësia bën atë zgjedhje, njësia do të zbatojë metodën e kapitalit për çdo pjesë të mbetur të investimit të saj në një pjesëmarrje që nuk mbahet nëpërmjet një organizate kapitali të sipërmarrjes, ose një fondi të përbashkët, njësie trustesh dhe njësie të ngjashme duke përfshirë fondet e siguracionit të lidhura me investimet. Kur një njësi ka një investim në një pjesëmarrje, një pjesë e së cilës mbahet në mënyrë indirekte nëpërmjet një njësie investuese, njësia do të masë atë pjesë të investimit me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit në përputhje me SNKSP 41.

Ndalimi i Përdorimit të Metodës së Kapitalit

26. **Një njësi do të ndërpresë përdorimin e metodës së kapitalit neto nga data kur investimi i saj ndalon së qeni një pjesëmarrje ose një sipërmarrje e përbashkët si më poshtë:**

- (a) Nëse investimi bëhet një njësi e kontrolluar, njësia do të kontabilizojë investimin e saj në përputhje me SNKSP 40, *Kombinimet e Sektorit Publik* dhe SNKSP 35.
- (b) Nëse interesi i mbajtur në pjesëmarrjen ose sipërmarrjen e përbashkët të mëparshme është një aktiv financiar, njësia do të masë interesin e mbajtur me vlerën e drejtë. Vlera e drejtë e interesit të mbajtur do të konsiderohet si vlera e drejtë e tij në njohjen fillestare si një aktiv financiar në përputhje me SNKSP 41. Njësia do të njohë në suficit ose deficit çdo diferencë midis:
 - (i) Vlerës së drejtë të çdo interesi të mbajtur dhe çdo të ardhurë nga shitja e/heqja dorë nga një pjese të interesit në pjesëmarrjen ose sipërmarrjen e përbashkët; dhe
 - (ii) Vlerës së mbartur të investimit në datën kur përdorimi i metodës së kapitalit u ndërpre.
- (c) Kur një njësi ndërpret përdorimin e metodës së kapitalit, njësia do të kontabilizojë të gjitha shumat e njohura më parë drejtpërdrejt në aktivet/kapitalin neto të njësisë në lidhje me atë investim në të njëjtën bazë siç do të kërkohej nëse i investuari do të kishte shitur/hequr dorë drejtpërdrejt nga aktivet ose detyrimet e lidhura.

27. Nëse një investim në një pjesëmarrje bëhet një investim në një sipërmarrje të përbashkët ose një investim në një sipërmarrje të përbashkët bëhet një

investim në një pjesëmarrje, njësia vazhdon të zbatojë metodën e kapitalit dhe nuk e rimat interesin e mbajtur.

Ndryshime në Interesin e Pronësisë

28. Nëse interesi i pronësisë së një njësie në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët reduktohet, por investimi vazhdon të klasifikohet përkatësisht ose si pjesëmarrje ose një sipërmarrje e përbashkët, njësia do të transferojë drejtpërdrejt te sufiçitet ose defiçitet e akumuluar pjesën e fitimit ose humbjes që ishte njohur më parë në aktivet/kapitalin neto që lidhen me atë reduktim në interesin e pronësisë nëse ky fitim ose humbje do të kërkohej të transferohej drejtpërdrejt në sufiçitet ose defiçitet e akumuluar në heqjen dorë nga/shitjen e aktiveve ose detyrimeve përkatëse.

Procedurat e Metodës së Kapitalit

29. Shumë nga procedurat që janë të përshtatshme për zbatimin e metodës së kapitalit janë të ngjashme me procedurat e konsolidimit të përshkruara në SNKSP 35. Për më tepër, konceptet që qëndrojnë në themel të procedurave të përdorura në kontabilitetin për blerjen e një njësie të kontrolluar janë adoptuar gjithashtu në kontabilizimin e blerjes së një investimi në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët.
30. Pjesa e një njësie ekonomike në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët është përmbledhja e zotërimeve në atë pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët nga njësia kontrolluese dhe njësitet e saj të kontrolluara. Zotërimet e shoqërive të tjera ose sipërmarrjeve të përbashkëta të njësive ekonomike nuk merren parasysh për këtë qëllim. Kur një pjesëmarrje ose një sipërmarrje e përbashkët ka njësi të kontrolluara, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkëta, sufiçiti ose defiçiti dhe aktivet neto të marra parasysh në zbatimin e metodës së kapitalit janë ato të njohura në pasqyrat financiare të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët (përfshirë pjesën e pjesëmarrjes ose të sipërmarrjes së përbashkët të sufiçiteve ose defiçiteve dhe aktiveve neto të shoqërive të saj dhe sipërmarrjeve të përbashkëta), pas çdo rregullimi të nevojshëm për t'i dhënë efekt politikave kontabël uniforme (shih paragrafët 37–39).
31. Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga transaksionet "upstream" dhe "downstream" që përfshijnë aktive që nuk përbëjnë një operacion, siç përcaktohet në SNKSP 40, midis një njësie (duke përfshirë njësitet e saj të kontrolluara të konsoliduara) dhe pjesëmarrjes së saj ose sipërmarrjes së përbashkët, njihen në pasqyrat financiare të njësive vetëm në masën e interesave të investuesve të palidhur në pjesëmarrjen ose sipërmarrjen e përbashkët. Transaksionet "upstream" janë, për shembull, shitjet e aktiveve nga një pjesëmarrje ose një sipërmarrje e përbashkët tek investuesi. Pjesa e njësive në fitimet ose humbjet e pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët që rezultojnë nga këto transaksione eliminohet. Transaksionet "downstream" janë, për shembull, shitjet ose kontributet e aktiveve nga investuesi te pjesëmarrja ose sipërmarrja e tij e përbashkët.

32. Kur transaksionet downstream japin evidencë për një reduktim në vlerën neto të realizueshme të aktiveve që do të shiten ose kontribuohen, ose për një humbje nga zhvlerësimi i këtyre aktiveve, ato humbje do të njihen plotësisht nga investuesi. Kur transaksionet upstream japin evidencë për një reduktim të vlerës neto të realizueshme të aktiveve që do të blihen ose për një humbje nga zhvlerësimi të atyre aktiveve, investuesi duhet të njohë pjesën e tij në ato humbje.
33. Fitimi ose humbja që rezulton nga kontributi i aktiveve jomonetare që nuk përbëjnë një operacion, siç përcaktohet në SNKSP 40, për një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët në këmbim të një interesi të kapitalit në atë pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët do të kontabilizohet në përputhje me paragrafin 31, me përjashtim të rasteve kur kontributit i mungon substanca komerciale, siç përshkruhet në SNKSP 17, *Ndërtesa, Makineri dhe Pajisje*. Nëse një kontributi të tillë i mungon thelbi tregtar, fitimi ose humbja konsiderohet si e porealizuar dhe nuk njihet përveçse kur zbatohet edhe paragrafi 34. Fitime dhe humbje të tilla të porealizuara do të eliminohen kundrejt investimit të kontabilizuar duke përdorur metodën e kapitalit dhe nuk do të prezantohen si fitime ose humbje të shtyra në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar të njësisë ose në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë në të cilën investimet kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit.
34. Nëse, përveç marrjes së një interesi të kapitalit në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët, një njësi merr aktive monetare ose jomonetare, njësia njihet plotësisht në sufiçit ose defiçit pjesën e fitimit ose humbjes në kontributin që lidhet me aktivet monetare ose jomonetare të marrë.
- 34A. Fitimi ose humbja që rezulton nga një transaksion downstream që përfshin aktive që përbëjnë një operacion, siç përcaktohet në SNKSP 40, ndërmjet një njësie (duke përfshirë njësitë e kontrolluara të konsoliduara) dhe pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së saj të përbashkët, njihet plotësisht në pasqyrat financiare të investuesit.
- 34B. Një njësi mund të shesë ose të kontribuojë aktive në dy ose më shumë marrëveshje (transaksione). Për të përcaktuar nëse aktivet e shitura ose të kontribuara përbëjnë një operacion, siç përcaktohet në SNKSP 40, një njësi duhet të marrë parasysh nëse shitja ose kontributi i këtyre aktiveve është pjesë e një grupi marrëveshjes që duhet të kontabilizohet si një transaksion i vetëm në përputhje me kërkesat në paragrafin 53 të SNKSP 35.
35. Një investim kontabilizohet duke përdorur metodën e kapitalit nga data në të cilën ai bëhet një pjesëmarrje ose një sipërmarrje e përbashkët. Me blerjen e investimit, çdo diferencë midis kostos së investimit dhe pjesës së njësisë në vlerën e drejtë neto të aktiveve dhe detyrimeve të identifikueshëm të të investuarit llogaritet si më poshtë:
- (a) Kur një njësi ka përfshirë emrin e mirë që lidhet me një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët në vlerën e mbartur të investimit, amortizimi

i atij emri të mirë nuk lejohet.

- (b) Çdo tejkalim i pjesës së njësisë në vlerën e drejtë neto të aktiveve dhe detyrimeve të identifikueshëm të investuarit mbi koston e investimit përfshihet si e ardhur në përcaktimin e pjesës së njësisë të suficitit ose deficitit të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët në periudhën në të cilën investimi është blerë.

Rregullimet e duhura të pjesës së njësisë në suficitin ose deficitin e pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët pas blerjes bëhen për të kontabilizuar, për shembull, zhvlerësimin e aktiveve të amortizueshëm bazuar në vlerat e tyre të drejta në datën e blerjes. Në mënyrë të ngjashme, rregullimet e duhura të pjesës së njësisë në suficitin ose deficitin e pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët pas blerjes bëhen për humbjet nga zhvlerësimi, si p.sh. për ndërtesat, makineritë, dhe pajisjet ose, sipas rastit, emri i mirë.

- 36. **Pasqyrat financiare më të fundit të disponueshme të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët përdoren nga njësia në zbatimin e metodës së kapitalit. Kur fundi i periudhës së raportimit të njësisë është i ndryshëm nga ai i një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët, njësia ose:**

- (a) **Merr, për qëllimin e zbatimit të metodës së kapitalit, informacion financiar shtesë në të njëjtën datë me pasqyrat financiare të njësisë; ose**
- (b) **Përdor pasqyrat financiare më të fundit të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët të rregulluara për efektet e transaksioneve ose ngjarjeve të rëndësishme që ndodhin midis datës së këtyre pasqyrave financiare dhe datës së pasqyrave financiare të njësisë.**

- 37. **Pasqyrat financiare të njësisë do të përgatiten duke përdorur politika uniforme të kontabilitetit për transaksione dhe ngjarje të ngjashme në rrethana të ngjashme.**

- 38. Përveç siç përshkruhet në paragrafin 39, nëse një pjesëmarrje ose një sipërmarrje e përbashkët përdor politika kontabël të ndryshme nga ato të njësisë për transaksione dhe ngjarje të ngjashme në rrethana të ngjashme, do të bëhen rregullime për të bërë që politikat kontabël të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët të jenë në përputhje me ato të njësisë kur pasqyrat financiare të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët përdoren nga njësia në zbatimin e metodës së kapitalit.

- 39. **Pavarësisht nga kërkesat në paragrafin 38, nëse një njësi ka një interes në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët që është një njësi investuese, njësia, kur zbaton metodën e kapitalit, do të mbajë matjen e vlerës së drejtë të zbatuar nga ajo pjesëmarrje ose sipërmarrje e përbashkët e njësies investuese ndaj interesit të saj në njësitë e kontrolluara.**

40. Nëse një pjesëmarrje ose një sipërmarrje e përbashkët ka aksione preferenciale të akumuluar të papaguara që mbahen nga palë të ndryshme nga njësia dhe klasifikohen si kapital, njësia llogarit pjesën e saj të suficitit ose deficitit pas rregullimit për dividendët në këta aksione, pavarësisht nëse dividendët janë deklaruar apo jo.
41. Nëse pjesa e një njësie e deficitit të një pjesëmarrje ose një sipërmarrjeje të përbashkët është e barabartë ose tejkalon interesin e saj në pjesëmarrjen ose sipërmarrjen e përbashkët, njësia ndërpret njohjen e pjesës së saj të deficiteve të mëtejshme. Interesi në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët është vlera e mbartur e investimit në pjesëmarrjen ose sipërmarrjen e përbashkët, e përcaktuar duke përdorur metodën e kapitalit së bashku me çdo interes afatgjatë që, në thelb, është pjesë e investimit neto të njësisë në pjesëmarrjen ose sipërmarrjen e përbashkët. Për shembull, një artikull për të cilin shlyerja as nuk është planifikuar dhe as ka gjasa të ndodhë në të ardhmen e parashikueshme është, në thelb, një zgjerim/zgjatim i investimit të njësisë në atë pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët. Artikuj të tillë mund të përfshijnë aksione preferenciale dhe të arkëtueshme ose kredi afatgjata, por nuk përfshijnë të arkëtueshmet tregtare, të pagueshmet tregtare ose ndonjë të arkëtueshme afatgjate për të cilën ekziston kolateral adekuat, siç janë kreditë e siguruara. Deficitet e njohura duke përdorur metodën e kapitalit, që tejkalojnë investimin e njësisë në aksione të zakonshme, zbatohen për përbërësit e tjerë të interesit të njësisë në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët në rendin e kundërt të vjetërsisë së tyre (d.m.th. përparësia në likuidim).
42. Pasi interesi i njësisë reduktohet në zero, bëhen përgatitje për deficite shtesë dhe njihet një detyrim, vetëm në masën që njësia ka marrë/shkaktuar obligime ligjore ose konstruktive ose ka bërë pagesa në emër të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët. Nëse pjesëmarrja ose sipërmarrja e përbashkët raporton më pas suficite, njësia rifillon të njohë pjesën e saj të atyre suficiteve vetëm pasi pjesa e saj e suficiteve të jetë e barabartë me pjesën e deficiteve të panjohur.

Humbjet nga Zhvlerësimi

43. Pas zbatimit të metodës së kapitalit, duke përfshirë njohjen e deficiteve të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët në përputhje me paragrafin 41, njësia zbaton paragrafët 44A–44C për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive që investimi i saj neto në pjesëmarrjen ose sipërmarrjen e përbashkët është zhvlerësuar.
44. [Fshirë]
- 44A. Investimi neto në një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët është zhvlerësuar dhe humbjet nga zhvlerësimi ndodhin nëse, dhe vetëm nëse, ka evidencë objektive të zhvlerësimit si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të investimit neto (një 'ngjarje e humbjes')

dhe ajo ngjarje (ose ngjarjet) e humbjes ka një ndikim në flukset e ardhshme monetare të vlerësuar nga investimi neto që mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Mund të mos jetë e mundur të identifikohet një ngjarje e vetme, diskrete që ka shkaktuar zhvlerësimin. Në vend të kësaj, efekti i kombinuar i disa ngjarjeve mund të ketë shkaktuar zhvlerësimin. Humbjet e pritshme si rezultat i ngjarjeve të ardhshme, pavarësisht sa të mundshme, nuk njihen. Evidenca objektive se investimi neto është zhvlerësuar përfshin të dhëna të vëzhgueshme që vihen në vëmendje të njësisë për ngjarjet e mëposhtme të humbjes:

- (a) Vështirësi të konsiderueshme financiare të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët;
- (b) Një shkelje e kontratës, e tillë si mospagimi ose vonesa në pagesa nga pjesëmarrja ose sipërmarrja e përbashkët;
- (c) Njësia, për arsye ekonomike ose ligjore që lidhen me vështirësitë financiare të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët, i jep pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët një koncesion që njësia nuk do ta merrte në konsideratë përndryshe;
- (d) Bëhet e mundshme që pjesëmarrja ose sipërmarrja e përbashkët do të hyjë në falimentim ose një riorganizim tjetër financiar; ose
- (e) Zhdukja e një tregu aktiv për investimin neto për shkak të vështirësive financiare të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët.

44B. Zhdukja e një tregu aktiv për shkak se kapitali ose instrumentet financiare të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët nuk tregtohen më publikisht nuk është evidencë e zhvlerësimit. Një ulje e vlerësimit të kreditit së një pjesëmarrje ose sipërmarrjeje të përbashkët ose një rënie në vlerën e drejtë të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët, nuk është në vetvete, evidencë e zhvlerësimit, megjithëse mund të jetë evidencë e zhvlerësimit kur merret parasysh me informacione të tjerë të disponueshëm.

44C. Krahas llojeve të ngjarjeve në paragrafin 44A, evidenca objektive e zhvlerësimit për investimin neto në instrumentet e kapitalit të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët përfshin informacion rreth ndryshimeve të konsiderueshme me një efekt negativ që kanë ndodhur në fushën teknologjike, të tregut, ekonomike ose mjedisin ligjor në të cilin operon pjesëmarrja ose sipërmarrja e përbashkët, dhe tregon se kostoja e investimit në instrumentin e kapitalit mund të mos rikuperohet. Një rënie e konsiderueshme ose e zgjatur e vlerës së drejtë të një investimi në një instrument të kapitalit nën koston e tij është gjithashtu evidencë objektive e zhvlerësimit.

45. Kurdoherë që zbatimi i paragrafëve 44A–44C tregon se investimi në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët mund të zhvlerësohet, një njësi zbaton SNKSP 26, *Zhvlerësimi i Aktiveve që Gjenerojnë Mjete Monetare*, dhe ndoshta, SNKSP 21, *Zhvlerësimi i Aktiveve që nuk Gjenerojnë Mjete Monetare*.

46. SNKSP 26 drejton një njësi të përcaktojë vlerën në përdorim të investimit gjenerues të mjeteve monetare. Në përcaktimin e vlerës në përdorim të investimit gjenerues të mjeteve monetare në përputhje me SNKSP 26, një njësi vlerëson:
- (a) Pjesën e tij në vlerën aktuale të flukseve monetare të vlerësuara të ardhshme që pritet të gjenerohen nga pjesëmarrja ose sipërmarrja e përbashkët, duke përfshirë fluksin monetar nga operacionet e pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët dhe të ardhurat nga shitja e investimit; ose
 - (b) Vlerën aktuale të flukseve monetare të ardhshëm të vlerësuar që pritet të krijohen nga dividendët ose shpërndarjet e ngjashme që do të merren nga investimi dhe nga shitja përfundimtare e tij.

Duke përdorur supozimet e duhura, të dyja metodat japin të njëjtin rezultat.

47. SNKSP 21 kërkon që, nëse shumat e rikuperueshme e shërbimit të një aktivi është më e vogël se vlera e tij e mbartur, vlera e mbartur duhet të reduktohet në shumën e rikuperueshme të shërbimit. Shumat e rikuperueshme e shërbimit është më e larta midis vlerës së drejtë të një aktivi, minus kostot për shitje dhe vlerës së tij në përdorim. Vlera në përdorim e një aktivi që nuk gjeneron mjete monetare përcaktohet si vlera aktuale e potencialit të mbetur të shërbimit të aktivitetit. Vlera aktuale e potencialit të shërbimit të mbetur mund të vlerësohet duke përdorur qasjen e kostos së zëvendësimit të amortizuar, qasjen e kostos së restaurimit ose qasjen e njësisë të shërbimit, sipas rastit.
48. **Shumat e rikuperueshme e një investimi në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët do të vlerësohet për çdo pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, përveç rastit kur pjesëmarrja ose sipërmarrja e përbashkët nuk gjenerojnë flukse monetare hyrës nga përdorimi i vazhdueshëm që janë kryesisht të pavarur nga ato nga aktivet e tjera të njësisë.**

Pasqyrat Financiare të Veçanta

49. **Një investim në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët do të kontabilizohet në pasqyrat financiare të veçanta të njësisë në përputhje me paragrafin 12 të SNKSP 34, *Pasqyrat Financiare të Veçanta*.**

Dispozitat Kalimtare

50. Dispozitat Kalimtare për ndryshimin nga konsolidimi proporcional në metodën e kapitalit, ose nga metoda e kapitalit në kontabilizimin e aktiveve dhe detyrimeve në lidhje me një operacion të përbashkët përcaktohen në SNKSP 37.

Data Efektive dhe Periudha Kalimtare

51. **Një njësi duhet të zbatojë këtë Standard për pasqyrat financiare vjetore që**

mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2017. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton këtë standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2017, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe të zbatojë SNKSP 34, SNKSP 35, SNKSP 37 dhe SNKSP 38, *Paraqitja e Interesave në Njësitë e Tjera*, në të njëjtën kohë.

- 51A. Paragrafët 6 dhe 7 u fshinë nga *Zbatueshmëria e SNKSP-ve*, botuar në prill 2016. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2018. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.
- 51B. Paragrafi 26 u ndryshua nga SNKSP 40, *Kombinimet e Sektorit Publik*, botuar në janar 2017. Një njësi do të zbatojë këtë ndryshim për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2019. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimin për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2019, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe të zbatojë SNKSP 40 në të njëjtën kohë.
- 51C. Paragrafët 31 dhe 33 u ndryshuan dhe paragrafët 34A dhe 34B u shtuan nga SNKSP 40, *Kombinimet e Sektorit Publik*, botuar në janar 2017. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime në mënyrë prospektive për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNKSP. Zbatimi i mëparshëm lejohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe, nëse nuk e ka bërë tashmë këtë, do të zbatojë SNKSP 40 në të njëjtën kohë.
- 51D. Paragrafët 20, 24, 25, 26, 43, 44 dhe 45 u ndryshuan dhe paragrafët 44A, 44B dhe 44C u shtuan nga SNKSP 41, publikuar në gusht 2018. Një njësi duhet t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janar, 2022. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2022, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 41 në të njëjtën kohë.
- 51E. Paragrafi 24 u ndryshua nga Përmirësime të SNKSP-ve, 2018, botuar në tetor 2018. Një njësi do të zbatojë këtë ndryshim për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2019. Zbatimi i mëparshëm lejohet. Nëse një njësi e zbaton këtë ndryshim për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2019, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.
- 51F. Paragrafi 20A u shtua dhe paragrafi 44 u fshi nga Interesat Afatgjata në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta (Ndryshimet në SNKSP 36)

dhe Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNKSP 41), botuar në janar 2019. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime në retrospektivë në përputhje me SNKSP 3, Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet, për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2022, përveç siç specifikohet në paragrafët 51G–51I. Zbatimi i mëparshëm lejohet. Nëse një njësi i zbaton këta ndryshime për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2022, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 41 në të njëjtën kohë.

- 51G. Një njësi që zbaton fillimisht ndryshimet në paragrafin 51F në të njëjtën kohë që zbaton fillimisht SNKSP 41, do të zbatojë kërkesat e tranzicionit në SNKSP 41 për interesat afatgjata të përshkruara në paragrafin 20A.
- 51H. Një njësi që zbaton fillimisht ndryshimet në paragrafin 51F pasi të zbatojë fillimisht SNKSP 41, do të zbatojë kërkesat e tranzicionit në SNKSP 41 të nevojshme për zbatimin e kërkesave të përcaktuara në paragrafin 20A për interesat afatgjata. Për këtë qëllim, referencat në datën e zbatimit fillestar në SNKSP 41 do të lexohen se i referohen fillimit të periudhës vjetore të raportimit në të cilën njësi zbaton për herë të parë ndryshimet (data e zbatimit fillestar të ndryshimeve). Njësisë nuk i kërkohet të riparaqesë periudhat e mëparshme për të pasqyruar zbatimin e ndryshimeve. Njësi mund të riparaqesë periudhat e mëparshme vetëm nëse është e mundur pa përdorimin e një analize të re në retrospektivë.
- 51I. Nëse një njësi nuk riparaqit periudhat e mëparshme duke zbatuar paragrafin 51H, në datën e zbatimit fillestar të ndryshimeve, ajo do të njohë në sufitin ose deficitin fillestar të akumuluar (ose përbërës tjetër të aktiveve/kapitalit neto, sipas rastit) çdo ndryshim midis:
- Vlerës së mbartur të mëparshme të interesave afatgjatë të përshkruar në paragrafin 20A në atë datë; dhe
 - Vlerës së mbartur të atyre interesave afatgjatë në atë datë.
52. Kur një njësi adopton SNKSP-të sipas kontabilitetit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara siç përcaktohet në SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP)* sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara për qëllime të raportimit financiar pas kësaj date efektive, ky Standard zbatohet për pasqyrat financiare vjetore të njësisë që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës së adoptimit të SNKSP-ve.

Shfuqizimi dhe Zëvendësimi i SNKSP 7 (Dhjetor 2006)

53. Ky Standard zëvendëson SNKSP 7 *Investimet në Pjesëmarrje* (Dhjetor 2006). SNKSP 7 mbetet i zbatueshëm derisa SNKSP 36 të zbatohet ose të hyjë në fuqi, cilado të jetë më herët.

SNKSP 37—MARRËVESHJET E PËRBASHKËTA

Shënime të Mirënjohjes

Ky Standard Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) është hartuar kryesisht nga Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar (SNRF) 11, *Marrëveshjet e Përbashkëta* publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Ekstrakte nga SNRF 11 janë riprodhuar në këtë publikim të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) me lejen e Fondacionit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Teksti i aprovuar i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) është ai i publikuar nga BSNK në gjuhën angleze dhe kopjet mund të merren direkt nga IFRS Foundation, Costumer Service, Columbus Building, 7 Westferry Circus, Canary Wharf, London E14 4HD, United Kingdom.

E-mail: publications@ifrs.org

Internet: www.ifrs.org

Të drejtat e autorit për SNRF-të, SNK-të, Draftet e Paraqitura dhe publikime të tjera të BSNK-së i përkasin Fondacionit SNRF.

"SNRF", "SNK", "BSNK", "Fondacioni SNRF", "Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit" dhe "Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar" janë marka tregtare të Fondacionit SNRF dhe nuk duhet të përdoren pa aprovimin e Fondacionit SNRF.

SNKSP 37—MARRËVESHJET E PËRBASHKËTA**Historia e SNKSP**

Ky version përfshin ndryshime që rezultojnë nga SNKSP-të e botuara deri në 31 janar, 2019.

SNKSP 37, *Marrëveshjet e Përbashkëta* u publikua në janar 2015.

Që atëherë, SNKSP 37 është ndryshuar nga SNKSP-të e mëposhtme:

- *Përmirësime të SNKSP-ve 2018* (botuar në tetor 2018)
- *SNKSP 41, Instrumentet Financiare* (botuar në gusht 2018)
- *SNKSP 40, Kombinimet e Sektorit Publik* (botuar në janar 2017)
- *Zbatueshmëria e SNKSP-ve* (botuar në prill 2016)

Tabela e Paragrafëve të Ndryshuar në SNKSP 37

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
5	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
6	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
24A	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
28	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
30	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
32	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017
41	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018

MARRËVESHJET E PËRBASHKËTA

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
41A	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
42A	I Ri	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
42B	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
42C	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
42D	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018
42E	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018
AG11	U Ndryshua	SNKSP 41 Gusht 2018
AG33A	U Ndryshua	SNKSP 40 Janar 2017 SNKSP 41 Gusht 2018
AG33B	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
AG33C	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017
AG33CA	I Ri	Përmirësime të SNKSP-ve Tetor 2018
AG33D	I Ri	SNKSP 40 Janar 2017

SNKSP 37—MARRËVESHJET E PËRBASHKËTA

PËRMBAJTJA

	Paragrafi
Objektivi	1–2
Objekti	3–6
Përkufizime	7–8
Marrëveshje Detyruese	8
Marrëveshjet e Përbashkëta	9–22
Kontrolli i Përbashkët	12–18
Llojet e Marrëveshjeve të Përbashkëta	19–22
Pasqyrat Financiare të Palëve në një Marrëveshje të Përbashkët	23–28
Operacionet e Përbashkëta	23–26
Sipërmarrjet e Përbashkëta	27–28
Pasqyrat Financiare të Veçanta	29–30
Dispozitat Kalimtare	31–41
Sipërmarrjet e Përbashkëta—Kalimi nga Konsolidimi Proporcional në Metodën e Kapitalit	32–36
Operacionet e Përbashkëta—Kalimi nga Metoda e Kapitalit në Metodën e Kontabilitetit të Aktiveve dhe Detyrimeve	37–40
Dispozitat Kalimtare në Pasqyrat Financiare të Veçanta të një Njësie	41
Kontabiliteti për Blerjet e Interesave në Operacionet e Përbashkëta	41A
Data Efektive	42–43
Shfuqizimi dhe Zëvendësimi i SNKSP 8 (Dhjetor 2006)	44

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik 37, *Marrëveshjet e Përbashkëta*, është përcaktuar në paragrafët 1–44. Të gjithë paragrafët kanë autoritet të barabartë. SNKSP 37 duhet të lexohet në kontekstin e objektivit të tij, Bazës për Konkluzione, *Parathënies së Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik*, dhe *Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar me Qëllim të Përgjithshëm nga Njësitë e Sektorit Publik*. SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, jep një bazë për zgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabël në mungesë të udhëzimeve të qarta.

Objektivi

1. Objektivi i këtij Standardi është të vendosë parime për raportimin financiar nga njësitë që kanë interes në aranzhimet që kontrollohen bashkarisht (d.m.th., marrëveshjet e përbashkëta).
2. Për të përmbushur objektivin në paragrafin 1, ky Standard përkufizon kontrollin e përbashkët dhe kërkon që një njësi që është palë në një marrëveshje të përbashkët të përcaktojë tipin e marrëveshjes së përbashkët në të cilën është përfshirë duke vlerësuar të drejtat dhe obligimet e saj dhe t'i kontabilizojë ato të drejta dhe obligime në përputhje me atë tip marrëveshjeje të përbashkët.

Objekti

3. Një njësi që pregatit dhe paraqet pasqyrat financiare sipas kontabilitetit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara do të zbatojë këtë Standard në përcaktimin e tipit të marrëveshjes së përbashkët në të cilën është përfshirë dhe në kontabilizimin e të drejtave dhe obligimeve të marrëveshjes së përbashkët.
4. Ky Standard do të zbatohet nga të gjitha njësitë që janë palë në një marrëveshje të përbashkët.
5. [Fshirë]
6. [Fshirë]

Përkufizime

7. Termat e mëposhtëm përdoren në këtë Standard me kuptimet e specifikuara:

Marrëveshje detyruese: Për qëllimet e këtij Standardi, një marrëveshje detyruese është një marrëveshje e cila u jep palëve të drejta dhe obligime të imponueshme sikur të ishte në formën e një kontrate. Ajo përfshin të drejtat nga kontratat ose të drejta të tjera ligjore.

Një **marrëveshje e përbashkët** është një marrëveshje në të cilën dy ose më shumë palë kanë kontroll të përbashkët.

Kontrolli i përbashkët është ndarja e rënë dakord e kontrollit të një marrëveshjeje me anë të një marrëveshjeje detyruese, e cila ekziston vetëm kur vendimet për aktivitetet përkatëse/relevante kërkojnë lejen/aprovimin unanimitet palëve që ndajnë kontrollin.

Një **operacion i përbashkët** është një marrëveshje e përbashkët ku palët që kanë kontroll të përbashkët të marrëveshjes kanë të drejta mbi aktivet, dhe obligime për detyrimet që lidhen me marrëveshjen.

Një **operator i përbashkët** është një palë në një operacion të përbashkët që ka kontroll të përbashkët të atij operacioni të përbashkët.

Një sipërmarrje e përbashkët është një marrëveshje e përbashkët ku palët që kanë kontroll të përbashkët të marrëveshjes kanë të drejta mbi aktivet neto të marrëveshjes.

Një sipërmarrës i përbashkët është një palë në një sipërmarrje të përbashkët që ka kontroll të përbashkët të asaj sipërmarrjeje të përbashkët.

Një palë në një marrëveshje të përbashkët është një njësi që merr pjesë në një marrëveshje të përbashkët, pavarësisht nëse ajo njësi ekonomike ka kontroll të përbashkët të marrëveshjes.

Një mjet i veçantë është një strukturë financiare e identifikueshme veç, duke përfshirë njësi juridike të veçanta ose njësi të njohura me statut, pavarësisht nëse ato njësi kanë një personalitet juridik.

Termet e përkufizuar në SNKSP-të e tjera përdoren në këtë Standard me të njëjtin kuptim si në ato Standarde dhe riprodhohen në *Fjalorin e Termave të Përkufizuar* publikuar veçmas. Termet e mëposhtëm përkufizohen në SNKSP 34, *Pasqyrat Financiare të Veçanta*, SNKSP 35, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara* ose SNKSP 36, *Investimet në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta*: përfitimet, kontrolli, metoda e kapitalit, fuqia, të drejtat mbrojtëse, aktivitetet përkatëse/relevante, pasqyrat financiare të veçanta dhe ndikim i konsiderueshëm.

Marrëveshje Detyruese

8. Marrëveshjet detyruese mund të evidentohen në disa mënyra. Një marrëveshje detyruese është shpesh, por jo gjithmonë, me shkrim, në formën e një kontrate ose diskutimesh të dokumentuara ndërmjet palëve. Mekanizmat statutorë si autoriteti legjislativ ose ekzekutiv mund të krijojnë gjithashtu rregullime të imponueshme, të ngjashme me marrëveshjet kontraktuale, ose më vete, ose në lidhje/së bashku me kontratat ndërmjet palëve.

Marrëveshjet e Përbashkëta (shih paragrafët AG2–AG33)

9. Një marrëveshje e përbashkët është një marrëveshje në të cilën dy ose më shumë palë kanë kontroll të përbashkët.
10. Një marrëveshje e përbashkët ka karakteristikat e mëposhtme:
 - (a) Palët janë të lidhura nga një marrëveshje detyruese (shih paragrafët G2–AG4).
 - (b) Marrëveshja detyruese u jep dy ose më shumë prej atyre palëve kontrollin e përbashkët të marrëveshjes (shih paragrafët 12–18).
11. Një marrëveshje e përbashkët është ose një operacion i përbashkët ose një sipërmarrje e përbashkët.

Kontroll i Përbashkët

12. **Kontrolli i përbashkët është ndarja e kontrollit të një marrëveshjeje, e cila ekziston vetëm kur vendimet për aktivitetet përkatëse kërkojnë aprovimin unanimit të palëve që ndajnë kontrollin. Ndarja e kontrollit mund të jetë rënë dakord me anë të një marrëveshjeje detyruese.**
13. **Një njësi që është palë në një marrëveshje do të vlerësojë nëse marrëveshja detyruese u jep të gjitha palëve, ose një grupi palësh, kontrollin e marrëveshjes kolektivisht. Të gjitha palët, ose një grup palësh, kontrollojnë marrëveshjen kolektivisht kur duhet të veprojnë së bashku për të drejtuar aktivitetet që ndikojnë ndjeshëm në përfitimet nga marrëveshja (d.m.th., aktivitetet përkatëse).**
14. Pasi të jetë përcaktuar se të gjitha palët, ose një grup palësh, kontrollojnë marrëveshjen kolektivisht, kontrolli i përbashkët ekziston vetëm kur vendimet për aktivitetet përkatëse kërkojnë aprovimin unanimit të palëve që kontrollojnë marrëveshjen kolektivisht.
15. Në një marrëveshje të përbashkët, asnjë palë e vetme nuk e kontrollon marrëveshjen më vete. Një palë me kontroll të përbashkët të një marrëveshjeje mund të parandalojë ndonjë nga palët e tjera, ose një grup palësh, nga kontrolli i marrëveshjes.
16. Një marrëveshje mund të jetë një marrëveshje e përbashkët edhe pse jo të gjitha palët e saj kanë kontroll të përbashkët të marrëveshjes. Ky Standard bën dallimin ndërmjet palëve që kanë kontroll të përbashkët të një marrëveshjeje të përbashkët (operatorë të përbashkët ose sipërmarrës të përbashkët) dhe palëve që marrin pjesë, por nuk kanë kontroll të përbashkët, në një marrëveshje të përbashkët.
17. **Një njësi do të duhet të zbatojë gjykimin kur vlerëson nëse të gjitha palët, ose një grup palësh, kanë kontroll të përbashkët të një marrëveshjeje. Një njësi duhet ta bëjë këtë vlerësim duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat (shih paragrafët AG5–AG11).**
18. **Nëse faktet dhe rrethanat ndryshojnë, një njësi duhet të rivlerësojë nëse ka ende kontroll të përbashkët të marrëveshjes.**

Llojet e Marrëveshjeve të Përbashkëta

19. **Një njësi duhet të përcaktojë tipin e marrëveshjes së përbashkët në të cilën është përfshirë. Klasifikimi i një marrëveshjeje të përbashkët si një operacion i përbashkët ose një sipërmarrje e përbashkët varet nga të drejtat dhe obligimet e palëve në marrëveshje.**
20. **Një njësi zbaton gjykimin kur vlerëson nëse një marrëveshje e përbashkët është një operacion i përbashkët ose një sipërmarrje e përbashkët. Një njësi do të përcaktojë tipin e marrëveshjes së përbashkët në të cilën është**

përfshirë duke marrë parasysh të drejtat dhe detyrimet e saj që vijnë nga marrëveshja. Një njësi vlerëson të drejtat dhe detyrimet e saj duke marrë parasysh strukturën dhe formën ligjore të marrëveshjes, kushtet e rëna dakord nga palët ose të vendosura nga autoriteti legjislativ ose ekzekutiv dhe, kur është e përshtatshme, fakte dhe rrethana të tjera (shih paragrafët AG12–AG33).

21. Ndonjëherë palët janë të detyruara nga një marrëveshje sipas kuadrit që përcakton kushtet e përgjithshme për ndërmarrjen e një ose më shumë aktiviteteve. Marrëveshja sipas kuadrit mund të parashikojë që palët të krijojnë marrëveshje të ndryshme të përbashkëta për t'u marrë me aktivitete specifike që janë pjesë e marrëveshjes. Edhe pse këto marrëveshje të përbashkëta lidhen me të njëjtën marrëveshje të kuadrit, lloji i tyre mund të jetë i ndryshëm nëse të drejtat dhe obligimet e palëve ndryshojnë kur ndërmerren aktivitete të ndryshme që trajtohen në marrëveshjen sipas kuadrit. Për pasojë, operacionet e përbashkëta dhe sipërmarrjet e përbashkëta mund të bashkëjetojnë kur palët ndërmarrin aktivitete të ndryshme që janë pjesë e së njëjtës marrëveshje sipas kuadrit.
22. Nëse faktet dhe rrethanat ndryshojnë, një njësi duhet të rivlerësojë nëse lloji i marrëveshjes së përbashkët në të cilën është përfshirë ka ndryshuar.

Pasqyrat Financiare të Palëve në një Marrëveshjeje të Përbashkët (shih paragrafët AG33A–AG37)

Operacionet e Përbashkëta

23. Një operator i përbashkët do të njohë në lidhje me interesin e tij në një operacion të përbashkët:
 - (a) Aktivitetet e tij, duke përfshirë pjesën e tij të çdo aktivi të mbajtur së bashku;
 - (b) Detyrimet e tij, duke përfshirë pjesën e tij të çdo detyrimi të krijuar së bashku;
 - (c) Të ardhurat e tij nga shitja e pjesës së tij të rezultatit përfundimtar që vjen nga operacioni i përbashkët;
 - (d) Pjesa e tij në të ardhurat nga shitja e rezultatit përfundimtar nga operacioni i përbashkët; dhe
 - (e) Shpenzimet e tij, duke përfshirë pjesën e tij të çdo shpenzimi të kryer së bashku.
24. Një operator i përbashkët do të kontabilizojë aktivitetet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me interesin e tij në një operacion të përbashkët në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme për aktivitetet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e veçanta.

- 24A. Kur një njësi fiton një interes në një operacion të përbashkët në të cilin aktiviteti i operacionit të përbashkët përbën një operacion, siç përcaktohet në SNKSP 40, *Kombinimet e Sektorit Publik*, ajo do të zbatohet, në masën e pjesës së saj në përputhje me paragrafin 23, të gjitha parimet mbi kontabilitetin e blerjeve në SNKSP 40 dhe SNKSP-të e tjera, që nuk janë në konflikt me udhëzimet në këtë Standard, dhe japin informacionin që kërkohet në ato SNKSP në lidhje me blerjet. Kjo vlen për blerjen e interesit fillestar dhe të interesave shtesë në një operacion të përbashkët në të cilin aktiviteti i operacionit të përbashkët përbën një operacion. Kontabilizimi për blerjen e një interesi në një operacion të tillë të përbashkët është specifikuar në paragrafët AG33A–AG33D.
25. Kontabilizimi për transaksione të tilla si shitja, kontributi ose blerja e aktiveve ndërmjet një njësie dhe një operacioni të përbashkët në të cilin ajo është një operator i përbashkët është specifikuar në paragrafët AG34–AG37.
26. Një palë që merr pjesë në një operacion të përbashkët, por nuk ka kontroll të përbashkët të tij, do të kontabilizojë gjithashtu interesin e saj në marrëveshjen në përputhje me paragrafët 23-25 nëse ajo palë ka të drejta mbi aktivet dhe obligimet për detyrimet, në lidhje me operacionin e përbashkët. Nëse një palë që merr pjesë në një operacion të përbashkët, por nuk ka kontroll të përbashkët të tij, nuk ka të drejta mbi aktivet dhe obligimet për detyrimet, që lidhen me atë operacion të përbashkët, ajo do të kontabilizojë për interesin e saj në operacionin e përbashkët në përputhje me SNKSP-të e zbatueshme për atë interes.

Sipërmarrjet e Përbashkëta

27. Një sipërmarrës i përbashkët do të njohë interesin e tij në një sipërmarrje të përbashkët si një investim dhe do të kontabilizojë atë investim duke përdorur metodën e kapitalit në përputhje me SNKSP 36, *Investimet në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta*, përveç rasteve kur njësia përjashtohet nga zbatimi i metodës së kapitalit siç specifikohet në atë Standard.
28. Një palë që merr pjesë në një sipërmarrje të përbashkët, por nuk ka kontroll të përbashkët të saj, duhet të kontabilizojë interesin e saj në marrëveshje në përputhje me SNKSP-të që trajtojnë instrumentet financiare, si SNKSP 28, *Instrumentet Financiare: Paraqitja*, SNKSP 30, *Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjegues* dhe SNKSP 41, *Instrumentet Financiare*, përveç rasteve kur ka ndikim të konsiderueshëm mbi sipërmarrjen e përbashkët, në të cilin rast ajo do ta kontabilizojë atë në përputhje me SNKSP 36.

Pasqyrat Financiare të Veçanta

29. Në pasqyrat e tij financiare të veçanta, një operator i përbashkët ose sipërmarrës i përbashkët duhet të kontabilizojë interesin e tij në:
- (a) Një operacion të përbashkët në përputhje me paragrafët 23–25; dhe
 - (b) Një sipërmarrje të përbashkët në përputhje me paragrafin 12 të SNKSP 34.
30. Në pasqyrat e saj financiare të veçanta, një palë që merr pjesë në një marrëveshje të përbashkët, por nuk ka kontroll të përbashkët në të, do të kontabilizojë interesin e saj në:
- (a) Një operacion të përbashkët në përputhje me paragrafin 26; dhe
 - (b) Një sipërmarrje të përbashkët në përputhje me SNKSP 41, përveç rastit kur njëzia ka ndikim të konsiderueshëm mbi sipërmarrjen e përbashkët, rast në të cilin ajo do të zbatojë paragrafin 12 të SNKSP 34.

Dispozita Kalimtare

31. Pavarësisht nga kërkesat e paragrafit 33 të SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, kur ky Standard zbatohet për herë të parë, një njësi duhet të prezantojë vetëm informacionin sasior të kërkuar nga paragrafi 33(f) i SNKSP 3, për periudhën vjetore menjëherë para periudhës së parë vjetore për të cilën zbatohet ky Standard ("periudha e menjëhershme paraardhëse"). Një njësi mund të paraqesë gjithashtu këtë informacion për periudhën aktuale ose për periudhat e mëparshme krahasuese, por nuk është e detyruar ta bëjë këtë.

Sipërmarrjet e Përbashkëta—Kalimi nga Konsolidimi Proporcional në Metodën e Kapitalit

32. Kur kalon nga konsolidimi proporcional në metodën e kapitalit, një njësi duhet të njohë investimin e saj në sipërmarrjen e përbashkët në fillim të periudhës menjëherë paraardhëse. Ky investim fillestar do të matet si shumatore e vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve që njëzia kishte konsoliduar më parë në mënyrë proporcionale, duke përfshirë çdo emër të mirë të blerë që vjen nga transaksionet e blerjes. Nëse emri i mirë i përkiste më parë një njësie më të madhe gjeneruese të mjeteve monetare, ose një grupi njësisish gjeneruese të mjeteve monetare, njëzia do të alokojë emrin e mirë për sipërmarrjen e përbashkët në bazë të vlerave të mbartura relative të sipërmarrjes së përbashkët dhe njësisë gjeneruese të mjeteve monetare, ose grupit të njërive gjeneruese të mjeteve monetare të cilave i përkiste.
33. Teprica fillestare e investimit e përcaktuar në përputhje me paragrafin 32 konsiderohet si kosto e supozuar e investimit në njohjen fillestare. Një njësi

do të zbatojë paragrafët 43–48 të SNKSP 36 për balancën fillestare të investimit për të vlerësuar nëse investimi është zhvlerësuar dhe do të njohë çdo humbje nga zhvlerësimi si një rregullim ndaj suficitit ose deficitit të akumuluar në fillim të periudhës menjëherë paraardhëse.

34. Nëse totali i të gjitha aktiveve dhe detyrimeve të konsoliduara në mënyrë proporcionale më parë rezulton në aktive neto negative, një njësi duhet të vlerësojë nëse ka obligime ligjore ose konstruktive në lidhje me aktivet neto negative dhe, nëse po, njësia do të njohë detyrimin korrespondues. Nëse njësia arrin në përfundimin se nuk ka obligime ligjore ose konstruktive në lidhje me aktivet neto negative, ajo nuk do të njohë detyrimin korrespondues, por do të rregullojë suficitin ose deficitin e akumuluar në fillim të periudhës menjëherë paraardhëse. Njësia do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt, së bashku me pjesën e saj të peregjistruar kumulative të humbjeve të sipërmarrjeve të saj të përbashkëta në fillim të periudhës menjëherë paraardhëse dhe në datën në të cilën ky Standard zbatohet për herë të parë.
35. Një njësi do të japë informacion për një ndarje të aktiveve dhe detyrimeve që janë përmbledhur në tepricën e zërit të vetëm të investimit në fillim të periudhës menjëherë paraardhëse. Ky informacion shpjegues do të përgatitet në një mënyrë të përmbledhur për të gjitha sipërmarrjet e përbashkëta për të cilat një njësi zbaton kërkesat e periudhës kalimtare të përmendura në paragrafët 32-36.
36. Pas njohjes fillestare, një njësi do të kontabilizojë investimin e saj në sipërmarrjen e përbashkët duke përdorur metodën e kapitalit në përputhje me SNKSP 36.

Operacionet e Përbashkëta - Kalimi nga Metoda e Kapitalit në Kontabilitetin për Aktivet dhe Detyrimet

37. Kur kalon nga metoda e kapitalit në kontabilitetin e aktiveve dhe detyrimeve në lidhje me interesin e saj në një operacion të përbashkët, një njësi, në fillim të periudhës menjëherë paraardhëse, çregjistron investimin që është kontabilizuar më parë duke përdorur metodën e kapitalit dhe çdo artikull tjetër që ishte pjesë e investimit neto të njësisë në marrëveshje në përputhje me paragrafin 41 të SNKSP 36 dhe njeh pjesën e saj në secilin prej aktiveve dhe detyrimeve në lidhje me interesin e saj në operacionin e përbashkët, duke përfshirë çdo emër të mirë që mund të ketë qenë pjesë të vlerës së mbartur të investimit.
38. Një njësi do të përcaktojë interesin e saj në aktivet dhe detyrimet që lidhen me operacionin e përbashkët në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të saj në një proporcion të caktuar në përputhje me marrëveshjen detyruese. Një njësi mat vlerat e mbartura fillestare të aktiveve dhe detyrimeve duke i ndarë ato nga vlera e mbartur e investimit në fillim të periudhës menjëherë

paraardhëse mbi bazën e informacionit të përdorur nga njësia në zbatimin e metodës së kapitalit.

39. Çdo diferencë që lind nga investimi i kontabilizuar më parë duke përdorur metodën e kapitalit së bashku me çdo zë/artikull tjetër që ishte pjesë e investimit neto të njësisë në marrëveshje në përputhje me paragrafin 41 të SNKSP 36 dhe shumën neto të aktiveve dhe detyrimeve, duke përfshirë çdo emër të mirë, të njohur do të jenë:
- (a) Kompensuar kundrejt çdo emri të mirë që lidhet me investimin me çdo diferencë të mbetur të rregulluar kundrejt suficitit ose deficitit të akumuluar në fillim të periudhës menjëherë paraardhëse, nëse shuma neto e aktiveve dhe detyrimeve, përfshirë çdo emër të mirë, të njohur është më e lartë se investimi (dhe secili nga artikujt e tjerë që ishin pjesë e investimit neto të njësisë) të çregjistruar.
 - (b) Rregulluar kundrejt suficitit ose deficitit të akumuluar në fillim të periudhës menjëherë paraardhëse, nëse shuma neto e aktiveve dhe detyrimeve, përfshirë çdo emër të mirë, të njohur është më e ulët se investimi (dhe çdo zë/artikull tjetër që ishte pjesë e investimit neto të njësisë) i çregjistruar.
40. Një njësi që ndryshon nga metoda e kapitalit në kontabilizimin e aktiveve dhe detyrimeve do të japë një rakordim midis investimit të çregjistruar dhe aktiveve dhe detyrimeve të regjistruara, së bashku me çdo diferencë të mbetur të rregulluar kundrejt suficitit ose deficitit të akumuluar, në fillim të periudhës menjëherë paraardhëse.

Dispozitat Kalimtare në Pasqyrat Financiare të Veçanta të një Njësie

41. Një njësi që, në përputhje me paragrafin 58 të SNKSP 6, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe të Veçanta*, më parë kontabilizonte në pasqyrat e saj financiare të veçanta interesin e saj në një operacion të përbashkët si investim duke përdorur metodën e kapitalit, me kosto ose në përputhje me SNKSP 41 do të:
- (a) Çregjistrojë investimin dhe njohë aktivet dhe detyrimet në lidhje me interesin e saj në operacionin e përbashkët në shumën e përcaktuara në përputhje me paragrafët 37-39.
 - (b) Bëjë një rakordim midis investimit të çregjistruar dhe aktiveve dhe detyrimeve të njohura, së bashku me çdo diferencë të mbetur të rregulluar në suficitin ose deficitin e akumuluar, në fillim të periudhës menjëherë paraardhëse.

Kontabiliteti për Blerjet e Interesave në Operacionet e Përbashkëta

- 41A. SNKSP 40, *Kombinimet e Sektorit Publik*, botuar në janar 2017, shtoi paragrafët 24A, 42B dhe AG33A–AG33D. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime në

mënyrë prospektive për blerjet e interesave në operacionet e përbashkëta në të cilat aktivitetet e operacioneve të përbashkëta përbëjnë operacione, siç përkufizohet në SNKSP 40, për ato blerje që ndodhin nga fillimi i periudhës së parë në të cilën ajo zbaton këto ndryshime. Rrjedhimisht, shumat e njohura për blerjet e interesave në operacionet e përbashkëta që ndodhin në periudhat e mëparshme nuk do të rregullohen.

Data Efektive

42. Një njësi do të zbatojë këtë Standard për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2017. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2017, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 34, SNKSP 35, SNKSP 36 dhe SNKSP 38, *Paraqitja e Interesave në Njësitë e Tjera*, në të njëjtën kohë.
- 42A. Paragrafët 5 dhe 6 u fshinë nga *Zbatueshmëria e SNKSP-ve*, botuar në prill 2016. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2018. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt.
- 42B. Paragrafët 24A, 41A dhe AG33A–AG33D u shtuan nga SNKSP 40, *Kombinimet e Sektorit Publik*, botuar në janar 2017. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime në mënyrë prospektive për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2019. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimin për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2019, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 40 në të njëjtën kohë.
- 42C. Paragrafi 32 u ndryshua nga SNKSP 40, *Kombinimet e Sektorit Publik*, botuar në janar 2017. Një njësi do të zbatojë këtë ndryshim për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2019. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimin për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2019, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 40 në të njëjtën kohë.
- 42D. Paragrafët 28, 30, 41, AG11 dhe AG33A u ndryshuan nga SNKSP 41, publikuar në gusht 2018. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2022. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2022, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe do të zbatojë SNKSP 41 në të njëjtën kohë.

- 42E. **Paragrafi AG33CA u shtua nga Përmirësime të SNKSP-ve, 2018, botuar në tetor 2018. Një njësi do të zbatojë këtë ndryshim për transaksionet në të cilat ajo merr kontroll të përbashkët në ose pas fillimit të pasqyrave të para financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2019. Zbatimi i mëparshëm lejohet. Nëse një njësi e zbaton këtë ndryshim për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2019, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt.**
43. Kur një njësi zbaton SNKSP-të sipas kontabilitetit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara siç përkufizohet në SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas kontabilitetit të ardhurave dhe detyrimeve të konstatuara* (SNKSP-të), për qëllime të raportimit financiar pas kësaj date efektive, ky Standard zbatohet për pasqyrat financiare vjetore të njësisë që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës së adoptimit të SNKSP-ve.

Shfuqizimi dhe Zëvendësimi i SNKSP 8 (Dhjetor 2006)

44. Ky Standard zëvendëson SNKSP 8, *Interesat në Sipërmarrjet e Përbashkëta* (Dhjetor 2006). SNKSP 8 mbetet i zbatueshëm derisa SNKSP 37 të zbatohet ose të hyjë në fuqi, cilado të jetë më herët.

SNKSP 38—DHËNIA E INFORMACIONEVE SHPJEGUESE NË LIDHJE ME INTERESAT NË NJËSITË E TJERA

Shënime të Mirënjohjes

Ky Standard Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) është hartuar kryesisht nga Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar (SNRF) 12, *Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në lidhje me Interesat në Njësitë e Tjera* publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Ekstrakte nga SNRF 12 janë riprodhuar në këtë publikim të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) me lejen e Fondacionit të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Teksti i aprovuar i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) është ai i publikuar nga BSNK në gjuhën angleze dhe kopjet mund të merren direkt nga IFRS Foundation, Customer Service, Columbus Building, 7 Westferry Circus, Canary Wharf, London E14 4HD, United Kingdom.

E-mail: publications@ifrs.org

Internet: www.ifrs.org

Të drejtat e autorit për SNRF-të, SNK-të, Draftet e Paraqitura dhe publikime të tjera të BSNK-së i përkasin Fondacionit SNRF.

"SNRF", "SNK", "BSNK", "Fondacioni SNRF", "Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit" dhe "Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar" janë marka tregtare të Fondacionit SNRF dhe nuk duhet të përdoren pa aprovimin e Fondacionit SNRF.

SNKSP 38—DHËNIA E INFORMACIONEVE SHPJEGUESE NË LIDHJE ME INTERESAT NË NJËSITË E TJERA

Historia e SNKSP

Ky version përfshin ndryshime që rezultojnë nga SNKSP-të e botuara deri në 31 janar, 2019.

SNKSP 38, *Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në lidhje me Interesat në Njësitë e Tjera* u publikua në janar 2015.

Që atëherë, SNKSP 38 është ndryshuar nga SNKSP-të e mëposhtme:

- SNKSP 41, *Instrumentet Financiare* (botuar në 14 gusht 2018)
- SNKSP 39, *Përfitimet e Punonjësve* (botuar në korrik 2016)
- *Zbatueshmëria e SNKSP-ve* (botuar në prill 2016)

Tabela e Paragrafëve të Ndryshuar në SNKSP 38

Paragrafi i Ndikuar	Si u Ndikua	Ndikuar Nga
4	U Ndryshua	SNKSP 39 Korrik 2016 SNKSP 41 Gusht 2018
5	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
6	U Fshi	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
61A	I Ri	Zbatueshmëria e SNKSP-ve Prill 2016
61B	I Ri	SNKSP 39 Korrik 2016
61C	I Ri	SNKSP 41 Gusht 2018

Janar 2015

**SNKSP 38—DHËNIA E INFORMACIONEVE SHPJEGUESE NË
LIDHJE ME INTERESAT NË NJËSITË E TJERA**

PËRMBAJTJA

	Paragrafi
Objektivi	1
Objekti	2–6
Përkufizime	7–8
Marrëveshje Detyruese	8
Dhënia e Informacionit për Interesat në Njësitë e Tjera	9–11
Gjykime dhe Supozime të Rëndësishme	12–14
Statusi i Njësisë Investuese	15–16
Interesat në Njësitë e Kontrolluara	17–26
Interesi që kanë Interesat Jokontrolluese në Aktivitetet dhe Flukset Monetare të Njësisë Ekonomike	19
Natyra dhe Shtrirja e Kufizimeve të Rëndësishëm	20
Natyra e Rreziqeve që Shoqërohen me Interesat e një Njësie në Njësitë e Strukturuara të Konsoliduara	21–24
Pasojat e Ndryshimeve në Interesin e Pronësinë së një Njësie Kontrolluese në një Njësi të Kontrolluar që nuk rezultojnë në një Humbje të Kontrollit	25
Pasojat e Humbjes së Kontrollit të një Njësie të Kontrolluar gjatë Periudhës së Raportimit	26
Interesat në Njësitë Ekonomike të Kontrolluara të Pakonsoliduara (Njësitë Investuese)	27–34
Interesat në Marrëveshjet e Përbashkëta dhe Pjesëmarrjet	35–39
Natyra, Shtrirja dhe Efektet Financiare të Interesave të një Njësie në Marrëveshjet e Përbashkëta dhe Pjesëmarrjet	36–38
Rreziqet që Shoqërohen me Interesat e Njësisë në Sipërmarrje të Përbashkëta dhe Pjesëmarrjet	39
Interesat në Njësitë e Strukturuara që nuk janë Konsoliduar	40–48

INFORMACIONE SHPJEGUESE PËR INTERESAT NË NJËSITË E TJERA

Natyra e Interesave	43–45
Natyra e Rreziqeve	46–48
Interesat Jo të Matshëm të Pronësisë	49–50
Interesat Kontrollues të Blerë me Qëllimin e Shitjes së tyre	51–57
Dispozita Kalimtare	58–60
Data Efektive	61–62

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit të Sektorit Publik 38, *Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në lidhje me Interesat në Njësitë e Tjera*, është përcaktuar në paragrafët 1–62. Të gjithë paragrafët kanë autoritet të barabartë. SNKSP 38 duhet të lexohet në kontekstin e objektivit të tij, Bazës për Konkluzione, *Parathënies së Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik*, dhe *Kuadrit Konceptual për Raportimin Financiar me Qëllim të Përgjithshëm nga Njësitë e Sektorit Publik*. SNKSP 3, *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*, jep një bazë për zgjedhjen dhe zbatimin e politikave të kontabilitetit në mungesë të udhëzimeve të qarta.

Objektivi

1. Objektivi i këtij Standardi është t'i kërkojë një njësie të paraqesë informacion që u mundëson përdoruesve të pasqyrave të saj financiare të vlerësojnë:
 - (a) Natyrën dhe rreziqet që lidhen me interesat e saj në njësitë e kontrolluara, njësitë e kontrolluara të pakonsoliduara, marrëveshjet e përbashkëta dhe pjesëmarrjet, dhe njësitë e strukturuar që nuk janë të konsoliduara; dhe
 - (b) Efektet e këtyre interesave në pozicionin e saj financiar, performancën financiare dhe flukset monetare.

Objekti

2. **Një njësi që përgatit dhe paraqet pasqyrat financiare sipas kontabilitetit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara do të zbatojë këtë Standard në dhënien e informacioneve për interesat e saj në njësitë e kontrolluara, njësitë e kontrolluara të pakonsoliduara, marrëveshjet e përbashkëta e pjesëmarrjet dhe njësitë e strukturuar që nuk janë të konsoliduara.**
3. **Ky Standard do të zbatohet nga një njësi që ka një interes në ndonjë nga sa vijon:**
 - (a) **Njësitë e kontrolluara;**
 - (b) **Marrëveshjet e përbashkëta (d.m.th., operacione të përbashkëta ose sipërmarrje të përbashkëta);**
 - (c) **Pjesëmarrjet; ose**
 - (d) **Njësitë e strukturuar të cilat nuk janë të konsoliduara.**
4. **Ky Standard nuk zbatohet për:**
 - (a) **Planet e përfitimeve të pas-punësimit ose plane të tjera afatgjata të përfitimeve të punonjësve për të cilat zbatohet SNKSP 39, *Përfitimet e Punonjësve*.**
 - (b) **Pasqyrat financiare të veçanta të një njësie për të cilat zbatohet SNKSP 34, *Pasqyrat Financiare të Veçanta*. Megjithatë:**
 - (i) **Nëse një njësi ka interesa në njësitë e strukturuar që nuk janë të konsoliduara dhe përgatit pasqyra financiare të veçanta si të vetmet pasqyra financiare, ajo do të zbatojë kërkesat në paragrafët 40-48 kur përgatit ato pasqyra financiare të veçanta.**
 - (ii) **Një njësi investuese që përgatit pasqyrat financiare në të cilat të gjitha njësitë e saj të kontrolluara maten me vlerën e drejtë nëpërmjet sufititit ose defiçitit në përputhje me paragrafin 56**

të SNKSP 35, do të japë dhe informacionet e kërkuara nga ky Standard në lidhje me njësitë investuese.

- (c) Një interes i mbajtur nga një njësi që merr pjesë, por nuk ka kontroll të përbashkët mbi një marrëveshje të përbashkët, përveç rastit kur ky interes rezulton në ndikim të konsiderueshëm mbi marrëveshjen ose është një interes në një njësi të strukturuar.
- (d) Një interes në një njësi tjetër që kontabilizohet në përputhje me SNKSP 41, *Instrumentet Financiare*. Megjithatë, një njësi do të zbatojë këtë Standard:
 - (i) Kur ky interes është një interes në një pjesëmarrje ose një sipërmarrje të përbashkët që, në përputhje me SNKSP 36, *Investimet në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta*, matet me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit; ose
 - (ii) Kur ky interes është një interes në një njësi të strukturuar që nuk është e konsoliduar.

5. [Fshirë]

6. [Fshirë]

Përkufizime

7. Termat e mëposhtëm përdoren në këtë Standard me kuptimet e specifikuara:

Marrëveshje detyruese: Për qëllimet e këtij Standardi, një marrëveshje detyruese është një marrëveshje e cila u jep palëve të drejta dhe obligime të imponueshme sikur të ishte në formën e një kontrate. Ajo përfshin të drejtat nga kontratat ose të drejta të tjera ligjore.

Një interes në një njësi tjetër, për qëllimin e këtij Standardi, i referohet përfshirjes me anë të marrëveshjeve detyruese ose ndryshe që ekspozon një njësi ndaj ndryshueshmërisë së përfitimeve nga performanca e njësisë tjetër. Një interes në një njësi tjetër mund të evidentohet nga, por nuk kufizohet vetëm në, mbajtjen/zotërimin e instrumenteve të kapitalit ose borxhit, si dhe forma të tjera të përfshirjes si dhënia e financimit, mbështetja/ndihma e likuiditetit, përmirësimi i kreditit dhe garancitë. Ai përfshin mjetet me të cilat një njësi ka kontroll apo kontroll të përbashkët, ose ndikim të konsiderueshëm mbi, një njësi tjetër. Një njësi nuk ka domosdoshmërisht një interes në një njësi tjetër vetëm për shkak të një marrëdhënieje tipike financues/përfitues ose klient/furnitor.

Paragrafët AG7–AG9 japin informacion të mëtejshëm për interesat në njësitë e tjera.

Paragrafët AG57–AG59 të SNKSP 35, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara* shpjegojnë ndryshueshmërinë e përfitimeve.

Të ardhurat nga një njësi e strukturuar, për qëllimin e këtij Standardi, përfshijnë, por nuk kufizohen në, tarifat e përsëritura dhe jo të përsëritura, interesat, dividendët ose shpërndarjet e ngjashme, fitimet ose humbjet nga rimatja ose çregjistrimi i interesave në njësitë e strukturuar dhe fitimet ose humbjet nga transferimi i aktiveve dhe detyrimeve të njësisë së strukturuar.

Një **njësi e strukturuar** është:

- (a) Në rastin e njësisë ku rregullimet administrative ose legjislativi janë zakonisht faktorët dominues për të vendosur se kush ka kontrollin e një njësie, një njësi që është projektuar në mënyrë që rregullimet administrative ose legjislativi të mos jenë faktorët dominues në vendosjen se kush e kontrollon njësinë, si p.sh. kur marrëveshjet detyruese janë të rëndësishme për përcaktimin e kontrollit të njësisë dhe aktivitetet përkatëse drejtohen me anë të marrëveshjeve detyruese; ose
- (b) Në rastin e njësisë ku votimi ose të drejtat e ngjashme janë normalisht faktori dominues për të vendosur se kush ka kontrollin e një njësie, një njësi që është projektuar në mënyrë që votimi ose të drejtat e ngjashme nuk janë faktorët dominues për të vendosur se kush e kontrollon njësinë, si p.sh. kur çdo e drejtë votimi lidhet vetëm me detyra administrative dhe aktivitetet përkatëse drejtohen me anë të marrëveshjeve detyruese.

Paragrafët AG20–AG23 japin informacion të mëtejshëm për njësitë e strukturuar.

Termet e përkufizuar në SNKSP-të e tjera përdoren në këtë Standard me të njëjtin kuptim si në ato Standarde dhe riprodhohen në *Fjalorin e Termave të Përkufizuar* publikuar veç. Termet e mëposhtëm përkufizohen ose në SNKSP 34, *Pasqyrat Financiare të Veçanta*, SNKSP 35, *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara*, SNKSP 36, *Investimet në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta* or SNKSP 37, *Marrëveshjet e Përbashkëta: pjesëmarrjet, pasqyra financiare të konsoliduara, kontroll, njësi e kontrolluar, njësi kontrolluese, njësi ekonomike, metoda e kapitalit, njësi investuese, marrëveshje e përbashkët, kontroll i përbashkët, operacion i përbashkët, sipërmarrje e përbashkët, interesa jokontrolluese, aktivitete përkatëse, pasqyra financiare të veçanta, mjet i veçantë dhe ndikim i konsiderueshëm.*

Marrëveshjet Detyruese

8. Marrëveshjet detyruese mund të evidentohen në disa mënyra. Një marrëveshje detyruese është shpesh, por jo gjithmonë, me shkrim, në formën e një kontrate ose diskutimesh të dokumentuara ndërmjet palëve. Mekanizmat statutorë si autoriteti legjislativ ose ekzekutiv mund të krijojnë gjithashtu rregullime të

imponueshme, të ngjashme me marrëveshjet kontraktuale, ose më vete ose në lidhje/së bashku me kontratat ndërmjet palëve.

Paraqitja e Informacionit për Interesat në Njësitë e Tjera

9. **Për të përmbushur objektivin në paragrafin 1, një njësi do të paraqesë:**
- (a) **Gjykimet dhe supozimet e rëndësishme që ka bërë në përcaktimin e:**
 - (i) Natyrës së interesit të saj në një njësi ose marrëveshje tjetër;
 - (ii) Tipit të marrëveshjes së përbashkët në të cilën ajo ka një interes (paragrafët 12–14); dhe
 - (iii) Faktit se plotëson përkufizimin e një njësie investuese, nëse është e zbatueshme (paragrafi 15); dhe
 - (b) **Informacionin për interesat e saj në:**
 - (i) Njësitë e kontrolluara (paragrafët 17–26);
 - (ii) Marrëveshjet e përbashkëta dhe pjesëmarrjet (paragrafët 35–39);
 - (iii) Njësitë e strukturuara që nuk janë të konsoliduara (paragrafët 40–48);
 - (iv) Interesat e pronësisë jo të matshëm (paragrafët 49–50); dhe
 - (v) Interesat kontrollues të marrë me synimin e shitjes/heqjes dorë (paragrafët 51–57).
10. Nëse informacionet shpjegues të paraqitur të kërkuar nga ky Standard, së bashku me informacionet shpjegues të kërkuar nga SNKSP-të e tjera, nuk përmbushin objektivin në paragrafin 1, një njësi do të paraqesë çdo informacion shtesë të nevojshëm për të përmbushur atë objektivi.
11. Një njësi do të marrë në konsideratë nivelin e detajeve të nevojshme për të përmbushur objektivin e dhënies së informacioneve në paragrafin 1 dhe sa theks duhet t'i kushtohet secilës prej kërkesave të këtij Standardi. Ajo do të grupojë ose zbërthejë informacionet në mënyrë që informacioni i dobishëm të mos errësohet as nga përfshirja e një sasive të madhe detajesh të parëndësishme ose nga grupimi i zërave që kanë karakteristika të ndryshme (shih paragrafët AG2–AG6).

Gjykime dhe Supozime të Rëndësishme

12. Një njësi do të paraqesë informacion shpjegues për metodologjinë e përdorur për të përcaktuar:
- (a) Se ka kontrollin e një njësie tjetër, siç përshkruhet në paragrafët 18 dhe 20 të SNKSP 35;

- (b) **Se ka kontroll të përbashkët të një marrëveshjeje ose ndikim të rëndësishëm mbi një njësi tjetër; dhe**
 - (c) **Tipin e marrëveshjes së përbashkët (d.m.th., operacion i përbashkët ose sipërmarrje e përbashkët) kur marrëveshja është strukturuar përmes një mjeti të veçantë.**
13. **Informacionet shpjegues të kërkuar nga paragrafi 12 do të jepen ose në pasqyrat financiare ose do të përfshihen me referencë të kryqëzuar nga pasqyrat financiare në ndonjë pasqyrë tjetër që është në dispozicion për përdoruesit e pasqyrave financiare në të njëjtat kushte si pasqyrat financiare dhe në të njëjtën kohë. Pa këtë informacion të përfshirë përmes referencave të kryqëzuara, pasqyrat financiare nuk janë të plota. Përdorimi i një metode të tillë referencimi mund të jetë subjekt i kufizimeve në juridiksione të ndryshme.**
14. **Për të respektuar paragrafin 12, një njësi duhet të paraqesë, për shembull, faktorët e konsideruar në përcaktimin se:**
- (a) **Ajo kontrollon një njësi specifike (ose kategori të ngjashme njësis) ku interesi në njësinë tjetër nuk evidentohet nga zotërimi i kapitalit ose i instrumenteve të borxhit;**
 - (b) **Ajo nuk kontrollon një njësi tjetër (ose kategori njësis) edhe pse zotëron më shumë se gjysmën e të drejtave të votimit të njësisë (ose njësive) tjetër;**
 - (c) **Ajo kontrollon një njësi tjetër (ose kategori njësis) edhe pse zotëron më pak se gjysmën e të drejtave të votimit të njësisë (ose njësive) tjetër;**
 - (d) **Ajo është një agjent ose një drejtues (shih paragrafët AG60–AG74 të SNKSP 35);**
 - (e) **Ajo nuk ka ndikim të konsiderueshëm edhe pse zotëron 20 për qind ose më shumë të të drejtave të votimit të një njësie tjetër; dhe**
 - (f) **Ajo ka ndikim të konsiderueshëm edhe pse zotëron më pak se 20 për qind të të drejtave të votimit të një njësie tjetër.**

Statusi i Njesisë Investuese

15. **Kur një njësi kontrolluese përcakton se ajo është një njësi investuese në përputhje me SNKSP 35, njësia investuese duhet të japë informacion shpjegues rreth gjykimëve dhe supozimeve të rëndësishme që ka bërë në përcaktimin se është një njësi investuese. Një njësie investuese nuk i kërkohet të japë informacion shpjegues nëse ka të gjitha karakteristikat në paragrafin 61 të SNKSP 35.**
16. **Kur një njësi bëhet, ose ndalon së qeni, një njësi investuese, ajo do të**

paraqesë informacion shpjegues për ndryshimin e statusit të njësisë investuese dhe arsytet e ndryshimit. Përveç kësaj, një njësi që bëhet një njësi investuese do të paraqesë informacion shpjegues për efektin e ndryshimit të statusit në pasqyrat financiare për periudhën e prezantuar, duke përfshirë:

- (a) Vlerën e drejtë totale, në datën e ndryshimit të statusit, të njësisive të kontrolluara që ndalojnë së konsoliduari;
- (b) Fitimin ose humbjen totale, nëse ka, të llogaritur në përputhje me paragrafin 64 të SNKSP 35; dhe
- (c) Zërat në sufiçit ose defiçit në të cilin fitimi ose humbja njihen (nëse nuk paraqiten veç).

Interesat në Njësitë e Kontrolluara

17. Një njësi do të paraqesë informacion shpjegues që u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare të konsoliduara:

- (a) Të kuptojnë:
 - (i) Përbërjen e njësisë ekonomike; dhe
 - (ii) Interesin që kanë interesat jokontrollues në aktivitetet dhe flukset monetare të njësisë ekonomike (paragrafi 19); dhe
- (b) Të vlerësojnë:
 - (i) Natyrën dhe shtrirjen e kufizimeve të rëndësishme në aftësinë e saj për të përdorur aktivet dhe për të shlyer detyrimet e njësisë ekonomike (paragrafi 20);
 - (ii) Natyrën dhe ndryshimet në rreziqet që shoqërohen me interesat e saj në njësitë e strukturuar të konsoliduara (paragrafët 21–24);
 - (iii) Pasojat e ndryshimeve në interesin e saj të pronësisë në një njësi të kontrolluar që nuk rezultojnë në humbjen e kontrollit (paragrafi 25); dhe
 - (iv) Pasojat e humbjes së kontrollit të një njësie të kontrolluar gjatë periudhës së raportimit (paragrafi 26).

18. Kur pasqyrat financiare të një njësie të kontrolluar të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara janë të një date ose për një periudhë që është e ndryshme nga ajo e pasqyrave financiare të konsoliduara (shih paragrafin 46 të SNKSP 35), një njësi do të paraqesë:

- (a) Datën e përfundimit të periudhës së raportimit të pasqyrave financiare të asaj njësie të kontrolluar; dhe
- (b) Arsyen e përdorimit të një date ose periudhe tjetër.

Interesi që kanë Interesat Jokkontrolluese në Aktivitetet dhe Flukset Monetare të Njesisë Ekonomike

19. Një njësi do të paraqesë informacione për secilën nga njësitë e saj të kontrolluara të cilat kanë interesa jokontrolluese që janë materialë për njësinë e raportimit:
- (a) Emrin e njesisë së kontrolluar;
 - (b) Vendin dhe formën juridike të njesisë së kontrolluar dhe juridiksionin në të cilin ajo operon;
 - (c) Pjesën e interesave të pronësisë të mbajtura nga interesat jokontrolluese;
 - (d) Pjesën e të drejtave të votimit që zotërohen nga interesat jokontrolluese, nëse është e ndryshme nga proporcioni i interesave të pronësisë të zotëruar/mbajtur;
 - (e) Suficitin ose deficitin e ndarë për interesat jokontrollues të njesisë së kontrolluar gjatë periudhës së raportimit;
 - (f) Interesat jokontrolluese të akumuluar të njesisë së kontrolluar në fund të periudhës së raportimit; dhe
 - (g) Informacionin financiar të përmbledhur për njësinë e kontrolluar (shih paragrafin AG10).

Natyrë dhe Shtrirja e Kufizimeve të Rëndësishme

20. Një njësi do të paraqesë:
- (a) Kufizime të rëndësishme në marrëveshjet detyruese (p.sh. kufizime statutore, kontraktuale dhe rregullatore) në aftësinë e saj për të përdorur ose përdorur aktivet dhe për të shlyer detyrimet e njesisë ekonomike, si p.sh.
 - (i) Ata që kufizojnë aftësinë e një njësie kontrolluese ose njësive të kontrolluara të saj për të transferuar mjete monetare ose aktive të tjera te (ose nga) njësitë e tjera brenda njesisë ekonomike.
 - (ii) Garancitë ose kërkesa të tjera që mund të kufizojnë dividendët dhe shpërndarjet e tjera të kapitalit që paguhen, ose kreditë dhe paradhëniet që bëhen ose shlyhen, për (ose nga) njësi të tjera brenda njesisë ekonomike.
 - (b) Natyrën dhe shkallën në të cilën të drejtat mbrojtëse të interesave jokontrolluese mund të kufizojnë ndjeshëm aftësinë e njesisë për të përdorur ose përdorur aktivet dhe për të shlyer detyrimet e njesisë ekonomike (si p.sh. kur një njësi kontrolluese është e detyruar të shlyejë detyrimet e një njësie të kontrolluar përpara se të kërkohet

shlyerja e detyrimeve të veta, ose aprovimi i interesave jokontrolluese ose për të përdorur aktivet ose për të shlyer detyrimet e një njësie të kontrolluar).

- (c) Vlerën e mbartur në pasqyrat financiare të konsoliduara të aktiveve dhe detyrimeve për të cilat zbatohen ato kufizime.

Natyra e Rreziqeve që Shoqërohen me Interesat e një Njësie në Njësitë e Strukturuar të Konsoliduara

21. Një njësi do të paraqesë informacion shpjegues për kushtet e çdo marrëveshjeje detyruese që mund t'i kërkojë njësisë kontrolluese ose njësisë të kontrolluara të saj të ofrojnë mbështetje financiare për një njësi të strukturuar të konsoliduar, duke përfshirë ngjarjet ose rrethanat që mund ta ekspozojnë njësinë raportuese ndaj një humbjeje (p.sh., marrëveshjet e likuiditetit ose indikatorët e klasifikimit të kreditit që shoqërohen me obligimet për të blerë aktive të njësisë së strukturuar ose për të ofruar mbështetje financiare).
22. Nëse gjatë periudhës së raportimit një njësi kontrolluese ose ndonjë nga njësitë e saj të kontrolluara, pa pasur një obligim sipas një marrëveshjeje detyruese për ta bërë këtë, ka dhënë/ofruar mbështetje financiare ose mbështetje tjetër për një njësi të strukturuar të konsoliduar (p.sh., blerja e aktiveve ose instrumenteve të emetuara nga, njësia e strukturuar), njësia do të paraqesë:
- (a) Tipin dhe sasinë e mbështetjes së dhënë, duke përfshirë situatat në të cilat njësia kontrolluese ose njësitë e saj të kontrolluara e kanë ndihmuar njësinë e strukturuar në marrjen e mbështetjes financiare; dhe
- (b) Arsyet për dhënien e mbështetjes.
23. Nëse gjatë periudhës së raportimit një njësi kontrolluese ose ndonjë nga njësitë e saj të kontrolluara, pa pasur një obligim sipas një marrëveshjeje detyruese për ta bërë këtë, ka dhënë mbështetje financiare ose mbështetje tjetër për një njësi të strukturuar më parë të pakonsoliduar dhe kjo dhënie e mbështetjes ka rezultuar që njësia të kontrollojë njësinë e strukturuar, njësia do të japë një shpjegim të faktorëve përkatës/relevantë në marrjen e këtij vendimi.
24. Një njësi do të paraqesë informacion për çdo synim aktual për të dhënë/ofruar mbështetje financiare ose mbështetje tjetër për një njësi të strukturuar të konsoliduar, duke përfshirë synimet për të ndihmuar njësinë e strukturuar në marrjen e mbështetjes financiare.

Pasojat e Ndryshimeve në Interesin e Pronësisë së një Njësie Kontrolluese në një Njësi të Kontrolluar që nuk Rezultojnë në një Humbje të Kontrollit

25. Një njësi do të prezantojë një skemë që tregon efektet në aktivet/kapitalin neto që i atribuohen pronarëve të njësisë kontrolluese të çdo ndryshimi në interesin e saj të pronësisë në një njësi të kontrolluar që nuk rezulton në një humbje të kontrollit.

Pasojat e Humbjes së Kontrollit të një Njësie të Kontrolluar gjatë Periudhës së Raportimit

26. Një njësi do të paraqesë informacion për fitimin ose humbjen, nëse ka, të llogaritur në përputhje me paragrafin 52 të SNKSP 35 dhe:
- (a) Pjesën e atij fitimi ose humbjeje që i atribuohet matjes së çdo investimi të mbajtur në njësinë e mëparshme të kontrolluar me vlerën e drejtë të saj në datën kur humbet kontrolli; dhe
 - (b) Zërat në suficit ose deficit në të cilin fitimi ose humbja njihen (nëse nuk prezantohen veç).

Interesat në Njësitë e Kontrolluara të Pakonsoliduara (Njësitë Investuese)

27. Një njësi investuese që, në përputhje me SNKSP 35, kërkohet të zbatojë përjashtimin nga konsolidimi dhe në vend të kësaj të kontabilizojë investimin e saj në një njësi të kontrolluar me vlerën e drejtë nëpërmjet suficitit ose deficitit, do të paraqesë informacion për këtë fakt.
28. Për çdo njësi të kontrolluar të pakonsoliduar, një njësi investuese do të paraqesë:
- (a) Emrin e njësisë së kontrolluar;
 - (b) Vendin dhe formën juridike të njësisë së kontrolluar dhe juridiksionin në të cilin ajo operon; dhe
 - (c) Pjesën e interesit të pronësisë të zotëruar nga njësia investuese dhe, nëse është e ndryshme, pjesën e të drejtave të votimit që zotërohen.
29. Nëse një njësi investuese është njësia kontrolluese e një njësie tjetër investuese, njësia kontrolluese do të japë gjithashtu informacionet në paragrafin 28(a)–(c) për investimet që kontrollohen nga njësia e kontrolluar investuese. Informacionet shpjegues mund të jepen duke përfshirë, në pasqyrat financiare të njësisë kontrolluese, pasqyrat financiare të njësisë së kontrolluar (ose njësive të kontrolluara) që përmbajnë informacionin e mësipërm.
30. Një njësi investuese do të paraqesë:
- (a) Natyrën dhe shtrirjen e çdo kufizimi të rëndësishëm që vjen nga marrëveshjet detyruese (p.sh., që rezultojnë nga marrëveshjet e huamarrjes, kërkesat rregullatore ose marrëveshjet kontraktuale) mbi aftësinë e një njësie të kontrolluar të pakonsoliduar për të transferuar fonde te njësia investuese në formën e dividendëve në

mjete monetare ose shpërndarje të ngjashme, ose për të ripaguar kreditë ose paradhëniet e bëra ndaj njësisë së kontrolluar të pakonsoliduar nga njësia investuese; dhe

- (b) Çdo angazhim ose synim aktual për të dhënë mbështetje financiare ose mbështetje tjetër për një njësi të kontrolluar të pakonsoliduar, duke përfshirë angazhimet ose synimet për të ndihmuar njësinë e kontrolluar në marrjen e mbështetjes financiare.

31. Nëse, gjatë periudhës së raportimit, një njësi investuese ose ndonjë nga njësitë e saj të kontrolluara, pa pasur një obligim që vjen nga një marrëveshje detyruese për ta bërë këtë, ka dhënë mbështetje financiare ose mbështetje tjetër për një njësi të kontrolluar të pakonsoliduar (p.sh., blerja e aktiveve ose instrumenteve të emetuara nga, njësia e kontrolluar ose që ndihmon njësinë e kontrolluar në marrjen e mbështetjes financiare), njësia do të paraqesë:

- (a) Tipin dhe shumën e mbështetjes që iu dha çdo njësie të kontrolluar të pakonsoliduar; dhe
- (b) Arsyet për dhënien e mbështetjes.

32. Një njësi investuese do të japë informacion shpjegues për kushtet e çdo marrëveshjeje detyruese që mund të kërkojë që njësia ose njësitë e kontrolluara të pakonsoliduara të japin mbështetje financiare për një njësi të pakonsoliduar, të kontrolluar, të strukturuar, duke përfshirë ngjarjet ose rrethanat që mund ta ekspozojnë njësinë raportuese ndaj një humbjeje (p.sh. marrëveshjet e likuiditetit ose indikatorët e klasifikimit të kreditit që shoqërohen me obligimet për të blerë aktive të njësisë së strukturuar ose për të ofruar mbështetje financiare).

33. Nëse gjatë periudhës së raportimit një njësi investuese ose ndonjë nga njësitë e saj të kontrolluara të pakonsoliduara ka dhënë, pa pasur një detyrim që vjen nga një marrëveshje detyruese për ta bërë këtë, mbështetje financiare ose mbështetje tjetër për një njësi të pakonsoliduar, të strukturuar që njësia investuese nuk e kontrollonte, dhe nëse kjo dhënie e mbështetjes ka rezultuar që njësia investuese të kontrollojë njësinë e strukturuar, njësia investuese do të japë një shpjegim të faktorëve përkatës në marrjen e vendimit për të dhënë atë mbështetje.

34. Një njësi kontrolluese që kontrollon një njësi investuese dhe nuk është në vetvete një njësi investuese, do të paraqesë në pasqyrat e saj financiare të konsoliduara, informacionin e kërkuar nga paragrafët 27 deri në 33 në lidhje me njësitë e tilla të kontrolluara të pakonsoliduara.

Interesat në Marrëveshjet e Përbashkëta dhe Pjesëmarrjet

35. Një njësi do të paraqesë informacion që u mundëson përdoruesve të

pasqyrave të saj financiare të vlerësojnë:

- (a) Natyrën, shtrirjen dhe efektet financiare të interesave të saj në marrëveshjet e përbashkëta dhe pjesëmarrjet, duke përfshirë natyrën dhe efektet e marrëdhënies së saj me investuesit e tjerë me kontroll të përbashkët ose ndikim të konsiderueshëm mbi marrëveshjet e përbashkëta dhe pjesëmarrjet (paragrafët 36 dhe 38); dhe
- (b) Natyrën dhe ndryshimet në rreziqet që shoqërohen me interesat e saj në sipërmarrjet e përbashkëta dhe pjesëmarrjet (paragrafi 39).

Natyra, Shtrirja dhe Efektet Financiare të Interesave të një Njësie në Marrëveshjet e Përbashkëta dhe Pjesëmarrjet

36. Një njësi do të paraqesë:

- (a) Për çdo marrëveshje dhe sipërmarrje të përbashkët që është materiale për njësinë e raportimit:
 - (i) Emrin e marrëveshjes së përbashkët ose të pjesëmarrjes;
 - (ii) Natyrën e marrëdhënies së njësisë me marrëveshjen e përbashkët ose pjesëmarrjen (duke përshkruar, për shembull, natyrën e aktiviteteve të marrëveshjes së përbashkët ose pjesëmarrjes dhe nëse ato janë strategjike për aktivitetet e njësisë);
 - (iii) Vendin dhe formën juridike të marrëveshjes ose pjesëmarrjes së përbashkët dhe juridiksionin në të cilin ajo vepron; dhe
 - (iv) Pjesën e interesit të pronësisë ose e aksionit pjesëmarrës që zotërohet nga njësia dhe, nëse është e ndryshme, pjesën e të drejtave të votimit të mbajtura (nëse është e zbatueshme).
- (b) Për çdo sipërmarrje të përbashkët ose pjesëmarrje që është materiale për njësinë raportuese:
 - (i) Nëse investimi në sipërmarrjen ose pjesëmarrjen e përbashkët matet duke përdorur metodën e kapitalit apo me vlerën e drejtë;
 - (ii) Informacionin e përmbledhur financiar rreth sipërmarrjes ose pjesëmarrjes së përbashkët siç specifikohet në paragrafët AG12 dhe AG13; dhe
 - (iii) Nëse sipërmarrja ose pjesëmarrja e përbashkët kontabilizohet duke përdorur metodën e kapitalit, vlerën e drejtë të investimit të saj në sipërmarrjen ose pjesëmarrjen përbashkët, nëse ka një çmim tregu të kuotuar për investimin.
- (c) Informacionin financiar siç specifikohet në paragrafin AG16 për

investimet e njësisë në sipërmarrjet ose pjesëmarrjet e përbashkëta që nuk janë individualisht materiale:

- (i) Në total për të gjitha sipërmarrjet e përbashkëta individualisht jomateriale; dhe
- (ii) Në total për të gjitha pjesëmarrjet individualisht jomateriale. Ky informacion i grupuar duhet të paraqitet veç nga informacioni i grupuar për sipërmarrjet e përbashkëta.

37. Një njësi investuese nuk ka nevojë të japë informacionet e kërkuara nga paragrafët 36(b)–36(c).

38. Një njësi do të paraqesë gjithashtu:

- (a) Natyrën dhe shtrirjen e çdo kufizimi të rëndësishëm (p.sh., që rezulton nga marrëveshjet e huamarrjes, kërkesat rregullatore ose marrëveshjet detyruese midis investuesve me kontroll të përbashkët ose ndikim të rëndësishëm mbi një sipërmarrje të përbashkët ose një pjesëmarrje) në aftësinë e sipërmarrjeve ose pjesëmarrjeve të përbashkëta për të transferuar fonde tek njësi në formën e dividendëve në mjete monetare ose shpërndarjeve të ngjashme, ose për të ripaguar kreditë ose paradhëniet e dhëna nga njësi.
- (b) Kur pasqyrat financiare të një sipërmarrjeje ose pjesëmarrjeje të përbashkët të përdorura në zbatimin e metodës së kapitalit janë të një date ose për një periudhë që është e ndryshme nga ajo e njësisë:
 - (i) Datën e fundit të periudhës së raportimit të pasqyrave financiare të asaj sipërmarrjeje ose pjesëmarrjeje të përbashkët; dhe
 - (ii) Arsyen e përdorimit të një date ose periudhe tjetër.
- (c) Pjesën e panjohur të humbjeve të një sipërmarrjeje të përbashkët ose pjesëmarrjeje, si për periudhën e raportimit, ashtu edhe në mënyrë kumulative, nëse njësi ka ndaluar së njohuri pjesën e saj të humbjeve të sipërmarrjes ose pjesëmarrjes së përbashkët, kur zbaton metodën e kapitalit.

Rreziqet që Shoqërohen me Interesat e një Njësie në Sipërmarrjet e ose Pjesëmarrjet e Përbashkëta

39. Një njësi do të paraqesë:

- (a) Angazhimet që ajo ka në lidhje me sipërmarrjet e saj të përbashkëta veç nga shuma e angazhimeve të tjera siç specifikohet në paragrafët AG17–AG19; dhe
- (b) Në përputhje me SNKSP 19, *Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivitetet e Kushtëzuara*, me përjashtim të rasteve kur probabiliteti i humbjes është i vogël, detyrimet e kushtëzuara të shkaktuara në

lidhje me interesat e saj në sipërmarrjet ose pjesëmarrjet e përbashkëta (përfshirë pjesën e saj të detyrimeve të kushtëzuara të shkaktuara së bashku me investues të tjerë me kontroll të përbashkët ose ndikim të konsiderueshëm mbi sipërmarrjet ose pjesëmarrjet e përbashkëta), veç nga shuma e detyrimeve të tjera të kushtëzuara.

Interesat në Njësitë e Strukturuara që nuk janë Konsoliduar

40. Një njësi duhet të paraqesë informacion që u mundëson përdoruesve të pasqyrave të saj financiare::
- (a) Të kuptojnë natyrën dhe shtrirjen e interesave të saj në njësitë e strukturuara që nuk janë konsoliduar (paragrafët 43–45); dhe
 - (b) Të vlerësojnë natyrën dhe ndryshimet në rreziqet që shoqërohen me interesat e saj në njësitë e strukturuara që nuk janë të konsoliduara (paragrafët 46–48).
41. Informacioni i kërkuar nga paragrafi 40(b) përfshin informacion për ekspozimin e një njësie ndaj rrezikut nga përfshirja që ajo kishte me njësitë e strukturuara që nuk janë konsoliduar në periudhat e mëparshme (p.sh. sponsorizimi i njësisë të strukturuar), edhe nëse njësia nuk ka më ndonjë përfshirje me anë të marrëveshjes detyruese me njësinë e strukturuar në datën e raportimit.
42. Një njësi investuese nuk ka nevojë të japë informacionet shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 40 për një njësi të strukturuar që ajo kontrollon, por që nuk është e konsoliduar, dhe për të cilën ajo prezanton informacionet shpjeguese të kërkuara nga paragrafët 27-33.

Natyra e Interesave

43. Një njësi duhet të paraqesë informacione cilësore dhe sasiore për interesat e saj në njësitë e strukturuara që nuk janë të konsoliduara, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, natyrën, qëllimin, madhësinë dhe aktivitetet e njësisë së strukturuar dhe mënyrën se si financohet njësia e strukturuar.
44. Nëse një njësi ka sponsorizuar një njësi të strukturuar që nuk është e konsoliduar për të cilën nuk jep informacionin e kërkuar nga paragrafi 46 (p.sh., sepse nuk ka një interes në njësinë në datën e raportimit), njësia do të paraqesë:
- (a) Si ka përcaktuar se cilat njësi të strukturuar ka sponsorizuar;
 - (b) Të ardhurat nga ato njësi të strukturuar gjatë periudhës së raportimit, duke përfshirë një përshkrim të llojeve të të ardhurave të paraqitura; dhe
 - (c) Vlerën e mbartur (në momentin e transferimit) të të gjitha aktiveve të transferuara tek ato njësi të strukturuar gjatë periudhës së raportimit.

45. Një njësi duhet të prezantojë informacionin në paragrafin 44(b) dhe (c) në formatin tabelor, përveç rastit kur një format tjetër është më i përshtatshëm, dhe të klasifikojë aktivitetet e saj sponsorizuese në kategoritë përkatëse (shih paragrafët AG2–AG6).

Natyra e Rreziqeve

46. Një njësi do të paraqesë informacion në formatin tabelor, përveç rastit kur një format tjetër është më i përshtatshëm, një përmbledhje të:
- (a) Vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve të njohura në pasqyrat e saj financiare në lidhje me interesat e saj në njësitë e strukturuar që nuk janë të konsoliduara;
 - (b) Zërave në pasqyrën e pozicionit financiar në të cilët njihen këta aktive dhe detyrime;
 - (c) Shumës që përfaqëson më mirë ekspozimin maksimal të njësisë ndaj humbjes nga interesat e saj në njësitë e strukturuar që nuk janë të konsoliduara, duke përfshirë mënyrën se si përcaktohet ekspozimi maksimal ndaj humbjes. Nëse një njësi nuk mund të përcaktojë sasinë e ekspozimit të saj maksimal ndaj humbjes nga interesat e saj në njësitë e strukturuar që nuk janë të konsoliduara, ajo do të paraqesë informacion për këtë fakt dhe arsyet; dhe
 - (d) Një krahasim të vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve të njësisë ekonomike që lidhen me interesat e saj në njësitë e strukturuar që nuk janë të konsoliduara dhe ekspozimit maksimal të njësisë ndaj humbjes nga ato njësi.
47. Nëse gjatë periudhës së raportimit një njësi, pa pasur një obligim sipas një marrëveshjeje detyruese për ta bërë këtë, ka dhënë mbështetje financiare ose mbështetje tjetër për një njësi të strukturuar që nuk është e konsoliduar në të cilën ka pasur më parë ose aktualisht ka një interes (për shembull, blerja e aktiveve të ose instrumenteve të emetuara nga njësia e strukturuar), njësia do të paraqesë:
- (a) Llojin dhe shumën e mbështetjes së dhënë, duke përfshirë situatat në të cilat njësia ka ndihmuar njësinë e strukturuar në marrjen e mbështetjes financiare; dhe
 - (b) Arsyet për dhënien e mbështetjes.
48. Një njësi do të japë informacion për çdo synim aktual për të dhënë mbështetje financiare ose mbështetje tjetër për një njësi të strukturuar që nuk është e konsoliduar, duke përfshirë synimet për të ndihmuar njësinë e strukturuar në marrjen e mbështetjes financiare. Këta synime aktualë përfshijnë synimet për të ofruar/dhënë mbështetje si rezultat i obligimeve sipas marrëveshjeve detyruese dhe synimet për të ofruar/dhënë mbështetje kur njësia nuk ka asnjë obligim sipas një marrëveshjeje detyruese.

Interesat Jo të Matshëm të Pronësisë

49. **Një njësi do të paraqesë informacion që u mundëson përdoruesve të pasqyrave të saj financiare të kuptojnë natyrën dhe shtrirjen e çdo interesi pronësie të pamatshëm në njësitë e tjera.**
50. **Në masën që ky informacion nuk është dhënë tashmë në përputhje me këtë Standard, një njësi do të paraqesë, në lidhje me çdo interes pronësie të pamatshëm që është material për njësinë raportuese:**
- (a) **Emrin e njësisë në të cilin ka një interes pronësie; dhe**
 - (b) **Natyra e interesit të tij të pronësisë në njësinë.**

Interesat Kontrolluese të Marra me Qëllimin e Shitjes së tyre

51. **Një njësi, e ndryshme nga një njësi investuese, do të paraqesë informacion rreth interesit të saj në një njësi të kontrolluar kur, në momentin në të cilin u krijua kontrolli, njësia kishte synimin të shiste atë interes dhe, në datën e raportimit, ajo ka një synim aktiv për të shitur atë interes.**
52. Ka një numër situatash në të cilat një njësi e sektorit publik mund të marrë kontrollin e një njësie tjetër, por kur njësia ka një synim aktiv për të shitur/hequr dorë nga të gjithë ose një pjese të interesit të saj kontrollues në të ardhmen e afërt.
53. Për shkak të përgjegjësisë së gjerë të një qeverie për mirëqenien ekonomike të një juridiksioni, ajo mund të ndërhyjë për të parandaluar pasojat e dështimit të një njësie, siç është një institucion financiar. Ndërhyrje të tilla mund të çojnë në marrjen e kontrollit të një qeverie mbi një njësi tjetër, edhe pse ajo nuk ka ndërmend të mbajë kontrollin mbi atë njësi. Përkundrazi, qëllimi i saj mund të jetë të shesë, ose ndryshe të heqë dorë nga, interesi i saj në njësinë e kontrolluar. Nëse njësia tjetër duhet të ristrukturohet për të lehtësuar nxjerrjen e saj jashtë përdorimit, ristrukturimi mund të ndodhë gjatë një periudhe prej një ose më shumë vitesh dhe qeveria mund të mbajë disa aktive ose detyrime të mbetura në fund të procesit. Konsolidimi i njërive të tilla të kontrolluara për periudhat e raportimit në të cilat kontrolli është i pranishëm, mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të konsoliduara. Marrja e kontrollit si rezultat i ndërhyrjeve për të parandaluar dështimin ka më shumë gjasa të ndodhë në kontekstin e qeverive, por mund të ndodhë edhe në rastin e njërive individuale të sektorit publik.
54. Një njësi e sektorit publik mund të fitojë gjithashtu një interes kontrollues në një njësi tjetër, me synimin për të hequr dorë nga i gjithë ose një pjese të atij interesi, në zbatimin e objektivave të politikës së qeverisë. Për shembull, një qeveri mund të drejtojë një njësi për të blerë/marrë disa interesa në njësi të tjera me qëllim rishpërndarjen.

55. **Një njësi do të japë informacionin e mëposhtëm në shënimet në lidhje me çdo njësitë kontrolluar të përmendur në paragrafin 51:**
- (a) **Emrin e njësisë së kontrolluar dhe një përshkrim të aktiviteteve të saj kryesore;**
 - (b) **Arsyen për blerjen e interesit kontrollues dhe faktorët e konsideruar në përcaktimin se kontrolli ekziston;**
 - (c) **Ndikimin në pasqyrat financiare të konsoliduara të konsolidimit të njësisë së kontrolluar duke përfshirë efektin mbi aktivet, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet dhe aktivet/kapitalin neto; dhe**
 - (d) **Statusin aktual të qasjes ndaj shitjes, duke përfshirë metodën e parashikuar dhe kohën e shitjes.**
56. **Informacionet shpjegues të kërkuara nga paragrafi 55 do të jepen në çdo datë raportimi derisa njësia të shesë interesin kontrollues ose të pushojë së pasuri synimin për të shitur atë interes. Në periudhën në të cilën njësia heq dorë nga interesi kontrollues ose ndalon së pasuri synimin për të hequr dorë nga interesi kontrollues, ajo do të paraqesë:**
- (a) **Faktin se ka shitje ose ndryshim në qëllimin e mbajtjes; dhe**
 - (b) **Efektin e shitjes ose të ndryshimit të qëllimit në pasqyrat financiare të konsoliduara.**
57. **Kur informacionet e tjerë shpjegues të kërkuar nga ky Standard ose SNKSP-të e tjera do të ofronin informacion të rëndësishëm për paragrafët 55 ose 56, do të jepet një referencë e kryqëzuar për ato informacione shpjegues të tjerë.**

Dispozitat Kalimtare

58. Një njësi inkurajohet të japë informacionin e kërkuar nga ky Standard më herët nga periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2017. Dhënia e disa prej informacioneve shpjegues të kërkuar nga ky Standard nuk e detyron njësinë të pajtohet me të gjitha kërkesat e këtij Standardi ose të zbatojë SNKSP 34, SNKSP 35, SNKSP 36 dhe SNKSP 37 herët.
59. Kërkesat për dhënie informacionesh shpjegues të këtij Standardi nuk janë të nevojshme të zbatohen për ndonjë periudhë të prezantuar që fillon përpara periudhës vjetore që i paraprin periudhës së parë vjetore për të cilën zbatohet ky Standard.
60. Kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të paragrafëve 40-56 dhe udhëzimi korrespondues në paragrafët AG20-AG25 të këtij Standardi nuk janë të nevojshme të zbatohen për ndonjë periudhë të prezantuar që fillon përpara periudhës së parë vjetore për të cilën zbatohet ky Standard.

Data Efektive

61. Një njësi do të zbatojë këtë Standard për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës 1 janar, 2017. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet.
- 61A. Paragrafët 5 dhe 6 u fshinë nga *Zbatueshmëria e SNKSP-ve*, botuar në prill 2016. Një njësi do t'i zbatojë këta ndryshime për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit 2018. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimet për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të paraqesë informacion shpjegues për këtë fakt.
- 61B. Paragrafi 4 u ndryshua nga SNKSP 39, *Përfitimet e Punonjësve*, botuar në korrik 2016. Një njësi do të zbatojë këtë ndryshim për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2018. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimin për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2018, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe të zbatojë SNKSP 39 në të njëjtën kohë.
- 61C. Paragrafi 4 u ndryshua nga SNKSP 41, në gusht 2018. Një njësi do të zbatojë këtë ndryshim për pasqyrat financiare vjetore që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas 1 janarit, 2022. Zbatimi i mëparshëm inkurajohet. Nëse një njësi zbaton ndryshimin për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar, 2022, ajo do të japë informacion shpjegues për këtë fakt dhe të zbatojë SNKSP 41 në të njëjtën kohë.
62. Kur një njësi zbaton SNKSP-të e kontabilitetit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara siç përkufizohet në SNKSP 33, *Miratimi për Herë të Parë i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) sipas të Drejtave dhe Detyrimeve të Konstatuara*, për qëllime të raportimit financiar pas kësaj date efektive, ky Standard zbatohet për pasqyrat financiare vjetore të njësisë ekonomike që mbulojnë periudhat që fillojnë në ose pas datës së adoptimit të SNKSP-ve.